

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2021**

BULETINI ZYRTAR

PËRMBAJTJA

VENDIME ME OBJEKT - MARRËVESHJE TË NDALUARA

Nr. 762, Datë 22.01.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel Co SHPK”

Nr. 783, Datë 12.03.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”

Nr. 785, Datë 25.03.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë”

Nr. 796, Datë 29.04.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, të zhvilluara nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK”

Nr. 803, Datë 28.05.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregimit me shumicë të vajit vegjetal”

Nr. 806, Datë 04.06.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK”

Nr. 819, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHENIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES PHARMA ONE SHPK”

Nr. 820, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES NEW MEDICAL PLUS SHPK”

Nr. 821, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES MEGAPHARMA SHPK”

Nr. 822, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES CFO PHARMA SHPK”

Nr. 823, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES FLORFARMA SHPK”

Nr. 824, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES AQUARIUS MEDICAL SHPK”

Nr. 825, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE

DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES FLORIFARMA SHPK”

Nr. 826, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE (1) ALDOSCH – FARMA SHPK; (2) AQUILA GROUP SHPK; (3) CAPITAL GROUP SHPK; (4) DELTA PHARMA – AL SHPK; (4) DELTA MED SHPK; (6) EVITA SHPK; (7) FEDOS SHPK; (8) FUFARMA SHA; (9) INCOMED SHPK; (10) MONTAL SHPK; (11) O.E.S DISTRIMED SHPK; (12) R&S FARMA SHPK; (13) REJSI FARMA SHPK; (14) SIROL 2008 SHPK DHE (15) WINPHARMA SHPK NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE”

Nr. 827, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN ALFAMARKOS SHPK”

Nr. 828, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN FARMA NET ALBANIA SHPK”

Nr. 829, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN EUROMED SHPK”

Nr. 830, Datë 02.09.2021

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E

**IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE
MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E
KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN TRIMED SHPK”**

Nr. 837, Datë 29.09.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel CO SHPK”

Nr. 839, Datë 29.09.2021

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

Nr. 772, Datë 11.02.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”

Nr. 804, Datë 04.06.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”

Nr. 812, Datë 02.09.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN-së me detyrime për ndërmarrjet koncesionare PIA SHA, Romano Port SHA dhe Portit MBM”

Nr. 816, Datë 02.09.2021

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ
NDËRMARRJES STAR PARKING SHPK NË TREGUN E MENAXHIMIT
TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË TIRANA INTERNATIONAL
AIRPORT”**

Nr. 853, Datë 24.12.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”

VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

Nr. 760, Datë 14.01.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.”

Nr. 761, Datë 22.01.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.”

Nr. 767, Datë 28.01.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Degës së Ndërmarrjes të shoqërisë Inso – Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A nga shoqëria Fincantieri Infrastrutture S.p.A.”

Nr. 770, Datë 04.02.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.”

Nr. 773, Datë 18.02.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.”

Nr. 788, Datë 01.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”

Nr. 789, Datë 15.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje te përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë MHP Management und IT Beratung GmbH dhe TransnetBW GmbH”

Nr. 790, Datë 15.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.”

Nr. 792, Datë 22.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.”

Nr. 795, Datë 29.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA”

Nr. 805, Datë 04.06.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT MBI SHOQËRINË DIGITAL CHARGING SOLUTION GMBH (JV), NËPËRMJET BLERJES TË AKSIONEVE NGA SHOQËRIA BP EUROPA SE.”

Nr. 808, Datë 10.06.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi shoqërinë SPV, nga shoqëria Bimal d.d. Brčko.”

Nr. 809, Datë 30.06.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ETABLISSEMENTS J. SOUFFLET NGA SHOQËRIA INVIVO GROUP.”

Nr. 810, Datë 30.06.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË THE
BOUNTIFUL COMPANY NGA SHOQËRIA NEXUS HOLDCO, LLC.”

Nr. 811, Datë 30.06.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË
GEOTHERMAL TARGET TWO II SINGLE-MEMBER SA NGA
SHOQËRIA GEOENERGY AEGEAN HOLDING SINGLE-MEMBER
SOCIETE ANONYME”

Nr. 817, Datë 02.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME
FUNKSIONE TË PLOTA (JOINT VENTURE), NGA SHOQËRITË
VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG DHE RIMAC AUTOMOBILI
D.O.O”

Nr. 818, Datë 02.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CHIPITA
INDUSTRIAL AND COMMERCIAL COMPANY S.A NGA SHOQËRIA
MONDELEZ NEDERLAND SERVICES B.V.”

Nr. 831, Datë 23.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT
(JOINT VENTURE), NGA SHOQËRITË ENEL X S.R.L. DHE
VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG SA”

Nr. 832, Datë 23.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SK WIND
GMBH & CO.KG NGA SHOQËRITË STATKRAFT GERMANY GMBH
DHE STATKRAFT HOLDING WIND & SOLAR DEUTSCHLAND
GMBH”

Nr. 833, Datë 23.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BISER
BIDCO S.A.R.L. DHE FILIALIT TË SAJ NOVA KREDITNA BANKA
MARIBOR D.D. NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT.”

Nr. 834, Datë 23.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË GRUPPO
SERVIZI ASSOCIATI S.P.A NGA SHOQËRIA EURIZON CAPITAL SGR
S.P.A”

Nr. 840, Datë 27.10.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË COMPAGNIE DE BANQUE PRIVEE QUILVEST S.A NGA SHOQËRIA FIDEURAM – INTESA SANPAOLO PRIVATE BANKING S.P.A”

Nr. 841, Datë 27.10.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENERGY PLUS SHPK NGA SHOQËRIA DUFERCO POBREG SHPK.”

Nr. 842, Datë 27.10.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË LOOM TECHNOLOGIES GMBH NGA SHOQËRIA TB DIGITAL SERVICES GMBH.”

Nr. 843, Datë 27.10.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CREDIT AGRICOLE SRBIJA A.D NOVI SAD NGA SHOQËRIA RAIFFEISEN BANKA A.D.”

Nr. 845, Datë 16.11.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRIA STELLANTIS N.V DHE SHOQËRIA WONDERFUL STARS PTE.LTD.”

Nr. 846, Datë 16.11.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBCHROME HOLDING SHPK DHE FILIALEVE TË SAJ NGA SHOQËRIA YILDIRIM INTERNATIONAL MINING INVESTMENTS B.V.”

Nr. 847, Datë 16.11.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EUROPCAR MOBILITY GROUP S.A NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG S.A DHE TRINITY INVESTMENTS DESIGNATED ACTIVITY COMPANY.”

Nr. 848, Datë 03.12.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA ENERGY CITY DEVELOPMENT COMPANY DHE COLOUR PATH HOLDINGS LIMITED.”

Nr. 849, Datë 03.12.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRIA SKY UK LIMITED DHE SHOQËRIA PARAMOUNT PICTURES INTERNATIONAL LIMITED”

Nr. 850, Datë 03.12.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË NGA SHOQËRIA EUROSIG SHA.”

VENDIME TË TJERA

Nr. 763, Datë 22.01.2021

“Rrëzimi i kërkesës së shoqërisë Vodafone Albania SHA për rishikimin të vendimit nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK””

Nr. 764, Datë 22.01.2021

“Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Aquarius Medical SHPK”

Nr. 765, Datë 22.01.2021

“Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Florfarma SHPK”

Nr. 766, Datë 22.01.2021

“Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen New Medical Plus SHPK”

Nr. 768, Datë 28.01.2021

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Patos SHA”

Nr. 769, Datë 28.01.2021

“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021”

Nr. 771, Datë 11.02.2021

“Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, i ndryshuar”

Nr. 774, Datë 04.03.2021

“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK”

Nr. 775, Datë 04.03.2021

“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes R&S Farma SHPK”

Nr. 776, Datë 04.03.2021

“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK”

Nr. 777, Datë 04.03.2021

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 719, datë 28.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve””

Nr. 778, Datë 04.03.2021

“Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””

Nr. 779, Datë 04.03.2021

“Mbi monitorimin e vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo” për periudhën 2019-2020 dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Nr. 780, Datë 04.03.2021

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në ankandin publik me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia”, zhvilluar nga Bashkia Shkodër”

Nr. 782, Datë 12.03.2021

“Për dhënie rekomandimi ndaj ndërmarrjes KESH SHA lidhur me shprehjen e interesit të Shoqërisë “Noa Energy Trade” SHPK për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA”

Nr. 784, Datë 12.03.2021

“Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”

Nr. 786, Datë 25.03.2021

“Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”

Nr. 787, Datë 25.03.2021

“Për rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Florfarma” SHPK për revokimin e vendimit nr.765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK””

Nr. 791, Datë 15.04.2021

“Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 676 datë 07.02.2020
“Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria

Vodafone Albania SHA” dhe vendimit nr.759, datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” të Komisionit të Konkurrencës”

Nr. 793, Datë 22.04.2021

“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD”

Nr. 794, Datë 27.04.2021

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatimin e masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore””

Nr. 797, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë IUTECREDIT ALBANIA SHA për rivlerësimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Nr. 798, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë UNIONI FINANCIAR TIRANË SHA për shfuqizimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Nr. 799, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë FONDI BESA SHA për shfuqizimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Nr. 800, Datë 21.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë ÇAÇA SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 ‘Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”

Nr. 801, Datë 21.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë AGRO BLEND SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 ‘Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”

Nr. 802, Datë 21.05.2021

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen Ujësjetës Kanalizime Sarandë SHA”

Nr. 813, Datë 02.09.2021

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 707 DATË 23.09.2020 “PËR HAPJEN E HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE, I NDRYSHUAR”

Nr. 814, Datë 02.09.2021

“Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”

Nr. 815, Datë 02.09.2021

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 28.05.2021 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”

Nr. 835, Datë 23.09.2021

“PËR MBYLLJEN E HETIMIT TË PËRGJITHSHËM NË TREGUN E SHËRBIMEVE SPITALORE DHE DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE”

Nr. 836, Datë 23.09.2021

“Për dhënien e disa rekomandimeve Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ndërmarrjes Koncesionare “Mbi zbatimin e kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)””

Nr. 838, Datë 29.09.2021

“Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)””

Nr. 844, Datë 27.10.2021

“Mbi mospranimin e ankesës së ITD SHPK për ndryshimin e VKK nr. 814/2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”

Nr. 851, Datë 03.12.2021

“Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”

Nr. 852, Datë 24.12.2021

“Për dhënie rekomandimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe dhënie detyrimi Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për rritjen e konkurrencës në ofrimin e shërbimit të auditimit ligjor”

AKTE TË MIRATUARA NË ZBATIM TË PKIE 2021-2023

Nr. 781, Datë 12.03.2021

“Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e 4 dhe 9 të Ligjit Nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve””

Nr. 807, Datë 10.06.2021

“Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 760, Datë 14.01.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

Sipas Marrëveshjes Kuadër nënshkruar më datë 23 nëntor 2020 palët në transaksion janë:

Pala Blerëse: Unione di Banche Italiane SPA është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionin Italian. Aktiviteti i saj fokusohet veçanërisht tek menaxhimi i portofolit të klientëve individë.

Unione di Banche Italiane SPA zotërohet 100% nga shoqëria Intesa Sanpaolo SPA, shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania ShA

Target: Aviva Vita SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë, e cila operon si një shoqëri sigurimi, ekskluzivisht në shtetin italian.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: Aviva Italia Holding SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Objekti i shoqërisë është ofrimi i sigurimeve të kredisë, mbrojtje investimesh, bono dhe politika të sigurimit të jetës.

Shitësi 2: Aviva Italia SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Objekti i shoqërisë është ofrimi i sigurimeve të kredisë, mbrojtje investimesh, bono dhe shërbime të tjera sigurimi, risigurime dhe menaxhim fondesh etj.

Analiza e konkurrencës

Mbështetur mbi dokumentacionin e depozituar, transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkon autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i sigurimeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfshirë në kontrollin të shoqërisë Aviva Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A. Unione di Banche Italiane S.p.A pas transaksionit do të marrë kontrollin e plotë të shoqërisë Aviva Vita S.p.A e cila është aktive në tregun e sigurimeve të jetës ekskluzivisht në Itali.

Aviva Vita S.p.A nuk është prezent në tregun shqiptar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Unione di Banche Italiane S.p.A. realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar nga Grupi Intesa Sanpaolo, bankës Intesa Sanpaolo Albania SHA, e cila është aktive në tregun e shërbimeve bankare.

Përqendrimi i njoftuar realizohet mes palëve që operojnë në tregje të ndryshme duke mos krijuar mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë efekt në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 761, Datë 22.01.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.

Sipas Marrëveshjes Kuadër nënshkruar më datë 23 Dhjetor 2020 palët janë:

Pala Blerëse: Unione di Banche Italiane S.p.A është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionin Italian. Aktiviteti i saj fokusohet veçanërisht te menaxhimi i portofolit të klientëve individë.

Unione di Banche Italiane S.p.A zotërohet 100% nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A, shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Target: Lombarda Vita S.p.A është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionin Italian, e cila operon si një shoqëri sigurimi, ekskluzivisht në shtetin italian.

Pala Shitëse: Societa Cattolica di Assicurazione – Societa Cooperativa është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian dhe operon si një shoqëri sigurimi.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i sigurimeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A. Unione di Banche Italiane S.p.A pas transaksionit do të marrë kontrollin e plotë të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A e cila është aktive në tregun e sigurimeve të jetës ekskluzivisht në Itali.

Unione di Banche Italiane S.p.A është pjesë e Grupit Financiar Intesa Sanpaolo, i cili realizon të ardhura në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Lombarda Vita S.p.A nuk është prezent në tregun shqiptar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar realizohet mes palëve që operojnë në tregje të ndryshme duke mos krijuar mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë efekt në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 762, Datë 22.01.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel Co SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e “Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, si dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbi disa praktika abuzive, me qëllim shtrembërimin dhe kufizimin e konkurrencës gjatë pjesëmarrjes

në procedurat e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve të zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), Posta Shqiptare, UKT, OSHEE dhe UKD, filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të vlerësimit të ankesës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me anë të Vendimit nr. 708, datë 23.09.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”, vendosi: hapjen e procedurës së hetimit Paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga 1 Janari 2018 deri në Dhjetor 2019.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga Autoritetet Kontraktore: AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

4. Në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
5. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, *tregu përkatës produkti është tregu i prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve, si printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj., të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.*
6. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, *tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet Tregu i prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD në*

zonën urbane më të populluar të RSH, Tiranë dhe Durrës, me shtrirje të produktit të shërbyer në tërë territorin e RSH.

II.2 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

7. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, është analizuar dhe vlerësuar dokumentacioni dhe të dhënat e administruara nga Autoritetet Kontraktore: AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.
8. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike (OECD - GUIDELINES FOR FIGHTING BID RIGGING IN PUBLIC PROCUREMENT), e cila është përshtatur në shqip nëpërmjet Udhëzuesit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, të Autoritetit të Konkurrencës.
9. Bazuar në këtë metodologji është vlerësuar sjellja e ndërmarrjeve (Operatorëve Ekonomik) nëse janë përfshirë në ndonjërin prej skemave të marrëveshjeve në oferta.
10. Nga përpunimi dhe vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë hetimit paraparak, rezultoi se:
 - a) Ndërmarrjet përdorin skemën e ofertës së përmbajtur duke rënë dakord që të përmbahen nga oferta dhe të mbështesin njëra-tjetërën me makineri/pajisje shtypshkrimi për qëllime kualifikimi dhe fitimin e procedurës së prokurimit, sjellje e cila vihet re në tenderat e mëposhtëm:
 - Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, viti 2018, me objekt: “Blerje Shtypshkrimesh”, me fond limit 44.607.547 lekë pa tvsh, ku ndërmarrja Inpress SHPK ka shprehur interes për këtë procedurë duke u ankuar mbi kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë duke lejuar ofertuesin Marketing&Distribution SHPK të ofertoj me makineri/pajisje shtypshkrimi të marra me qira nga vetë Inpress SHPK;
 - Në tenderin e zhvilluar nga AKBPM, viti 2018, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 16.915.000 lekë pa TVSH, ku Euroform SHPK ka shprehur interes për këtë procedurë pasi është ankuar pranë Autoritetit Kontraktor mbi kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë duke lejuar ofertuesin Kristalina KH SHPK të ofertojë me makineri/pajisje shtypshkrimi të marra me qira nga vetë Euroform SHPK;
 - Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, viti 2019, me objekt: “Blerje Shtypshkrimesh”, me fond limit 76.008.765,68 Lekë pa TVSH, ndërmarrjet Interlogistic, Inpress dhe Marketing&Distribution në fazën e përllogaritjes së fondit limit kanë paraqitur oferta me çmime zërash të njëjta. Në fazën e zhvillimit të procedurës ofertuesit Interlogistic SHPK dhe Inpress SHPK kanë ofertuar si

bashkim operatorësh ekonomik, ndërkohë që OE Marketing&Distribution SHPK nuk ka paraqitur ofertë;

- Në tenderi e zhvilluar nga UKD, 2019-2020, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”, me fond limit: 6,330,816 ku M&D ka shprehur interes në këtë procedurë pasi është ankuar pranë Autoritetit Kontraktor mbi kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë, ndërkohë që hyn si ofertues Inpress duke paraqitur për qëllime kualifikimi fatura tatimore shitje me blerës ndërmarrjen Marketing&Distribution dhe Interlogistic për materiale shtypshkrimesh;
 - Në tenderin e zhvilluar nga OSHEE SHA, viti 2019-2020, me objekt: “Printim i faturës të energjisë elektrike dhe zarfimi në versionin Selfmailer”, me fond limit 44.460.000 Lekë pa TVSH, vihet re se ndërmarrja Inpress SHPK, ka shprehur interes për procedurën e prokurimit dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë ekonomike duke i dhënë me nënqira Interlogistic SHPK makineri/pajisje shtypshkrimi, për qëllime kualifikimi në tender.
- b) Ndërmarrjet nën hetim përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili do paraqesë ofertën fituese në procesin e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, si dhe duke mbështetur njëra-tjetrën nëpërmjet paraqitjes së ofertave fiktive të cilat përmbajnë terma specifike të papranueshme nga blerësi (autoriteti kontraktor), me qëllim krijimin e përshtypjes së një oferte të pastër dhe një konkurrence të singertë, sjellje e cila vihet re në tenderat e mëposhtëm:
- Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, viti 2018, me objekt: “Blerje Shtypshkrimesh”, me fond limit 44.607.547 lekë pa tvsh, ku ndërmarrjet: M&D SHPK, Albdesign PSP SHPK dhe Kristalina KH ofertojnë me vlera prej 93%, 92% dhe 95% të fondit limit (këtu e në vijim FL);
 - Në tenderin e zhvilluar nga Ujësjelles Kanalizime Tirane SHA, viti 2018, me objekt: “Shërbim Printim fatura Uji”, me fond limit 4,362,938 lekë pa TVSH, ku ofertues janë vetëm ndërmarrjet Kristalina KH dhe ADPSP (Inform Albania) me vlera oferte përkatësisht prej 99% dhe 100% të FL dhe fiton ADPSP (Inform Albania) me 99%;
 - Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, viti 2019, me objekt: “Prodhimi i Emisioneve të Pullës për vitin 2019”, me fond limit: 8,319,625 lekë pa TVSH, ku vihet re se ndërmarrjet Kristalina KH dhe Albdesign PSP kanë ulur vlerën e ofertës së paracaktuar si fituese në 83% të FL, ndërkohë që kur ofertojnë të vetme vlerat e ofruara prej tyre janë mbi 90% të FL. Fitues është shpallur Kristalina KH me 83% të FL, mbështetur nga Albdesign PSP me 96% të FL;
 - Në tenderin e zhvilluar nga OSHEE, viti 2019-2020, me objekt: “Printim i faturës të energjisë elektrike dhe zarfimi në versionin Selfmailer”, me fond limit 44.460.000 Lekë pa TVSH, OE Inform Albania SHPK në procedurën e anuluar, zhvilluar në datën 21.10.2019, ka ofertuar i vetëm, me 94% të FL, ndërkohë që për të njëjtin objekt prokurimi, në procedurën e zhvilluar në datën 07.02.2020, ky operator ka ofertuar me 98% të FL (4% më shumë) edhe pse pjesëmarrja është

me e madhe (Adel CO me rreth 100% të FL dhe Interlogistic SHPK me 91% të FL). Oferta e Inform Albania është shpallur edhe oferta fituese e këtij tenderi.

c) Në rastet kur ofertues janë vetëm ndërmarrjet në marrëveshje, ofertat e paraqitura janë shumë afër fondit limit dhe ndryshojnë shumë pak nga njëra-tjetra, duke realizuar objektivin e rritjes se ofertes fituese dhe si rezultat dhe shumës që fituesi i ofertës do të marrë. Ndërsa kur pjesëmarrja e ofertuesve është më e madhe, vlerat e ofertave të paraqitura janë shumë më të ulëta në raport me fondin limit. Kjo sjellje vihet re në tenderat e mëposhtëm:

- Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, viti 2018, me objekt: “Prodhim i emisioneve të pullës postare, viti 2018”, me fond limit 10.000.000 lekë pa TVSH, ofertues janë: Adel Co me 95% të FL; Kristalina KH me 79% të FL dhe Albdesign PSP me 75% të FL. Vihet re se ofetat e paraqitura nga Albdesign PSP SHPK dhe Kristalina KH ndryshojnë shumë pak nga njëra-tjetëra dhe janë shumë më të ulëta në raport me fondin limit (75 % dhe 79%) se sa në rastet kur në tender janë pjesëmarrëse vetëm këto ndërmarrje. Fitues është shpallur oferta e Adel Co SHPK me 95% të FL.
- Në tenderin e zhvilluar nga AKBPM, viti 2018, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 16.915.000 lekë pa TVSH, ofertues janë: Albdesign PSP me 70.61% të FL; Kristalina KH SHPK me 73.89% të FL; Cetis Graphic and Documentation Services me 58.85% të FL; dhe Adel CO me 89.44% të FL. Ofetat e paraqitura nga ndërmarrjet: Albdesign PSP SHPK dhe Kristalina KH nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetëra dhe paraqiten me vlera të ulëta 70-74% të FL, ndërkohë që kur ofertojnë të vetme vlerat e ofruara prej tyre janë mbi 90% të FL.
- Në tenderin e zhvilluar nga OSHEE SHA, viti 2018, me objekt: “Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE SHA”, me fond limit 57.704.400 lekë pa tvsh, ofertues janë: ADPSS (Inform Albania) me 77% të FL; Kristalina KH, me 81% të FL dhe Adel CO me 92% të FL. Vihet re se ndërmarrjet Kristalina KH, me ofertë 81% të FL, dhe ADPSS (Inform Albania), me ofertë 77% të FL, kanë ulur vlerën e ofertës së paracaktuar si fituese 77% të FL, ndërkohë që kur ofertojnë të vetme vlerat e ofruara prej tyre janë mbi 90% të FL. Fitues është shpallur ADPSS (Inform Albania) me 77% të FL.

Sa më sipër, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK; Albdesign PSP SHPK; Kristalina.KH SHPK; Euroform SHPK; Interlogistic SHPK; Marketing & Distribution SHPK; Inpress SHPK; Adel CO SHPK, në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK; Albdesign PSP SHPK; Kristalina.KH SHPK; Euroform SHPK; Interlogistic SHPK; Marketing & Distribution SHPK; Inpress SHPK dhe Adel CO SHPK.
2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në 31.12.2019.
3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 763, Datë 22.01.2021

“Rrëzimi i kërkesës së shoqërisë Vodafone Albania SHA për rishikimin të vendimit nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Rishikim i pikës 2 të vendimit nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.

Baza Ligjore: Neni 12, pika 2, neni 24 germa d); neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; nenet 144-146 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Rregullorja “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej tyre”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë Vodafone Albania SHA për rishikim vendimi nr. 758, datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK”, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK dhe për shkelje të nenit 12, pika 2 i ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, vendosjen e gjobës mbi shoqërinë ABCom SHPK në masën 0.2 % e xhiros së vitit 2019 ose 3,986,270 (tre milion e nëntëdhjete e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë.

Shoqëria Vodafone Albania SHA (shoqëria përthithëse e ABCom SHPK), kërkoj nga Komisioni i Konkurrencës, rishikimin e pikës 2 të vendimit nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK, me qëllim pakësimin e masës së gjobës dhënë shoqërisë ABCom SHPK, me pretendimin se vonesat në njoftimin e rastit janë influencuar nga situata e krijuar prej pandemisë, e cila “shkaktoi

natyrshëm pasoja në drejtim të menaxhimit të rregullt të komunikimeve me palët e treta, përfshi këtu dhe autoritetet rregullatorë”.

Gjatë periudhës kur Qeveria Shqiptare, shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore (24 mars - 23 qeshor) për shkak të pandemisë Sars-Cov 2, Autoriteti i Konkurrencës ka funksionuar në mënyrë të plotë duke regjistruar dhe vlerësuar çdo shkresë nga si institucionet publike, ashtu edhe nga subjektet juridike private.

Njoftimi jashtë afateve të parashikuara në ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, nuk ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të AK, por është një sjellje e shoqërisë njoftuese ABCom SHPK dhe pretendimi i ngritur nga shoqëria Vodafone Albania SHA nuk qëndron.

Shkelja e nenit 12 pika 2 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, konsiderohet kundravajtje administrative dhe sanksioni parashikohet sipas nenit 73, pika 1, germa dh) të ligjit, në masën jo më shumë se 1% e xhiros totale të vitit paraardhës financiar.

Pretendimi i shoqërisë Vodafone, se përcaktimi i gjobës nuk është në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2012 “Për kundravajtjet administrative”, nuk qëndron. Përcaktimin e gjobës për shkelje të ligjit të konkurrencës, bazohet në ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij: Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” miratuar më VKK nr. 165 datë 14.12.2010, dhe Rregullorja “Për Gjjobat dhe Lehtësimin prej tyre” miratuar me VKK nr.120 datë 10.09.2009.

Kërkesën për rishikim të vendimit, shoqëria Vodafone e mbështet në nenin 144, pika 2 Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin parashikohet shprehimisht se: “*Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ*”. Gjatë hetimit administrativ, rezultoi se kërkuesi nuk paraqiti as edhe një provë të re për çështjen, dhe as nuk faktoi krijimin e ndonjë rrethane të re, të cilat mund të ndikonin në rishikimin e vendimit të KK, sipas përcaktimeve të K.Pr.A.

Gjoba në masën 0.2% të xhiros është llogaritur duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- njoftimi është bërë me iniciativën e palës, pavarësisht mos-respektimit të afatit ligjor **0.1%**
- Periudha e mos njoftimit (mars-korrik 2020)
+0.05%
- Përqendrimi vlerësohet si përqendrim horizontal
+0.05%

Në zbatim të nenit 15, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003 vlera e xhiros së ndërmarrjes është llogaritur si më poshtë:

Xhiro vjetore e shoqërisë ABCom SHPK për vitin 2019	XXX lekë
Xhiro ne tregun e transmetimeve televizive	XXX lekë
Totali i tatim-taksave	XXX lekë

Xhiro e shoqërisë pas taksave/tatimeve

XXX lekë

Masa e gjobës në përqindje

0.2%

Vlera e gjobës në lekë

3,986,269 lekë

Fitimi i shoqërisë

XXX lekë

Vlera e gjobës së vendosur në VKK nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK”, përbën 0.67% të xhiros në tregun përkatës të produktit (tregun e transmetimeve televizive), shumë e vogël krahasuar me vlerën bazë të llogaritjes së gjobës sipas Rregullores “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej tyre” (30% e xhiros në tregun përkatës të produktit).

Shoqëria ABCom SHPK nuk është në kushtet e pamundësisë së aftësisë paguese të gjobës, pasi rezulton të jetë me rezultat financiar pozitiv për vitin 2019.

Në bazë të nenit 80 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, gjoba është titull ekzekutiv dhe si e tillë ekzekutohet sipas dispozitave të K.Pr.C.

Për sa më sipër, pretendimet e shoqërisë Vodafone Albania SHA, se gjoba e vendosur është *diskriminuese, joproporcionale dhe e pa precedent*, nuk mbështeten në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 12 pika 2, nenit 24 germa d), nenit 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; neneve 144-146 të K.Pr.A.; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, dhe Rregullorja “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej tyre”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë Vodafone Albania SHA për rishikimin të pikës 2 të vendimit nr. 758 datë 28.12.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 764, Datë 22.01.2021

“Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Aquarius Medical SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Aquarius Medical SHPK

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, neni 67, neni 74, pika 1, germa (b), neni 75, pika 1 dhe neni 76, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003), Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e zbatimit të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- 2- Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:

- a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
- 3- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave
 - 4- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
 - 5- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
 - 6- Bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 prot., datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50prot., datë 19.10.2020, u kryen inspektim pranë ndërmarrjes, Aquarius Medical SHPK.
 - 7- Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35

dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.

- 8- Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, rezulton se ndërmarrja Aquarius Medical SHPK:
- 9- Ka realizuar shitje të produktit maska (*Maska kirurgjikale me llastik, Maska goje FFP1 dhe Maska kirurgjikale antibakteriale pa valvul*) për periudhën janar – nëntor 2020 me një total prej 856 221 copë.
- 10- Ka realizuar shitje të produktit *Maskë kirurgjikale me llastik* me një total prej 584 564 copë për periudhën janar – nëntor 2020. Në janar 2020 është blerë mesatarisht me 2.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 3.7 lekë/copë. Në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 2.5 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 5.8 lekë/copë. Në mars 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 36 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 67.7 lekë/copë. Në maj 2020 është blerë mesatarisht me 31.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 44.7 lekë/copë. Në qershor 2020 është blerë mesatarisht me 35.4 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 39.5 lekë/copë. Në korrik 2020 është blerë mesatarisht me 20.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 29.2 lekë/copë. Në gusht 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje, por është shitur mesatarisht me 37.5 lekë/copë. Gjithashtu në shtator 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje, megjithatë produkti është shitur mesatarisht me 21.3 lekë/copë. Në tetor 2020 është blerë mesatarisht me 5.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 16.5 lekë/copë. Në nëntor 2020 nuk janë realizuar blerje për këtë produkt por është shitur mesatarisht me 10.3 lekë/copë. Për produktin Maskë kirurgjikale me llastik konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës prill 2020.
- 11- Ka realizuar shitje të produktit *Maska goje FFP1* me një total prej 32 349 copë, për periudhën shkurt – nëntor 2020. Në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 95.2 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 118.4 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mesatarisht me 79.1 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 582.3 lekë/copë. Për këtë produkt, në prill 2020 nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 291.7 lekë/copë. Gjatë periudhës maj – tetor 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në nëntor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 156.4 lekë/copë. Për produktin Maska goje FFP1 konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës shkurt – mars 2020.
- 12- Ka realizuar shitje të produktit alkool (*Alkool i denatruar 70% 1 L, Alkool Spray 70% 100 ml (Aqua Medical), Alkool Spray 96% 100 ml (Aqua Medical) dhe Alkool etilik i denatruar 96% 1L*) për periudhën janar – nëntor 2020 me një total prej 12 073 njësi.
- 13- Ka realizuar shitje të produktit *Alkool Denatruar 70% 1L* me një total prej 2 420 njësi, për periudhën janar – nëntor 2020. Në janar 2020 është blerë mesatarisht me 183.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 250 lekë/copë. Në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 183.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 215.3 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mesatarisht me 179 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 296.7 lekë/copë. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 198.9 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 349.6 lekë/copë. Në maj 2020 është blerë mesatarisht me 291.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 346.4 lekë/copë. Në qershor 2020 është blerë mesatarisht

me 217.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 248.9 lekë/copë. Në korrik 2020 është blerë mesatarisht me 216.9 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 296.7 lekë/copë. Në gusht 2020 është blerë mesatarisht me 216 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 312.7 lekë/copë. Në shtator 2020 është blerë mesatarisht me 214.1 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 279.7 lekë/copë. Në tetor 2020 është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 291 lekë/copë. Në nëntor 2020 është blerë mesatarisht me 183.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 242.3 lekë/copë. Për produktin Alkool Denatyrar 70% 1L konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës mars – prill dhe gusht 2020.

- 14- Ka realizuar shitje te produktit Produkti *Alkool Spray 96% 100 ml (Aqua Medical)* me një total prej 1 557 njësi, për periudhën shkurt – prill 2020. Në shkurt 2020 për këtë produkti janë realizuar vetëm blerje me një çmim mesatar prej 200 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mestarisht me 166.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 180.4 lekë/copë. Në prill 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 250 lekë/copë. Për produktin Alkool Spray 96% 100 ml (Aqua Medical) konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës mars – prill 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 germa d, nenin 26, nenin 42, nenin 44, nenin 74, pika 1, germa (b), dhe nenin 75 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Gjobitjen e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 765, Datë 22.01.2021

“Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Florfarma SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Florfarma SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, neni 67, neni 74, pika 1, germa (b), neni 75, pika 1 dhe neni 76, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003), Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e zbatimit të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- 2- Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me

pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:

- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
- 3- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave
- 4- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
- 5- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

- 6- Bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 prot., datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 prot., datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjes Florfarma SHPK.
- 7- Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
- 8- Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, rezulton se ndërmarrja Florfarma SHPK:
- 9- Ka realizuar prodhim dhe shitje vetëm të produktit alkool 70% (*ALKOOL 0.1 LIT 70% dhe ALKOOL 1 LIT 70%*) për periudhën janar – nëntor 2020 me një total shitjesh prej 76 838 njësi.
- 10- Ka realizuar shitje të produktit *Alkool 1L 70%* me një total prej 17 709 njësi në periudhën janar- nëntor 2020. Në janar 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 190.7 lekë/njësi. Në shkurt 2020 është prodhuar me 159.2 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 205.6 lekë/njësi. Në mars 2020 është prodhuar me 205.5 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 243.8 lekë/njësi. Në prill 2020 është prodhuar me 349.3 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 267.3 lekë/njësi. Në maj 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 390.4 lekë/njësi dhe në qershor 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 381.9 lekë/njësi. Në korrik 2020 është prodhuar me 249.1 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 390.1 lekë/njësi. Në gusht 2020 është prodhuar me 249.1 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 391.5 lekë/njësi. Në shtator 2020 është prodhuar me 249.1 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 382.5 lekë/njësi. Në tetor 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 392.6 lekë/njësi dhe në nëntor 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 394.4 lekë/njësi. Për produktin *Alkool 1L 70%* konstatohet rritje e çmimit përgjatë periudhës janar – nëntor 2020.
- 11- Ka realizuar prodhim dhe shitje të vetëm të produktit gel dezinfektant me emërtim tregtar “Bactiflor” (*BACTIFLOR 95 ML dhe BACTIFLOR 1 LITER*) për periudhën janar – nëntor 2020 me një total shitjesh prej 60 977 njësi.
- 12- Ka realizuar shitje të produktit *BACTIFLOR 1L ML* me një total prej 18 961 njësi në periudhën janar- nëntor 2020. Në janar 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 458.3 lekë/njësi. Në shkurt 2020 është prodhuar me 333.9 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 451.4 lekë/njësi. Në mars 2020 është prodhuar me 380.8 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 505 lekë/njësi. Në prill 2020 është prodhuar me 441.8 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 529.3 lekë/njësi. Në maj 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 550.7 lekë/njësi. Në qershor 2020 nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 556.6 lekë/njësi. Në korrik 2020 është prodhuar me 366.6 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 594.2

lekë/njësi. Në gusht 2020 është prodhuar me 366.6 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 550.7 lekë/njësi. Në shtator 2020 është prodhuar me 366.6 lekë/njësi dhe është shitur mesatarisht me 598.9 lekë/njësi. Në tetor 2020 ky produkt nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 599.1 lekë/njësi dhe në nëntor 2020 ky produkt nuk rezulton se është prodhuar por produkti gjatë këtij muaji është shitur mesatarisht me 596.5 lekë/njësi. Për produktin *BACTIFLOR 1L ML* konstatohet rritje e çmimit përgjatë periudhës janar – nëntor 2020.

13- Ndërmarrja Florfarma SHPK nuk ka realizuar shitje të produktit maskë për periudhën janar – nëntor 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 germa d, nenin 26, nenin 42, nenin 44, nenin 74, pika 1, germa (b), dhe nenin 75 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Gjëbjetjen e ndërmarrrjes Florfarma SHPK për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrrjes Florfarma SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 766, Datë 22.01.2021

“Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen New Medical Plus SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen New Medical Plus SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, neni 67, neni 74, pika 1, germa (b), neni 75, pika 1 dhe neni 76, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003), Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e zbatimit të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- 2- Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me

pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:

- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
- 3- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave
- 4- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
- 5- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

- 6- Bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 prot., datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 prot., datë 19.10.2020, u kryen inspektim pranë ndërmarrjes, New Medical Plus SHPK.
- 7- Sipas procesverbalit për marrje shpjegimesh me pyetje-përgjigje në përputhje me nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, u morën në dorëzim dokumentat dhe provat materiale të kërkuara nga grupi i inspektimit.
- 8- Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, rezulton se ndërmarrja New Medical Plus SHPK:
- 9- Ka realizuar shitje të produktit maska (*Maska te thjeshta; Maska; Maska f; Maska goje me valvul 3M 8210 A9231 MGV3M; Maska goje me valvul RP07 A 1630; Maska hunde me valvul VIC822VFFP2; Maska hunde pa valvul FFP2; Maska Kirurgjikale; Maska Kirurgjikale me llastik; Maska Kirurgjikale me llastik x 100 cope/kuti; Maska Kirurgjikale me llastik x 50 cope/kuti; Maska nje perdorimshe; Maska pelhure; Maska tekstile me ngjyre te celet; Maske goje me valvul; Maske goje me valvul me ffp1; Maske goje me valvul FFP2; Maske goje me valvul FFP3; Maske goje pa valvul ffp1; Maske goje pa valvul ffp2 dhe Maske Profesionale per mbrojtjen e fytyrës*) për periudhën janar – nëntor 2020 me një total prej 682 651 copë.
- 10- Ka realizuar shitje të produktit *Maske Goje me Valvul (FFP2)* me një total prej 23 294 copë në periudhën janar- nëntor 2020. Në janar 2020, ky produkt është blerë me çmim mesatar 250 lekë/copë dhe për këtë muaj nuk ka realizuar shitje. Në shkurt 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 253.4 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 287.7 lekë/copë. Në muajt në vazhdim mars - nëntor 2020 nuk ka realizuar blerje për produktin Maske Goje me Valvul (FFP2). Në mars 2020 është shitur mesatarisht me 373.3 lekë/copë. Në prill 2020 është shitur mesatarisht me 373.3 lekë/copë. Në maj 2020 është shitur mesatarisht me 333.3 lekë/copë. Në muajin qershor është shitur mesatarisht me 403.9 lekë/copë. Në korrik 2020 ky produkt është shitur mesatarisht me 333.3 lekë/copë. Në muajin gusht 2020 është shitur mesatarisht me 333.3 lekë/copë. Në muajin shtator - tetor nuk ka realizuar shitje. Në muajin nëntor 2020 është shitur mesatarisht me 208.3 lekë/copë. Për produktin Maskë Goje me Valvul (FFP2) konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës shkurt - prill dhe qershor 2020.
- 11- Ka realizuar shitje të produktit alkool (*Alkool etilik i cnatyruar 70, perdorim i jashtëm, 750 ml me mekanizëm; Alkool; Alkool 70% 1L; Alkool 90% 1L; Alkool etilik i denatyruar 70% 1L me trigger spray; Alkool etilik i denatyruar 70% 100ml dhe Alkool etilik i denatyruar 70% 750 ml*) për periudhën janar – nëntor 2020 me një total prej 9 070 njësi.
- 12- Ka realizuar shitje të produktit *Alkool 70% 1L* me një total prej 8 801 njësi në periudhën shkurt - nëntor 2020. Në muajin janar 2020 nuk janë realizuar blerje dhe shitje për këtë produkt. Në shkurt 2020 është blerë mesatarisht me 192 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 249.1 lekë/copë. Në mars 2020 është blerë mesatarisht me 222.6 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 316 lekë/copë. Në prill 2020 është blerë mesatarisht me 275.1 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 405.8 lekë/copë. Në muajin maj është blerë mesatarisht me 233

lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 340.5 lekë/copë. Në qershor 2020 është blerë mesatarisht me 233 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 295.5 lekë/copë. Në muajin korrik nuk ka realizuar blerje por ky produkt është shitur mesatarisht me 264.5 lekë/copë. Në muajin gusht 2020 nuk ka realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 282.7 lekë/copë. Në shtator 2020 është blerë mesatarisht me 225 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 288.8 lekë/copë. Në muajin tetor 2020 është blerë mesatarisht me 212 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 279.9 lekë/copë. Në nëntor 2020 është blerë mesatarisht me 216.6 lekë/copë dhe shitur mesatarisht me 291.3 lekë/copë. Për produktin Alkool 70 1L konstatohet rritje e çmimit gjatë periudhës mars - prill 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 germa d, nenin 26, nenin 42, nenin 44, nenin 74, pika 1, germa (b), dhe nenin 75 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Gjobitjen e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, përkatësisht në shumën 1 000 000 (një milion) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK të zbatojë nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 767, Datë 28.01.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Degës së Ndërmarrjes të shoqërisë Inso – Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A nga shoqëria Fincantieri Infrastrutture S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Degës së Ndërmarrjes të shoqërisë Inso - Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A nga shoqëria Fincantieri Infrastrutture S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të Degës së Ndërmarrjes të shoqërisë Inso - Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A nga shoqëria Fincantieri Infrastrutture S.p.A.

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të Degës së Ndërmarrjes të shoqërisë Inso - Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A nga shoqëria Fincantieri Infrastrutture S.p.A.

Sipas 2(dy) “Kontratave për shitblerjen e degës së ndërmarrjes”, palët në transaksion janë:

Blerësi1: Fincantieri Infrastrutture S.p.A., është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, me seli në Trieste, e cila është e specializuar në projektimin, realizimin dhe montimin e strukturave prej çeliku të projekteve me përmasave të mëdha si ura, stadione, porte si dhe projekte industriale, tregtare dhe institucionale.

Fincantieri Infrastrutture S.p.A, kontrollohet tërësisht nga Fincantieri S.p.A. Fincantieri S.p.A, dhe është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, e kuotuar në Bursën Italiane. Fincantieri operon kryesisht në sektorin e ndërtimit të anijeve civile dhe ushtarake.

Blerësi2: Sviluppo Imprese Centro Italia SGR S.p.A, është një shoqëri e themeluar në vitin 1998 në Firenze, Itali, me iniciativën e Fidi Toscana, MPS Capital Services, CR Firenze dhe CR Lucca-Pisa-Livorno si një mjet eksperimental dhe i përbashkët për të vepruar në fushën e Kapitalit Privat.

Shitësi: Inso – Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, aktive në projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturave në sektorin e kujdesit shëndetësor, si dhe instalimin, transformimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe shërbimeve të objekteve dhe infrastrukturave të kujdesit shëndetësor në përgjithësi.

Target: Dega e Ndërmarrjes – Inso, është një shoqëri me kapital aksionar, e zotëruar 100% nga INSO. Dega e Ndërmarrjes – Inso përfshin personelin, brand dhe know-how të INSO, të gjithë kapitalin aksionar të Sof S.p.A dhe kuotat e pjesëmarrjes të mbajtura nga INSO.

Shitësi kryen veprimtari në mënyrë të tërthortë në Shqipëri, nëpërmjet pjesëmarrjes 100% në kapitalin e shoqërisë Inso Albania SHPK, shoqëri e cila vepron në fushën e projektimit dhe ndërtimit me çelësa në dorë të zyrave dhe infrastrukturave në veçanti në sektorin sanitar, projektimin, furnizimin, instalimin e paketave të veglave elektromjeksore dhe të mirëmbajtjes së tyre, etj.

Më datë 22 dhjetor 2020, janë nënshkruar 2(dy) “Kontrata për shitblerjen e degës së ndërmarrjes”, nëpërmjet palës blerëse Fincantieri Infrastrutture S.p.A. dhe palës shitëse Inso - Inso-Sistemi Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A në Administrim të Jashtëzakonshëm. Në kontratën e dytë është përfshirë edhe projekti Vimercate dhe Projektet e Patransferuara.

Pas transaksionit, kapitali aksionar i shoqërisë Target do të zotërohet 90% nga Fincantieri Infrastrutture S.p.A. dhe 10% nga Sviluppo Imprese Centro Italia SGR S.p.A.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, referuar praktikave të

Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të Degës së Ndërmarrjes së shoqërisë Inso Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A. nga Fincantieri Infrastructure S.p.A.

Pas transaksionit, Dega e Ndërmarrjes-Inso do të zotërohet 90% nga Fincantieri Infrastructure S.p.A. dhe 10% nga Sviluppo Imprese Centro Italia SGR S.p.A.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Degës së Ndërmarrjes së shoqërisë Inso Sistemi Per le Infrastrutture Sociali S.p.A. nga Fincantieri Infrastructure S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 768, Datë 28.01.2021

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Patos SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Patos SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Patos SHA,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 02 prot., datë 06.01.2021, informon Autoritetin e Konkurrencës se me Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 129 prot., datë 11.11.2020, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për miratimin dhe ndryshimin e tarifës së ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Patos SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen në një nivel të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura, shitjen e ujit me shumicë si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për miratimin e tarifave të ndryshuara dhe vendosjen e tyre në një nivel të ri tarifor si edhe projekt-vendimin përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Patos SHA”, rezultoi se:

3. Aplikimi i metodologjisë për miratimin e tarifave dhe ndryshimin në një nivel të ri tarifor ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e treguesve të performancës, e cila tregon për miratimin e tarifave për herë të parë pas katër vitesh të licensimit të UK Patos SHA për kategorinë e furnizimit me ujë, shërbimit të largimit të ujërave të ndotura, tarifat fikse për ofrimin e të dy shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura si dhe shitjen me shumicë të ujit.
4. UK Patos SHA ka aplikuar tarifat të pa miratuara nga ERRU. UK Patos SHA ka aplikuar tarifat e ish Komunës Zharrëz, të bazuara në një vendim të ish komunës, por që në këto katër vite nuk janë miratuara nga ERRU, duke mos zbatuar pikën 3 të kreut II të VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, për miratimin e tarifave në momentin e licensimit të UK Patos SHA, pas riorganizimit. Në këto kushte UK Patos SHA kërkon të aplikoj një tarifë të miratuar dhe të unifikuar në të gjithë zonën e shërbimit, për të siguruar shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve si OSSH dhe të tjerë, në përballimin e kostove të larta të operimit dhe të mirëmbajtjes dhe konsiderimin e rritjes së cilësisë së shërbimit.
5. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivele tarifimi volumetrik shërbimi për FU pasi për KUN nuk është aplikuar asnjë tarifë shërbimi. Këto tarifa për FU janë aplikuar për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga UK Patos SHA përfshirë dhe dy njësitë administrative Cakran dhe Portez, të cilat pas riorganizimit administrativ kanë qenë pjesë e Bashkisë Fier. ERRU me Vendimin e KKRRU nr. 139, datë 27.11.2020 ka miratuar ndryshimin e zonës së shërbimit të Bashkisë Patos duke hequr njësit Administrative Portez dhe Cakran.
6. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Patos SHA propozon ndryshimin e tarifave si rezultat: a) UK Patos SHA aplikon tarifa të pa miratuara nga ERRU që nga licensimi në vitin 2017; b) ndërmarrja synon rritjen e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërisë pasi UK Patos SHA është një shoqëri e cila bën pjesë në grupin e shoqërive mjaft të dobëta financiarisht me nivel shumë të ulët të mbulimit të Kostove O&M prej 23%; c) Përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.
7. Tarifa volumetrike e furnizimit me ujë pëson një rritje prej 20 lek/m³ ose 40% të tarifës aktuale. Tarifa volumetrike e furnizimit me ujë për konsumatorin publik dhe privat rritet me 35 lek/m³ ose 35% e tarifës aktuale, ndërkohë që për konsumatorët familjar të zonës Cakran, Portez të cilat kanë kaluar tashmë në shërbimin e ofruar nga UK Fier SHA rritja e miratuar është bërë për 2 lek/m³.
8. UK Patos SHA kërkon të miratoj dhe të aplikoj tarifat volumetrike për KUN (largimin e ujërave të ndotura) për të tre konsumatorët. Aktualisht UK Patosh SHA nuk aplikon tarifa për këtë shërbim. Tarifat e miratuara rriten me 20lek/m³ ose 100% për konsumatorin familjarë, konsumatorin publik dhe për konsumatorin privat. Përcaktimi i tarifës fikse të shërbimit është kërkuar të përcaktuar të jetë 200 lekë/muaj për të gjithë konsumatorët duke shkaktuar një rritje 100% të konsumatorit familjar, publik dhe privat. Shitja e ujit me shumicë është përcaktuar të jetë 38 lekë/m³ ose 58% e tarifës aktuale të aplikuar.

9. UK Patos SHA ka kërkuar miratimin, rritjen dhe unifikimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimin e ujërave të ndotura, për vendosjen në një nivel të ri referuar treguesve të performancës dhe vlerësimit të kostove për secilën zonë.
10. ERRU ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësive të qeverisjes vendore. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU duhet të mbroj konsumatorët nga çmimet monopol; të inkurajoj efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të paktët; duhet të pasqyrojë hapur dhe qartë subvencionet e dhëna nga Këshilli i Ministrave; duhet të pasqyrojë ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera midis klasave të klientëve dhe llojeve të shërbimit, në varësi të subvencioneve që do të aplikohen.
11. ERRU ka miratuar “Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”. Bazuar në këtë metodologji shqyrtimi i aplikimit për ndryshim tarife fillon me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe analizën e treguesve të performancës. Rritja e tarifave duhet të bëhet gradualisht në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet në përmirësimin e performancës së shërbimeve. Tarifat e reja duhet të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve, nëpërmjet rritjes së eficensës dhe transparencës në realizimin e investimeve si edhe të subvencioneve të marra, por subvencionet nuk kanë qenë pjesë e analizës ekonomike, në kundërshtim me nenin 21 pika 2 (e) dhe 2 (f) të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.
12. Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Patos është licencuar nga KKRR me Vendimin nr. 03, datë 03.02.2017, për të kryer shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura në zonën e shërbimit të njësive administrative të Bashkisë Patos Patos, Zharrëz dhe Ruzhdië dhe të dy njësive administrative Portez dhe Cakran që janë zona të riorganizimit administrativ të Bashkisë Fier dhe për të cilat tarifa e miratuara nga KKRR, për furnizimin me ujë është 52 lek/m³ shumë më pak se 70 lek/m³ që ERRU ka propozuar për miratim për UK Patos SHA dhe tarifa për largimin e ujërave të ndotura nga 13 lek/m³ për UK Fier SHA është miratuar shumë më e lartë për UK Patos SHA me 20 lek/m³.
13. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, niveli i kostove për vitin 2019 dhe vitin 2020 referuar treguesve të performancës nuk tregon ndonjë rritje evidente, që UK Patos SHA të mund të përfitoj investime për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe KUN në të gjithë zonën. UK Patos SHA nuk ka menaxhuar punën për reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve

ujore, faturimin mbi bazën e matësve, rritjen e nivelit të menaxhimit, reduktimin e numrit të punësuarve për 1000/lidhje, i cili rezulton të jetë tepër i lartë në krahasim me UK-të e tjera.

14. Ndarja e kostove të këtyre shërbimeve për secilën zonë individuale do të siguronte një analizë më të saktë dhe vendosje të tarifave më të drejta. Për vlerësimin e kostove së arritshme të një ndërmarrjeje UK, rregullatori ka përdor si bazë kostot sipas zonave, duke siguruar një nivel të paarsyeshëm rritje tarifash në raport me shërbimin e ofruar si dhe nivelin e mbulimit të shërbimit, burimet alternative të përdorimit etj. Kjo ka sjellë vendosjen e tarifave në nivele më të larta se UK e tjera, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmim më të lartë për produktin dhe shërbimin që u ofrohet, vetëm me argumentin se kjo ndërmarrje është në prag falimentimi nga mospagimi i detyrimeve ndaj OSSH.
15. ERRU-së për vitin 2020 dhe vitin 2021 synon përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e efikasitetit në reduktimin e numrit të stafit, i cili është i lartë, 24.8 staf/1000/lidhje, rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
16. ERRU nuk i ka miratuar tarifat për ofrimin e shërbimeve eficiente nga vitit 2017 deri më sot për UK Patos SHA. Bazuar në nenin 13 të Vendimit nr. 42, datë 09.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” për ofrimin e shërbimeve eficiente, ERRU kërkon që UK Patos SHA të ketë shpenzime O&M “të arsyeshme dhe të nevojshme” me synimin që konsumatorët të paguajnë vetëm kosto të justifikuara.
17. Nga analiza ekonomiko-financiare, rezulton se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Patos SHA pas riorganizimit sipas nenit 14 të Vendimit të KKRR nr. 42, datë 09.12.2015 analiza e vlerësimit të performancës bazohet në disa tregues krahasimi. Treguesit e mosrealizimit nga UK Patos SHA nga viti 2017 deri më sot kanë çuar në një vlerësim të ulët të performancës pasi UK Patos SHA nuk është në gjendje të mbulojë deri në 50% të kostove të operimit & mirëmbajtjes. Ndryshimi i tarifave për të përballuar borxhet ndaj OSSH, për shkak të keq menaxhimit, në një tarifë prej 8 milion Euro e vlerëson këtë ndërmarrje pranë falimentit.
18. Gjithashtu në vlerësimin e kostos nuk janë marrë në konsideratë treguesit e njësish administrative Portez dhe Cakran të cilat kanë kaluar në juridiksionin e UK Fier SHA me Vendimin e KKRRU nr. 139, datë 27.11.2020. Për këto dy njësi që kanë qenë pjesë e UK Patos SHA tarifat e miratuara nga KKRR për UK Fier SHA me Vendimin nr. 142, datë 27.11.2020 janë më të ulta konkretisht tarifa e konsumit familjar për furnizimin me ujë është miratuar 52 lek/m³ ndërsa për UK Patos SHA kjo tarifë është më e lartë në 70 lek/m³, gjithashtu dhe tarifa e KUN është më e rritur se UK Fier për konsumatorin familjar nga 13 lek/m³ në 20 lek/m³ për UK Patos SHA.
19. Informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së me Vendimi KKRR-së nr. 129, datë 11.11.2020 të UK Patos SHA, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit nr. 492, datë

28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, nëpërmjet të cilit kërkohet nga ERRU: “Publikimi dhe bërja transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime për vitet 2019 dhe 2020, të publikuara me treguesit e parashikuar për “Ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.

20. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Patos SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të evidentojë të gjitha lidhjet me rrjetin, si edhe të hartojë një plan biznesi 5 vjeçar duke marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, nivelin e debive dhe rritjen e investimeve për të përmirësuar shërbimin në kuadër të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” me qëllim argumentimin për nevojën e investimeve në lidhje me përmirësimin e shërbimit si edhe qëndrueshmërinë financiare.
21. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Patos SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
22. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2020 mbetet thuajse në nivele relativisht të ulta krahasuar me ato të vitit 2019 me një rritje rreth 1%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit duhet të jenë transparente, të kontabilizohen dhe të merren në konsideratë për vlerësimeve e kostove.
23. Nga vlerësimi i konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Patos SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Patos SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për unifikimin e tarifës dhe nivelin e ri të tarifës për FU dhe KUN, UK Patos SHA ka realizuar ndarjen veç e veç të kostove sipas shërbimit FU dhe KUN, megjithëse KUN është një shërbim që faturohet për herë të parë në largimin e ujërave të ndotura në të gjithë zonën.
24. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot të ndara për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e), por nuk ka pasqyruar subvencionet dhe investimet e përfituara aktualisht nga kjo ndërmarrje.
25. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- a) Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Patos SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit,
- b) ERRU të kërkojë nga Ujësjiellës Kanalizime Patos SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar, paraqitjen e subvencioneve të përfituara duke njoftuar Autoritetin e Konkurrencës brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
- c) ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos duke përfshirë dhe subvencionet dhe investimet e përfituara.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 769, Datë 28.01.2021

**“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës
për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Raportit Vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të :

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021,

VËREN SE :

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka depozituar Draft-Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 770, Datë 04.02.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.02.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d), dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.

Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen e Shit-Blerjes së Aksioneve më datë 20 nëntor 2020.

Pala Blerëse: MAN Energy Solutions SE është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti prodhimin, shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe aparateve të të gjitha llojeve, veçanërisht të motorëve me naftë, duke përfshirë edhe motorët e anijeve dhe motorët për impiante stacionare dhe të makinerive turbo

MAN Energy Solutions SE është një filial i zotëruar indirekt nga grupi Volkswagen Aktiengesellschaft. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK, Porsche Mobility SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala Shitëse: GP JOULE IPP Assets GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti mbajtjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të pjesëmarrjes në shoqëri të tjera.

Target: H-TEC Systems GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt aktiviteti projektimin, prodhimin dhe shitjen e pajisjeve dhe impianteve, duke përfshirë hardware dhe software, si dhe konsulencë dhe shërbime në fushën e teknologjisë së hidrogjenit dhe teknologjive të lidhura me të.

Më datë 20 nëntor 2020, shoqëria GP JOULE IPP Assets GmbH dhe shoqëria MAN Energy Solutions SE kanë nënshkruar “Marrëveshje Shit-Blerje Aksionesh” për blerjen e aksioneve të shoqërisë target H-TEC Systems GmbH.

Bazuar në këtë marrëveshje shoqëria MAN Energy Solutions SE do të blejë 31,677 aksione të shoqërisë target H-TEC Systems GmbH, të cilat zotërohen nga shoqëria GP JOULE IPP Assets GmbH.

Shoqëria MAN Energy Solutions SE aktualisht zotëron 21,569 aksione, që përfaqësojnë 39.26% të kapitalit aksionar të shoqërisë target dhe pas transaksionit shoqëria MAN Energy Solutions SE do të zotërojë në total 53,246 aksione, që përfaqësojnë 96.91% të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të elektrolizatorëve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundi i kontrollit të shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.

MAN Energy Solutions SE është një filial i zotëruar indirekt nga grupi Volkswagen Aktiengesellschaft dhe nuk operon në Shqipëri, por realizon të ardhura përmes shoqërive të kontrolluara nga Grupi Volkswagen.

Target nuk ka filiale në Republikën e Shqipërisë dhe as nuk ka gjeneruar të ardhura në tregun shqiptar në vitin 2019.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit shoqërisë H-TEC Systems GmbH nga shoqëria MAN Energy Solutions SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 771, Datë 11.02.2021

“Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, i ndryshuar”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.02.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore për periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020. Raporti i hetimit paraprak duhej të paraqitej në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Për realizimin e proceduarve hetimore është kërkuar informacion nga ndërmarrjet që veprojnë në tregun e prodhimit të barnave në vend si dhe ndërmarrjet që importojnë dhe tregtojnë pajisje mjekësore, informacion i cili ende nuk është depozituar.
3. Koha e mbetur në dispozicion, dhe mungesa e informacionit të kërkuar është e pamjaftueshme

për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 707, datë 23.09.2020, i ndryshuar.

4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 mars 2021”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 772, Datë 11.02.2021

**“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë
veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.02.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Raporti i hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë
veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka”

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, germa d), neni 26 dhe neni 43 i ligji nr. 9121, datë 28.07.2003
“Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

-Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

-Raportit të hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jobanka

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 28 të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka monitoruar tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo bankë, tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimit të pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike, të cilat rezultuan me karakteristikat e një tregu të përqendruar.
2. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003, me vendimin nr.712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, ka vendosur hapjen e procedurave të hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka.

II.ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1. Tregu përkatës

3. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa i përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensionet:
 - a. Tregun e produkteve.
 - b. Tregun gjeografik.
4. Tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo bankë: tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimi i pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike.
5. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.
6. Bazuar në Udhëzimin “Për përcaktimin e tregut përkatës”, barrierat e hyrjes konsiderohen të gjitha pengesat që kufizojnë hyrjen e lirë në treg të një konkurenti potencial. Këto barrierë mund të jenë në formën e barrierave ligjore, rregullatore, licenca, barrierë ekonomike etj.
7. Në lidhje me barrierat në hyrje, nga ana e SFJB-ve kërkohet plotësimi i kriterëve financiarë dhe ligjorë për marrjen e licencës nga Banka e Shqipërisë, pra mund të themi se ka barrierë në hyrje.
8. Në lidhje me strukturën e tregut të SJFB, rezulton se gjatë periudhës hetimore:
 - Në tregun e kredihënies operojnë 8 SFJB: Ak Invest, Albanian Financial Institution, Agrokredit, Fondi Besa, Final, Microcredit Albania, NoA dhe Tranzit.
 - Në tregun e mikrokredise operojnë 6 SFJB: Agro & Social Fund, Capital Invest, Iute Credit Albania, Agro Partner, Kreda Finance, Micro Credit Risk.
 - Në tregun e faktoringut operojnë 8 SFJB: AK-Invest, Tranzit, Crimson Finance Fund Albania, Tirana Asset Partners (ish Albania Factoring Services), OMNI Factor, Tirana Factoring & Lease, Tirana Capital Trade, Albanian Financial Institution.
 - Në tregun e qirasë financiare operojnë 10 SFJB: Tranzit, Raiffeisen Leasing, Fin-al, Landeslease, Porche Leasing, Albania Leasing, Crimson Finance Fund Albania, MOGO Albania, Tirana Factoring & Lease, Albanian Financial Institution.
 - Në tregun e shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave operojnë 9 SJFB: Unioni Financiar i Tiranës, AK-Invest, NoA, EasyPay, Posta Shqiptare, M-Pay, Kastrati, Pay & GO (ka operuar deri në 15.04.2020), RAEA Financial Services.
 - Në tregun e parasë elektronike operojnë 3 SFJB: Unioni Financiar i Tiranës, Easy Pay dhe Posta Shqiptare.

9. Në tregun e **kredithënies**. Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut, konstatohet se ndërmarrja Fondi Besa SHA, ka ruajtur pjesë tregu në periudhën hetimore (viti 2018, viti 2019, 31 Gusht 2020), me mbi 60% të tregut dhe tregu është shumë i përqendruar. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka barriera për hyrësit e rinj (kriteret financiare dhe plotësimi i kriterëve ligjorë) nga ana e SFJB për licencim. Lidhur me rrjetin e shpërndarjes, vihet re se subjekti Fondi Besa SHA, është një ndërmarrje me një eksperiencë disa vjeçare në treg, duke arritur të zgjerojë rrjetin e shpërndarjes dhe duke pasur zyra në të gjithë territorin e RSH.
10. Për sa më sipër, duke marrë parasysh: strukturën e tregut, pjesën e tregut që zotëron, barrierat ligjore dhe ekonomike në hyrje, nivelin e konkurrencës aktuale si dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Fondi Besa SHA ka pozitë dominuese në tregun e kredisë.
11. Nga analiza e komisioneve dhe penaliteteve konstatohet se SFJB që operojnë në këtë treg, nuk aplikojnë komisione dhe penalitete në vlera të njëjta, shenjë e cila nuk tregon për një shkelje të mundshme të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, por nga analiza e sjelljes në lidhje me normat e interesit vihet re se Fondi Besa SHA aplikon norma interesi të larta, që mund të jetë një shenjë për shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr.9121/2003.
12. Në tregun e **mikrokredisë**. Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut, konstatohet se pjesa e tregut të ndërmarrjes Iute Credit Albania SHA, në periudhën hetimore, është mbi 60% të tregut dhe tregu është shumë i përqendruar. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka barriera për hyrësit e rinj (kriteret financiare dhe plotësimi i kriterëve ligjorë) nga ana e SFJB për licencim. Lidhur me rrjetin e shpërndarjes, vihet re se subjekti Iute Credit Albania SHA ka 6 pika të ofrimit të produktit në Tiranë dhe nga 1 pikë në qytetet Fier, Vlorë, Korçë, Berat, Shkodër, Durrës dhe Elbasan.
13. Për sa më sipër, duke marrë parasysh: strukturën e tregut, pjesën e tregut që zotëron, barrierat ligjore dhe ekonomike në hyrje, nivelin e konkurrencës aktuale si dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Iute Credit Albania SHA ka pozitë dominuese në tregun e mikrokredisë.
14. Në tregun e mikrokredisë vihet re se ka një lidhje vertikale me tregun e kredisë, pasi Fondi Besa SHA, i cili operon në tregun e kredisë dhe zotëron pozitë dominuese në këtë treg, zotëron 100% të ndërmarrjes Agro&Social Fund SHA, ndërmarrje e cila operon në tregun e mikrokredisë. Pavarësisht se Iute Credit Albania SHA ka pjesën më të lartë të tregut, aplikon norma interesi më të ulëta se Agro&Social Fund SHA, e cila aplikon norma më të larta interesi.
15. Nga analiza e interesave, komisioneve dhe penaliteteve konstatohet se SFJB që operojnë në këtë treg, nuk aplikojnë tarifa të njëjta. Iute Credit Albania SHA ka një maksimum komision procesimi (disbursimi) më të lartë se SFJB e tjera. Për sa më sipër, mund të evidentohen shenja të një shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr.9121/2003.

16. Në tregun e **faktoringut**. Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët e tregut të faktoringut konstatohen se ka ndryshime të pjesëve të tij. Tirana Factoring & Lease SHA zë pjesë të konsiderueshme në këtë treg, gjë që tregon se ka pozitë dominuese. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka barriera për hyrësit e rinj (kriterë financiarë dhe plotësimi i kriterëve ligjorë) nga ana e SFJB për licencim.
17. Nga analiza e interesave rezulton se SFJB-të ofrojnë norma të ndryshme interesi për faktoringun për periudhën nën hetim. Nga analiza e komisioneve dhe penaliteteve konstatohet se SFJB që operojnë në këtë treg, nuk aplikojnë komisione dhe penalitete në vlera të njëjta. Treguesit e përqendrimit të këtij tregu kanë vlera të larta dhe Tirana Factoring & Lease SHA aplikon norma të ulëta të interesit dhe komisioneve, shenjë që mund të përbëjë një shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr.9121/2003.
18. Në tregun e **qirasë financiare**. Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut, konstatohet se Mogo Albania SHA për periudhën hetimore, ka rritur pjesën e saj të tregut deri në 45%, gjë që tregon se Mogo Albania SHA ka pozitë dominuese në këtë treg. SFJB në tregun e qirasë financiare nuk kanë patur qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë periudhës nën hetim. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka barriera për hyrësit e rinj (kriterë financiarë dhe plotësimi i kriterëve ligjorë) nga ana e SFJB për licencim.
19. Nga analiza e komisioneve dhe penaliteteve konstatohet se SFJB që operojnë në këtë treg, nuk aplikojnë komisione dhe penalitete në vlera të njëjta, shenjë e cila nuk tregon për një shkelje të mundshme të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003. Vihet re se Mogo Albania SHA ka aplikuar norma të ulëta interesi ndërmjet SFJB-ve që ushtrojnë aktivitetin e qirasë financiare dhe ka rritur pjesën e saj të tregut, shenjë e cila mund të përbëjë një shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.
20. Në tregun e **parasë elektronike**. Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut të parasë elektronike, konstatohet se ndërmarrja Unioni Financiar i Tiranës SHA zë mbi 90% të tregut. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka barriera për hyrësit e rinj (kriterë financiarë dhe plotësimi i kriterëve ligjorë) nga ana e SFJB për licencim. Lidhur me rrjetin e shpërndarjes, vihet re se Unioni Financiar i Tiranës SHA ka një rrjet të gjerë shpërndarje në treg, mbi 600 pika, në të cilat ofron shërbimet e saj. Është një ndërmarrje me një eksperiencë disa vjeçare në treg, duke arritur të zgjerojë rrjetin e shpërndarjes dhe duke pasur zyra në të gjithë territorin e RSH.
21. Për sa më sipër, duke marrë parasysh: strukturën e tregut, pjesën e tregut që zotëron, barrierat ligjore dhe ekonomike në hyrje, nivelin e konkurrencës aktuale si dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Unioni Financiar i Tiranës SHA ka pozitë dominuese në tregun e parasë elektronike.
22. Në tregun e **shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave**. Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut të shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare, konstatohet se ndërmarrja Unioni Financiar i Tiranës SHA zë mbi 70% të tregut të pagesave dhe mbi 90% të tregut të

transfertave kombëtare dhe ndërkombëtare. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka barriera për hyrësit e rinj (kriteret financiare dhe plotësimi i kriterëve ligjore) nga ana e SFJB për licencim. Lidhur me rrjetin e shpërndarjes, vihet re se Unioni Financiar i Tiranës SHA ka një rrjet të gjerë shpërndarje në treg mbi 600 pika në të cilat ofron shërbimet e saj, është një ndërmarrje me një eksperiencë disa vjeçare në treg, duke arritur të zgjerojë rrjetin e shpërndarjes dhe duke pasur zyra në gjithë territorin e RSH.

23. Për sa më sipër, duke marrë parasysh: strukturën e tregut, pjesën e tregut që zotëron, barrierat ligjore dhe ekonomike në hyrje, nivelin e konkurrencës aktuale si dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Unioni Financiar i Tiranës SHA ka pozitë dominuese në tregun e tregut të shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare.
24. Shërbimi i parasë elektronike është shërbim i lidhur me shërbimin e pagesave, pasi institucionet e parasë elektronike përveç emitimit të parasë elektronike mund të ushtrojnë të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave. Në lidhje me komisionet, konstatohet se SFJB nuk aplikojnë komisione në lidhje me kreditimin e llogarive të parasë elektronike. Ndërkohë, tregu i shërbimit të pagesave paraqitet shumë i përqendruar, me tendencë në rritje dhe vihen re marrëdhëniesh kontraktuale të SFJB me ndërmarrje të tjera në treg, lidhur me kryerjen e pagesave, nga ku mund të evidentohen shenja të cilat mund të përbëjnë shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.
25. Në tregun e shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare, ashtu edhe në tregun e parasë elektronike, vihet re se ka një lidhje vertikale mes UFT me Bankën Union pasi UFT, i cili operon në këtë treg dhe zotëron pozitë dominuese në këtë treg, zotëron 100% të Union Bank SHA, bankë e nivelit të dytë që operon në tregun bankar.
26. Referuar sa më sipër, treguesit e përqendrimit të këtij tregu kanë vlera të larta dhe lind dyshimi për sjellje të mundshme antikonkurruese të Fondi Besa SHA në tregun e kredisë, Iute Credit SHA në tregun e mikrokredisë, Tirana Factoring & Lease SHA në tregun e faktoringut, Mogo Albania SHA në tregun e qirasë financiare dhe Unioni Financiar i Tiranës SHA në tregun e shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave (kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe parasë elektronike, të cilat mund të çojnë në shkelje të mundshme të nenit 9 ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 9, nenit 24, shkronja d), nenit 26 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar, për shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ndaj ndërmarrjeve:
 - Fondi Besa SHA në tregun e kredisë;
 - Iute Credit Albania SHA në tregun e mikrokredisë;
 - Tirana Factoring & Lease SHA në tregun e faktoringut;
 - Mogo Albania SHA në tregun e qirasë financiare dhe
 - Unioni Financiar i Tiranës SHA në tregun e parasë elektronike, shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave (kombëtare dhe ndërkombëtare).
- II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore 1 janar 2018 deri 31 Dhjetor 2020.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 773, Datë 18.02.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.02.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d), dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE,

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.

Pala Blerëse: Traton SE është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: përfshirje në sipërmarrje, të cilat kanë si qëllim të biznesit të tyre

prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesoreve të tyre dhe të gjitha impianteve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike.

Traton SE është një filial i zotëruar indirekt nga grupi Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen. Traton SE nuk ka filiale, degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri.

Grupi Volkswagen operon dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK

Dusk Inc është një shoqëri e regjistruar në Shtetin Delaware, SHBA, i cili zotërohet tërësisht në mënyrë indirekte nga Traton SE (shoqëria mëmë).

Shoqëria Target: Navistar International Corporation, është një shoqëri e regjistruar në Shtetin Delaware, SHBA, me objekt aktiviteti: Prodhimin e autobusëve të linjës urbane dhe motorë diesel, anije tregtare dhe pasagjerësh, automjete tregtare dhe automjete pasagjerësh dhe makineri bujqësore në Amerikën e Veriut dhe në Amerikën e Jugut, etj.

Shoqëria Target Navistar International Corporation nuk ka filiale në Republikën e Shqipërisë.

Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen dhe Planin e Bashkimit më datë 07 nëntor 2020.

Shoqëria Traton SE, aktualisht zotëron XXX% të aksioneve të shoqërisë Navistar International Corporation dhe nëpërmjet transaksionit të njoftuar synohet blerja indirekt e XXX % të aksioneve të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE, ndërmjet filialit të zotëruar plotësisht prej tij Traton US Inc.

Pas transaksionit, shoqëria Traton SE do të përftojë kontrollin e plotë të shoqërisë Navistar International Corporation.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe tregtimit të kamionëve komercial, autobusëve, automjeteve mbrojtëse dhe motorëve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Navistar International Corporation nga shoqëria Traton SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 774, Datë 04.03.2021

**“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes New
Medical Plus SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 33 pika 2 dhe pika 3, neni 43, dhe neni 74 pika 1, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- 2- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

- 3- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
- 4- Autoriteti i Konkurrencës për realizimin e procedurave hetimore për vlerësimin e konkurrencës në tregun e tregtimit me shumicë të këtyre materialeve paramjekësore me shkresën nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes New Medical Plus SHPK, në lidhje me shit-blerjet analitike dhe importet analitike për periudhën nga 01 nëntor 2019 deri në 31 dhjetor 2020, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 15.01.2021. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 5- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” i është drejtuar përsëri ndërmarrjes New Medical Plus SHPK për mundësimin e sigurimit të të dhënave të nevojshme brenda datës 08.02.2021. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk i është përgjigjur përsëri kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 6- Informacioni i kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës është shumë i rëndësishëm për realizimin e procedurave hetimore, pasi përmban informacione të detajuara të veprimtarisë së ndërmarrjeve, për të cilat është hapur dhe procedura hetimore.
- 7- Për sa më sipër, kur ndërmarrjet nuk japin të dhënat e kërkuara, brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe pika 3 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni kur e vlerëson të nevojshme i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 33 pika 2 dhe pika 3, nenin 43 dhe nenin 74 pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i kërkojë ndërmarrjes New Medical Plus SHPK të depozitojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin si më poshtë vijon:
 - a. *Blerjet (lokale) Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*

- b. Importet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*
 - c. Shitjet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 Nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe klientët përkatës.*
- II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të përmbushet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar.
- III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja New Medical Plus SHPK ndëshkohet me gjobë në masën jo më shumë se deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 775, Datë 04.03.2021

“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes R&S Farma SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes R&S Farma SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 33 pika 2 dhe pika 3, neni 43, dhe neni 74 pika 1, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- 2- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

- 3- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
- 4- Autoriteti i Konkurrencës për realizimin e procedurave hetimore për vlerësimin e konkurrencës në tregun e tregtimit me shumicë të këtyre materialeve paramjekësore me shkresën nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes R&S Farma SHPK në lidhje me shit-blerjet analitike dhe importet analitike për periudhën nga 01 nëntor 2019 deri në 31 dhjetor 2020, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 15.01.2021. Ndërmarrja R&S Farma SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 5- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” i është drejtuar përsëri ndërmarrjes R&S Farma SHPK për mundësimin e sigurimit të të dhënave të nevojshme brenda datës 08.02.2021. Ndërmarrja R&S Farma SHPK nuk i është përgjigjur përsëri kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 6- Informacioni i kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës është shumë i rëndësishëm për realizimin e procedurave hetimore, pasi përmban informacione të detajuara të veprimtarisë së ndërmarrjeve, për të cilat është hapur dhe procedura hetimore.
- 7- Për sa më sipër, kur ndërmarrjet nuk japin të dhënat e kërkuara, brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe pika 3 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni kur e vlerëson të nevojshme i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 33 pika 2 dhe pika 3, nenin 43 dhe nenin 74 pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i kërkojë ndërmarrjes R&S Farma SHPK të depozitojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin si më poshtë vijon:

- a. *Blerjet (lokale) Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*
 - b. *Importet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*
 - c. *Shitjet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 Nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe klientët përkatës.*
- II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të përmbushet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar.
 - III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja R&S Farma SHPK ndëshkohet me gjobë në masën jo më shumë se deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 776, Datë 04.03.2021

**“Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius
Medical SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 33 pika 2 dhe pika 3, neni 43, dhe neni 74 pika 1, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

- 1- Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- 2- Me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

- 3- Për këto arsye, KK bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
- 4- Autoriteti i Konkurrencës për realizimin e procedurave hetimore për vlerësimin e konkurrencës në tregun e tregtimit me shumicë të këtyre materialeve paramjekësore me shkresën nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK, në lidhje me shit-blerjet analitike dhe importet analitike për periudhën nga 01 nëntor 2019 deri në 31 dhjetor 2020, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 15.01.2021. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 5- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” i është drejtuar përsëri ndërmarrja Aquarius Medical SHPK për mundësimin e sigurimit të të dhënave të nevojshme brenda datës 08.02.2021. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur përsëri kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.
- 6- Informacioni i kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës është shumë i rëndësishëm për realizimin e procedurave hetimore, pasi përmban informacione të detajuara të veprimtarisë së ndërmarrjeve, për të cilat është hapur dhe procedura hetimore.
- 7- Për sa më sipër, kur ndërmarrjet nuk japin të dhënat e kërkuara, brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, në zbatim të nenit 33, pika 2 dhe pika 3 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni kur e vlerëson të nevojshme i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 33 pika 2 dhe pika 3, nenin 43 dhe nenin 74 pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i kërkojë ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin si më poshtë vijon:
 - a. *Blerjet (lokale) Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*

- b. Importet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe furnitorët përkatës.*
 - c. Shitjet Analitike për produkt (të gjithë llojet dhe modelet e maskave, xhelit desinfektant, alkoolit dhe termometrave infrared) për periudhën 01 Nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, duke cilësuar çmimin dhe klientët përkatës.*
- II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të përmbushet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar.
- III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ndëshkohet me gjobë në masën jo më shumë se deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 777, Datë 04.03.2021

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 719, datë 28.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 719, datë 28.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve.

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 719, datë 28.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve, për periudhën kohore Janar 2017 deri në Tetor 2020, si dhe raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Porti MBM; Petrolifera Italo Albanese (PIA); Romano Port SHA;

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Qendra Kombëtare e Biznesit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Porti Detar Vlorë SHA; Portit Detar Shëngjin SHA; Autoriteti Portual Durrës.

3. Informacioni i depozituar në përgjigje të kërkesave për informacion nuk është i mjaftueshëm për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve koncesionare kundrejt operatorëve me të cilët kanë lidhur kontrata shërbimi. Për këtë arsye nevojitet informacion, prova dhe të dhëna shtesë. Si rrjedhojë, me qëllim përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit paraprak me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 719, datë 28.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, afati i përcaktuar në pikën “III”, shtyhet me 3 (tre) muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 778, Datë 04.03.2021

“Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”

Baza Ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe dh), neni 26 dhe neni 84, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar si dhe Udhëzimi “Mbi formën e Njoftimit të Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

-Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,

VËREN SE:

1. Autoriteti i Konkurrencës, është përballur me një numër në rritje të procedurave të kontrollit të përqendrimeve dhe njoftimeve përkatëse lidhur me përqendrimet.
2. Transaksionet e njoftuara ndodhin në tregun e brendshëm shqiptar, por edhe në tregun e huaj ndërkombëtar duke patur impakt në tregun e brendshëm.
3. Transaksionet e njoftuara janë të ndryshme dhe prekin një numër të konsiderueshëm tregjesh dhe sektorësh të ekonomisë.

4. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson transaksionet e njoftuara në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
5. Autoriteti i Konkurrencës, autorizon transaksionet e njoftuara që përbëjnë një përqendrim sipas kuptimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në rastet e bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve, të përfuturit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kur krijohet një ndërmarrje e përbashkët etj.
6. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson edhe transaksionet të cilat shoqërohen me bashkime të ndërmarrjeve, përfutim kontrolli etj, por që nuk përmbushin kriteret e neneve 10 ose 12 të ligjit nr.9121/2003 “për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe dh), neni 24 dhe neni 84 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar si dhe Udhëzimit “Mbi formën e Njoftimit të Përqendrimit”:

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës” si më poshtë:

Neni 4 “Caktimi i tarifave për ndjekjen e procedurave në rastet e kontrollit të përqendrimeve” pika 1 e Rregullores, ndryshohet si më poshtë:

1. *Për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës, në rastet e kontrollit të përqendrimit, aplikohen tarifat e mëposhtme:*
 - a. *Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrjet pjesëmarrëse i një transaksioni, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 10 ose 12 të ligjit dhe për të cilin nuk kërkohet plotësimi i “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.*
 - b. *Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës i “Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit (që bashkohen, që përftojnë kontroll, për krijimin e një ndërmarrjeve të përbashkët si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.*
 - c. *Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës i “Formularit të Plotë të Njoftimit të Përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit (që bashkohen, që përftojnë kontroll, për krijimin e një ndërmarrjeve të përbashkët si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.*

2. Për çdo procedurë të njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, do të zbatohen dispozitat e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 779, Datë 04.03.2021

“Mbi monitorimin e vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo” për periudhën 2019-2020 dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e kushteve dhe detyrimeve dhënë me vendimin nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, për periudhën 2019-2020

Baza Ligjore: Neni 3, neni 24 pika d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve dhënë me vendimin nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, për periudhën 2019-2020,

VËREN SE:

- Me vendimin nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen me kushte dhe detyrime të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa Sanpaolo”, KK vendosi mbylljen e procedurave hetimore dhe detyrimin e bankave objekt hetimi për të rishikuar brenda 1 viti nga marrja e këtij vendimi:
 - Komisionet e shërbimeve bankare, drejt uljes për produktet e depozitave, kredive si dhe për shërbimet e transfertave e pagesave.

- b) Normat e interesit për produktet depozita dhe kredi, me synim ngushtimin e *spread*-it midis normave respektive.
 - c) Kostot penguese (*switching costs*) për lëvizshmërinë e klientëve nga një bankë në tjetrën.
 - d) Politikat e bankës për zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve on-line, për të mundësuar rritjen e shkallës së përfshirjes së popullatës në shërbimet bankare (financial inclusion).
2. Detyrimin e bankave, që gjatë periudhës së zbatimit të detyrimeve të mësipërme, të njoftojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës për çdo ndryshim në normat e interesit në produktet e depozitave dhe kredive si dhe ndryshimet në komisione për shërbimet të ofruara.
 3. Periudha e marrë në vlerësim gjatë procedurave hetimore kanë qenë vitet 2016-2018, dhe vendimmarrja e Komisionit u mbështet mbi analizat e provave dhe fakteve të konstatuara gjatë periudhës hetimore.
 4. Pas vitit 2018, bankat objekt hetimi kanë zhvilluar aktivitetin e tyre ekonomik dhe me qëllim vlerësimin e sjelljes së bankave gjatë viteve 2019-2020, Komisioni i Konkurrencës ftoi bankat objekt hetimi në seanca konsultative të organizuara në datën 14 janar dhe 28 janar 2021.
 5. Gjatë seancave, përfaqësuesit e bankave parashtruan opinionin e tyre ndaj vendimit nr. 723 datë 17.11.2020 “Për mbylljen me kushte dhe detyrime të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa Sanpaolo” dhe nëpërmjet korrespondencave shkresore kanë informuar Autoritetin e Konkurrencës në lidhje me aktivitetin e tyre për periudhën 2019-2020.
 6. Nëpërmjet shkresës nr. 246/43 prot., i AK datë 09.02.2021 “ Për rishikimin e vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 të Autoritetit të Konkurrencës “Për mbylljen me kushte dhe detyrime të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa Sanpaolo”, sipas nenit 46 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Banka Raiffeisen ka shprehur strategjinë e saj në drejtim të përmirësimit dhe zgjerimit të platformave dixhitale, nëpërmjet të cilave banka synon uljen e kostove për shërbimet bankare, rritjen e përdoruesve të platformave elektronike, uljen e kostove dhe kohës së miratimit paraprak të kredive për konsumatorin dhe biznesin. Banka Raiffeisen përdorë metodologji dhe udhëzime bashkohore në përcaktimin e komisioneve dhe interesave, si pjesë e politikave të Grupit ku bën pjesë.
 7. Banka Kombëtare Tregtare, nëpërmjet shkresës nr. 246/44 prot., i AK datë 10.02.2021 “Informacion për komisionet e shërbimeve bankare, normat e interesit dhe komisionet për produktet e depozitave dhe kredive për periudhën 2019-2020 dhe Janar 2021”, informon Autoritetin mbi ndryshimin e normave të interesit të depozitave, kredive, komisionet për shërbimet bankare, përfshirë edhe ato të transfertave të pagesave.
 8. Sipas bankës, ndryshimet e normave të interesit të depozitave janë ndikuar nga ndryshimet e normës baze të interesit të *FED* (rezerva federale amerikane) për USD, Bankës Evropiane për monedhën Euro dhe ndryshimin e normës së interesit të Bonove të Thesarit. Ndryshimi i normave të interesit të kredive dhe depozitave gjatë kësaj periudhe ka ndikuar në rënien e Spread-i i BKT, krahasuar me vitin 2018. BKT ka ulur penalitetet

kontraktuale të aplikuara për këstet e vonuara të kredive si dhe ka ulur komisionet e tansfertave bankare.

9. Nëpërmjet shkresës nr. 246/38 prot i AK, datë 27.01.2021 “Shprehje qëndrimi në vijim të takimit konsultativ me KK datë 14 janar 2021 mbi vendimin nr 723, datë 17.11.2020”, Banka Intesa SanPaolo ka deklaruar se interesi i kredive për konsumatorët, kreditë hipotekore në monedhën EURO kanë qenë në një rënie të vazhdueshme; kreditë për investimet të kompanive në LEK dhe EURO kanë qenë pjesë e rishikimeve nga ana e komiteteve të Bankës; banka nuk aplikon asnjë komision për kreditë hipotekore, në rast se nga ana e klientit kredimarrës kërkohet të kryhet shlyerja para afatit e kredisë hipotekore; banka ka aplikuar ulje të komisioneve të transfertave duke adaptuar rregulloret e Bankës së Shqipërisë.
10. Banka Intesa SanPaolo ka realizuar investime në teknologjinë e informacionit (Mobile Banking) dhe aktualisht, projekti DIGICAL do të mundësojë përveç saktësisë në identifikimin e klientit edhe kursimin e kostove administrative për klientët, kosto të tilla, si: kohë, rimbushje formularësh, përgatitje dokumentacioni etj; Banka informon se ka aktivizuar një fushatë edukimi, e dizenuar dhe e konceptuar si një seri mesazhesh të shkurtra edukative, që do të shtrihet përgjatë gjithë vitit 2021.
11. Banka Credins, nëpërmjet shkresës nr. 246/45 prot., AK datë 11.02.2021 “ Referuar shkresës suaj nr. prot 246/41”, ka depozituar një material përmbledhës mbi normat e interesit të depozitave, kredive, komisioneve bankare si dhe politikave të bankës në drejtim të zgjerimit të produkteve online nëpërmjet platformave elektronike nga analiza e të cilave konstatohet se banka ka miratuar ulje të normave të interesit të depozitave në lekë dhe valutë; ulje të normës së interesit të kredisë, kryesisht kredisë Micro dhe Agro; banka ka vendosur kushte lehtësuese për kredimarrësit, të ndikuar nga rrethanat e pandemisë, rritje të disa komisioneve të shërbimeve bankarë si dhe përmirësim të platformave e-banking dhe përmirësimin e portofolit të produkteve dixhitale ku gjatë vitit 2020 është dyfishuar numri i përdoruesve të platformave online.
12. Për shkak të pandemisë së krijuar nga virusi SarsCOV 2, rezulton se bankat, gjatë vitit 2020, kanë zgjeruar gamën e shërbimeve bankare nëpërmjet platformave elektronike dhe kanë rritur në mënyrë të ndjeshme numrin e transaksioneve të realizuar nëpërmjet këtyre platformave.
13. Për sa më sipër, dhe pas vlerësimit të aktivitetit të bankave, për periudhën 2019-2020, sipas pikës 2 të vendimit nr. 723, datë 17.11.2020 “Për mbylljen me kushte dhe detyrime të procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa Sanpaolo”, vihet re se bankat kanë miratuar ndryshime në norma interesi për depozitat, kreditë dhe komisionet e shërbimeve në përputhje me kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në vendim dhe të pafluencuara nga vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës.
14. Aktiviteti i bankave ka reflektuar kushtet e tregut vendas dhe ndërkombëtar si dhe politikat konkurruese të bankave.
15. Bankat objekt i vendimit nr. 723, datë 17.11.2020, kanë detyrimin ligjor, në kuptim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, për të konkurruar në tregun e shërbimeve bankare, duke siguruar konkurrencë efektive mes bankave, cilësi shërbimesh; inovacion në teknologji dhe kosto sa më të ulët për klientët.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 3, neni 24 pika d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo që gjatë miratimit të politikave të tyre monetarë:
 - a. të eliminojë kostot penguese, duke lehtësuar lëvizshmërinë e klientit mes bankave;
 - b. të zgjerojë gamën e shërbimeve dhe produkteve nëpërmjet platformave dixhitale.
2. Monitorimin e sjelljes së Bankës Raiffeisen, Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Bankës Intesa SanPaolo për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 780, Datë 04.03.2021

**“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në ankandin publik me objekt
“Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia”, zhvilluar nga
Bashkia Shkodër”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Relacionit “Mbi vlerësimin e kërkesës së personit fizik “Almiro Gurakuqi” për vlerësimin e kritereve të vecanta të dokumenteve të ankandit me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia”, zhvilluar nga Bashkia Shkodër”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacion “Mbi vlerësimin e kërkesës së personit fizik “Almiro Gurakuqi” për vlerësimin e kritereve të vecanta të dokumenteve të ankandit me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia”, zhvilluar nga Bashkia Shkodër,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, nga personi fizik “Almiro Gurakuqi”, është paraqitur një kërkesë për vlerësimin e kritereve të vecanta të dokumenteve të ankandit me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia” SHA, zhvilluar nga Bashkia Shkodër.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nëpërmjet kësaj ankese rezulton se:

- Autoriteti shitës Bashkia Shkodër ka filluar procedurën e hapur të ankandit me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia” SHA në masën 100%”, me vlerë fillestare të ankandit 50,794,000 lekë. Si afat i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje është caktuar data 09.03.2020, ora 10.00.

- Referuar pikës 3.3.1, gërma dh), të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, lista e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti shitës, për të drejtën për të marrë pjesë në procesin e ankandit, duhet të hartohen në përputhje me nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar (LAP).
- Në seksionin 4 të Dokumenteve Standarte të Ankandit (DSA) të hartuara nga Bashkia Shkodër, përcaktohet se: “Kandidatet blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për t’u kualifikuar sipas shtojcës 5 të DSA”, duke mos përcaktuar kriteret sipas LAP-së si dhe DSA-të e miratuara nga APP, kriteret këto të cilat nuk duhet të modifikohen apo ndryshohen nga Autoriteti Shitës.
- Konkretisht sipas LAP-së dhe DSA-ve, kandidatët blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për t’u kualifikuar:
 - a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
 - b) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
 - c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
 - d) *në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit.*
- Sa më sipër, nga vlerësimi i DSA-ve të hartuara nga Autoriteti Shitës Bashkia Shkodër, vihet re se në Shtojcën 5, pika 1, mungon kriteri sipas pikës ç) më sipër, i cili përcakton se: *“në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit”*. Gjithashtu në pikën 2, gërma a), të kësaj shtojce, ku përcaktohen “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, kërkohej që ofertuesi të jetë person juridik, në kundërshtim me LAP-në, i cili i jep mundësinë si personave fizikë ashtu edhe atyre juridikë për të qenë ofertues në një procedurë ankandi publik, duke kufizuar pjesëmarrjen e këtyre operatorëve fizik në këtë procedurë ankandi të hapur, përmes të cilit çdo kandidat blerës i interesuar mund të dorëzojë ofertën e vet.
- Sipas pikës 2, të Shtojcës 5 të DSA-ve, kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të plotësohen nga Autoriteti Shitës, në pajtim me kërkesat e parashikuara në Seksionin 4 të këtyre dokumenteve, pra në pajtim me kriteret sipas gërmave a), b), c) dhe ç) të sipërcituara.
- Autoriteti Shitës ka përjashtuar pjesëmarrjen e personave fizik, siç argumentohet më sipër, si dhe ka vendosur edhe kriteret e shumta të cilat tejkalojnë frymën dhe qëllimin e LAP-së, siç përmendim: krahas kontratave, transaksioneve dhe eksperiencave të ngjashme; edhe sponsorizime të ngjashme në masën 40% të vlerës fillestare të ankandit, etj. Këto kriteret shtrembërojnë konkurrencën duke krijuar pabarazi në mundësi midis operatorëve ekonomikë.
- Kriteret e ankandit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe qëllimin e tij duke mundësuar një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe objektive, duke i vendosur operatorët në kushte të barabarta dhe jodiskriminuese konkurrence.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d, e f), nenin 26 dhe 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Autoritetit Shitës, Bashkisë Shkodër, rishikimin e kriterëve të përcaktuara në DSA, me qëllim sigurimin e mundësive të barabarta për operatorë ekonomikë të ndryshëm, duke rritur pjesëmarrjen në këtë procedurë ankandi.
2. Autoriteti Shitës, Bashkia Shkodër, të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 781, Datë 12.03.2021

“Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e 4 dhe 9 të Ligjit Nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e 4 dhe 9 të Ligjit Nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve”

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,
- Draft udhëzimit “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e 4 dhe 9 të Ligjit Nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve”

VËREN SE :

1. Udhëzimi parashikon rregulla lidhur me dorëzimin e provave ekonomike, të dhënave sasiore, për të siguruar të dhëna ne kohën e duhur, të cilat janë të rëndësishme për procedurat hetimore.

2. Udhëzimi ofron rekomandime në lidhje me përmbajtjen dhe prezantimin e analizave ekonomike ose ekonometrike, duke theksuar rëndësinë që ka mënyra se si janë mbledhur të dhënat, duke përshkruar në tërësi burimet e të dhënave, shembullin, procesin e përzgjedhjes, etj.
3. Të dhëna sasiore duhet të sigurohen në kohë, në një format të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara. Nga ana e vet, AK, kur është e nevojshme për të mbrojtur konfidencialitetin e të dhënave, siguron se qasja në të dhënat dhe informacionin e depozituar do të jetë subjekt i detyrimeve të rrepta të ruajtjes së konfidencialitetit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e 4 dhe 9 të Ligjit Nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 782, Datë 12.03.2021

“Për dhënie rekomandimi ndaj ndërmarrjes KESH SHA lidhur me shprehjen e interesit të Shoqërisë “Noa Energy Trade” SHPK për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësim ligjor i kërkesës së shoqërisë “Noa Energy Trade” SHPK “Mbi shprehjen e interesit për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA”.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d), neni 26, neni 69 dhe 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit “Mbi vlerësimin ligjor të kërkesës së shoqërisë Noa Energy Trade SHPK “Mbi shprehjen e interesit për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA”,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, shoqëria “Noa Energy Trade” SHPK, nëpërmjet shkresës nr. 46-1 prot, datë 05.03.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 130 prot, datë 05.03.2021), ka paraqitur një “Kërkesë për vlerësim ligjor”, përcjellë për dijeni edhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH).
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi ligjor i kësaj kërkesë, në kuptim të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, rezulton si më poshtë vijon:
 - Shprehja e interesit të shoqërisë “Noa Energy Trade” SHPK, mbi lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA, parashtrohet elementet kryesore lidhur me kapacitetin, vëllimin në lëvrim/pranim, pikat e lëvrimin dhe skemën e tarifave në rastet kur energjia lëvrohet dhe pranohet nga Shoqëria, si dhe kushtet e pjesëmarrjes së palëve në marrëveshjen në fjalë.



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

- “Noa Energy Trade” SHPK e bazon kërkesën e saj në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe rregullat e procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike.
 - Kjo shoqëri, në respektim të VKM nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, merr përsipër që në rast të lidhjes së kësaj marrëveshjeje me shoqërinë KESH SHA nuk do të silllet apo veprojë në kundërshtim me rregullat e konkurrencës ndaj pjesëmarrësve të tregut shqiptar (PTSH) të ngarkuar dhe licencuar me detyrimin e shërbimit publik.
3. Autoriteti i Konkurrencës, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003 vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projektaktet normative.
- Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 vendosi “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”.
4. Në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohen transaksione të tilla si blerja, shitja dhe shkëmbimi. Referuar nenit 20, germa h), të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë ka autoritetin për të miratuar kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.
5. Në zbatim të vendimi nr. 644, datë 31.07.2019 të KK, nga ana e KESH SHA me shkresën nr. 24/17 prot., datë 02.10.2019 objekt “*Mbi vlerësimin e disa kërkesave të drejtuara nga pjesëmarrës të tregut për shoqërinë KESH*”, janë paraqitur për vlerësim dy kontrata për të cilat AK i ka kërkuar KESH zbatimin e vendimit të mësipërm, pasi nga vlersimi i tyre është konstatuar se ato janë të njëjta në përmbajtje me kontratat për të cilat Komisioni i Konkurrencës ka dhënë vendimin e sipërcituar (VKK nr. 644/2019, me shkresën nr. 24/19 prot, datë 07.01.2020).
6. “Shprehja e interesit” nga shoqëria “Noa Energy Trade” SHPK për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA, depozituar pranë AK, nuk përmban dispozita kufizuese në kuptim të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- KESH SHA gjatë procedurave për shqyrtimin e shprehjes së intersit të Shoqërisë “Noa Energy Trade” SHPK për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA: të garantojë përmbushjen e detyrimit për shërbim publik për furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve; të respektojë parimet e leverdisshmërisë



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

ekonomike/energjitike në kushtet kur e kërkon situata hidrike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d, nenin 26, nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë ndërmarrjes KESH SHA që gjatë procedurave për shqyrtimin e shprehjes së interesit të Shoqërisë “Noa Energy Trade” SHPK për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA:
 - a. të garantojë përmbushjen e detyrimit për shërbim publik për furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve;
 - b. të respektojë parimet e leverdisshmërisë ekonomike/energjitike në kushtet kur e kërkon situata hidrike.
2. “Shprehja e interesit” nga shoqëria “Noa Energy Trade” SHPK për lidhjen e një marrëveshjeje për shkëmbim të energjisë elektrike me KESH SHA, depozituar pranë AK, nuk përmban dispozita kufizuese në kuptim të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA, si operator me pozitë dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos të drejta të veçanta ose ekskluzive, për ndërmarrje (kompani) ose për produkte të caktuara, të kërkojë një vlerësim paraprak nga Komisioni i Konkurrencës.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 783, Datë 12.03.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”,

VËREN SE :

1. Nisur nga shqetësimet e ngritura në media mbi rritjen e çmimit të plehrave kimike, bazuar në nenin 28, germa a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në datën 11 dhe 12 Mars 2021, procedoi me kryerjen e monitorimeve në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.
2. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit të kryer pranë ndërmarrjeve kryesore në tregun e importit dhe shitjes me shumicë, si dhe në ambjentet e Shoqatës së Tregtarëve Shqiptarë të Plerave Kimike dhe Inputeve Bujqësore “AFADA”, rezultoi se: disa ndërmarrje gëzojnë të drejta ekskluzive në tregtimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve; ndërmarrjet kanë realizuar importe të përbashkëta dhe kanë siguruar gjendje të produkteve në magazina, duke i shitur ato

me çmime shumë më të lartë se kostot e blerjes së tyre. Në treg operojnë ndërmarrje të konsoliduara dhe me pjesë të konsiderueshme të tregut.

3. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore ka elementë të një sjelljeje të bashkërenduar, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2020 deri në 31 mars 2021.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 784, Datë 12.03.2021

“Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi marrjen e masës së përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.

Bazë ligjore: Neni 4, pika 1, neni 24, shkronja d), neni 44, pika 1 dhe 2, dhe neni 61, shkronja d), i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi marrjen e masës së përkohshme në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”,

VËREN SE:

1. Nisur nga shqetësimet e ngritura në media mbi rritjen e çmimit të plehrave kimike, bazuar në nenin 28, germa a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në datën 11 dhe 12 Mars 2021, procedoi me kryerjen e monitorimeve në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.
2. Bazuar në rezultatet e monitorimit, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 783, datë 12.03.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, vendosi hapjen e

hetimit paraparak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.

3. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit të kryer pranë ndërmarrjeve kryesore në tregun e importit dhe shitjes me shumicë, si dhe në ambjentet e Shoqatës së Tregtarëve Shqiptarë të Plerave Kimike dhe Inputeve Bujqësore “AFADA”, rezultoi se: disa ndërmarrje gëzojnë të drejta ekskluzive në tregtimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve; ndërmarrjet kanë realizuar importe të përbashkëta dhe kanë siguruar gjendje të produkteve në magazina, duke i shitur ato me çmime shumë më të lartë se kostot e blerjes së tyre. Në treg operojnë ndërmarrje të konsoliduara dhe me pjesë të konsiderueshme të tregut.
4. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore ka elementë të një sjelljeje të bashkërenduar, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Si përfundim, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes se ndërmarrjeve që operojnë në tregun e plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1, nenin 8, 9, nenin 24, shkronja d), nenin 44, pika 1 dhe 2, dhe nenin 61, shkronja d), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Marrjen e masës së përkohshme për eliminimin e pasojave antikonkurruese sipas nenit 44, pika 1, si vijon:
 - a. *Ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore t’i japin fund bashkëpunimit mes tyre duke u sjellë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre tregtar sa i përket: importeve të produkteve; caktimit të çmimit të shitjes dhe/ose ndarjes së tregut përkatës; si dhe përdorimit të të drejtave ekskluzive.*
2. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen dijeni të këtij vendimi.
3. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.

4. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrjet ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.
5. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrjet të veprojnë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 785, Datë 25.03.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë”,

VËREN SE :

1. Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 315 prot, datë 10.03.2021, me lëndë, “Mbi verifikimin e konstatimeve në shkelje të konkurrencës në procedurën e prokurimit” (protokolluar pranë AK me nr. 134 prot., datë 10.03.2021), ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës konstatimet e bëra mbi disa shkelje të konkurrencës në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, MK me afat 12 muaj, ndarë në 5 lote.
2. Në vijim të procedurave të prokurimit të lartpërmendur, KPP me vendimin nr. 209/4 prot, datë 11.03.2021 dhe vendimin nr. 228/5 prot, datë 11.03.2021 (vendime këto të cilat i janë përcjellë edhe AK-së, si subjekt i interesuar) ka vendosur:
 - a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë M.C.Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK, për procedurën e

prokurimit me objekt Loti I: “Blerje mish vici, mish pule dhe vezë”, me fond limit 39,274,333 lekë pa TVSH, dhe objekt Loti IV: “Blerje artikuj ushqimor”, me fond limit 36,178,027 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.01.2021 nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë; si dhe

- b) T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e bëra, si dhe të informojë KPP-në në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.
3. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, si dhe KPP, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, vihet re se:
- Operatori Eagle Cons SHPK (anëtar i bashkimit të operatorëve Eagle Cons SHPK dhe Eraldo 2013 SHPK) me operatorin ekonomik M.C.Catering SHPK, ofertues në të njëjtin lot, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët;
 - Në deklaratat e të dy operatorëve rezulton se, personat në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të operatorëve respektiv (Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK), janë motër e vëlla;
 - Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;
 - Të dy operatorët ekonomikë, ofertues në të njëjtin lot, kanë autorizuar të njëjtin person për të kryer kampionimin e mostrave pranë ISUV;
 - Gjithashtu nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga këta ofertues, rezulton se nga 22 artikuj të këtij loti, për 16 artikuj janë paraqitur mostra të njëjta nga të dy operatorët ekonomikë. 16 mostrat e paraqitura nga të dy operatorët ekonomik kanë të njëjtin emërtim, prodhues dhe të njëjtën datë skadence;
 - Në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se për artikullin “Rigon i tharë”, dokumentacioni që lidhet me raportin e provës për këtë artikull, i paraqitur nga operatori ofertues M.C.Catering SHPK, të jetë në emrin e operatorit Eagle Cons SHPK, ofertues në të njëjtin lot.
4. Sa më sipër ngrihen dyshime të arsyeshme se dërmarrjet M.C.Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të singertë.
5. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

6. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, ka elementë të një sjelljeje antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 786, Datë 25.03.2021

**“Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive
Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”; Rregullorja “Për kategoritë e Marrëveshjeve të Specializimit”; Rregullorja “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara”; Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation,

VËREN SE:

Procedura e ndjekur:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është kërkuar përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

KT&G Corporation është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit korean, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e cigareve dhe materialeve në lidhje me to,

prodhimin dhe shitjen e ushqimeve dhe pijeve dhe gjithashtu është e specializuar në fushën e biofarmaceutikes dhe produkteve të bukurisë.

KT&G Corporation nuk është aktualisht aktive në Shqipëri.

Philip Morris Products S.A është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e produkteve të duhanit, i të gjitha produkteve që përmbajnë nikotinë dhe i pajisjeve dhe aksesorëve që lidhen me to.

Philip Morris Products S.A është prezente në Shqipëri përmes shoqërisë Philip Morris Albania SHPK. Philip Morris Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: blerjen, shitjen, importin dhe eksportin e produkteve të duhanit dhe mallrave të tjera të konsumit, përfshirë pajisjet elektrike.

Më datë 29 janar 2020, ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT & G Corporation është lidhur një marrëveshje e përbashkët tregtare (marrëveshje distribucioni), sipas së cilës Philip Morris Products S.A, ekskluzivisht, do të tregtojë dhe të shesë produkte “smoke –free” të KT & G Corporation jashtë Koresë së Jugut në këmbim të të ardhurave bazuar në shitjet e produkteve të konsumit të KT&G Corporation dhe KT&G Corporation & Philip Morris Products S.A.

Për këtë qëllim Philip Morris Products S.A. i është dhënë një licencë ekskluzive në lidhje me pronësinë intelektuale dhe markën KT&G Corporation. Marrëveshja lejon Philip Morris Products S.A të shpërndajë produkte “smoke –free” si dhe produkte që janë evolucion i produkteve “smoke –free” të KT&G Corporation mbi një bazë ekskluzive dhe nuk kufizon Philip Morris Products S.A në shpërndarjen e produkteve të veta ose të palëve të treta.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të maksimizojë potencialin për shitjet e produkteve të KT&G Corporation jashtë Koresë dhe se përdorimi ekskluziv i rrjetit të marketingut, shitjeve dhe shpërndarjes së Philip Morris Products S.A është i domosdoshëm për arritjen e këtij qëllimi dhe për rrjedhojë i domosdoshëm për arritjen e kësaj efijence dhe përfitimeve për konsumatorët.

Marrëveshja e distribucionit është një marrëveshje horizontale mes shoqërive të cilat do të merren me tregtimin dhe shitjen e produkteve pa tym në tregun e cigareve dhe në zbatim të nenit 5 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet përjashtimin individual i marrëveshjeve nga zbatimi i nenit 4 të tij, si dhe Rregullores “Për kategoritë e Marrëveshjeve të Specializimit”, marrëveshja e njoftuar është marrëveshje që kërkon përjashtim nga Komisioni i Konkurrencës.

Palët, besojnë se Marrëveshja e Distribucionit nuk çon në parandalimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës duke mos qenë një marrëveshje kufizuese sipas nenit 4/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Sipas këtij vetëvlerësimi marrëveshja është në përputhshmëri të plotë me ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve” dhe Rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të specializimit”.

Analiza e konkurrencës

Në Shqipëri, tregtimi i produkteve të duhanit rregullohen në mënyrë rigoroze me ligjin nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” dhe legjislacioni fiskal, që përfshijnë detyrimet e monitorimit, kufizimet e reklamimit dhe etiketimit, tarifa të konsiderueshme doganore dhe tarifat e akcizës dhe një regjim specifik të përcaktimit të çmimit me pakicë.

Produktet konvencionale të duhanit (dhe veçanërisht cigaret) përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të tregut të produkteve që përmbajnë nikotinë (rreth. 99,1% në vitin 2019). Produktet alternative/produktet pa djegie që përmbajnë nikotinë janë një segment i tregut në zhvillim, me dinamizëm dhe rritje relativisht të theksuar të tregut në krahasim me produktet konvencionale.

Gjithsesi, edhe brenda segmentit të produktit alternativ që përmbajnë nikotinë, evidentohen ndryshime të teknologjisë, konkretisht mes cigareve elektronike dhe produkteve “heat-non-burn”, në terma si (i) zvogëlimi i riskut për të dy produktet; (ii) përmbajtja e nikotinës; (iii) mungesa e tymit; (iv) mungesa e hirit; dhe (v) mungesa e djegshmërisë.

Konsumi i produkteve të tilla kërkon pajisjen e konsumatorit me një paketë, e cila përbëhen nga: (a) një produkt i konsumueshëm, i cili nxjerr nikotinën, (b) një pajisje që mundëson konsumin dhe (c) bateri (e cila ose mund të përfshihet në pajisjen e dorëzimit, ose mund të jetë veçmas). Produktet alternative nuk kanë djegie, nuk prodhojnë tym ose hi, kanë nevojë për rimbushje/ri-karikim dhe mund të kenë nevojë për pastrim. Pas blerjes fillestare, produkti i konsumueshëm shitet veçmas nga pajisjet

Në bazë të nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përbëhet nga tregu përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit përcaktohet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.

Pavarësisht se të gjitha produktet që përmbajnë nikotinë mund të konsiderohen të zëvendësueshme, përdoruesit e produkteve “heat - non - burn” janë të detyruar të përdorin pajisje për përfitim të nikotinës, i cili mund të klasifikohet si një produkt i diferencuar krahasuar me produktet e tjera me përmbajtje nikotinë (cigaret tradicionale).

Duke marrë parasysh që *Marrëveshja* përfshin produkte që përmbajnë nikotinë, të përdorshme nëpërmjet pajisjes specifike, tregu përkatës i produktit do të përcaktohet **tregu i shitjes me shumicë të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë.**

Tregu përkatës gjeografik do të **përcaktohet territori kombëtar i Republikës së Shqipërisë.**

Mbështetur mbi të dhënat e depozituara nga pala njoftuese, rezulton se vlera e produkteve “heat - non -burn” të shitura nga shoqërisë Philip Morris Products S.A për vitin 2019 përbën vetëm 1 % të shitjeve të realizuara të produktet që përmbajnë nikotine.

Në tregun vendas të produkteve që përmbajnë nikotinë, Philip Morris Albania SHPK është konkurrent kryesor duke zënë 39.2% të tij në vitin 2019, i ndjekur nga Karelia Tobacco me 35.7% të tregut. Të ardhurat totale nga shitja e cigareve të Philip Morris Albania SHPK në Shqipëri arritën në 96.16 milion dollarë (USD) në vitin 2019 dhe të ardhurat nga shitja për produktet “heat-non-burn” gjatë të njëjtit vit arritën në vlerën 2.08 milion USD. Si rezultat, pjesa e tregut që zënë cigaret “heat-non-burn”, ndaj tregut të cigareve në tërësi është rreth 2%.

Marrëveshja e lidhur mes Philip Morris Products S.A dhe KT & G parashikon krijimin e një produkti hibrid (kombinim i duhanit “heat-non-burn” me teknologjitë e avujve elektronikë) dhe produktet e-vapor, i cili ende nuk është hedhur në treg nga asnjë nga palët në Marrëveshje.

Por duke qenë se Philip Morris Albania SHPK është një konkurrent i fuqishëm në tregun e shitjes me shumicë të produkteve që përmbajnë nikotinë (të produkteve konvecionale, veçanërisht të cigares) në Shqipëri, mendohet se duke përdorur si avantazh konkurrues rrjetin e konsoliduar të shitjes së këtyre produkteve dhe besnikërinë e markës, në vitet në vazhdim do të kemi një zhvillim të tregut të cigares “smoke-free” dhe produkteve të reja që do të ofrohen nga Philip Morris Albania SHPK.

Tregu përkatës për produktin “smoke-free” zë një pjesë shumë të vogël të tregut të shitjes së cigareve në Shqipëri dhe për më tepër, produkti i parashikuar nga marrëveshja për përjashtim ende nuk është lançuar dhe hedhur në treg nga palët në marrëveshje. Sipas deklaratës së palëve njoftuese, edhe konkurrentët e tjerë në treg janë drejt procedurave të ofrimit në treg të produktet “smoke-free”, duke i bërë edhe këta konkurrentë potencialë të këtij tregu.

Sipas marrëveshjes, produkti i ri që do krijohet, gjatë tre viteve të para do të lançohet dhe hidhet në tregjet e Rusisë (Lil Solid dhe FHT), Ukrainës (Lil Solid dhe FHT), dhe Japonisë (Lil Hibrid dhe MHX).

Pas lançimit në tre tregjet e para siç parashikohet në nenin 4.1 “Tregjet”, të marrëveshjes, nëse kriteret e zgjerimit janë përmbushur në dy nga tre tregjet e para, Philip Morris Products S.A do ti japë KT & G një plan biznesi ku të detajojë procesin e zgjerimit edhe në shtatë tregje të tjera brenda tre muajve nga plotësimi i kriterëve të zgjerimit në dy nga tre tregjet e para. Njëkohësisht Philip Morris Products S.A do të fillojë procesin e lançimit në secilin prej këtyre tregjeve dhe më pas do ti japë KT & G një tjetër plan zgjerimi ku do të detajohet procesi i zgjerimit edhe në 13 tregje të tjera brenda tre muajve. Nëse nuk përmbushen kriteret e zgjerimit për të gjithë numrin e tregjeve të përmendura më lart, Philip Morris Products S.A ka të drejtë të lançojë produktet në tregjet e tjera të reja.

Prekja e tregut shqiptar nga produkti i parashikuar në marrëveshje nuk është i menjëhershëm, por do të jetë pjesë e zgjerimit pas përmbushjes së nenin 4.1 “Tregjet”, të marrëveshjes.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.
2. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 787, Datë 25.03.2021

“Për rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Florfarma” SHPK për revokimin e vendimit nr.765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Florfarma” SHPK për revokimin e vendimit nr.765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK ””

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe neni 46.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

-Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Florfarma” SHPK ka depozituar shkresën me nr. 110/157 Prot., AK, datë 08.02.2021 “Kërkesë për anulim vendimi”, ku kërkohet anulimi i vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK ””

2. Ndërmarrja “Florfarma” SHPK pretendon se mund të ketë patur gabime në vlerësim apo mungesë interpretimi të fakteve.
3. Në datë 12.03.2021, u zhvillua seanca dëgjimore me ndërmarrjen “Florfarma” SHPK, ku Komisioni i Konkurrencës dëgjoi pretendimet e ndërmarrjes “Florfarma” SHPK.
4. Nga shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Florfarma” SHPK dhe i dokumentacioneve të depozituara në seancën dëgjimore, konstatohet se ndërmarrja “Florfarma” SHPK, nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë të re.
5. Referuar nenit 46 të Ligjit nr. 9121/2003, revokimi i vendimit mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës, vetëm kur përmbushet të paktën njëri nga 3 (tre) kushtet e përcaktuara në këtë nen:
 - njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
 - palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
6. Si përfundim, duke mos përmbushur asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 46 të ligjit nr.9121/2003, kërkesa e ndërmarrje “Florfarma” SHPK, për revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK ””, është e pabazuar në ligj dhe prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Florfarma” SHPK për anulimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK ””.
2. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 765 datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr.685 datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen “Florfarma” SHPK ””.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 788, Datë 01.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo Vita S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve dhe

risigurimeve në fushën e jetës, aksidenteve dhe degët e sigurimeve shëndetësore. Intesa Sanpaolo Vita S.p.A kontrollohet nga Grupi Intesa Sanpaolo. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Pala shitëse: BNP Paribas Cardif S.A., është një shoqëri franceze. BNP Paribas Cardif S.A zotëron 100% shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A.

Shoqëria Target: Cargeas Assicurazioni S.p.A., është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian. Cargeas është aktive në tregun e sigurimit të jo-jetës në Itali.

Cargeas Assicurazioni S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Më datë 20 Shkurt 2021 palët kanë konfirmuar dhe nënshkruar Propozimin e Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve nga dhe ndërmjet BNP Paribas Cardif S.A. dhe Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Në datën e kësaj Marrëveshjeje shitësi BNP Paribas Cardif S.A zotëronte 63,100,000 aksione të zakonshme të targetit Cargeas Assicurazioni S.p.A, të cilat përfaqësojnë kolektivisht 100% të të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, blerësi Intesa Sanpaolo Vita S.p.A do të blejë nga shitësi BNP Paribas Cardif S.A. të gjitha kuotat e zotëruara tek shoqëria target Cargeas Assicurazioni S.p.A.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A., është përfitim i kontrollit të vetëm nga Intesa Sanpaolo Vita S.p.A mbi shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A. Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës mund të konsiderohet tregu i sigurimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Në tregun shqiptar, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 789, Datë 15.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje te përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë MHP Management und IT Beratung GmbH dhe TransnetBW GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë MHP Management und IT Beratung GmbH dhe TransnetBW GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë MHP Management und IT Beratung GmbH dhe TransnetBW GmbH.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë MHP Management und IT Beratung GmbH dhe TransnetBW GmbH.

Pala 1: MHP Management und IT Beratung GmbH është një shoqëri konsulence, e themeluar sipas legjislacionin gjerman, e cila kryen të gjitha aktivitetet në fushën e këshillimit të menaxhimit si dhe në fushën e biznesit dhe teknologjisë së informacionit, në veçanti këshillime, trajnime, shitje të pajisjeve dhe programeve kompjuterike, prodhim i të gjitha llojeve të produkteve.

MHP Management und IT Beratung GmbH është një filial i zotëruar plotësisht nga Dr.Ing. h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, shoqëri pjesë e Grupit Volkswagen i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit, shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG). Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruara indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK, Porsche Mobility SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala 2: TransnetBW GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti sigurimin dhe përdorimin e rrjeteve të transportit, në veçanti ndërtimin dhe funksionimin e rrjeteve të transportit për transmetimin e energjisë dhe substancave që përmbajnë energji.

TransnetBW GmbH është në zotërim të plotë të EnBW Energie Baden-Württemberg AG, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman dhe nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri.

Joint Venture do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve inteligjente të sistemeve të energjisë, për klientët e palëve të treta në Gjermani dhe pjesën tjetër të Evropës.

Më datë 26 shkurt 2021 palët kanë nënshkruar “Marrëveshje Konsorciumi”, për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksione të plota.

Palët pranojnë të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ku secila nga shoqëritë MHP Management und IT Beratung GmbH dhe TransnetBW GmbH do të zotërojë 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë së përbashkët.

Njësia e biznesit IE2S, pjesë e shoqërisë MHP Management und IT Beratung GmbH do të transferohet tek shoqëria e përbashkët Joint Venture.

Shoqëria e përbashkët (Joint Venture) do të ofrojë shërbime këshillimi në fushën e strategjisë, menaxhimit dhe këshillimit teknik (energjetik), shërbime ndihmëse në lidhje me sistemet Smart, në veçanti sistemet inteligjente të energjisë, infrastruktura energjetike dhe furnizimi me energji. Në fokus do të jenë si fillim klientët e palëve të treta në Gjermani dhe në pjesën tjetër të Evropës.

Shoqëria e përbashkët do të themelohet për një afat të pacaktuar dhe do të funksionojë si shoqëri e pavarur në treg, do të ketë emrin e vet të ndërmarrjes, shenjat e markës tregtare, menaxhimin etj.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i konsulencës, implementimit dhe shërbimeve IT në

sistemin e energjisë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëria MHP Management – und IT Beratung GmbH dhe shoqëria TransnetBW GmbH.

Shoqëria MHP Management – und IT Beratung GmbH, nuk operon në Shqipëri por është pjesë e Grupit Volkswagen, i cili realizon të ardhura në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK. Shoqëria TransnetBW GmbH zotërohet tërësisht nga shoqëria EnBW Energie Baden-Württemberg AG, e cila nuk ka filiale dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Shoqëria Joint - Venture nuk do të operojë në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje te përbashkët, me funksione të plota nga shoqëria MHP Management – und IT Beratung GmbH dhe shoqëria TransnetBW GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 790, Datë 15.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.

Pala 1: LG Electronics INC (LGE), shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Koresë dhe objekti i veprimtarisë së shoqërisë është të prodhojë dhe të shesë makineri dhe pajisje elektronike, elektrike dhe të komunikimit; të prodhojë, shesë dhe të japë me qera pajisje software dhe hardware, pajisje

transmetimi, të komunikimit satelitor, rrjete të komunikimit, rrjete audio/video etj, pajisje optike, përfshirë edhe kamerat etj.

LG Electronics Inc., nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet aktiviteteve në fushën e zbavitjes në shtëpi (Home Entertainment), pajisjeve shtëpiake dhe rregulluesve të ajrit (H&A).

Pala 2: Magna Metalforming GmbH (Magna), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Austrisë. Objekti i shoqërisë është zhvillim, modelim, prodhim, montim në fabrikë dhe tregtim i kallëpeve metalike dhe produkteve të tjera për automjete; prodhim dhe tregtim i formave dhe kallëpeve të derdhura në metal; ofrim i shërbimit të përpunimit automatik të të dhënave dhe teknologjinë e informacionit, analizë të sistemeve dhe përpunim i të dhënave në funksionin e një qendre elektronike të përpunimit të të dhënave dhe menaxhimit të kontabilitetit të grupit; blerje, ndërtim dhe administrim i pasurive të patundshme etj.

Magna nuk ka degë apo filial në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura në mënyrë direkte apo indirekte në vend.

Ndërmarrja e përbashkët (JV) do të jetë një shoqëri aksionare, me seli në Kore. Emri i përkohshëm i saj do të jetë LG Magna e-Powertrain Co.,Ltd, dhe shoqëria e re do të merret me shitjen e sistemeve e-Drive dhe sistemet inverter të automjeteve në Kore dhe Japoni.

Më datë 23 dhjetor 2020 palët kanë nënshkruar dy marrëveshje “Marrëveshje e ndërmarrjes së përbashkët” dhe “Marrëveshje për shitblerje aksionesh”.

Marrëveshja për ndërmarrjen e përbashkët është nënshkruar nga LG Electronics INC dhe Magna Metalforming GmbH dhe në ditën e kësaj marrëveshje LGE pranon të ndajë një nga bizneset e saj, “Biznesin e Gjelbër”, pasuritë e të cilit përfaqësohen nga Filiali LG Electronics Nanjing Vehicle Components Co. Ltd në Kore dhe LG Electronics Vehicle Components LLC në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në të njëjtën ditë, shoqëria Magna Metalforming GmbH, nëpërmjet marrëveshjes për shitblerje aksionesh (MSHBA) do të jetë përfituese e 49% të aksioneve të ndërmarrjes së re. Marrëveshja për ndërmarrjen e përbashkët parashikon riorganizim horizontal nëpërmjet ndarjes së pasurisë së Biznesit të Gjelbër nga bizneset e tjera të LG Electronics INC dhe vertikal, nëpërmjet krijimit të filialeve të reja.

Ndërmarrja e re që do të krijohet do të ketë dy filiale, në Kore dhe SHBA, të cilat do të përfaqësojnë pasuritë respektive të Biznesit të Gjelbër në këto dy shtete. Ndërmarrja e re, bashkë me filialet, do të jetë plotësisht funksionale dhe e pavarur, e mbështetur nga palët në marrëveshje. Për shkak të të drejtave strategjike të vetos së Magna-s, JV-ja do të kontrollohet bashkërisht nga Magna dhe LGE.

Referuar marrëveshjeve dhe pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i pjesëve të automjeteve, sistemet e-Drive dhe sistemet

Inverter për automjetet elektrike dhe hibride, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i synuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, e kontrolluar bashkërisht nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.

LG Electronics nuk është prezentë në Shqipëri nëpërmjet degëve apo filialeve, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjes indirekt (nëpërmjet furnitorëve) të pajisjeve elektroshtëpiake, të argëtimit dhe kondicionimit të ajrit. Shoqëria Magna Metalforming GmbH nuk operon në tregun shqiptar dhe nuk realizon të ardhura në këtë treg.

Shoqëria e re (JV) do të funksionojë në tregun e pajisjeve të sistemeve e-Drive të automjeteve dhe përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje te përbashkët me funksione të plota, nga Magna Metalforming GmbH dhe LG Electronics Inc.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 791, Datë 15.04.2021

“Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” dhe vendimit nr.759, datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve dhënë shoqërisë Vodafone Albania SHA me vendimin nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, dhe vendimit nr.759, datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” të Komisionit të Konkurrencës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 2, neni 8, neni 9, neni 24, germa d), nenit 74 pika 1 germa c); Udhëzimi “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimit të vendimin nr. 676 datë 07.02.2020, nga shoqëria Vodafone Albania SHA,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK

nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, përkatësisht në pikën 1, germa a); në pikën 3 dhe pikën 4, ka vendosur:

- Detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA të mos abuzojë më pozitën e saj dominuese nëpërmjet :
 - i. Vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit dhe detyrimin e orientimit e tyre drejt kostos së shërbimeve,
 - ii. Vendosjes së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta, e të pafavorshme për konkurrencën,
 - iii. Vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtese, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
- Monitorim për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e këtij vendimi, të veprimtarisë së shoqërive Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK.
- Detyrimin e shoqërive Vodafone Albania SHA dhe ABCom SHPK, të njoftojnë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës për të gjitha ndryshimet që do të kryejnë në paketat ekzistuese dhe paketat e reja që do të hedhin në treg, gjatë periudhës së monitorimit.

Në fund të vitit 2020, shoqëria Vodafone Albania SHA njoftoi pranë Autoritetit të Konkurrencës marrëveshjen e bashkimit me përthithje me shoqërinë ABCom SHPK, për të cilin Komisioni i Konkurrencës me vendimi nr. 759 datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, vendosi mos klasifikimin si përqendrim të bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA dhe detyrimin e shoqërisë Vodafone Albania SHA:

- për zbatimin e pikës 1, germa a) të vendimit nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”,
- vazhdimin e periudhës së monitorit të veprimtarisë së shoqërisë Vodafone Albania SHA deri në 31 dhjetor 2021.

Mbështetur në të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)¹, si dhe informacionit të depozituar pranë AK nga shoqëria Vodafone Albania SHA në zbatim të pikës 3 të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, rezulton se shoqëria Vodafone Albania SHA zotëron 47% të numrit të përdoruesve aktive celular në fund të vitit 2020, nga të cilët 72.8% i ka përdorues me parapagim.

Gjithashtu, rreth 49% e përdoruesve të shërbimit të akses broadband 3G dhe 4G janë klientë të shoqërisë Vodafone Albania SHA.²

Në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Kreut II, germa a), pika 2 të Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar miratuar me VKK nr. 332 datë

¹ AKEP, Treguesit Statistikor të Tregut të Komunikimeve Elektronike, Tremujori IV 2020

² Ibid.

09.10.2014, si dhe praktikave evropiane³, konstatohet se shoqëria Vodafone Albania SHA ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të telefonisë celulare.

Në zbatim të pikës 4 të vendimit nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, shoqëria Vodafone Albania SHA ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës paketat e reja të shërbimeve celulare të hedhura në treg. Nga vlerësimi i të cilave konstatohet se shoqëria nuk ka patur rishikim të çmimit të paketave ekzistuese, por ka ofruar paketa të reja (kombinime të reja të shërbimeve të përfshira në to).

Gjatë periudhës së monitorimit, pranë Autoritetit të Konkurrencës, shoqëria ONE Telecommunications SHA ka depozituar shkresën nr. 107 prot., i AK datë 26.02.2021 “Letër ankimore mbi praktikat komerciale të kryera nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, bashkëlidhur së cilës edhe një mesazh zanor mbi ofertën e shoqërisë Vodafone Albania SHA për klientët e shoqërisë ONE, në rast të portabilitetit të numrit drejt operatorit Vodafone. Shoqëria ONE Telecommunications SHA shprehet se elementet e ofertave promotionale dhe çmimi i shërbimit janë nën kosto.

Nga vlerësimi i ofertave të dy operatorëve të tjerë celulare përgjatë periudhës së monitorimit të shoqërisë Vodafone Albania SHA në zbatim të VKK nr.676, datë 07.02.2020 dhe VKM nr.759, datë 30.12.2020, për shërbimin e portabilitetit të numrit vërehet se:

- Shoqëria Albtelecom SHA u ofron abonentëve kohë komunikimi në vlerën 100 lekë në muaj, internet 3G/4G në sasinë 5 GB dhe internet me instalimin dhe regjistrimin në aplikacionin “Profili Im”.
- Shoqëria One Telecommunications SHA ju ofron abonentëve kohë komunikimi 100 lekë në muaj, internet 3G/4G në sasinë 3 GB dhe internet 3G/4G për 12 muaj me aktivizimin e një pakete në sasinë 3 GB.

Sipas përmbajtjes së mesazhit zanor, shoqëria Vodafone Albania SHA nëpërmjet thirrjeve telefonike drejtuar abonentëve jo-Vodafone në rast bartjen e numrit drejt Vodafone, ju ofron dy lloje paketash: (1) paketën 400 lekë me kohë komunikimi 2500 minuta, internet në sasinë 8 GB dhe 2200 SMS, dhe (2) paketën 1000 leke me kohë komunikimi 3000 minuta dhe internet në sasinë 20GB për një periudhë 1 vjeçare.

Nga krahasimi i ofertave mes tre operatorëve gjatë periudhës së monitorimit, për shërbimin e portabilitetit të numrit, konstatohet se oferta e shoqërisë Vodafone Albania SHA (sipas mesazhit zanor), përkatësisht në shërbimin e internetit, është 8 dhe 20 GB internet (referuar paketave) për një periudhë 1 vjeçare, kur dy operatorët e tjerë ofrojnë 3 GB dhe 5 GB internet për një periudhë 1 vjeçare.

³ https://ec.europa.eu/competition/publications/factsheets/antitrust_procedures_102_en.pdf. **Market shares** are a useful first indication of the importance of each firm on the market in comparison to the others. The Commission's view is that the higher the market share, and the longer the period of time over which it is held, the more likely it is to be a preliminary indication of dominance. If a company has a market share of less than **40%**, it is unlikely to be dominant.

Pjesët e tregut janë treguesi i parë i dobishëm i rëndësisë së secilës firmë në treg në krahasim me të tjerët. Pikëpamja e Komisionit është që, sa më e lartë të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë të jetë periudha kohore gjatë së cilës ajo mbahet, aq më shumë ka të ngjarë të ketë një tregues paraprak të dominancës. Nëse një kompani ka më pak se 40% pjesë të tregut, nuk ka gjasa të jetë në pozita mbizotëruese.

Shoqëria Vodafone Albania SHA është ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare, e cila në respektim të nenit 9 pika 2 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, VKK nr. 676 datë 07.02.2020, dhe VKK nr.759, datë 30.12.2020, duhet të mos abuzojë me pozitën e saj dominuese nëpërmjet:

- i. Vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit dhe detyrimin e orientimit e tyre drejt kostos së shërbimeve,
- ii. Vendosjes së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta, e të pafavorshme për konkurrencën,
- iii. Vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtese, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

Ofertat e shoqërisë Vodafone Albania SHA, me një çmim, i cili është i ulët krahasuar me atë të dy shoqërive të tjera që operojnë në tregun e telefonisë celulare, ngre dyshim të arsyeshëm se ndodhemi përpara një sjellje me orientim drejt “çmime grabitqare” (*predatory pricing*).

Me këtë mënyrë sjellje, në mos respektim të detyrimeve dhe kushteve të vendosura me VKK nr. 676 datë 07.02.2020 dhe VKK nr.759 datë 30.12.2020, shoqëria Vodafone Albania SHA, i vendos konkurrentët në kushte të pafavorshme për të konkurruar.

Gjatë periudhës së monitorimit, pranë Autoritetit të Konkurrencës janë depozituar 4 (katër) ankesa nga abonentë Vodafone⁴, të cilët janë ankuar se kanë patur pengesa për portabilitetin e numrit drejt operatorëve të tjerë në treg.

Komisioni i Konkurrencës, me shkresën nr 169 prot. datë 26.03.2021, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ftoi në seancë dëgjimore shoqërinë Vodafone Albania SHA.

Në seancën dëgjimore të datës 01.04.2021 me Komisionin e Konkurrencës, nga shoqëria Vodafone Albania SHA u pranua se, për shkak të problemeve të paraqitura në platformën CRDB (Central Reference Database), platformë e administruar nga nënkontraktori i AKEP, ka pengesa në portabilitetin e abonentëve nga shoqëria drejt operatorëve të tjerë, problematikë e cila, sipas shkresës me nr. 169/2 prot., i AK datë 12.04.2021 të shoqërisë Vodafone Albania SHA, është bërë me dije edhe në AKEP.

Për sa më sipër, gjykojmë se shoqëria Vodafone Albania SHA duhet të respektojë kushtet dhe detyrimet e vendosura në pikën 1 germa a) të vendimit nr. 676 datë 07.02.2020 të Komisionit të Konkurrencës, i rikonfirmuar ky detyrimin edhe në vendimin nr.759, datë 30/12.2020 të Komisionit të Konkurrencës.

Vendimi nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” dhe vendimin nr. 759 datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA” të Komisionit të Konkurrencës, diktojnë respektimin e kushteve dhe detyrimeve në respektim të kërkesave të nenit 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

⁴ Ankesa e z. A.N nr. 331 prot., datë 17.09.2020; ankesa e z. E.I nr. 432/1 prot datë 29.12.2020; ankesa e z. F.D nr. 88 datë 04.02.2021 dhe ankesa e z. K.B nr. 133 datë 10.03.2021.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 2, neni 8, neni 9, neni 24, germa d); neni 74 pika 1 germa c) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

1. Detyrimin e Shoqëria Vodafone Albania SHA, që në zbatim të VKK nr. 676 datë 07.02.2020 “Mbi autorizimin me kushte dhe detyrime të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, dhe VKK nr.759, datë 30.12.2020 “Mbi bashkimin me përthithje të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA”, për sa më poshtë:
 - a. Të mos hedhë në treg oferta promotionale, të cilat sjellin:
 - i. Vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit;
 - ii. Vendosjes së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta, e të pafavorshme për konkurrencën;
 - iii. Vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtese, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
 - b. Të sigurojë portabilitetin e numrave për klientët e rrjetit Vodafone Albania drejt operatorëve të tjerë.
2. T’i rekomandojmë AKEP, marrjen e masave për zgjidhjen e problematikave teknike në procedurën e portabilitetit të numrave, me qëllim sigurimin e konkurrencës mes operatorëve në treg.
3. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të Vendimit, shoqëria Vodafone Albania SHA ndëshkohet me penalitet sipas dispozitave të nenit 74, pika 1 germa c) e ligjit nr. 9121/2003.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 792, Datë 22.04.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.

Më datë 11 mars 2021, Asambleja e Jashtëzakonshme e ortakëve të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH, ka miratuar një ndryshim në statutin e shoqërisë.

Shoqëria TeleDoc Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin Austriak, me objekt veprimtarie ndërmjetësimin e konsultave mjekësore përmes telefonit dhe videos, ndihma mjekësore me telefon dhe video, call center, shërbime të tjera në fushën e shëndetësisë dhe aktivitete të tjera të profesioneve shëndetësore jo-mjekësore

Shoqëria TeleDoc Holding GmbH zotërohet nga Z. [...] (person fizik); [...] (shoqëri); Z. [...] (person fizik) dhe Viveca Beteiligungen GmbH (shoqëri).

TeleDoc Holding GmbH operon në Shqipëri përmes filialit të zotëruar indirekt prej tij TeleDoc Albania SHPK

Shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin Austriak, me objekt veprimtarie blerjen, mbajtjen, menaxhimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, sidomos pjesëmarrja në ndërmarrje dhe shoqëri të tjera.

Viveca Beteiligungen GmbH kontrollohet 100% nga LVP Holding Group dhe kjo e fundit kontrollohet 100% nga Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe.

Viveca Beteiligungen GmbH nuk kryen veprimtari në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet shoqërive të kontrolluara nga Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe.

Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe zotëron 89.05% të kapitalin aksionar të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SHA, 89.98% të kapitalin aksionar të Intersig Vienna Insurance Group SHA dhe 89.52% të kapitalin aksionar të VIG Services Shqipëri.

Sipas ndryshimeve në statutin e shoqërisë TeleDoc Holding GmbH, shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH do të ketë një të drejtë absolute të vetos kur shoqëria të kalojë rezoluta për çështje, transaksione dhe masa dhe/ose për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Nëse shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH voton kundër një rezolute të tillë nga Asambleja e Përgjithshme, ajo në asnjë rast nuk do të miratohet.

Përftimi i kontrollit nëpërmjet të drejtave që krijojnë mundësinë e një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrje, përbën një përfitim kontrolli, e parashikuar në nenin 10, pika 2 germa b e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara edhe në nenin 12, pika 1 germa a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i ofrimit të konsultave mjekësorë dhe ndihmës mjekësorë përmes telefonit dhe videos, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH nëpërmjet të drejtës absolute të vetos, të përcaktuar në statutin e shoqërisë.

Në Shqipëri, shoqëria TeleDoc Holding GmbH, nëpërmjet TeleDoc Albania SHPK, ofron shërbimin e konsultave mjekësorë dhe ndihmës mjekësorë përmes telefonit dhe videos,

ndërkohë që shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH nuk operon në Shqipëri. Shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH zotërohet nga shoqëria Vienna Insurance Group AG, e cila operon në Shqipëri, nëpërmjet shoqërive Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SHA dhe Intersig Vienna Insurance Group SHA, në tregun e sigurimit dhe ri-sigurimit të jo-jetës.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TeleDoc Holding GmbH nga shoqëria Viveca Beteiligungen GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 793, Datë 22.04.2021

“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zbatimi i VKK nr. 702, datë 30.07.2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD.

Baza Ligjore: Neni 8, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020 nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 702/2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, pikat II, III, IV e në vijim të dispozitivit, ka vendosur:
 - II. *Dhënien e rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD si subjekt me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH:*

1. Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;
 2. Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.
- III. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK:
1. çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës;
 2. çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.
- IV. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK për vlerësim paraprak çdo draft kontratë që do të lidhë me çdo rafineri, në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- V. T’i rekomandojë Albpetrol SHA, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
- i. Të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
 - ii. Të mbikëqyrë planet e furnizimit të tregut vendas nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- VI. T’i rekomandojë AKBN, në respektim të Marrëveshjes Hidrokarbure:
- i. Në bashkëpunim me Albpetrol, të bëjë parashikimet/planifikimin e nevojave të tregut vendas për furnizimet e nevojshme me naftë bruto;
 - ii. Të mbikëqyrë dhe monitorojë planet e prodhimit të naftës bruto nga ana e Bankers Petroleum Albania LTD.
- VII. Moszbatimi i përmbushjes së pikës II, III dhe IV të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit 9121/2003 ndëshkohet me penalitetet përkatëse.
- VIII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të pikave II, III dhe IV të këtij vendimi.
2. Bazuar në pikën VIII të VKK nr. 702/2020, Autoriteti Konkurrencës po monitoron sjelljen e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD duhet të raportojë çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të pikave II, III dhe IV të këtij vendimi.
 3. Në zbatim të VKK nr. 702/2020, si dhe në përgjigje të kërkesave tona nr. 307/5 prot. datë 12.11.2020, nr. 307/10 prot, datë 07.12.2020 dhe nr. 168 prot, datë 26.03.2021, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka depozituar informacion me anë të shkresve: nr. 729/3 prot, datë 20.11.2020; nr. 729/5 prot, datë 29.12.2020; nr. 119 prot, datë 29.01.202; si dhe nr. 306/1 prot, datë 8.04.2021 (protokolluar me tonën nr. 168/1 datë 8.4.2021).
 4. Nga përpunimi dhe vlerësimi i informacionit të depozituar si më sipër, në zbatim të VKK nr. 702/2020 dhe detyrave të lëna në seancën dëgjimore të datës 17 dhjetor 2020, rezulton se ky informacion nuk përmbush detyrimet e dhëna Bankers Petroleum Albania LTD

sipas pikës III të VKK nr. 702/2020, pasi nuk ka sjelle të dhënat e kërkuara sipas kësaj pike.

5. Konkretisht nga informacioni i depozituar me anë të shkresës nr. 306/1 prot, datë 8.4.2021 “Përgjigje shkrës tuajës nr.168 prot. datë 26.03.2021 për monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 702/2020 të AK” Bankërs Petroleum Albania LTD nuk ka zbatuar pikën III të VKK nr. 702/2020 në lidhje me kostot e naftës, prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure, sjellje kjo e cila në kuptim të nenit 74 pika c të ligjit nr. 9121/2003 gjohet në deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.
6. Në respektim të pikës IV të VKK 702/2020, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka depozituar pranë AK draft-kontratën e shitjes së naftës bruto, për periudhën 29 janar 2021 - 31 dhjetor 2021, ndërmjet Bankers Petroleum Albania LTD dhe rafinerisë vendase AL. Global Oil SHA.
7. Pas vlerësimit paraprak të draft-kontratës, nëpërmjet shkresës nr. nr. 306/1 prot, datë 8.04.2021, ndërmarrjes Bankers i është kërkuar bërja e ndryshimeve përkatëse referuar pikave 3.2 dhe 3.3 të nenit 3, si dhe pikës 6.1 të nenit 6 të draft-kontratës, me qëllim vendosjen e Blerësit AL. Global Oil SHA përballë kushteve të drejta të tregtimit.
8. Në përgjigje të këtyre kërkesave, ndërmarrja Bankers ka bërë amendimin e neneve 3 dhe 6 të kontratës fillestare. Konkretisht pika 3.2 është riformuluar duke u hequr e drejta e Bankers për të zgjedhur nëse do të dorëzojë vëllimet e naftës bruto të kërkuara nga blerësi AL. Global Oil SHA, si dhe përcaktohet më qartë procedura e negocimit, nëpërmjet takimeve dhe/ose komunikimeve elektronike, midis palëve mbi hartimin e Programit Mijor të Dorëzimit të naftës bruto, duke reflektuar vërejtjet e bëra nga AK. Por në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 9121/2003, ku sanksionohet se: *“1. Anëtarët e Komisionit dhe të gjithë punonjësit e Sekretariatit ose personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni për zbatimin e këtij ligji ruajnë sekretin profesional dhe nuk u japin të dhëna konfidenciale, të siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur duhet të dëshmojnë përpara gjykatës. Kjo vlen dhe pas mbarimit të detyrës. 2. Publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret tregtar.”*, Bankers me pa të drejtë shprehet se: *“Për shkak të detyrimeve kontraktore për konfidencialitetin e këtyre elementëve të marrëdhënies kontraktore e kemi objektivisht të pamundur t’ju vëmë në dispozicion në mbështetje të kësaj komunikimit me email që do të konfirmonin këtë deklaram tonin”*.
9. Sa i përket amendimit të nenit 6.1, ai është riformuluar duke përcaktuar sasinë e furnizimit me naftë bruto të rafinerisë AL.Global Oil SHA edhe për muajt prill, maj e qershor 2021, ndërsa për muajt korrik-dhjetor 2021, përcaktohet se *palët në baza tre mujore do të bien dakord bashkërisht për sasinë e naftës bruto që do të dorëzohet cdo muaj sipas parashikimeve të prodhimit të shitësit/Bankers dhe furnizimin me prodhim të nevojitur nga blerësi/AL.Global*.
10. Sa më sipër rezulton se Bankers në amendimin e bërë nuk ka zbatuar kërkesat e AK sipas shkresës nr. 168 prot, datë 26.03.2021, mbi përcaktimin e sasisë së furnizimit të

naftës bruto për gjithë muajt e vitit 2021, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA, me qëllim vendosjen e Blerësit Al. Global Oil përballë kushteve të drejta të tregtimit.

11. Refruar pikës II/2 të VKK nr. 702/2020, ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD si një ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH, i është rekomanduar që: *“Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil”*.
12. Për vetë natyrën periodike dhe të vazhdueshme të kontratës së furnizimit me naftë bruto, në përmbushje të detyrimeve që ka Bankers si palë furnizuese me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto, nevojitet që në kontratën përkatëse të përcaktohet sasia e furnizimit të naftës bruto për muaj, bazuar në nevojat normale të rafinerisë Al.Global Oil SHA, si dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në kontratë me qëllim vendosjen e Blerësit Al. Global Oil përballë kushteve të drejta të tregtimit.
13. Për sa më sipër konstatohet moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara sipas pikës III të VKK nr. 702/2020 nga ana e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 24, shkronja (d), nenin 45 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD, si ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto, të zbatojë detyrimet e dhëna me VKK nr. 702/2020.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD si ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e prodhimit të naftës bruto në RSH:
 - Të aplikojë kushte tregtimi të barabarta për veprime tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktore;
 - Të furnizojë ndërmarrjet e përpunimit të naftës bruto në tregun vendas, në respektim të marrëdhënieve kontraktore bazuar në dispozitat e Kodit Civil.
- III. Detyrimin e Bankers Petroleum Albania LTD të depozitojë pranë AK:
 - çdo raportim tremujor mbi kostot e naftës;
 - çdo raportim tremujor mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure.
- IV. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 702/2020, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN”, periudha e monitorimit e përcaktuar në pikën VIII, shtyhet deri në 31 korrik të vitit 2022.

- V. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma (c) të ligjit nr. 9121/2003.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 794, Datë 27.04.2021

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatimin e masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.04.2021 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatimin e masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, neni 74, pika 1, shkronja (b), neni 75, pika 1 dhe neni 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003); Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi zbatimin e masës së përkohshme nga ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 783, datë 12.03.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.
2. Për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, Komisioni i

Konkurrencës me vendimin nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, ka vendosur:

1. “Marrjen e masës së përkohshme për eliminimin e pasojave antikonkurruese sipas nenit 44, pika 1, si vijon:
 - a. *Ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore t’i japin fund bashkëpunimit mes tyre duke u sjellë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre tregtar sa i përket: importeve të produkteve; caktimit të çmimit të shitjes dhe/ose ndarjes së tregut përkatës; si dhe përdorimit të të drejtave ekskluzive.*
 2. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen dijeni të këtij vendimi.
 3. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 4. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrjet ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.
 5. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrjet të veprojnë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003”.
3. Në zbatim të vendimeve të mësipërme të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 138/2, datë 12.03.2021 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë kësaj periudhe të hetimit paraprak kanë proceduar me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO - GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO - MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, I.A.M. SHPK, AGROHELP-SA SHPK, BESNIKU SHPK.
 4. Vendimet nr. 783, datë 12.03.2021 dhe nr. 784, datë 12.03.2021, u janë njoftuar ndërmarrjeve gjatë inspektimeve të kryera.
 5. Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të masës së përkohshme, referuar informacionit të administruar nga inspektimet e realizuara në ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, është analizuar sjellja e këtyre ndërmarrjeve.
 6. Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve të inspektuara rezultoi se: ndërmarrjet AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK kanë realizuar sjellje të koordinuar në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, duke importuar plehrat kimike: Hidrogjenortofosfat diamoni (DAP), Nitrat dhe URE në fillim të vitit 2021, dhe duke hedhur këto produkte në treg me çmim të rritur nga muaji shkurt 2021 e në vijim. Kjo sjellje antikonkurruese në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, ka vazhduar edhe pas marrjes në dijeni të VKK nr.

784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”.

7. Theksojmë se nga inspektimet e realizuara në këto ndërmarrje rezultoi se në faturat e blerjes dhe shitjes së këtyre ndërmarrjeve nuk përcaktohet produkti i tregtuar, në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, sjellje e cila e bën këtë treg në pjesën më të madhe të tij informal, duke cënuar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
8. Sa më sipër konstatohet se nga ana e ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK nuk është zbatuar masa e përkohshme dhënë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, sjellje e cila përbën kundërvajtje administrative dhe në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (b), të ligjit nr. 9121/2003, sanksionohet në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës.
9. Zbatimi i masës së përkohshme sipas VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, do të vijojë të vlerësohet deri në përfundim të procedurës hetimore.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 germa d, nenin 26, nenin 42, nenin 44, nenin 74, pika 1, germa (b), nenin 75, pika 1, dhe 76, pika 1, germa b), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Gjeditjen e ndërmarrjeve për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, si vijon:
 1. Gjeditjen e ndërmarrjes “AGRO BLEND” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë;
 2. Gjeditjen e ndërmarrjes “MBM” SHPK përkatësisht në shumën 2 000 000 (dy milion) Lekë;
 3. Gjeditjen e ndërmarrjes “ÇAÇA” SHPK përkatësisht në shumën 500 000 (pesë qind mijë) Lekë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK të veprojnë në përputhje me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”.
- III. Në rast të moszbatimit të masës së përkohshme edhe në vijim, Komisioni i Konkurrencës do të vendosë sanksionet e parashikuara në nenin 76, pika 1, germa b),

të ligjit nr. 9121/2003, deri sa ndërmarrjet të veprojnë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 795, Datë 29.04.2021

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë
Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfitimin e kontrollit të shoqërisë Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA.

Pala Blerëse: Shoqëria TV Klan SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtarinë në fushën e mediave televizive, prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji, me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara për publikun, nëpërmjet valëve elektromagnetike, satelitëve apo me çdo formë tjetër të transmetimit televiziv.

Pala Shitëse: Z. Pal Toma është person fizik, shtetas shqiptar, aksioner 100% i aksioneve të shoqërisë Radio Klan SHA.

Target: Radio Klan SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtarinë radiofonike, që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve dhe

informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, sinjaleve të koduara, të shkrimit, të destinuara këto për publikun.

Më datë 3 mars 2021, shoqëria TV Klan SHA dhe personi fizik Pal Toma kanë nënshkruar “Marrëveshje për Blerje Aksionesh”, me objekt blerjen e aksioneve të shoqërisë target, Radio Klan SHA.

Bazuar në këtë marrëveshje, shoqëria TV Klan SHA do të blejë të gjitha aksionet e zotëruara nga z. Pal Toma dhe pas transaksionit, TV Klan SHA do të jetë zotërues i 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, Radio Klan SHA.

Me vendimin nr. 45, datë 18.03.2021, Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka miratuar ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Radio Klan” SHA., licencuar për subjektin audio kombëtar “Radio Klan”.

Me anë të këtij transaksioni, shoqëria TV Klan SHA ka për qëllim diversifikimin e aktiviteteve dhe plotësimin e tyre në fushën mediatike.

Vlerësimi i konkurrencës

Transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i shërbimeve mediatike audio dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është përfitimi i kontrollit të shoqërisë Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA.

Shoqëria TV Klan SHA kryen aktivitet ekonomik në tregun e shërbimeve mediatike audiovizive dhe shoqëria Radio Klan SHA kryen aktivitet në tregun e shërbimeve mediatike audio në Shqipëri.

Shoqëritë veprojnë në tregje të ndryshme të transmetimeve mediatike dhe përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Radio Klan SHA nga shoqëria TV Klan SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 796, Datë 29.04.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, të zhvilluara nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, të zhvilluara nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 45, pika (2), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003); Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”, miratuar me VKK nr. 437, datë 5.10.2016.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, të zhvilluara nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë”,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur:

1. Nisur nga konstatimet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, mbi disa shkelje të konkurrencës në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, të evidentuara edhe në vendimet e KPP me nr. 209/4 prot, datë 11.03.2021 dhe nr. 228/5 prot, datë 11.03.2021, të cilat i janë

përcjellë Autoritetit të Konkurrencës, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në respektim të neneve 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka ndjekur procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të këtij rasti.

2. Referuar rezultateve të këtij vlerësimi, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, me anë të vendimit nr. 785, datë 25.03.2021 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, kanë filluar procedurat e hetimit paraprak në tregun objekt hetimi, me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme, bazuar në nenet 33 dhe 34, dhe kryerjen e inspektimeve në bazë të nenit 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003, si dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 134/4, datë 25.03.2021 “Autorizim Inspektorësh”.
4. Në vijim të procedurave të hetimit paraprak ndërmarrja Eagle Cons SHPK ka depozituar pranë AK-së shkresën e saj nr. 32 prot, datë 19.04.2021, me lëndë “Dërgohet relacion shpjegues në lidhje me hetimin paraprak” (protokolluar pranë AK me nr. 134/16 prot, datë 19.04.2021), si dhe ndërmarrja M.C. Catering SHPK, ka depozituar shkresën e saj me nr. 61 prot, datë 19.04.2021, me lëndë “Dërgohet relacion shpjegues në lidhje me hetimin paraprak” (protokolluar pranë AK me nr. 134/17 prot, datë 19.04.2021).
5. Nëpërmjet këtyre shkresave ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK, referuar Rregullores “Për procedurat e angazhimeve”, si dhe nenit 45 të ligjit nr. 9121/2003, kanë dhënë sqarimet përkatëse dhe kanë paraqitur vullnetarisht angazhimet e tyre me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të identifikuar të konkurrencës në tregun objekt hetimi, dhe përmbushjen e menjëherëshme të këtyre angazhimeve.
6. Sa më sipër, në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, miratuar me VKK nr. 437, datë 5.10.2016, angazhimet janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrjet nën hetim, duke bërë të nevojshme vlerësimin nëse këto angazhime janë të qarta, të vetëekzekutueshme, të përshtatshme për të eliminuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës, duke rivendosur konkurrencën në treg dhe siguruar ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.

8. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, *treg përkatës produkti është tregu i prokurimit publik me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V.*
9. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Për vlerësimin e impaktit që shkaktonte ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, *tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet Tregu i prokurimit publik me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.*

II.2 Vlerësimi i sjelljes dhe angazhimeve të ndërmarrjeve

10. Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurën e hapur të prokurimit të zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, më datë 18.01.2021, me objekt: Loti I: “Blerje mish viçi, mish pule dhe vezë”; Loti IV: “Blerje artikuj ushqimor”; dhe Loti V: “Blerje fruta dhe zarzavate”, vihet re se:
 1. Operatorët ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK, ortakët e të cilëve kanë lidhje familjare, (janë motër e vëlla binjakë), e zhvillojnë aktivitetin e tyre në të njëjtën zyrë qendrore, me adresë të përbashkët;
 2. Operatorët ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK, kanë punonjës të përbashkët, të cilët merren me përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe ndjekjen e procedurave të tyre pranë Autoritetit Kontraktor;
 3. Të dy operatorët ekonomikë Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK kanë autorizuar të njëjtin person për të kryer kampionimin e mostrave pranë ISUV;
 4. Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga këta ofertues, për Lotin IV: “Blerje artikuj ushqimor”, rezultoi se nga 22 artikuj të këtij loti, për 16 artikuj janë paraqitur mostra të njëjta nga të dy operatorët ekonomikë. 16 mostrat e paraqitura nga të dy operatorët ekonomikë kanë të njëjtin emërtim, prodhues dhe të njëjtën datë skadence.
11. Referuar shqetësimeve të ngritura nga DPÇK, Bashkia Tiranë, mbi vijimësinë e procedurave të prokurimit objekt hetimi (shkresat e DPÇK nr. 464 prot, datë 13.04.2021 dhe nr. 464/1 prot, datë 15.04.2021, si dhe shkresa e KPP nr. 209/9 prot, datë 19.04.2021, përcjellë për dijeni AK-së) rezultoi se jemi përballë një situatë emergjence dhe nevojë ekstreme të furnizimit të përditshëm me ushqime të çerdheve dhe kopshteve publike të Tiranës.
12. Nisur nga kjo situatë e krijuar, si dhe duke pasur parasysh që rastet e “zgjidhjes me angazhime” mund të sjellin një ndryshim me të shpejtë dhe efektiv në treg, Autoriteti i Konkurrencës ka identifikuar si më sipër shqetësimet e ngritura të konkurrencës të cilat mund të eliminohen me marrjen e angazhimeve nga ana e ndërmarrjeve.
13. Poçedurat me angazhime çojnë në marrjen e vendimeve me angazhime, të cilat pas miratimit bëhen detyruese për ndërmarrjet të cilave i'u adresohet ky vendim si dhe

çon në përfundimin e procedurave hetimore, për të cilat nuk është e domosdoshme kryerja e të gjitha hapave procedurale të hetimit.

14. Bazuar në Rregulloren “Për procedurat e angazhimeve”, e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrjet M.C. Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK kanë paraqitur vullnetarisht angazhimet e tyre me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun e prokurimit objekt hetimi, dhe përmbushjen e menjëherëshme të këtyre angazhimeve. Sipas këtyre ndërmarrjeve është keqinterpretuar sjellja e tyre në procedurën e prokurimit objekt i këtij hetimi, për shkak të lidhjes familjare që ato kanë.
15. Konkretisht ndërmarrja Eagle Cons SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:
 1. Eagle Cons SHPK ka ofertuar deri më sot dhe do të ofertojë në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me asnjë konkurent tjetër, në lidhje me: çmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit, qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar;
 2. Eagle Cons SHPK ka operuar dhe do të operojë me punonjësit e saj, në mënyrë të pavarur si më sipër;
 3. Duke qenë se ortakët e shoqërisë Eagle Cons SHPK dhe shoqërisë M.C. Catering SHPK, janë familjarë, motër e vëlla, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, me qëllim evitimin e ndonjë keqkuptimi, marrin angazhimin se nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive, njëkohësisht me dy oferta të ndryshme, pavarësisht se janë dy shoqëri të pavarura nga njëra-tjetëra.
16. Ndërmarrja M.C. Catering SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:
 1. M.C. Catering SHPK ka ofertuar deri më sot dhe do të ofertojë në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me asnjë konkurent tjetër, në lidhje me: çmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit, qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar;
 2. M.C. Catering SHPK ka operuar dhe do të operojë me punonjësit e saj, në mënyrë të pavarur si më sipër;

3. Duke qene se ortakët e shoqërisë M.C. Catering SHPK dhe shoqërisë Eagle Cons SHPK, janë familjarë, motër e vëlla, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, me qëllim evitimin e ndonjë keqkuptimi, marrin angazhimin se nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive, njëkohësisht me dy oferta të ndryshme, pavarësisht se janë dy shoqëri të pavarura nga njëra-tjetëra.
17. Në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, angazhimet e mësipërme janë marrë nga ndërmarrjet nën hetim për gjithë periudhën kohore në të ardhmen. Këto agazhime janë të qarta, të vetëekzekutueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrjet.
18. Shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës konsistojnë në dyshimin e një marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomik Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të ushqimeve të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, sjellje e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
19. Angazhimet e depozituara vullnetarisht nga ndërmarrjet M.C. Catering SHPK dhe Eagle Cons SHPK, vlerësohen të përshtatshme për të eliminuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës, të identifikuara nga Autoriteti i Konkurrencës, pasi konkurrenca midis ndërmarrjeve në treg bëhet efektive kur këto ndërmarrje operojnë në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me njëra-tjetrën, dhe për më tepër kur ndërmarrjet në fjalë marrin përsipër të mos ofertojnë njëkohësisht me dy oferta konkurruese të ndryshme në të njëjtën procedurë prokurimi, për çdo prokurim që ka për objekt një nga veprimtaritë e tyre, duke siguruar ruajtjen e konkurrencës efektive në të gjitha tregjet e prokurimit ku këto ndërmarrje ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre.
20. Sa më sipër vlerësojmë se këto angazhime mund të sjellin një ndryshim me të shpejtë dhe efektiv në treg, duke eliminuar shqetësimet e ngritura të konkurrencës në tregun e prokurimit të ushqimeve, si dhe duke dhënë garanci për sjelljen e këtyre ndërmarrjeve edhe gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha tregjet e prokurimit ku këto ndërmarrje operojnë sipas objektit të veprimtarisë së tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 45, pika (2), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2021”, Loti I, Loti IV dhe Loti V, zhvilluar nga

Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë;

- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C. Catering SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si vijon:
 1. Ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C. Catering SHPK gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre:
 - a) do të ofertojnë në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me asnjë konkurent tjetër, në lidhje me: çmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit, qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar;
 - b) do të operojnë me punonjësit e tyre, në mënyrë të pavarur si më sipër;
 - c) nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive, njëkohësisht me dy oferta të ndryshme.
- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.
- IV. Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve Eagle Cons SHPK dhe M.C.Catering SHPK.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM
Nr. 797, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë IUTECREDIT ALBANIA SHA për rivlerësimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Rivlerësimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për sa i takon shoqërisë “IuteCredit Albania” SHA.

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 42 dhe neni 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “IuteCredit Albania” SHA për rivlerësimin e Vendimit 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”,

VËREN SE:

Autoriteti bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka monitoruar tregun ku ushtrojnë veprimtarinë ekonomike subjektet financiare jo banka, konkretisht tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimit të pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike, të cilat rezultuan me karakteristikat e një tregu të përqendruar.

Në vijim të monitorimit Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003, me Vendimin nr. 712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak.

Pas mbledhjes së të dhënave dhe analizave të kryera gjatë hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konstatoi se mund të ketë shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka. Mbështetur në sa më sipër Komisioni i Konkurrencës morri Vendimin

nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për të verifikuar nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, ndërmarrja “IuteCredit Albania” SHA, me shkresën nr. 161/32 prot., datë 19.04.2021, ka paraqitur kërkesën për rivlerësimin e këtij vendimi. Nëpërmjet këtij ankimi drejtuar Komisionit të Konkurrencës ndërmarrja “IuteCredit Albania” SHA ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 që hap hetimin e thelluar në këtë treg.

Lidhur me kërkesën për rivlerësimin e vendimit, sqarojmë se Vendimi nr. 772, datë 11.02.2021, që hap hetimin e thelluar është një vendim i cili në përmbajtje e tij përcakton ndërmarrjet ndaj të cilave do të sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për të bërë analiza dhe vlerësuar nëse ka shkelje të ligjit nr. 9121/2003. Në përmbajtjen e vetë vendimit nuk ka asnjë sanksion që mund të cenojë ndonjë interes të ligjshëm të ndërmarrjeve.

Mbështetur në nenin 43 të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës është i detyruar që të fillojë procedurat e hetimit të thelluar kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës. Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar dhe pasi ka dëgjuar edhe palët Komisioni i Konkurrencës del me një vendim përfundimtar të mbështetur në provat, analizat e kryera dhe qëndrimet e palëve.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “IuteCredit Albania” SHA është i pabazuar në ligj, pasi neni 43 i ligjit nr. 9121/2003 ja njeh qartësisht këtë kompetencë Komisionit. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën e një institucioni hetues për të mbikëqyr tregjet ku mund të ketë shkelje të tij, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Nuk qëndron pretendimi i ankuesit për cenim të interesave të tyre të ligjshme ndërkohë që nuk kemi një vendim përfundimtar nga Komisioni i Konkurrencës.

Lidhur me pretendimet e ndërmarrjes “IuteCredit Albania” SHA, për rivlerësimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 (germa d); nenit 26, nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “IuteCredit Albania” SHA për rivlerësimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 798, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë UNIONI FINANCIAR TIRANË SHA për shfuqizimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për sa i takon shoqërisë “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA.

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 42 dhe neni 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA për shfuqizimin e Vendimit 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”,

VËREN SE:

Autoriteti bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka monitoruar tregun ku ushtrojnë veprimtarinë ekonomike subjektet financiare jo banka, konkretisht tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimit të pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike, të cilat rezultuan me karakteristikat e një tregu të përqendruar.

Në vijim të monitorimit Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003, me Vendimin nr. 712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak.

Pas mbledhjes së të dhënave dhe analizave të kryera gjatë hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konstatoi se mund të ketë shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka. Mbështetur në sa më sipër Komisioni i Konkurrencës morri Vendimin

nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për të verifikuar nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, ndërmarrja “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA, me shkresën nr. 161/10 prot., datë 06.04.2021, ka paraqitur ankim administrativ për shfuqizimin e këtij vendimi. Nëpërmjet këtij ankimi drejtuar Komisionit të Konkurrencës ndërmarrja “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 që hap hetimin e thelluar në këtë treg.

Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit, sqarojmë se Vendimi nr. 772, datë 11.02.2021, që hap hetimin e thelluar është një vendim i cili në përmbajtje e tij përcakton ndërmarrjet ndaj të cilave do të sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për të bërë analiza dhe vlerësuar nëse ka shkelje të ligjit nr. 9121/2003. Në përmbajtjen e vetë vendimit nuk ka asnjë sanksion që mund të cenojë ndonjë interes të ligjshëm të ndërmarrjeve.

Mbështetur në nenin 43 të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës është i detyruar që të fillojë procedurat e hetimit të thelluar kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës. Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar dhe pasi ka dëgjuar edhe palët Komisioni i Konkurrencës del me një vendim përfundimtar të mbështetur në provat, analizat e kryera dhe qëndrimet e palëve.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA është i pabazuar në ligj, pasi neni 43 i ligjit nr. 9121/2003 ja njeh qartësisht këtë kompetencë Komisionit. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën e një institucioni hetues për të mbikëqyr tregjet ku mund të ketë shkelje të tij, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Nuk qëndron pretendimi i ankuesit për cenim të interesave të tyre të ligjshme ndërkohë që nuk kemi një vendim përfundimtar nga Komisioni i Konkurrencës.

Lidhur me pretendimet e ndërmarrjes “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA, për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d); nenit 26, nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “UNIONI FINANCIAR TIRANË” SHA për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 799, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë FONDI BESA SHA për shfuqizimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për sa i takon shoqërisë “Besa” SHA.

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 42 dhe neni 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “Fondi Besa” SHA për shfuqizimin e Vendimit 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”,

VËREN SE:

Autoriteti bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka monitoruar tregun ku ushtrojnë veprimtarinë ekonomike subjektet financiare jo banka, konkretisht tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimit të pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike, të cilat rezultuan me karakteristikat e një tregu të përqendruar.

Në vijim të monitorimit Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003, me Vendimin nr. 712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak.

Pas mbledhjes së të dhënave dhe analizave të kryera gjatë hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konstatoi se mund të ketë shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka. Mbështetur në sa më sipër Komisioni i

Konkurrencës morri Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për të verifikuar nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, ndërmarrja “Fondi Besa” SHA, me shkresën nr. 161/31 prot., datë 14.04.2021, ka paraqitur ankim administrativ për shfuqizimin e këtij vendimi. Nëpërmjet këtij ankimi drejtuar Komisionit të Konkurrencës ndërmarrja “Fondi Besa” SHA ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 që hap hetimin e thelluar në këtë treg.

Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit, sqarojmë se Vendimi nr. 772, datë 11.02.2021, që hap hetimin e thelluar është një vendim i cili në përmbajtje e tij përcakton ndërmarrjet ndaj të cilave do të sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për të bërë analiza dhe vlerësuar nëse ka shkelje të ligjit nr. 9121/2003. Në përmbajtjen e vetë vendimit nuk ka asnjë sanksion që mund të cenojë ndonjë interes të ligjshëm të ndërmarrjeve.

Mbështetur në nenin 43 të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës është i detyruar që të fillojë procedurat e hetimit të thelluar kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës. Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar dhe pasi ka dëgjuar edhe palët Komisioni i Konkurrencës del me një vendim përfundimtar të mbështetur në provat, analizat e kryera dhe qëndrimet e palëve.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “Fondi Besa” SHA është i pabazuar në ligj, pasi neni 43 i ligjit nr. 9121/2003 ja njeh qartësisht këtë kompetencë Komisionit. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën e një institucioni hetues për të mbikëqyr tregjet ku mund të ketë shkelje të tij, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Nuk qëndron pretendimi i ankuesit për cenim të interesave të tyre të ligjshme ndërkohë që nuk kemi një vendim përfundimtar nga Komisioni i Konkurrencës.

Lidhur me pretendimet e ndërmarrjes “Fondi Besa” SHA, për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d); nenit 26, nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Fondi Besa” SHA për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 800, Datë 21.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë ÇAÇA SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 ‘Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”, për sa i takon shoqërisë “ÇAÇA” SHPK

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 44, neni 74, pika 1 germa b, neni 75 pika 1 dhe neni 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “ÇAÇA” SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 783, datë 12.03.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.

Për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore nga mundësia e shkeljeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, për ndërmarrjet që operojnë në këtë treg morri Vendimin nr. 784, datë 12.03.2021 për vendosjen e masës së përkohshme.

Në vijim të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës u kryen inspektime dhe analiza të ndërmarrjeve që janë nën hetim, nga ku rezultoi se ndërmarrja ankuese “ÇAÇA” SHPK ka sjellje të koordinuar në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003, për produktet plehra kimike: Hidrogjenortofosfat diamoni (DAP), Nitrat dhe URE. Ndërmarrja ankuese ka rritur çmimin e produkteve në tregun e plehrave kimike nga muaji shkurt 2021 e në vijim edhe pse ka marrë dijeni për marrjen e masës së përkohshme nga Komisioni i Konkurrencës. Lidhur me Vendimin nr. 794, datë 27.04.2021 të Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrja “ÇAÇA” SHPK ka paraqitur ankim me shkresën nr. 138/57 prot., datë 04.05.2021. Nëpërmjet këtij ankimi ndërmarrja “ÇAÇA” SHPK ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me VKK nr. 794, datë 27.04.2021 dhe në përfundim ka kërkuar shfuqizimin e tij.

Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit, ndërmarrja “ÇAÇA” SHPK nuk ka paraqitur shkaqe ligjore që të mbështesin një kërkesë të tillë në Autoritetin e Konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 74, pika 1/b, kur konstaton se nuk janë zbatuar kushtet dhe detyrimet e dhëna ndaj ndërmarrjeve në vendimin e masës së përkohshme, merr vendim për sanksionimin e tyre me gjobë.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “ÇAÇA” SHPK është i pabazuar në ligj pasi sjellja e ndërmarrjes është në shkelje të nenit 44 të ligjit nr. 9121/2003, për masat e përkohshme. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën për të marrë vendime, konkretisht dhënien e masave të përkohshme për raste urgjente, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Lidhur me pretendimet e “ÇAÇA” SHPK, për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d), nenit 26, nenit 44, nenit 74, pika 1 germa b, nenit 75 pika 1 dhe nenit 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “ÇAÇA” SHPK për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 801, Datë 21.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë AGRO BLEND SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 ‘Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”, për sa i takon shoqërisë “Agro Blend” SHPK

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 44, neni 74, pika 1 germa b, neni 75 pika 1 dhe neni 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “Agro Blend” SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 783, datë 12.03.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.

Për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore nga mundësia e shkeljeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, lidhur me sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg morri Vendimin nr. 784, datë 12.03.2021 për vendosjen e masës së përkohshme.

Në vijim të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës u kryen inspektime dhe analiza të ndërmarrjeve që janë nën hetim, nga ku rezultoi se ndërmarrja ankuese “Agro Blend” SHPK ka sjellje të koordinuar në kuptimtë nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003, për produktet plehra kimike: Hidrogjenortofosfat diamoni (DAP), Nitrat dhe URE. Ndërmarrja ankuese ka rritur çmimin e produkteve në tregun e plehrave kimike nga muaji shkurt 2021 e në vijim edhe pse ka marrë dijeni për marrjen e masës së përkohshme nga Komisioni i Konkurrencës. Lidhur me Vendimin nr. 794, datë 27.04.2021 të Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrja “Agro Blend” SHPK ka paraqitur ankim me shkresën nr. 138/59 prot., datë 11.05.2021. Nëpërmjet këtij ankimi ndërmarrja “Agro Blend” SHPK ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me VKK nr. 794, datë 27.04.2021 dhe në përfundim ka kërkuar shfuqizimin e tij.

Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit, ndërmarrja “Agro Blend” SHPK nuk ka paraqitur shkaqe ligjore që të mbështesin një kërkesë të tillë në Autoritetin e Konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 74, pika 1/b, kur konstaton se nuk janë zbatuar kushtet dhe detyrimet e dhëna ndaj ndërmarrjeve në vendimin e masës së përkohshme, merr vendim për sanksionimin e tyre me gjobë.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “Agro Blend” SHPK është i pabazuar në ligj pasi sjellja e ndërmarrjes është në shkelje të nenit 44 të ligjit nr. 9121/2003, për masat e përkohshme. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën për të marrë vendime, konkretisht dhënien e masave të përkohshme për raste urgjente, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Lidhur me pretendimet e “Agro Blend” SHPK, për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d), nenit 26, nenit 44, nenit 74, pika 1 germa b, nenit 75 pika 1 dhe nenit 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Agro Blend” SHPK për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 802, Datë 21.05.2021

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard Ypi	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Opinion/rekomandim mbi projekt-vendimin e Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA,

VËREN SE:

1. ERRU-ja, nëpërmjet shkresës nr. 157 prot., datë 21.04.2021, kërkon vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 69, dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mbi Projekt-Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA”. Projekt-vendimi shoqërohet me relacionin shpjegues përkatës, i cili pasqyron procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të aplikimit të shoqërisë UK Sarandë SHA për ndryshimin e tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe mbledhjes e largimit të ujrave të ndotura, të cilat konsistojnë në unifikimin dhe vendosjen në një nivel të ri të tarifave të këtyre shërbimeve, të shitjes së ujit me shumicë, si edhe të tarifës fikse në zonën e shërbimit.

2. Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ERRU nëpërmjet strukturës së saj vendimmarrëse, Komisionit Kombëtar Rregullator, miraton çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik.
3. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU ka miratuar “Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”. Bazuar në këtë metodologji, shqyrtimi i aplikimit për ndryshim tarife fillon me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe analizën e treguesve të performancës. Rritja e tarifave duhet të bëhet gradualisht në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet në përmirësimin e performancës së shërbimeve. Tarifat e reja duhet të jenë të orientuara drejt kostove të justifikuara, rritjes së eficiencës, vendosjen e objektivave përkatës për përmirësimin e tyre, si edhe verifikimin e kriterit të përballueshmërisë së pagesës së faturës së shërbimeve nga konsumatorët. I gjithë procesi duhet të shoqërohet me transparencë ndaj publikut i cili duhet të informohet në një seancë dëgjimore paraprake mbi tarifat e reja që shoqëria synon të aplikojë në propozimin e saj.
4. Informacioni mbi aplikimin, si dhe Vendimi KKRR për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së me Vendimin KKRR-së; nr. 161 prot., datë 30.12.2020.
5. UK Sarandë SHA është licencuar me Vendimin e KKRR nr. 62, datë 06.09.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 86, datë 04.03.2021, për të kryer shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura për katër ne Bashkisë Sarandë që përfshin njësitë administrative Sarandë dhe Ksamil. Deri tani UK Sarandë ka zbatuar tarifat të miratuara nga ERRU sipas vendimit të KKRR-së nr. 15, datë 22.04.2015, përkatësisht për konsumatorët familjarë 52 lek/m³ për Sarandën dhe 50 lek/m³ për Ksamilin, për konsumatorët publikë e private 138 lek/3 për Sarandën, dhe 50 lek/m³ për Ksamilin.
6. UK Sarandë aplikon për rishikimin e tarifave pranë ERRU-së duke synuar rritjen dhe unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, si edhe duke përcaktuar objektiva të reja të treguesve kryesorë të performancës për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërisë dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.
7. ERRU ka shqyrtuar dhe vlerësuar informacionin mbi aplikimin për miratimin e tarifave të ndryshuara dhe vendosjen e tyre në një nivel të ri tarifar, si edhe ka miratuar projekt-vendimin përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë UK Sarandë SHA.”, ku miraton tarifat volumetrike të furnizimit me ujë, përkatësisht për konsumatorin familjar me një rritje prej 8 lek/m³ për Sarandën dhe 10 lek/m³ për Ksamilin ndaj tarifës aktuale, si edhe për konsumatorin publik

dhe privat me një rritje prej 2 lek/m³ për zonën e Sarandës dhe 90 lek/m³ për zonën e Ksamilit.

8. ERRU miraton në projekt vendim gjithashtu tarifat volumetrike të unifikuara për KUN (largimin e ujërave të ndotura) për të tre kategoritë e konsumatorëve, të cilat rriten me 5 lek/m³ për konsumatorët familjarë në të gjithë zonën e shërbimit, ndërsa rriten me 14 lek/m³ për Sarandën dhe me 25 lek/m³ për Ksamilin për konsumatorët publikë dhe privat. Përcaktimi i tarifës fikse të shërbimit është miratuar të rritet me 50 lekë/muaj për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit. Me anë të tarifave që do të miratojë ERRU për UK Sarandë, kjo e fundit arrin të mbulojë mbi 100% të kostove të O&M, si edhe deri 31% të kostove të amortizimit të aseteve të saj.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, rezulton se UK Sarandë SHA pas riorganizimit sipas nenit 14 të Vendimit të KKRR nr. 42, datë 09.12.2015, rezulton që vlerësimi i performancës bazohet në disa tregues krahasimi të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar dhe konstruktive nga ERRU. Treguesit e realizimit nga UK Sarandë SHA nga viti 2019 deri më sot tregojnë një performancë të mirë, pasi UK Sarandë SHA arrin të mbulojë deri në 73% të kostove totale të operimit & mirëmbajtjes, në të cilat përfshihen dhe kostot e amortizimit dhe të shlyerjes së kredive.
10. ERRU në analizën ekonomiko-financiare të saj ka analizuar drejt dhe ka marrë në konsideratë vetëm kostot e justifikuara të paraqitura nga UK Sarandë SHA, të cilat përcaktojnë nevojat për të ardhura të shoqërisë si faktori bazë përcaktues në procesin e miratimit të tarifave.
11. ERRU në miratimin e tarifave ka zbatuar në mënyrë korrekte kriterin e Përbalueshmërisë i cili rezulton në vlerën 1.8%, ndaj 5% që përcakton ky kriter si kufi maksimal.
12. ERRU bazuar në një analizë të saktë ka përcaktuar objektivat e performancës tekniko-financiare të shoqërisë në të ardhmen në përputhje me ato të propozuara nga kjo e fundit, por duke vendosur objektiv më agresiv në drejtim të uljes së treguesit të Ujit pa të Ardhura në 48% nga 51,1 % të propozuar nga shoqëria.
13. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2020 mbetet thuajse në të njëjtat nivele me ato të vitit 2019, me një ulje rreth 2%, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit duhet të jenë transparente dhe të kontabilizohen në përputhje me legjislacionin mbi kontabilitetin.
14. Për sa më sipër, rekomandimet e ERRU-së ndaj UK Sarandë SHA dhe vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës mbi projekt-vendimin “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Sarandë SHA”, janë në përputhje me ligjin nr. 8102/1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- a) Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Sarandë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- b) ERRU të kërkojë nga Ujësjiellës Kanalizime Sarandë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar, paraqitjen e subvencioneve të përfituara duke njoftuar Autoritetin e Konkurrencës brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 803, Datë 28.05.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e në tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”,

VËREN SE :

1. Nisur nga shqetësimet e ngritura në media mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal, bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, procedoi me kryerjen e monitorimeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.
2. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit të kryer pranë subjekteve që tregtojnë këtë produkt, u konstatua se çmimi i vajit të lulediellit ka pësuar rritje duke filluar që nga muaji dhjetor 2020, me një rritje prej 10 lekë deri në muajin mars, dhe në muajt në vazhdim kjo rritje ka vijuar me nga 5 lekë. Kryesisht vihet re një rritje më e dukshme tek çmimi i vajit të lulediellit, por gjatë monitorimit rezultoi se në muajt e fundit është rritur edhe çmimi i vajit të misrit.

3. Nga deklaratat e marra gjatë monitorimit, u konstatua një rritje periodike të çmimit të vajit të luledielli nga prodhuesit dhe tregtuesit me shumicë të këtij produkti. Vihet re se ndërmjet ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, kanë rritje të njëjta çmimi në afate të përafërta kohore.
4. Tregu i shitjes me shumicë përfshin si ofertën nga ndërmarrjet prodhuese ashtu edhe ndërmarrjet importuese të vajit vegjetal. Rritja e çmimit të vajit vegjetal është reflektuar në tregun e shitjes me pakicë dhe për pasojë duke rezultuar në çmime më të larta për konsumatorin fundor.
5. Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, mund të përbejë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim nën 4, pika 1 dhe nën 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nën 4, nën 9, nën 24, shkronja (d), nën 26, nën 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 tetor 2020 deri në 20 maj 2021.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 804, Datë 04.06.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi Hetimin Paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 dhe 2, e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve; dhe,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit paraprak;

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 719, datë 28.10.2020 vendosi: “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, për periudhën kohore Janar 2017 deri në Tetor 2020.

2. Në zbatim të këtij Vendimi, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që operojnë në tregun objekt hetimi; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Qendra Kombëtare e Biznesit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Porti Detar Vlorë SHA; Portit Detar Shëngjin SHA; Autoriteti Portual Durrës.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

3. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
4. Referuar VKK nr. 719, datë 28.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, *treg përkatës të produktit do të konsiderojmë:*
 - *Tregun e ngarkim/shkarkimit dhe depozitimit të karburanteve në portet Porti Vlora 1 dhe Porto Romano Durrës;*
 - *Tregun e importit të karburanteve dhe të shitjes me shumicë të karburanteve për dy nëntregjet: nëntregu i produktit benzinë; nëntregu i produktit naftë (diesel).*
5. Ndërmarrjet nën hetim e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
6. *Shërbimet e ngarkim- shkarkimit dhe depozitimit nëpërmjet rrugës detare ofrohen nga Porti Vlora -1 në Vlorë dhe Porto Romano në Durrës. Lidhur me mënyrën e funksionit të secilit port si dhe bazuar në marrëveshjet koncesionare, secili nga portet vlerësohet si treg përkatës gjeografik i veçantë.*
7. *Përsa i përket importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve ndërmarrjet nën hetim zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.*

II.2 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

8. Ndërmarrjes PIA SHA, i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj, në portin Vlora-1, si dhe ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale të nevojshme në shërbim të terminalit bregdetar. Në bazë të kontratës Koncesionare, Koncesionari PIA është i vetmi entitet, në të gjithë zonën e Gjirit të Vlorës (përfshirë zonën detare dhe platformat detare, nëse ka, të Gjirit të Vlorës), që do të lejohet të ndërtojë dhe të shfrytëzojë një terminal bregdetar dhe infrastrukturën e tij portuale, përfshirë këtu edhe platformat në det, si dhe i vetmi entitet i pajisur me të drejtën për të depozituar e trajtuar (ngarkim-shkarkim)

(nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti) naftë, produkte të naftës, produkte të gazit të lëngshëm dhe produkte të tjera të lëngshme. ***Në bazë të këtij koncesioni ndërmarrja PIA SHA zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të karburanteve në portin Vlora-1.***

9. Për ofrimin e shërbimit të trajtimit (ngarkim-shkarkimit) dhe depozitimit të naftës dhe të nënprodukteve të saj, në portin Vlora-1, ku operon koncesionari PIA SHA, ndodhen 13 depozita për karburantet me kapacitet total përdorimi XXX m³. PIA SHA ka hyr në marrëdhënie kontraktore me operatorët e kualifikuar të interesuar për të operuar në këtë terminal lidhur me këto depozita. Gjatë periudhës hetimore PIA ka depozituar 7 (shtatë) kontrata të lidhura ndër vite: 3 (tre) me shoqëri shqiptare dhe 4 (katër) me shoqëri të huaja.
10. PIA SHA lidh kontrata në terma afate gjatë, si dhe kërkon garanci financiare ose kontribut për investimet nga këta operatorë, duke i dhënë asaj mundësinë si ndërmarrje me pozitë dominuese, për të vendosur kushte kontraktore, të cilat mund të pengojnë, kufizojnë, ose shtrembërojnë konkurrencën në tregun përkatës.
11. Me vendimin e OSHA nr. 4, datë 01.04.2010 janë miratuar tarifat e shërbimeve portuale të aplikuara nga PIA në Portin Vlora 1. Në lidhje me tarifat për shërbimet ndihmëse të depozitimit si trajtimi (ngarkim/shkarkimi) i anijeve ose për shërbime të tjera tregtare që ajo kryen për klientët që kanë kontraktuar kapacitete në terminalin PIA, ato vendosen me marrëveshje midis palëve kontraktuale, *pasi nuk janë të miratuara paraprakisht nga OSHA*. PIA SHA nuk është e detyruar të shpallë dhe/ose të paraqesë për miratim pranë OSHA-së tarifat për shërbimet ndihmëse të depozitimit si trajtimi (ngarkim/shkarkimi) i anijeve ose për shërbime të tjera tregtare që ajo kryen për klientët që kanë kontraktuar kapacitete në terminalin PIA.
12. Në Porto Romano, Durrës, operojnë dy ndërmarrje koncesionare: (1) ndërmarrja Romano Port SHA, dhe (2) ndërmarrja Porti MBM.
13. Ndërmarrjes Romano Port SHA i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës. ***Në bazë të këtij koncesioni ndërmarrja Romano Port SHA zotëron pozitë dominuese për kapacitetin deri në 20.000 ton në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburante në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***
14. Tarifat e aplikuara për shërbimet portuale për Romano Port SHA, Porto Romano, Durrës, janë miratuar me vendimin e OSHA nr. 3, datë 04.03.2009, Vendimin nr. 6, datë 10.09.2009 dhe Vendimin nr. 1, datë 09.06.2014. Tarifat e ngarkim-shkarkimit të anijeve në Romano Port SHA përshihen në këto vendime të OSHA-së, *ndryshe nga koncesionari PIA SHA i cili i vendos këto tarifa me marrëveshje midis palëve.*
15. Për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të anijeve me karburante ndërmarrja koncesionare Romano-Port SHA ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me Agjencitë Detare/Spedicionere ose pritësin e mallit, pronarin e mallit (Operatorët Ekonomikë). Konkretisht gjatë periudhës hetimore Romano-Port SHA ka lidhur 18 kontrata tip, nga të cilat 8 kontrata me Operatorët

e tregut dhe 10 kontrata me Agjencitë Detare/Spedicionere. Këto janë kontrata Tip, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me të njëjtat kushte të përgjithshme për nga objekti, qëllimi, mënyra e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me realizimin e shërbimit të ngarkim/shkarkimit të anijeve, si dhe kushtet e tjera të kontratës me të cilën operon ndërmarrja Romano-Port në Porto Romano, Durrës.

16. Në kontrat përcaktohet se Koncesionari Romano Port SHA për ofrimin e shërbimeve të përpunimit (ngarkim-shkarkimit) të anijeve me karburante, aplikon tarifat e miratuara nga OSHA me vendimin nr. 3, datë 04.03.2009, vendimin nr. 6, datë 10.09.2009 dhe Vendimin nr. 1, datë 09.06.2014. Tarifat e papërcaktuara nga OSHA, negocohen me mirëkuptim mes palëve.
17. Ndërmarrja Porti MBM në bazë të kontratës koncesionare (ligji nr. 104/2015, datë 23.9.2015) ka fituar të drejtën ekskluzive për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, në Porto Romano Durrës, për një periudhë prej 35 vjetësh. ***Në bazë të këtij koncesioni ndërmarrja Porti MBM zotëron pozitë dominuese për kapacitetin mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburanteve në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***
18. Për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të anijeve me karburante, ndërmarrja koncesionare Porti MBM ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me Agjencitë Detare/Spedicionere ose pritësin e mallit, pronarin e mallit (Operatorët Ekonomikë). Konkretisht gjatë periudhës hetimore Porti MBM ka lidhur 11 kontrata tip, nga të cilat 5 kontrata me Operatorët e tregut dhe 6 kontrata me Agjencitë Detare/Spedicionere. Këto janë kontrata Tip, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me të njëjtat kushte të përgjithshme për nga objekti, qëllimi, mënyra e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me realizimin e shërbimit të ngarkim/shkarkimit të anijeve, si dhe kushtet e tjera të kontratës me të cilën operon ndërmarrja Porti MBM në Porto Romano, Durrës.
19. Për ofrimin e këtyre shërbimeve Koncesionari aplikon tarifat e miratuara me Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE nr. 5749/5, datë 10.09.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”, të cilat ofrohen në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e terminalit të Portit MBM. Tarifat e papërcaktuara në këtë udhëzim, negocohen me mirëkuptim mes palëve.
20. Tarifat e miratuara nga OSHA për ngarkim-shkarkimin e karburanteve si për Romano Port SHA dhe Portin MBM, në Porto Romano Durrës janë njësoj. Përsa i përket tarifave të tjera portuale tarifat maksimale janë të njëjta dhe për Romano Port SHA ka dhe tarifa minimale, por Porti MBM ka disa zëra shtesë për shkak të pozicionit të tij gjeografik.
21. *Referuar lidhjes aksionare në Porto Romano Durrës, rezulton se ekziston një lidhje integrimi vertikal e shoqërive koncesionare dhe shoqërive që kanë depozitat në këto koncesione, si dhe me importuesit/tregtarët me shumicë në tregun e karburanteve, duke i dhënë ndërmarrjeve koncesionare një fuqi tregu, e cila duke patur parasysh pozitën e koncesionarëve në treg, mund të çojë në lidhjen e marrëveshjeve të ndaluara gjë që bie në*

kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003 si dhe në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 9121/2003 nëpërmjet vendosjes së kushteve të padrejta të tregtimit dhe për pasojë në abuzim me pozitën e tyre në treg.

22. Në lidhje me tregun e importit dhe shitjes me shumicë, vihet re se pjesa më e madhe e karburanteve që importohen në vendin tonë është mbi XX% naftë dhe më pak se XX% benzinë. Pjesa më e madhe e importit të benzinës dhe naftës, për periudhën nën hetim, kryhet nëpërmjet Portit të Durrësit (rreth XX% e importit) dhe një pjesë e vogël e importit realizohet nëpërmjet portit të Vlorës.
23. Sjellja e koncesionarit PIA SHA si ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun përkatës, në lidhje me vet përcaktimin e tarifave për shërbimet ndihmës të depozitimit si trajtimi (ngarkim/shkarkimi) i anijeve ose për shërbime të tjera tregtare që ajo kryen për klientët që kanë kontraktuar kapacitete në terminalin PIA, si dhe lidhja e këtyre kontratave në terma afat gjatë me nënkontraktorët mund të përbëjë sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4 apo 9 të ligjit nr. 9121/2003.
24. Referuar strukturës së tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve, nga dy ndërmarrje koncesionare: (1) ndërmarrja Romano Port SHA, dhe (2) ndërmarrja Porti MBM, që operojnë në Porto Romano, Durrës, rezulton se ekziston një lidhje integrimi vertikal e shoqërive koncesionare dhe shoqërive që kanë depozitat në këto koncesione, si dhe me importuesit/tregtarët me shumicë në tregun e karburanteve, duke i dhënë ndërmarrjeve koncesionare një fuqi tregu, e cila duke patur parasysh pozitën e koncesionarëve në treg, mund të çojë në lidhjen e marrëveshjeve të ndaluara gjë që bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003 si dhe në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 9121/2003, nëpërmjet vendosjes së kushteve të padrejta të tregtimit dhe për pasojë në abuzim me pozitën e tyre në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 4 dhe 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve ndaj ndërmarrjeve:
 1. Koncesionarit PIA SHA dhe ndërmarrjeve që kanë kontrata depozitimi afatgjatë me të.
 2. Koncesionarit Romano Porto SHA dhe ndërmarrjen e integruar vertikalisht me të.
 3. Koncesionarit Porti MBM dhe ndërmarrjet e integruar vertikalisht me të.
 4. Ndërmarrjet të cilat kanë depozita në zonën e Porto Romanos dhe kanë kontrata me Romano Port SHA dhe Portin MBM.

- II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore 1 Janar 2017 deri në 30 Tetor 2020.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 805, Datë 04.06.2021

**“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT MBI SHOQËRINË DIGITAL CHARGING
SOLUTION GMBH (JV), NËPËRMJET BLERJES TË AKSIONEVE NGA SHOQËRIA
BP EUROPA SE.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar	
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar	
Z. Eduard YPI	Anëtar	
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar	Në mbledhjen e tij të datës 04.06.2021, shqyrtoi çështjen me:
Z. Denar BIBA	Anëtar	

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Digital Charging Solution GmbH (JV), nëpërmjet blerjes të aksioneve nga shoqëria BP Europa SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Digital Charging Solution GmbH (JV), nëpërmjet blerjes të aksioneve nga shoqëria BP Europa SE.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfitim të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Digital Charging Solution GmbH (JV), nga shoqëria BP Europa SE.

Më datë 29 mars 2021, palët kanë nënshkruar një Marrëveshje Investimi.

BP Europa SE është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin Gjerman, me objekt veprimtarie; nxjerrja, përfitimi, përpunimi, magazinimi, transporti dhe shpërndarja e gazit, naftës së përpunuar, gazit natyror dhe mineraleve të tjera, etj. BP Europa SE, është një filial indirekt i BP p.l.c., në Mbretërinë e Bashkuar.

BP p.l.c. realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së zotëruar prej saj, **Air BP Albania**, një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti; Veprime biznesi në fushën e tregtimit me shumicë të lëndëve djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive si dhe karburanteve për avionë dhe mjete motorike si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për shoqërinë.

Digital Charging Solution GmbH(JV) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me seli në Berlin, me objekt aktiviteti; zhvillimi, tregtimi dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve në fushën e lëvizjes, veçanërisht ofrimi i shërbimeve të informacionit dhe aksesit teknologjik në infrastrukturën e karikimit elektrik për makina elektrike dhe hibride dhe shërbime për funksionimin e rrjetit të stacioneve të karikimit për automjetet elektrike dhe hibride.

Shoqëria Digital Charging Solution GmbH nuk është prezente në Shqipëri.

Aktualisht aksionet në shoqërinë Digital Charging Solution GmbH zotërohen 100% nga shoqëria Your NOW Holding GmbH.

Your NOW Holding GmbH është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman. Shoqëria zotërohet nga BMV INTEC Beteiligungs GmbH dhe Daimler Mobility Services GmbH nga 50% të aksioneve të shoqërisë Your NOW Holding GmbH secila.

Digital Charging Solution GmbH(JV), kontrollohet bashkërisht indirekt nga Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft dhe Daimler AG.

Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft (BMW), është një shoqëri e regjistruar në Mynih, Gjermani, me objekt aktiviteti; Prodhimi dhe shitja e motorëve dhe automjeteve të pajisura me to, aksesorëve të tyre, makinerive dhe produkteve metalurgjike, si dhe ofrimi i shërbimeve në lidhje me sa sipër.

BMV nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet distributorit të saj H.L.– GROUP SHPK.

Daimler AG (Daimler), është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, me objekt veprimtarie; veprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve, veçanërisht në degët si: automjetet, motorët dhe disqet teknike të të gjitha llojeve, përfshirë pjesët dhe aksesorët e tyre, produkte të tjerë

transporti, pajisje elektronike, instalime dhe sisteme, komunikimi dhe teknologjia e informacionit, shërbime dhe koncepte të lëvizshmërisë dhe transportit, shërbime bankare dhe sigurimesh, financiare dhe pagesë si dhe ndërmjetësim dhe sigurim i sigurimeve, menaxhimi dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme.

Daimler nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri por realizon të ardhura në vend nëpërmjet distributorit AUTO STAR ALBANIA SHA.

Më datë 29 mars 2021, shoqëritë Your NOW Holding GmbH; BP Europa SE; Digital Charging Solution GmbH; BMV INTEC Beteiligungs GmbH dhe Daimler Mobility Services GmbH, kanë nënshkruar një Marrëveshje Investimi.

Sipas marrëveshjes, shoqëria BP Europa SE do të hyjë si një aksionar i ri kontrollues në shoqërinë Digital Charging Solution GmbH dhe pas përfundimit të transaksionit të propozuar, BMW dhe Daimler së bashku do të mbajnë (indirekt, nëpërmjet Your NOW Holding GmbH) afërsisht 66.67% të kapitalit total të emetuar të shoqërisë Digital Charging Solution GmbH (JV) dhe shoqëria BP Europa SE do të mbajë afërsisht pjesën e mbetur prej 33,33% të kapitalit.

Sipas nenit 10 të Ligjit, si dhe pikës 1.2 “Mënyrat e kontrollit” të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, përftimi i kontrollit përkufizohet si një mundësi për të ushtruar vendimmarrje në shoqëri dhe nga sa është parashikuar në Marrëveshjen e Investimit, pas implementimit të transaksionit të propozuar, shoqëria Digital Charging Solution GmbH (JV) do të kontrollohet bashkërisht nga BP Europa SE, BMW dhe Daimler.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara edhe në nenin 12, pika 1 germa a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i të gjitha shërbimeve të lëvizshmërisë elektronike (e-mobility) por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Digital Charging Solution GmbH (JV), ndërmjet blerjes së aksioneve nga shoqëria BP Europa SE.

Asnjë nga palët nuk janë aktive në Shqipëri në lidhje me shërbimet e lëvizshmërisë elektronike (e-mobility). Si rrjedhojë, transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Digital Charging Solution GmbH (JV), nëpërmjet blerjes të aksioneve nga shoqëria BP Europa SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 806, Datë 04.06.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike”.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 dhe 2, e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike; dhe,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit paraprak;

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 783, datë 12.03.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore, për periudhën kohore nga 01.01.2020 deri në 31.03.2021.

2. Për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 784, datë 12.03.2021 ka vendosur marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, si vijon: *“a. Ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore t’i japin fund bashkëpunimit mes tyre duke u sjellë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre tregtar sa i përket: importeve të produkteve; caktimit të çmimit të shitjes dhe/ose ndarjes së tregut përkatës; si dhe përdorimit të të drejtave ekskluzive”*. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
3. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimeve të mësipërme, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr.138/2, datë 12.03.2021, "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e AK gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi.
4. Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të masës së përkohshme, referuar informacionit të administruar nga inspektimet e realizuara në ndërmarrjet që operojnë në tregun objekt hetimi, Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 794, datë 27.04.2021, *“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatimin e masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore””, ka vendosur gjobitjen e ndërmarrjeve për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 784/2021, si dhe detyrimin e tyre që të veprojnë në përputhje me këtë vendim.*
5. Lidhur me vendimin nr. 794, datë 27.04.2021 të Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe ÇAÇA SHPK, kanë paraqitur ankim pranë AK-së duke kërkuar shfuqizimin e tij. Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave, KK me vendimet nr. 800, datë 21/05/2021 dhe nr. 801, datë 21/05/2021 ka vendosur rrëzimin e kërkesave të shoqërive ÇAÇA SHPK dhe AGRO BLEND SHPK për shfuqizimin e vendimit nr. 794/2021.
6. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, *“Për mbrojtjen e konkurrencës”*, të ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: ndërmarrjet që operojnë në tregun objekt hetimi; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Qendra Kombëtare e Biznesit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

7. Tregu i plehrave kimike që përdoren në bujqësi, ose Fertilizuesve, funksionon dhe rregullohet nga ligji nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”, i cili përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin e funksionimit të strukturave përkatëse.
8. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit;
 - b) Tregu përkatës gjeografik.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

9. Plehrat janë lëndë organike ose minerale, që përmbajnë elemente ushqyese për bimët dhe që hidhen në tokë ose në pjesën mbitolësore të bimëve (plehrimi gjethor) për të rritur pjellorinë e tokës. Ato ndahen në organike dhe minerale (kimike).
10. Duke u nisur nga rëndësia që kanë produktet plehëruese për fermerët në plehrimin e tokës dhe kultivimin e bimëve, për analizën e këtij tregu janë marrë parasysh tre produktet kryesore DAP, Nitrat dhe Ure, të cilët përdoren në ciklin e bimës si:
 - **DAP (Hidrogenortofosfat diamoni)** - i cili përdoret gjatë plehërimit të tokës bujqësore kur mbillet bima. Ky produkt ka përdorim sezonal kryesisht në 6-mujorin e parë të vitit;
 - **Nitrat dhe Ure** – të cilat përdoren gjatë rritjes së bimës, kryesisht gjatë gjithë vitit.
11. Sa më sipër, për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është: *Tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike i ndarë në nëntregje sipas produkteve:*
 - *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit DAP;*
 - *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit Nitrat;*
 - *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit Ure.*

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

12. Importi dhe tregtimi me shumicë i plehrave kimike realizohet nga ndërmarrje, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, *pra tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.*

II.2 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

13. Nga analiza e strukturës së tregut të importit rezulton se për produktin DAP gjatë vitit 2020 kanë realizuar importe të plehut kimik DAP 6 (gjashtë) subjekte ku pjesën më të madhe të importeve e kanë realizuar AGROBLEND SHPK dhe MBM SHPK me rreth XX% pjesë tregu, dhe IAM SHPK rreth XX% pjesë tregu. Për periudhën janar –mars 2021 kanë realizuar importe në sasi të mëdha ndërmarrjet Agroblend SHPK përkatësisht me XX% pjesë tregu dhe MBM SHPK përkatësisht me XX% pjesë tregu. Importi i plehut kimik DAP realizohet kryesisht në pjesën e parë të vitit. AGROBLEND SHPK dhe MBM SHPK realizojnë importe për plehun kimik DAP nga Tunizia, ndërsa IAM SHPK nga Maroku. Në lidhje me indekset e përqendrimit CR₃ dhe HHI, vihet re se gjatë periudhës hetimore tregu i importit të plehut kimik DAP është shumë i përqendruar.
14. Nga analiza e strukturës së tregut të importit për produktin Nitrat rezulton se gjatë vitit 2020 pjesën më të madhe të importeve e kanë realizuar AGROBLEND SHPK me rreth XX% pjesë tregu dhe MBM SHPK me rreth XX% pjesë tregu. Për periudhën janar-mars 2021 pjesën më të madhe të importit të Nitratit e kanë realizuar ndërmarrjet AGROHELP-SA SHPK rreth 68% pjesë tregu dhe Besniku SHPK rreth XX% pjesë tregu. Përsa i përket indekseve të përqendrimit CR₃ dhe HHI, vihet re se gjatë periudhës hetimore tregu i importit të Nitratit është shumë i përqendruar.
15. Nga analiza e strukturës së tregut të importit për produktin Ure, rezulton se gjatë vitit 2020 pjesën më të madhe të importeve të Uresë e kanë realizuar AGROBLEND SHPK rreth XX% pjesë tregu, MBM SHPK rreth XX% pjesë tregu, IAM SHPK rreth XX% pjesë tregu dhe CACA SHPK rreth 19% pjesë tregu. Për periudhën janar-mars 2021 pjesën më të madhe të importit të Uresë e kanë realizuar ndërmarrjet AGROBLEND SHPK rreth XX% pjesë tregu dhe MBM SHPK me XX% pjesë tregu. Përsa i përket indekseve të përqendrimit CR₃ dhe HHI, vihet re se gjatë periudhës hetimore tregu i importit të Uresë është i përqendruar.
16. Sa më sipër struktura shumë e përqendruar e tregut të importit tregon se mund të ketë një sjellje antikonkurruese nga këto ndërmarrje në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.
17. Nga analiza e të dhënave të faturave të blerjes dhe shitjes së ndërmarrjeve objekt hetimi rezulton se: Ndërmarrjet kryesore importuese realizojnë transaksione shitje-blerje të produkteve DAP, Nitrat dhe Ure midis tyre, sjellje e cila tregon bashkëpunimin e vazhdueshëm midis këtyre ndërmarrjeve, gjë e cila mund të çojë në një sjellje të koordinuar midis tyre në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003.
18. Nga analiza e çmimit mesatar të shitjes së produkteve DAP, Nitrat dhe Ure nga ndërmarrjet objekt hetimi Agroblend SHPK, MBM SHPK, CACA SHPK, IAM SHPK, ECO GREEN SHPK, AGRO MENS SHPK, AGROHELP SA SHPK, ARLI INTERNATIONAL SHPK, BESNIKU SHPK, LILA SHPK vërehet se gjatë tre mujorit të parë të vitit 2021 (periudha janar - mars) ka patur një tendencë rritjeje të çmimit mesatar të shitjes me shumicë, duke

aplikuar çmime të përafërta, dhe duke alternuar shitjet e produkteve sipas nevojave të tregut në periudhën përkatëse. Kjo sjellje e ndërmarrjeve, të cilat ndjekin njëra-tjetrën reflektohet në çmime më të larta përfundimtare të shitjes, e cila mund të përbëjë një sjellje të bashkërenduar në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK DHE BESNIKU SHPK.
- II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore 1 Janar 2020 deri 30 Shtator 2021.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 807, Datë 10.06.2021

“Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,
- Draft udhëzimit “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”

VËREN SE :

1. Udhëzimi sqaron procedurat që ndiqen në rastet e analizave dhe vlerësimeve që kryhen për kontrollin e përqendrimeve, duke filluar nga depozitimi i njoftimit paraprak për një transaksion të mundshëm deri në përfundim të procedurës dhe marrjes së vendimit përfundimtar.
2. Në udhëzim theksohet rëndësia që ka depozitimi i informacioneve dhe mbajtja e kontakteve të rregullta ndërmjet AK dhe palëve njoftuese, për identifikimin e hershëm të problemeve dhe shqetësimeve që mund të ngrejë një transaksion, afatet kohore dhe rëndësia e respektimit të tyre, pjesëmarrja e gjithë palëve të interesuara gjatë procedurës etj.

3. Draft udhëzimi parashikon rëndësinë që ka ruajtja e konkurrencës efektive në treg, analiza që duhet të kryhet për përcaktimin e pozicionit në treg të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, fuqia e tyre ekonomike dhe financiare, analiza e barrierave të mundshme etj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 808, Datë 10.06.2021

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shoqërinë SPV, nga shoqëria Bimal d.d. Brčko.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shoqërinë SPV, nga shoqëria Bimal d.d. Brčko.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shoqërinë SPV, nga shoqëria Bimal d.d. Brčko.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimit të kontrollit mbi shoqërinë SPV nga shoqëria Bimal d.d. Brčko. Sipas “Marrëveshjes për shprehje interesi/Memorandum Mirëkuptimi”, palët janë:

Pala blerëse: Bimal d.d. Brčko është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Bosnjë Hercegovinës, me objekt veprimtarie prodhimin e vajrave dhe yndyrave, etj.

Bimal Agri d.o.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Bosnjë Hercegovinës, me objekt aktiviteti tregtinë me shumicë të drithërave, duhanit të papërpunuar, farave dhe ushqimeve për kafshë.

Në tregun shqiptar, grupi Bimal, realizon të ardhura në mënyrë të tërthortë nëpërmjet shoqërisë Agrana-Studen Albania SHPK, e cila ka objekt aktiviteti tregtimin me shumicë të sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore, si dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me tregtimin me shumicë/pakicë, distribucionin, logjistikën etj.

Pala shitëse: Eraković d.o.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë, me objekt aktiviteti tregtinë me shumicë të drithërave, duhanit të papërpunuar, farave dhe ushqimeve të gatshme për kafshët shtëpiake.

Shoqëria Eraković d.o.o nuk ka shoqëri të regjistruara në tregun shqiptar dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

SPV (SPV-Bimal Agri / shoqëria e qëllimit) është filiali, i krijuar për qëllime të veçanta, nga shoqëria Eraković d.o.o, me kontribut 100% të kapitalit themeltar në formën e kompleksit të pasurive të paluajtshme të fabrikës së foragjereve.

Më datë 29 prill 2021, shoqëritë Eraković d.o.o, Bee Logistika 021 doo Becej, Bimal d.d. Brčko, Veselina Erakovića, Bimal Agri d.o.o. Becej dhe Extra Farm doo Srbobran, kanë nënshkruar “Marrëveshje për shprehje interesi/Memorandum Mirëkuptimi”.

Qëllimi dhe objekti i këtij Memorandumi është krijimi i një filiali të shoqërisë Eraković d.o.o me emrin e ushtrimit të aktivitetit SPV. Pas krijimit, shoqëria Bimal d.d. Brčko, do të blejë 66.67% në SPV dhe Z.Veselin Eraković do të jetë zotërues i 33.33% të shoqërisë.

Palët në Marrëveshje bien dakort që, pas përfundimit të blerjes, do të realizohet bashkimit me përthithje i SPV me shoqërinë Bimal Agria dhe pas përfundimit të fazave të përshkruara më lart, raporti i pronësisë së aksioneve në Bimal Agri do të jetë 84.06% pjesë në zotërim të Bimal d.d. Brčko dhe 15.94% pjesë në zotërim të Z.Veselin Eraković..

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i prodhimit të ushqimeve të gatshme për kafshët shtëpiake por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit mbi shoqërinë SPV/shoqërinë e qëllimit, nga shoqëria Bimal d.d.. Brčko.

Në Shqipëri, grupi Bimal është prezente në mënyrë indirekte nëpërmjet shoqëria Agrana-Studen Albania e cila vepron në tregtimin me shumicë të sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore. SPV (shoqëria e qëllimit) dhe Eraković d.o.o. nuk janë prezente dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri. Asnjë nga palët nuk është aktive në Shqipëri në tregun e prodhimit të

ushqimeve të gatshme për kafshë shtëpiake.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shoqërinë SPV, nga shoqëria Bimal d.d. Brčko.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 809, Datë 30.06.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ETABLISSEMENTS J. SOUFFLET NGA SHOQËRIA INVIVO GROUP.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfthimin e kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group.

Më datë 1 maj 2021, palët kanë nënshkruar marrëveshjen “Protokoll Shitjeje”.

Pala Blerëse: InVivo Group është një shoqëri aksionare e thjeshtuar (shoqëri me një ortak të vetëm), regjistruar sipas legjislacionin francez, me objekt veprimtarie: ofrim shërbimesh për shoqëritë e sektorit bujqësor. InVivo Group zotërohet plotësisht nga Union InVivo.

InVivo group nuk ka filiale në Shqipëri dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar në vitin 2020.

Garantuesi: Union InVivo është një bashkim kooperativash bujqësore me kapital të ndryshueshëm (kooperativa sipas ligjit francez), me objekt aktiviteti: ofrim shërbimesh për shoqëritë e sektorit bujqësor

Pala shitëse:

Shitësi 1: Z. Michel Soufflet, person fizik, shtetas i huaj, i regjistruar në shtetin francez dhe aksionar i shoqërisë Etablissements J. Soufflet, ku zotëron 67.64% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 2: Z. Jean-Michel Soufflet, person fizik, shtetas i huaj, i regjistruar në shtetin francez dhe aksionar i shoqërisë Etablissements J. Soufflet, ku zotëron 2.58% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 3: Silos Soufflet, shoqëri aksionare e thjeshtuar, me numër regjistrimi 334076056, me objekt aktiviteti: mbajtjen ose zotërimin e letrave me vlerë të kompanive të tjera, përveç bankave. Silos Soufflet përfaqësohet nga Z. Jean-Michel Soufflet dhe zotëron 17.38% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 4: Sceaux International, shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, regjistruar sipas legjislacionit holandez, përfaqësuar nga Z. Jean-Michel Soufflet dhe zotëron 12.41% të kapitalit të shoqërisë target.

Shoqëria Target: Etablissements J. Soufflet është një shoqëri aksionare, regjistruar sipas legjislacionin francez, me objekt veprimtarie: shitjen dhe blerjen, importimin dhe shfrytëzimin e farave, drithërave, kashtës, transformimin dhe shitjen e të gjitha produkteve bujqësore dhe të gjitha veprimtaritë e ngjashme apo të lidhura me qendrat e farave etj. Etablissements J. Soufflet është shoqëria holding e Soufflet Group.

Etablissements J. Soufflet¹ nuk ka prezencë fizike në Shqipëri, por ka deklaruar shitje në vendin tonë, të cilat kryhen nga shoqëritë e mëposhtme, të kontrolluara nga shoqëria target.

Soufflet Negoce, e zotëruar 100% nga shoqëria target, me objekt aktiviteti: shpërndarjen e produkteve bujqësore, transportimin dhe eksportimin e drithërave, farërave të vajit dhe produkteve të bulmetit etj.

Agro Ingredients Technology, e zotëruar 99.99% nga shoqëria target, me objekt aktiviteti: prodhimin, tregtimin e përbërësve për sektorin agro-ushqimor, veçanërisht për industrinë e bluarjes dhe prodhimin e bukës.

Sladara Soufflet Srbija doo Backa Palancka, e zotëruar 100% nga shoqëria target, me objekt aktiviteti: prodhimin e meltit (lloj elbi).

¹ Burimi: Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit

Sladovny Soufflet Ceska Republika-SSCR, e zotëruar 100% nga shoqëria target, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e melltit në botë.

Nëpërmjet marrëveshjes “Protokoll Shitjeje”, shoqëria InVivo Group do të fitojë pronësinë e plotë mbi totalin e aksioneve të zotëruara nga shitësit, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë target Etablissements J. Soufflet. Shoqëria InVivo Group do të gëzojë aksionet dhe do të zëvendësojë shitësit, në të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me aksionet, përfshirë të drejtën mbi dividendin dhe shpërndarjet e tjera lidhur me to.

Shoqëria InVivo Group autorizohet që të mundësojë blerjen nga Union InVivo të një pjese më të vogël se 10% të numrit total të aksioneve. Një blerje e tillë e pjesshme e aksioneve nga Union InVivo nuk do të ketë asnjë pasojë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të asnjë lloji ose mase mbi shitësit, në lidhje me të cilët InVivo Group do të konsiderohet se ka blerë të gjitha aksionet për qëllimet e marrëveshjes.

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i agrikulturës dhe produkteve bujqësore, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group.

Shoqëritë InVivo group dhe Etablissements J. Soufflet nuk kanë filiale në Shqipëri dhe vetëm kjo e fundit ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar në vitin 2020, nëpërmjet produkteve të shitura nga shoqëritë që ka në zotërim.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Etablissements J. Soufflet nga shoqëria InVivo Group.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 810, Datë 30.06.2021

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË THE BOUNTIFUL COMPANY NGA SHOQËRIA
NEXUS HOLDCO, LLC.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

Referuar “Marrëveshje dhe Plan Përqendrimi” të nënshkruar më datë 29 prill 2021, palët janë:

Nexus Holdco, LLC, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në shtetin Delaware dhe është një filial indirekt, që zotërohet plotësisht nga shoqëria Nestlé S.A.

XXX

Nexus Merger Sub, Inc. dhe Nexus Holdco, LLC, XXX realizimin e transaksionit të propozuar.

XXX

Nestlé S.A është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit zviceran me seli Vevey, Zvicër, me objekt aktiviteti; kryesisht në prodhimin, tregtimin dhe shitjen e një larmie të madhe të produkteve ushqimore dhe pijeve, përfshirë produktet e bulmetit, pije kafeje, ujë i paketuar, drithëra, produkte të kuzhinës duke përfshirë ushqime të përgatitura, erëza, salca dhe makarona të thata, akullore, çokollatë dhe pije çaji, produkte ëmbëlsirash, ushqime për kafshë shtëpiake dhe produkte ushqimore të kujdesit shëndetësor.

Nestlé nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjes nga të tjerë të kategorisë së produkteve Nestlé, të cilat përfshijnë kafënë me pakicë, ujëra, produkte të kulinarisë, bulmet, ëmbëlsira, ushqim për kafshët dhe ushqim për fëmijë.

Shoqëria Target: The Bountiful Company është një shoqëri me seli në New Jersey, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me objekt aktiviteti; prodhimin, tregtimin dhe furnizimin e vitaminave, mineraleve, suplementeve bimore dhe suplementeve të tjera të specializuara dhe produkteve të ushqimit aktiv. Më datë 14 janar 2021 është ndryshuar emri korporatës nga Clover Acquisition Holdings Inc në The Bountiful Company. Grupi Bountiful nuk ka filiale, degë ose zyra përfaqësimi dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

XXX

Transaksioni i synuar do të bëhet në përputhje me “Marrëveshjen dhe Planin e Përqendrimit”, datë 29 prill 2021 nga dhe nëpërmjet The Bountiful Company, Nexus Holdco, LLC, XXX Clover Parent Holdings L.P dhe XXX.

XXX Pas kryerjes së transaksionit, shoqëria The Bountiful Company do zotërohet plotësisht në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shoqëria Nexus Holdco, LLC dhe d në mënyrë indirekte nga shoqëria Nestlé S.A.

Referuar marrëveshjeve dhe pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i vitaminave dhe mineraleve (VMS) por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

Grupi Nestlé nuk ka filiale apo zyra përfaqësimi në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve nga të tjerë të produkteve të shpërndara të kafesë, ujit, produkte të kulinarisë, bulmet, ëmbëlsira, ushqim për kafshët dhe ushqim për fëmijë. The Bountiful Company nuk është prezente

dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri në mënyrë të drejtpërdrejtë por nëpërmjet XXX. Asnjë nga palët nuk është aktive në Shqipëri në tregun e vitaminave dhe mineraleve (VMS).

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 811, Datë 30.06.2021

**“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË GEOTHERMAL TARGET TWO II SINGLE-
MEMBER SA NGA SHOQËRIA GEOENERGY AEGEAN HOLDING SINGLE-MEMBER
SOCIETE ANONYME”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.06.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Geothermal Target Two II Single-Member SA nga shoqëria Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Geothermal Target Two II Single-Member SA nga shoqëria Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Geothermal Target Two II Single-Member SA nga shoqëria Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme.

Palët kanë nënshkruar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e 12.750 aksioneve në shoqërinë anonime me një anëtar të vetëm Geothermal Target Two II Single-Member SA”, “Marrëveshja e Aksionarëve” dhe “Marrëveshje Bashkëpunimi”.

Blerësi: Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit grek, me objekt aktiviteti financimin, projektimin, instalimin ndërtimin dhe funksionimin e termocentraleve gjeotermale në 4 zona gjeografike në Greqi. Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme zotërohet 100% nga shoqëria Elector SA Energy and Enviromental Applications.

Garantuesi: Helector SA Energy and Enviromental Applications është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit grek dhe që zotërohet 94.44% nga Ellaktor SA, e cila është pjesë e Ellaktor Group, grupi më i madh i infrastrukturës në Greqi, me një prani ndërkombëtare dhe portofol të larmishëm aktiviteteve që fokusohet në ndërtim, koncesione, mjedis, energji të rinovueshme dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme.

Ellaktor Group ushtron veprimtarinë e tij në Shqipëri përmes shoqërive të mëposhtme:

Vector-AL SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: ndërtim rrugësh, veprash hidroteknike, godinash civile, ekonomike, industriale, etj.

Copri-Actor Shoqëri e Thjeshtë është një shoqëri e krijuar dhe themeluar për zbatimin e projektit Rruga Tiranë-Elbasan.

Aktor Shoqëri Anonime Teknike është një shoqëri aksionare, e cila është aktive në tregun e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sistemit të koncesionit të cilado veprave publike, komunale etj.

Shitësi: PPC Renewables S.A është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit grek, me objekt veprimtarie: studimin, projektimin, instalimin, menaxhimin dhe funksionimin e objekteve dhe stacioneve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë nga çdo burim pa kufizim në shumën e buxhetit të tyre, së bashku me pajisjet dhe mjetet e tyre përkatëse etj.

PPC Renewables S.A është një filial i zotëruar plotësisht nga Public Power Corporation SA. Grupi Public Power Corporation SA është aktiv në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike pavarësisht nga burimi, si në sistemin e interkoneksionit ashtu edhe në sistemin e transmetimit të thjeshtë.

Grupi Public Power Corporation SA zotëron plotësisht filialin e saj në Shqipëri PPC Albania SHA, e cila është një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: importin, eksportin, tregtinë dhe prodhimin e energjisë elektrike etj.

Shoqëria Target: Geothermal Target Two II Single-Member SA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit grek, e zotëruar tërësisht nga shoqëria PPC Renewables. Geothermal Target Two II Single-Member SA dhe ka si objekt aktiviteti: menaxhimin, zhvillimin, financimin, ndërtimin dhe operimin lidhur me projektet specifike të burimeve të energjisë së rinovueshme, që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e rezervave gjeotermale të puseve gjeotermale të dhëna me qira nga shteti grek.

Shoqëria Geothermal Target II single Member SA nuk operon në Shqipëri.

Më datë 06 maj 2021, shoqëritë PPC Renewables S.A, Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme dhe Helector SA Energy and Enviromental Applications kanë nënshkruar “Marrëveshjen për shitjen dhe blerjen e 12.750 aksioneve në shoqërinë anonime me një anëtar të vetëm Geothermal Target Two II Single-Member SA”.

Pas përfundimit të transaksionit, shoqëria target Geothermal Target Two II Single-Member SA do të zotërohet 51 % nga Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme dhe 49% nga PPC Renewables S.A.

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike pavarësisht burimit dhe tregu i furnizimit me energji elektrike në nivelin e shitjes me shumicë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Geothermal Target Two II Single Member SA nga shoqëria Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme.

Blerësi, shoqëria Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme, zotërohet nga Ellaktor Group, i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive Vector-Al SHPK; Copri-Aktor Shoqëri e Thjeshtë dhe Aktor SHA Teknike, të cilat janë aktive në tregun e ndërtimeve në Shqipëri.

Targeti, shoqëria Geothermal Target Two II single Member SA, nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Geothermal Target Two II Single Member SA nga shoqëria Geoenergy Aegean Holding Single-Member Societe Anonyme.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 812, Datë 02.09.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN-së me detyrime për ndërmarrjet koncesionare PIA SHA, Romano Port SHA dhe Portit MBM”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN”.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d, neni 26, neni 43, pika 5, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN; dhe,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar.

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 675, datë 07.02.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës” vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit GLN, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003.

2. Në zbatim të vendimit nr. 675, datë 07.02.2020 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 52/4, datë 13.02.2020 “Autorizim për Inspektim”, Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve nën hetim të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës. Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve sipas nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Referuar konkluzioneve të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 711, datë 08.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN, për periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në 30.09.2020.
4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet koncesionare Romano Port SHA, Porti MBM dhe Petrolifera Italo Albanese (PIA), si dhe ndërmarrjet e tjera që operojnë në tregun objekt hetimi; MFE; MIE; DPD; Autoriteti Portual Durrës; Porti Detar Shëngjin SHA; Porti Detar Vlorë SHA; ISHTI; QKB; DPM.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
6. GLN është produkt i cili përftohet nga përpunimi i naftës bruto nëpërmjet procesit të distilimit në rafineritë e përpunimit të naftës. GLN përdoret për përftimin e nxehtësisë në kaldaja dhe për gjenerimin e fuqisë në makina/makineri, për përdorim rezidencial, etj.
7. Për shkak të karakteristikave që GLN mbart në përfitimin e nxehtësisë për përdorim rezidencial, në industri, si karburant për automjetet, etj, si edhe të çmimeve të ulëta krahasuar me karburantet e tjera për shkak të trajtimit të ndryshëm për sa i përket taksimit në vend, GLN paraqet një zëvendësueshmëri të ulët nga ana e kërkesës konsumatore.
8. Tregu përkatës i produktit GLN përbëhet nga :
 - a. Tregu i ngarkim – shkarkimit
 - b. Tregu i depozitimit
 - c. Tregu i importit
 - d. Tregu i shitjes me shumicë

9. Në këto kushte, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është tregu i ngakrim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe tregtimit me shumicë të produktit GLN.
10. Ndërmarrjet nën hetim e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm**.

II.2 Vlerësimi i pozitës dominuese

11. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, për sjellje të mundshme antikonkurrense në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 9121/2003, Përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
12. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003.
13. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: *pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve, fuqia kundërvepruese e blerësve; zhvillimi e rrjetit të shpërndarjes etj.; karakteristika të tjera të tregut përkatës*.
14. Ndërmarrjes PIA SHA, i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj, në portin Vlora-1, si dhe ndërtimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturës portuale të nevojshme në shërbim të terminalit bregdetar. Në bazë të kontratës Koncesionare, Koncesionari PIA SHA është i vetmi entitet, në të gjithë zonën e Gjirit të Vlorës (përfshirë zonën detare dhe platformat detare, nëse ka, të Gjirit të Vlorës), që do të lejohet të ndërtojë dhe të shfrytëzojë një terminal bregdetar dhe infrastrukturën e tij portuale, përfshirë këtu edhe platformat në det, si dhe i vetmi entitet i pajisur me të drejtën për të depozituar e trajtuar (ngarkim-shkarkim) (nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti) naftë, produkte të naftës, produkte të gazit të lëngshëm dhe produkte të tjera të lëngshme.
15. ***Në bazë të këtij koncesioni ndërmarrja PIA SHA zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së në portin Vlora-1.***

16. Ndërmarrjes Romano Port SHA i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës. Në bazë të këtij koncesioni ndërmarrja Romano Port SHA ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, me kapacitet të kufizuar të përpunimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure, deri në 20.000 ton. Referuar ligjit nr. 9578, datë 11.7.2006, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, ratifikuar me ligjin nr. 9298, datë 28.10.2004”, Romano Port SHA operon me kapacitet 15.000 ton për gazin e lëngshëm të naftës (GLN) dhe 20.000 ton për naftën.
17. ***Në bazë të këtij koncesioni Romano Port SHA aktualisht zotëron pozitë dominuese për kapacitetin deri në 15.000 tonë në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***
18. Ndërmarrjes Porti MBM i është dhënë me koncesion e drejta ekskluzive për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, në Porto Romano Durrës.
19. ***Në bazë të këtij koncesioni Porti MBM zotëron pozitë dominuese për kapacitetin mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë GLN në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***

II.3 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

6. Importi, depozitimi dhe ngarkim-shkarkimi i GLN-së në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet nëpërmjet 3 Konçensionave në dy porte në zonën gjeografike të ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit: PIA SHA, Romano Port SHA dhe Porti MBM i cili operon në det, si dhe ndërmarrje që kanë depozita me qera të cilat operojnë në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN.
7. **Ndërmarrjes PIA SHA**, në bazë të kontratës Koncesionare, ndërmarrja PIA SHA zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së në portin Vlora-1.
8. Tarifat e shërbimeve portuale të aplikuara nga PIA SHA në Portin Vlora 1, janë miratuar me vendimin e OSHA nr. 4, datë 01.04.2010. Tarifat për ofrimin e shërbimit të depozitimit dhe trajtimit (ngarkim-shkarkimit) të anijeve me GLN, si dhe për shërbime të tjera tregtare që PIA SHA kryen për klientët që kanë kontraktuar kapacitete në terminalin PIA, vendosen me marrëveshje midis palëve kontraktuale, pasi nuk janë të miratuara paraprakisht nga OSHA në vendimin nr. 4/2010.

9. Ndërmarrja PIA zotërohet 100% nga LA PETROLIFERA ITALO RUMENA, e cila me koncesion Portin dhe infrastrukturën e ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së. Për ofrimin e shërbimit të depozitimit dhe trajtimit (ngarkim-shkarkimit) të GLN-së në terminalin e PIA-s në Vlorë, Koncesionari PIA ka hyrë në marrdhënie kontraktore me operatorin Fam Gas L.L.C. Kontrata e lidhur midis PIA-s dhe Fam Gas L.L.C është një kontratë afatgjatë, e cila ka të përcaktuar kapacitetin depozitues të dy sferave prej 4,800 m³, tarifat e ofrimit të shërbimit në varësi të sasisë së GLN-së së depozituar, si dhe një garanci (bankare ose cash) në një shumë prej 120,000 ose 200,000 euto (sipas kërkesës së PIA-s).
10. FAM GAS LLC operon në magazinë të lirë doganore dhe realizon zhdoganime të GLN nëpërmjet Kevin Gaz SHA, i cili ka si aksioner z. Gjergj Lekaj. Kevin Gaz SHA zotëron 100 % të aksioneve në ndërmarrjen Emanuel Gas SHPK, i cili operon në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë. Përsa më sipër rezulton se PIA SHA realizon depozitimin dhe ngarkim-shkarkimin e GLN në përputhje me kontratën koncesionare duke mos qenë e integruar vertikalisht në asnjë hallkë të tregtimit të GLN.
11. Xhiro e PIA SHA për vitin financiar 2019 është 620,248,147 lekë, me një fitim prej 117,020,895 lekë dhe normë fitimi prej 18.87 %. Fitimi i ndërmarrjes PIA SHA ka një rritje prej 16.2 % nga viti 2017 në vitin 2018, ndërsa nga viti 2018 në vitin 2019 fitimi është ulur me 28%. ***PIA SHA rezulton me një normë fitimi rreth 20% për periudhën nën hetim duke patur parasysh dhe pozitën e saj si ndërmarrja e vetme koncesionare në portin e Vlorës.***
12. Kontrata e lidhur midis PIA-s dhe Fam Gas L.L.C është një kontratë afatgjatë, e cila ka të përcaktuar kapacitetin depozitues të dy sferave prej 4,800 m³, tarifat e ofrimit të shërbimit në varësi të sasisë së GLN-së së depozituar, si dhe një garanci (bankare ose cash) në një shumë prej 120,000 ose 200,000 euto (sipas kërkesës së PIA-s). Duke qenë se tarifat për ofrimin e shërbimit të depozitimit dhe trajtimit (ngarkim-shkarkimit) të anijeve me GLN, si dhe për shërbime të tjera tregtare që PIA SHA kryen për klientët që kanë kontrata depozitimi në PIA SHA, nuk janë të miratuara paraprakisht nga OSHA, *ato janë vendosur me marrëveshje midis palëve kontraktuale.*
13. Referuar VKM-së nr. 110/2011, pikës 1/ii), midis Palëve (OSHA dhe PIA SHA) është rënë dakord se standardi tip për ofrimin e këtyre shërbimeve është kontrata me afat për kapacitete të dedikuara, *edhe me afat të gjatë, si dhe duke siguruar nga klienti edhe garanci financiare ose një kontribut për investimet që do të kryhen nga PIA SHA.* PIA SHA dhe klientët e saj janë gjithashtu, të lirë të negociojnë forma të tjera kontrate. OSHA-ja është dakord se *kontratat me afat janë thelbësore për të siguruar efikasitetin e investimit dhe furnizimin e rregullt të tregut.* Operatorët do të kontaktojnë PIA SHA drejtpërdrejt dhe kohë më parë në mënyrë të mjaftueshme për shërbimet e saj.

14. OSHA konfimon të drejtat e plota të PIA SHA kundrejt operatorëve të kualifikuar, të interesuar për të operuar në terminal, duke e lejuar atë që të lidhë kontrata me afate të gjata, si dhe të kërkojë garanci financiare ose kontribut për investimet nga këta operatorë.
15. Gjithashtu, referuar pikës 1/iii) të VKM nr. 110/2011, jepet si shembull që PIA-ja *nuk duhet t'u shërbejë operatorëve që nuk vendosin garanci financiare të kënaqshme për PIA-n, që i kryejnë pagesat me vonesë ose që nuk i kryejnë fare ato, ose që kanë refuzuar të përmbushin kontratat e tyre në të kaluarën.*
16. ***Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes PIA SHA gjatë periudhës hetimore është bazuar në VKM nr. 110/2011.***
17. **Ndërmarrja Romano Port SHA**, në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit, ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, me kapacitet të kufizuar të përpunimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure, deri në 20.000 ton për naftën dhe 15.000 ton për gazin e lëngshëm të naftës (GLN). Në bazë të këtij koncesioni Romano Port SHA aktualisht zotëron pozitë dominuese për kapacitetin deri në 15.000 tonë në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.
18. Referuar ekstrakteve të regjistrit tregtar, ndërmarrja ROMANO PORT SHA zotërohet nga Z. Piro Bare me 99.84% të aksioneve. Ndërmarrja INTER GAZ SHA që ka ndërtuar depozita gazi pranë këtij Porti, zotërohet gjithashtu 50% nga Z.Piro Bare dhe 50% nga Z.Artan Dulaku. Ky aksionar (Z. Piro Bare) zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen A&V GAZ SHA, e cila kryen veprimtari importi dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë të GLN. Ndërmarrja A&V GAZ SHA zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen AV Distribution SHA, e cila ushtron veprimtarinë në tregun e shitjes me shumicë të GLN-së. Për sa më sipër konstatohet se Romano Port SHA, kryen veprimtari në import, depozitim, tregtim me shumicë të GLN.
19. Tarifat e aplikuara për shërbimet portuale ku përfshihen edhe tarifatat për ngarkim-shkarkim të GLN, në portin të Romano Port SHA, Porto Romano, Durrës, janë miratuar me vendimin e OSHA nr. 3, datë 04.03.2009, Vendimin nr. 6, datë 10.09.2009 dhe Vendimin nr. 1, datë 09.06.2014.
20. Romano Port SHA funksionon në bazë të “Rregullores së funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë Pomano Port”, miratuar me vendimin nr. 4, datë 27.04.2009 nga Organi Shtetëror i Autorizuar (MIE, MFE, MTM). Në nenin 5 të kësaj rregulloreje përcaktohen standardet teknike për akostimin e anijeve në platformë sipas madhësisë së anijes, të cilat variojnë nga 1.000 ton me zhytje 3.5 m deri në 40.000 ton me zhytje 11.5 m.

21. ***Referuar Kontratës Koncesionare, rezulton se Regullorja e Funksionimit, ka tejkalur të drejtën ekskluzive që i është dhënë Koncesionarit Romano Port SHA për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure të madhësive deri në 20.000 ton, në Porto Romano Durrës, duke i lejuar atij, që të kryejë përpunimin e anijeve të madhësive edhe më të mëdha se 20.000 ton.***
22. Xhiro e Romano Port SHA për vitin financiar 2019 është 290,167,233 Lekë, me një humbje prej 9,805,277 lekë ose 3.38 %. Fitimi i Romano Port SHA ka një rënie prej 45 % nga viti 2017 në vitin 2018 dhe ka vijuar rënien duke rezultuar me humbje gjatë vitit financiar 2019.
23. Nga të dhënat e depozituara nga Romano Port SHA dhe Porti MBM në lidhje me trajtimin (ngarkim –shkarkim) e anijeve me GLN në Porto Romano rezulton që prej fillimit të aktivitetit të ndërmarrjes Porti MBM në vitin 2019 e në vazhdim gjatë 2020 vihet re një rritje në sasinë e GLN të shkarkuar në portin MBM. Në portin e Durrësit, deri në momentin që ka filluar aktivitetin Porti MBM, koncesionari Romano Port SHA ka rezultuar me fitim. Në vitin 2019 vërehet se të ardhurat e realizuara nga Romano Port kanë pësuar rënie në krahasim me vitet e mëparshme dhe gjatë këtij viti Romano Port SHA ka rezultuar me humbje.
24. Për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të anijeve me GLN, ndërmarrja koncesionare Romano-Port SHA ka hyrë në marrëdhënie juridike detyrimi me Agjencitë Detare/Spedicionere ose pritësin e mallit, pronarin e mallit (Operatorët Ekonomikë), nëpërmjet kontratës Tip, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me të njëjtat kushte të përgjithshme për nga objekti, qëllimi, mënyra e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me realizimin e shërbimit të ngarkim/shkarkimit të anijeve, si dhe kushtet e tjera të kontratës me të cilën operon ndërmarrja Romano-Port në Porto Romano, Durrës.
25. Në kontratë përcaktohet se Koncesionari Romano Port SHA për ofrimin e shërbimeve të përpunimit (ngarkim-shkarkimit) të anijeve me GLN, aplikon tarifat e miratuara nga OSHA me vendimin nr. 3, datë 04.03.2009, vendimin nr. 6, datë 10.09.2009 dhe vendimin nr. 1, datë 09.06.2014. Tarifat e papërcaktuara nga OSHA, negocohen me mirëkuptim mes palëve.
26. Sa më sipër, kontratat e lidhura nga ndërmarrja Romano-Port me Operatorët Ekonomikë dhe Agjencitë Detare/Spedicionere nuk përcaktojnë çmime apo pagesa të tjera të ndryshme nga ato të miratuara nga OSHA në ngarkim të palëve, dhe të gjitha palët janë vendosur përballë kushteve të barabarta të ofrimit të shërbimeve portuale nga ana e Koncesionarit Romano-Port SHA.

27. **Ndërmarrjes Porti MBM** në bazë të kontratës koncesionare (ligji nr. 104/2015, datë 23.9.2015) ka fituar të drejtën ekskluzive për përdorimin e portit dhe zotërimin e lirë të zonës (neni 32, pika 1/a), për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, në Porto Romano Durrës, për një periudhë prej 35 vjetësh. ***Në bazë të këtij koncesioni Porti MBM zotëron pozitë dominuese për kapacitetin mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë GLN në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***
28. Tarifat për shërbimet portuale të Portit MBM, ku përfshihen edhe tarifatat për ngarkim-shkarkim të GLN, janë të miratuara me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave nr. 5749/5 datë 10.9.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”. ***Vërehet se ndërmarrjet Romano Port SHA dhe Porti MBM, të cilat operojnë në tregun e ngarkim-shkarkimit në porto Romano Durrës, aplikojnë pothuajse tarifa të njëjta lidhur me përpunimin dhe administrimin e produktit të GLN-së të miratuara me vendimet përkatëse nga OSHA.***
29. Porti MBM funksionon në bazë të “Rregullores së funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë koncesionare MBM”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 03.05.2019 të MIE si Organi Shtetëror i Autorizuar. Në nenin 8 të kësaj rregulloreje përcaktohen standartet teknike për akostimin e anijeve në platformë sipas madhësisë së anijes, të cilat variojnë nga 1.000 ton me zhytje 3.5 m deri në 40.000 ton me zhytje 11.5 m.
30. ***Nëpërmjet Rregullores së Funksionimit, MIE ka lejuar Portin MBM të kryejë ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve hidrokarbure të madhësive nën 20.000 ton duke i lejuar atij, siç rezulton edhe nga të dhënat e depozituara nga Porti MBM se gjatë periudhës hetimore ky koncensionar ka realizuar ngarkim – shkarkim të anijeve me GLN me kapacitet nën 20 000 ton.***
31. Porti MBM zotërohet 99% nga ndërmarrja ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SHPK, e cila zotërohet 65% nga KASTRATI GROUP. TENET SHA, e cila operon në tregun e depozitimit të GLN dhe shitjes me shumicë zotërohet 50% nga KASTRATI GROUP. TENET SHA shet në tregun e pakicës nëpërmejt ndërmarrjes Albania Gas Tech SHA e cila është pjesë e KASTRATI GROUP.
32. Xhiro e Porti MBM për vitin financiar 2019 është 1,024,913,252 Lekë, me një fitim prej 217,999,296 lekë dhe normë fitimi prej 21.3 %. Në vitet 2017 dhe 2018 ndërmarrja MBM ka rezultuar me humbje që përkon me periudhën e kryerjes së

investimeve, pasi ndërmarrja ka filluar operimin në vitin 2019¹. Porti MBM gjatë vitit 2019 ka realizuar të ardhura në vlerën 1,024,913,252 dhe ka rezultuar me fitim.

33. Për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të anijeve me hidrokarbure, ndërmarrja koncesionare Porti MBM ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me Agjencitë Detare/Spedicionere ose pritësin e mallit, pronarin e mallit (Operatorët Ekonomikë). Konkretisht gjatë periudhës hetimore Porti MBM ka lidhur 11 kontrata tip, nga të cilat 5 kontrata me Operatorët e tregut dhe 6 kontrata me Agjencitë Detare/Spedicionere. Këto janë kontrata Tip, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me të njëjtat kushte të përgjithshme për nga objekti, qëllimi, mënyra e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me realizimin e shërbimit të ngarkim/shkarkimit të anijeve, si dhe kushtet e tjera të kontratës me të cilën operon ndërmarrja Porti MBM në Porto Romano, Durrës.
34. Sipas kontratave për ofrimin e shërbimeve nga Koncesionari aplikohen tarifat e miratuara me Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE nr. 5749/5, datë 10.09.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”, të cilat ofrohen në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e terminalit të Portit MBM. Tarifat e papërcaktuara në këtë udhëzim, negociohen me mirëkuptim mes palëve.
35. ***Kontratat tip të lidhura nga Porti MBM me operatorët dhe Agjencitë Detare/Spedicionere nuk përcaktojnë çmime apo pagesa të tjera të ndryshme nga ato të miratuara me udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE në ngarkim të palëve, dhe të gjitha palët janë vendosur përballë kushteve të barabarta të ofrimit të shërbimeve portuale nga ana e Koncesionarit Porti MBM.***
36. Në lidhje me strukturën dhe përqendrimin e tregut të importit të GLN vërehet se:
- Për vitin 2017 ndërmarrja me pjesën më të lartë të tregut prej 32.98% është ndërmarrja Kevin-Gaz SHA, ndërmarrja A&V GAS SHA zotëron pjesën prej 28.12% të tregut, ndërsa TENET SHA zotëron pjesën prej 20.58% të tregut.
 - Për vitin 2018 ndërmarrja me pjesën më të lartë të tregut prej 35.02% është ndërmarrja AV INTERNATIONAL GROUP SHA, ndërmarrja TENET SHA zotëron pjesën prej 33.74% të tregut, ndërsa Kevin-Gaz SHA zotëron pjesën prej 21.47% të tregut.
 - Për vitin 2019 vihet re se ndërmarrja me pjesën më të lartë të tregut prej 34.63% është ndërmarrja TENET SHA, ndërmarrja AV INTERNATIONAL GROUP SHA zotëron pjesën prej 31.94% të tregut, ndërsa KEVIN-GAZ zotëron pjesën prej 25.3% të tregut.

¹ Siç rezulton nga të dhënat e sjella nga ndërmarrja MBM.

- Për periudhën janar-shtator 2020 ndërmarrja me pjesën më të lartë të tregut prej 35.2% është ndërmarrja AV INTERNATIONAL GROUP SHA, ndërmarrja Kevin-Gaz SHA zotëron pjesën prej 22.32% të tregut, ndërsa TENET SHA zotëron pjesën prej 20.48% të tregut.
37. Ndërmarrjet e integruara vertikalisht me koncesionarët përkatësisht Tenet SHA dhe AV International Group SHA realizojnë pjesën më të madhe të importit gati 50 %. Tregu i importit të GLN gjatë periudhës hetimore paraqitet me tregues shumë të lartë përqendrimi HHI.
38. Nga analiza e çmimeve të shitjes me shumicë të ndërmarrjeve nën hetim, nuk konstatohen çmime të përafërta apo të njëjta si rrjedhojë nuk jemi përpara rastit të një sjellje të bashkërenduar në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.9121/2003.
39. Me qëllim realizimin e analizës ekomike të ngjeshjes së çmimeve për secilën nga ndërmarrjet e integruara vertikalisht në nivele të ndryshme tregtimi, janë krahasuar çmimet mesatare vjetore të blerjes dhe shitjes së ndërmarrjeve të integruara dhe ndërmarrjeve jo të integruara, si dhe është bërë analiza financiare e fitimeve, nga ku rezulton se:
- Ndërmarrja AV International Group SHA, e integruar vertikalisht me Koncesionarin Romano Port SHA nuk aplikon ngjeshje të çmimeve me qëllim transferimin e fitimeve, duke mos qënë para kushteve të nenit 9 të ligjit nr 9121/2003 për abuzimin me pozitën dominuese.
 - Ndërmarrja Kevin-Gaz SHA, e integruar vertikalisht me Emanuel Gas SHPK nuk aplikon ngjeshje të çmimeve me qëllim transferimin e fitimeve, duke mos qënë para kushteve të nenit 9 të ligjit nr 9121/2003 për abuzimin me pozitën dominuese.
 - Ndërmarrja Tenet SHA, e integruar vertikalisht me Koncesionarin Porti MBM nuk aplikon ngjeshje të çmimeve me qëllim transferimin e fitimeve, duke mos qënë para kushteve të nenit 9 të ligjit nr 9121/2003 për abuzimin me pozitën dominuese.
40. Referuar sa më sipër, nuk konstatohen shënja të kufizimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve nën hetim në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN-së, por ndërmarrjet koncesionare, PIA SHA, Romano Port SHA dhe Porti MBM, të cilat kanë pozitë dominuese, kanë detyrim të veçantë për të mos abuzuar me pozitën dominuese që zotërojnë dhe të mos kryejnë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003.
- Në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003 OSHA (MIE, MFE) ka detyrimin të zbatojë dispozitat e ligjit nr. 9121/2003 dhe të sigurojë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Detyrimin e ndërmarrjeve koncesionare PIA SHA, Romano Port SHA, Portit MBM në respektim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, në veçanti të sillen:
 - a) *duke mos vendosur, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmime të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushte të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *duke mos zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke mos i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - c) *duke mos vendosur kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*
- II. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 813, Datë 02.09.2021

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 707 DATË 23.09.2020 “PËR HAPJEN E HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE, I NDRYSHUAR”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, për periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020.
2. Gjatë periudhës së realizimit të procedurës hetimore, në përputhje me afatet kohore të parashikuara në vendimin nr.707, datë 23.09.2020, Sekretariati u has me vështirësi në mbledhjen e informacionit dhe të dhënave të nevojshme, si nga ndërmarrjet që janë subjekt i këtij hetimi ashtu edhe nga institucionet shtetërore, informacion dhe të dhëna të cilat nuk janë sjellë në kohën e duhur dhe në mënyrë të plotë dhe të saktë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, të lidhura këto edhe me situatën e krijuar nga pandemia Covid-19.
3. Nëpërmjet dy vendimeve, përkatësisht: VKK nr. 754, datë 09.12.2020, dhe VKK nr. 771, datë 11.02.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 707, datë 23.09.2020, u vendos zgjatja e afateve proceduriale të hetimit deri më 31.03.2021.

4. Në vijim të procedurës hetimore, bazuar në të dhënat e administruara, sekretariati hartoi draft raportin e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, nga ku u konstatua se mungesa e informacionit të kërkuar nga Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, e bën të pamundur përcaktimin e strukturave të tregut dhe analizën e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe shitjes më shumicë të barnave.
5. Për realizimin e proceduarve hetimore, Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar ndërmarrjes SICPA Security Solutions Albania SHPK, mbajtëse e kontratës së koncesionit për pajisjen me pullë fiskale, si dhe nga ana tjetër, kërkoi përsëri informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), e cila me shkresën nr. 268/5 prot., datë 21.06.2021 “Kthim përgjigje” ka depozituar një informacion mbi subjektet e pajisura me licencë për tregtimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore, informacion i cili nuk u depozitua në shkresën nr. 362/8 prot., datë 28.12.2020.
6. Procedura hetimore në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, përmban dy komponentë: (1) barnat dhe (2) pajisjet mjekësore. Procedura hetimore në drejtim të pajisjeve mjekësore, në bazë të të dhënave të sjella nga ndërmarrjet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka lejuar Sekretariatit të përpunojë të dhënat dhe informacionin e mbledhur deri tani.
7. Me qëllim realizimin e një hetimi të plotë, të saktë dhe gjithëpërfshirës, Sekretariati referuar shkresës nr.268/5 datë 21.06.2021 “Kthim përgjigje” të AKBPM, i lind nevoja e domosdoshme që të kërkojë prova dhe të dhëna nga çdo subjekt i licencuar për importin dhe shitjen me shumicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore, procedurë e cila kërkon kohën e saj të nevojshme.
8. Procedura e hetimit paraprak, rregulluar nga neni 42 i ligjit nr.9121/2003 nuk e kushtëzon Sekretariatit me një afat kohor.
9. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 707, datë 23.09.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:
“Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 814, Datë 02.09.2021

“Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Relacion “Mbi ankesën e shoqërive M&D SHPK, Interlogistic SHPK, Mond Office SHPK, Adastra SHPK, Adenis Kastrati PF dhe Europrinty Group SHPK, për procedurat e prokurimit publik me objekt “Blerje Tonera/ bojëra”, lidhur me vendosjen në DST të kriterit të kualifikimit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi ankesën e shoqërive M&D SHPK, Interlogistic SHPK, Mond Office SHPK, Adastra SHPK, Adenis Kastrati PF dhe Europrinty Group SHPK, për procedurat e prokurimit publik me objekt “Blerje Tonera/ bojëra”, lidhur me vendosjen në DST të kriterit të kualifikimit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi”,

VËREN SE :

I. Procedura

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Marketing & Distribution SHPK (M&D) nëpërmjet shkresës me nr. 41 prot, datë 18.01.2021, ka paraqitur një ankesë

- lidhur me kriterin e paraqitjes së autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje Tонера”, të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, gjatë vitit 2020.
2. Lidhur me vlerësimin e kësaj ankese është hartuar relacioni me nr. 41/1 prot, datë 10.02.2021 “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes Marketing & Distribution lidhur me procedurat e prokurimit me objekt “Blerje Tонера”, të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, gjatë vitit 2020”, si dhe është dërguar shkresa nr. 41/2 prot, datë 4.3.2021, “Për shqyrtim ankese”, drejtuar APP-së dhe për dijeni Marketing & Distribution SHPK.
 3. Në vijim, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara nëpërmjet shkresës me nr. 833 prot, datë 30.04.2021, me lëndë “Kërkesë për verifikim” (protokolluar pranë AK me nr. 228 prot, datë 05.05.2021) ka paraqitur një kërkesë për vlerësim lidhur me po të njëjtin kriter kualifikues sipas të cilit *“operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar për tregtimin e tonerave”*, në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje Tонера”, të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (këtu e në vijim ABP).
 4. Lidhur me këtë kërkesë është hartuar relacioni me nr. 228/1 prot., datë 21.05.2021 “Mbi kërkesën për vlerësim të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, dhe i është kthyer përgjigje ABP-së me shkresën nr. 228/2 prot, datë 01.06.2021 “Kthim përgjigje”.
 5. Ndërmarrja Marketing & Distribution SHPK ka paraqitur pranë AK-së kërkesën nr. 5071200372 prot, datë 08.06.2021, me lëndë “Kërkesë për informacion” (protokolluar me tonën nr. 41/5 prot, datë 08.06.2021), nëpërmjet së cilës pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana jonë mbi ankesën e datës 14.01.2021, lidhur me procedurat e prokurimit me objekt “Blerje Tонера”, të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, ***por gjatë një procesi gjyqësor të hapur nga kjo shoqëri në lidhje me këtë problematikë është njohur me shkresën tonë drejtuar ABP-së, si më sipër.***
 6. Lidhur me këtë kërkesë të M&D SHPK, nëpërmjet shkresës sonë nr. 41/7 prot, datë 14.06.2021, kësaj shoqërie i është përcjellë shkresa e AK nr. 41/2 prot, datë 4.3.2021, me lëndë “Për shqyrtim ankese”, drejtuar APP-së dhe për dijeni Marketing & Distribution SHPK, si dhe kopje nga Libri i Postës - Viti 2021 të Autoritetit të Konkurrencës, mbi dërgimin e kësaj shkrese.
 7. Lidhur me problematikën e mësipërme, me shkresën nr. 5071200384 prot, datë 10.06.2021 (protokolluar me tonën nr. 41/6 prot, datë 11.06.2021), ndërmarrjet: M&D SHPK, Interlogistic SHPK, Mond Office SHPK, Adastra SHPK, Adenis Kastrati PF dhe Europrinty Group SHPK, kanë paraqitur të njëjtën kërkesë për vlerësim lidhur me kriterin kualifikues sipas të cilit: *“operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar për tregtimin e tonerave”*, të aplikuar kryesisht në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje Tонера/bojëra”, të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, duke parashtruar të njëjtat argumente mbështetur në vendimin nr. 00-2015 (42), datë 23.01.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe vendimin e KPP-së nr. 128/2020 dhe kërkuar shqyrtimin e çështjes nga Komisioni i Konkurrencës.

8. Për vlerësimin e ankesës, bazuar në nenin 28, 29/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, Autoritetit të Konkurrencës ka ndjekur procedura e vlerësimit dhe monitorimit.
9. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit të administruar gjatë procedurës së vlerësimit dhe monitorimit të ankesës së paraqitur nga ndërmarrjet “Marketing&Distribution” Shpk, “Interlogistic” Shpk, “Mond Office” Shpk, “Adastra” Shpk, “Adenis Kastrati” PF de “Europrinty Group” Shpk”, rezulton si vijon:
 - Me vendimin nr. 00-2015 (42), datë 23.01.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në çështjen administrative me palë paditëse shoqërinë Marketing&Distribution SHPK, palë të paditur KPP-në dhe palë të tretë Ministrinë e Brendshme, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 430/4 prot., datë 15.05.2021 të KPP-së, ka vendosur shfuqizimin e këtij vendimi i cili ka rrëzuar ankimin e OE M&D SHPK lidhur me kundërshtimin e kriterit kualifikues të “Formës së Autorizimit të Prodhuesit”. Konkretisht, referuar këtij vendimi (pikat 37, 38, 39) Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shprehet se: *“Duke u kthyer në rastin konkret evidentohet se kriteri objekt kundërshtimi nga pala paditëse “paraqitja e formës së autorizimit nga prodhuesi”, nuk plotëson kushtet për të qenë një kriter specifik kualifikues në përputhje me ligjin”*. Gjykata ka arritur në këtë përfundim duke argumentuar se: *së pari*, autoriteti kontraktor në hartimin e DST-ve nuk ka arsyetuar/argumentuar në për zgjedhjen e këtij kriteri si një kriter i domosdoshëm për kualifikimin e kandidatëve në procedurën e prokurimit; dhe *së dyti*, vërtetimi i origjinalitetit të bojërave, sikurse përcaktohet në DST, mund të garantohej me pajisjen e tyre me vulën e origjinalitetit të pahapur dhe jo të rimbushura, duke konkluduar se kërkesa për “paraqitjen e formës së autorizimit të prodhuesit/distributorit”, si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit të mallit. Ndodhur në këto rrethana Kolegji Administrativ ka vlerësuar se mos përmbushja e kriterit të veçantë në përputhje me të gjithë elementët që e detyron ligji, në çështjen objekt gjykimi ka bërë që autoriteti kontraktor të duket sikur e ka përzgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.
10. Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, më datë 24.02.2020 ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) Dokumentet Standarte të Tenderit (DST) për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tонера për Kolegjin e Posaçëm të Apelit”, me fond limit 4,977,210 lekë, pa tvsh.
11. Operatori ekonomik M&D ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderi *(revokimin e kriterit kualifikues ku operatori ekonomik duhet të vërtetojë që është i autorizuar nga prodhuesi dhe nga distributor i autorizuar, sipas pikës 2.3 “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të DST-ve)*, ankesë e cila nuk është pranuar nga ky autoritet.

12. Më pas Operatorët Ekonomikë M&D si dhe Erison Company SHPK kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt ankese si në autoritetin kontraktor, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
13. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) me vendimin nr. 128/2020 *ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Marketing & Distribution SHPK dhe Erisoni Company SHPK për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tonera për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”, me fond limit 4,977,210 lekë pa tvsh, publikuar më datë 24.02.2020 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe detyrimin e tij që të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.*
14. Në këtë vendimmarrje KPP ka marrë në konsideratë Vendimin nr. 00-2015 (42), datë 23.01.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili shprehet se: “... *evidentohet se kriteri objekt kundërshtimi nga pala paditëse “paraqitja e formës së autorizimit nga prodhuesi”, nuk plotëson kushtet për të qenë një kriter specifik kualifikues në përputhje me ligjin*”.
15. Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, më datë 21.08.2020 ka publikuar në SPE Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Tonera”, me fond limit 4,820,024 lekë, pa TVSH.
16. Operatori ekonomik M&D ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit si në tenderin e lartpërmendur (*revokimin e kriterit kualifikues ku operatori ekonomik duhet të vërtetojë që është i autorizuar nga prodhuesi dhe nga distributor i autorizuar, sipas pikës 2.3 “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të DST-ve*), me pretendimin se ky kriter kualifikues është një kriter i cili me vendim të formës së prerë, nuk plotëson kushtet për të qenë një kriter specifik kualifikues.
17. Ankesa nuk është pranuar nga autoriteti kontraktor. Për këtë arsye M&D ka vazhduar ankimimin pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i cili me vendimin nr. 431/2020 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik Marketing & Distribution SHPK, duke argumentuar se: *kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi është në përputhje me ligjin dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore, dhe nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë.*
18. Gjithashtu në vendimin e KPP nr. 803/2019, datë 24.12.2019, KPP gjykon se “... për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të dijë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë “*autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit*” dhe jo detyrimisht që ky autorizim të jetë për rajonin, pasi siç u interpretua më sipër kjo kërkesë kufizon rrethin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi”, duke konsideruar të nevojshëm këtë kriter;

19. Sa më sipër Ankimuesi M&D kërkon nga AK vlerësimin e situatës së krijuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe KPP, në lidhje me vendosjen e kriterëve të kualifikimit (Autorizimin e Distributorit të Autorizuar) në procedurat e prokurimit për blerjen e produkteve tonera/bojëra , pasi kufizon konkurrencën në këtë treg, duke sjellë kualifikimin e vetëm një operatori ekonomik që e zotëron këtë autorizim në territorin e RSH-së.

II. Vlerësimi i Ankesës:

20. Deri në 31 mars 2021, procedurat e prokurimit publik, objekt shqyrtimi, janë rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar (këtu e në vijim LPP), si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
21. Referuar neneve 20, 23 dhe 46 të këtij ligji, *autoritetet kontraktore gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta, duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Këto kriterë duhet të janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.*
22. Përcaktimi i kriterëve për kualifikim, bëhet nga autoriteti kontraktor rast pas rasti, dhe vendosja e tyre duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.
23. Sa i përket pretendimit të Ankimuesit M&D SHPK mbi kriterin e *përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, më datë 21.08.2020, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me vendimin e tij nr. 431/2020, në zbatim dhe interpretim të LPP-së (nenit 46) dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 27).*
24. Në ligjin e ri të prokurimeve (ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”) në nenin 3, pika 2, të tij, sanksionohet qartë detyrimi që kanë *autoritetet dhe entet kontraktore për të mos shmangur fushën e zbatimit të këtij ligji dhe për të mos ngushtuar/kufizuar në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
25. Referuar nenit 21, pika 1, të LPP nr. 162/2020, *autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirë planifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike, nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
26. Në respektim të nenit 35, pika 1, të LPP-së: *“Përpara se të nisin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim. Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor mund të*

konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës”.

27. Referuar nenit 77, pika 1, të LPP-së: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

28. Në zbatim të nenit 23 dhe 129 të LPP-së, Agjencia e Prokurimit Publik kryen hetim administrativ për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, dhe në përfundim të hetimit shprehet me vendimin përkatës. Vendimet e dhëna nga Agjencia e Prokurimit Publik janë përfundimtare administrativisht dhe personat e interesuar kanë të drejtën të ankohen në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

29. Në përputhje me nenin 132 të LPP-së, në përfundim të një hetimi administrativ, mund të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë. Konkretisht në respektim të nenin 132, gërma g), të LPP-së, *mosrespektimi i detyrimit për përcaktimin e kërkesave për kualifikim, të cilat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës sipas nenit 77, pika 1, të këtij ligji*, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

30. Referuar nenit 24 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Vendimet e marra nga KPP janë administrativisht përfundimtare dhe mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit.

Për sa më sipër, mosrespektimi i detyrimit për përcaktimin e kërkesave për kualifikim, të cilat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, janë objekt shqyrtimi dhe hetimi administrativ nga institucionet kompetente të përcaktuara në LPP.

31. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, ndër vite ka vlerësuar barrierat rregulluese të konkurrencës në tregjet e prokurimeve publike si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse ligjore për mirëfunksionimin e këtij tregu, rekomandime të cilat janë implementuar në legjislacionin përkatës, duke shmangur barrierat e panevojshme me qëllim rritjen e konkurrencës.

III. Vlerësimi i tregut:

32. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së monitorimit si dhe dokumentacionit shkresor të depozituar nga ndërmarrjet në shkresën nr. 41/6 prot, datë 11.06.2021(ndërmarrjet: M&D SHPK, Interlogistic SHPK, Mond Office SHPK, Adastra SHPK, Adenis Kastrati PF dhe Europrinty Group SHPK), u konstatua sa më poshtë:
1. Oferta për tonera në vend, plotësohet nga ndërmarrje të cilat sigurojnë furnizim nga importi. Në treg shiten tre kategori tonerash:
 - a) tonera/bojëra origjinale, të cilat në paketimin e jashtëm janë të pajisura në elementët e sigurisë, kodin QR, OEM dhe shiriti i sigurisë, me të njëjtën markë si marka e pajisjes (fotokopje ose printer),
 - b) bojëra kompatible, bojë me kapacitet me të ulët por që i përshtatet pajisjes me të cilën përdoret, të cilat funksionojnë në pajisjen specifike dhe kanë cilësi dhe rentabilitet të ulët, dhe
 - c) bojëra të rimbushura të cilat kanë cilësi shumë të ulët.
33. Sipas informacionit të deklaruar gjatë monitorimit të subjekteve ankuese, u konstatua se ndërmarrja ITD SHPK është distributori i vetëm i autorizuar në Shqipëri për tonerat e markave HP, Lexmark dhe Xerox dhe ndërmarrja BNT SHPK është distributori i vetëm i autorizuar në Shqipëri për markat OKI, Kyocera dhe Toshiba¹.
34. Ndërmarrjet e tjera importuese, tregtojnë të gjitha llojet e tonerave/bojërave, qofshin
- a) origjinale, b) kompatible ose c) të rimbushura, produkte të blera nga shitës të autorizuar ose jo jashtë vendit.
35. Ndërmarrjet e tjera importuese mund të furnizohen nga furnitor jashtë vendit dhe të tregtojnë lirisht këto produkte pa patur kufizime në lidhje me pasjen ose jo të autorizimit të prodhuesit/distributorit. Pajisja me autorizim prodhuesi me markat specifike përfitohet nëse bojërat blihen pranë distributorëve të autorizuar në vend përkatësisht në Shqipëri nga ndërmarrjet ITD dhe BNT me çmime të përcaktuara shumë më të larta se çmimi i blerjes. Ndërmarrjet në ankesë pohojnë se çmimi i ofruar nga ndërmarrjet ITD dhe BNT (distributorët) që zotërojnë autorizimin e prodhuesit, është më i lartë se çmimi i produktit të importuar (tonera/bojëra) nga jashtë dhe asnjë nga ndërmarrjet nuk ka praktikë furnizimi nga distributorët ITD dhe BNT.
36. Nga monitorimi konstatohet se Autoritetet Kontraktore nëpërmjet Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) në veçanti me vendosjen e kriterit të kualifikimit të autorizimit të prodhuesit/distributorit në procedurat e prokurimit me objekt blerje

¹ Referuar vendimit të KPP nr. 222/2017, datë 13.04.2017, pika II.2.1, autoriteti kontraktor FSDKSH, në përgjigjen që i ka kthyer ankuesit Mond Office SHPK, në argumentimin e bërë ka deklaruar se: “... vetëm në Shqipëri janë 3 distributorë të kompanisë Xerox dhe akoma më shumë në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Kroaci etj, që i përkasin Rajonit të Ballkanit. Për bandën HP në Shqipëri ka 3 distributorë të autorizuar dhe rreth 12 të tjerë në gjithë rajonin e Ballkanit. Edhe përse i përket brandave të tjera, shifrat e distributorëve të autorizuar janë pak a shumë në këto nivele”.

- tonera/bojra, kanë vendosur në kushte të pabarabarta konkurrence operatorët ekonomik në këto procedura prokurimi.
37. Tonerat/ bojërat klasifikohen si produkte plotësuese me pajisjen për të cilën përdoret (fotokopje/printer) dhe kërkesa në treg për to kushtëzohet nga zotërimi i një marke të caktuar të printerit dhe fotokopjes. Këto pajisje kanë një përdorim shumë të gjerë dhe përdoruesit kryesor janë institucionet shtetërore dhe bizneset.
 38. Sipas të dhënave të deklaruara nga ndërmarrjet ankuese, blerjet nëpërmjet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për administratën publike, përbëjnë rreth 40% të volumit të shitjeve.
 39. Planifikimi i nevojave për bojëra sipas markave të caktuara, kushtëzohet nga numri i pajisjeve elektronike (printer dhe fotokopje) që kanë në zotërim institucionet publike dhe planifikimi korrekt dhe eficient i nevojave për bojëra kërkon mbi të gjitha një evidencë të saktë të gjendjes së pajisjeve aktive.
 40. Autoritetet kontraktore dhe Agjencia e Blerjeve të Përqendruara duhet të realizojnë një planifikim strategjik që në momentin e blerjes së pajisjeve, e cila kushtëzon për vitet në vijim nevojën për tonera/bojëra. Mbi bazën e kësaj analize autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë në mënyrë të drejtë kriteret specifike për të siguruar një produkt cilësor duke mos vendosur pengesa në hyrje në tregun përkatës nëpërmjet specifikimeve në DST, dhe duke i dhënë të drejtën operatorëve ekonomik për të marrë pjesë dhe për tu kualifikuar në procedura të prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojëra.
 41. Zbatimi i kontratave që rrjedhin nga këto procedura prokurimi të realizuara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe ose Autoritetet Kontraktore, shtrihet në një hark kohor minimalisht 1- 2 vjet. Ky fakt i jep mundësinë të gjithë operatorëve të kualifikuar, të furnizohen në mënyrë të pavarur pa autorizim prodhuesi/distributori nga furnitorë jashtë vendit. Këta operatorë tregtojnë lirisht në tregun vendas të njëjtin mall me të njëjtat parametra dhe elementë sigurie si operatorët të cilët zotërojnë autorizim prodhuesi/distributori duke përmbushur zbatimin e këtyre kontratave, për produktet tonera/bojëra pa patur kufizime në lidhje me pasjen ose jo të autorizimit të prodhuesit/distributorit, kriter i cili i ka përjashtuar këta operatorë që në fillim të garës gjatë procedurës së prokurimit me objekt blerje tonera/bojëra. Këtë konkluzion e provon dhe fakti se vet operatorët ekonomik me autorizim prodhuesi/distributori furnizohen nga këta operatorë të përjashtuar në tregun vendas.
 42. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në kuptim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vlerëson se autorizimi i prodhuesit/ distributorit nuk mund të përdoret si kriter përjashtues dhe kufizues për kualifikimin e operatorëve ekonomikë në prokurimet publike me objekt blerje tonera/ bojëra.
 43. Autoritetet kontraktore, duhet të vlerësojnë rast pas rasti përcaktimin e kriterëve kualifikuesë në DST, mbështetur në analiza konkrete të nevojave për mallra apo shërbime dhe mundësisë që ka tregu për plotësimin e tyre. Vendosja e kriterëve në DST në asnjë rast nuk duhet të jetë përjashtuese duke kufizuar numrin e operatoreve ekonomik të kualifikuar duke sjellë si pasojë kufizimin e konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d, e f), nenin 26, nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimeve Publike që:
 1. Të udhëzojë autoritetet kontraktore të mos vendosin kritere përjashtuese në DST si autorizimin e prodhuesit/distributorit, duke krijuar barriera dhe pengesa në hyrje në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojëra.
 2. Të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në lidhje me barrierat rregulluese të konkurrencës të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrative në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojëra.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 815, Datë 02.09.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 28.05.2021 “PËR HAPJEN E
PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT
DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121/2003, me vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi:
 - i. Hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.
 - ii. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 tetor 2020 deri në 20 maj 2021.
 - iii. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 4 (katër) muaj nga marrja e vendimit.

2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak, për vlerësimin e konkurrencës në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, është kërkuar informacion nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
3. Lidhur me kërkesën për informacion drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 245/6 prot., datë 11.06.2021 dhe nr. 245/9 prot., datë 01.07.2021, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 4987/1 prot., datë 12.07.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 245/10 prot., datë 13.07.2021), duke e bërë të pamjaftueshme kohën e mbetur në dispozicion për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, si dhe duke e bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 803, datë 28.05.2021.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:
Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 4 (katër) muaj nga marrja e vendimit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 816, Datë 02.09.2021

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ
NDËRMARRJES STAR PARKING SHPK NË TREGUN E MENAXHIMIT TË
FACILITETEVE TË PARKIMIT TË TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes Star Parking SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Z. Taq Dafa, administrator i shoqërisë ADIS SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 171 prot. datë 29.03.2021, ka depozituar ankesën mbi abuzimin e pozitës dominuese nga ndërmarrja Star Parking Rinas.
2. Z. Dafa, nëpërmjet kësaj ankese pretendon se ndërmarrja Star Parking Rinas po abuzon me pozitën e saj dominuese, duke rritur tarifat për telepaset e autobuzave në mënyrë të pa justifikuar. Në vazhdimësi, Z. Dafa paraqiti dhe formularin e ankesës protokolluar pranë AK me nr. 171/3 prot. datë 9.4.2021, ku bashkëlidhur gjenden korrespondenca dhe kontratat e qirasë me Star Parking SHPK.
3. ADIS SHPK, si ndërmarrje që operon në tregun e transportit të udhëtarëve me autobus nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, i duhet të lidhë dy kontrata, përkatësisht me TIA (Tirana International Airport) për qeranë e sheshit në të cilin pushojnë autobuzat dhe me Star Parking SHPK për tarifën e telepasit për të hyrë në parkim, për të lënë dhe marrë pasagjerët.
4. Në bazë të kontratës së lidhur përmes TIA dhe Star Parking, konstatohet se Star Parking SHPK është subjekti i vetëm që menaxhon facilitetet e parkimit, shërbimet dhe pajisjet e karrocave. Sipas kësaj kontrate, TIA i jep Star Parking të drejtën të caktojë tarifa mbi klientët e parkimit të cilët

përdorin facilitetet e parkimit, si dhe të gjenerojë të ardhura/xhiro në kuadër të këtij aktiviteti. Përmes dokumentacionit paraqitur nga z. Taq Dafa protokolluar pranë AK me shkresën nr. 171 prot. datë 29.03.2021, si dhe me formularin e ankesës nr. 171/3 prot. datë 09.04.2021, vihet re se kemi një rritje të tre-fishtë të çmimeve të telepasit, krahasimisht me periudhën kontraktuale para-ardhëse.

5. Në korrik 2020, çmimi për telepas u rrit nga 6000 lekë/telepas në muaj, siç ishte parashikuar tek kontrata e vjetër, në 18.000 lekë/telepas në muaj. Gjithashtu, Star Parking SHPK nuk lejon që një ndërmarrje të përdorë të njëjtin telepas për disa automjete, por çdo automjet duhet të ketë telepasin e tij të veçantë, pra subjekti detyrohet të paguajë 18000 lekë në muaj për çdo automjet që hyn në parking.
6. Star Parking SHPK është vetmi subjekt i cili menaxhon facilitetet e parkimit, shërbimet dhe pajisjet e karrocave është. Çdo subjekt i cili kërkon të hyjë në ambientet e parkimit të aeroportit, me qëllim për të transportuar pasagjerë, e ka të detyruar të lidhë kontratë me të, në të kundërt nuk mund ta ushtrojë këtë aktivitet.
7. Për sa më sipër, nisur nga problematika e ngritur, sjellja e ndërmarrjes Star Parking SHPK mund të përbejë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës bazuar në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Star Parking SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 30 qershor 2021.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 817, Datë 02.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA (JOINT VENTURE), NGA SHOQËRITË VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG DHE RIMAC AUTOMOBILI D.O.O”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture), nga shoqëritë Volkswagen Finance Luksemburg SA dhe Rimac Automobili d.o.o.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture), nga shoqëritë Volkswagen Finance Luksemburg SA dhe Rimac Automobili d.o.o.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture), nga shoqëritë Volkswagen Finance Luksemburg SA dhe Rimac Automobili d.o.o.

Palët kanë nënshkruar më datë [.....] “Marrëveshje e Opsionit të Vendosijs” ku;

Pala 1: Rimac Automobili d.o.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas ligjeve të Kroacisë, e cila operon në tregun e automjeteve, aktive në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e pjesëve për automjete elektrike dhe zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e makinave ekskluzive dhe të kufizuara (elektrike) sportive me performancë të lartë (hiper-makina) etj. [...]

Pala 2: Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare gjermane, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, pjesë e grupit Volkswagen. Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

[.....].

Përfituesi 1: Volkswagen Finance Luksemburg SA është një shoqëri aksionare, e organizuar sipas ligjeve të Luksemburgut dhe është pjesë e menaxhimit dhe industrisë së ndërmarrjeve. Volkswagen Finance Luksemburg SA është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.

Përfituesi 2: Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, e cila operon në prodhimin, zhvillimin dhe shitjen kryesisht të makinave sportive dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbime financiare për automjetet, duke përfshirë marketimin e shërbimeve të konektivitetit, nëpërmjet markës ndihmëse MOIA.

Porsche është pjesë e Grupit Volkswagen dhe me anë të biznesit Bugatti përbëhet nga 3 entitete: Bugatti Automobiles SAS, Francë, (entitet aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e hiper-makinave), Bugatti International SA, Luksemburg (entitet që mban dhe administron markat tregtare Bugatti) dhe Bugatti Engineering GmbH, Gjermani (nuk do të jetë pjesë e transaksionit të propozuar).

New-Co / JV do të jetë ndërmarrja e përbashkët, e cila do të krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Kroaci. NewCo do të jetë një shoqëri e qëndrueshme dhe me vetë-financim, aktive në prodhimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e hiper makinave.

Ndërmarrja e përbashkët NewCo nuk operon në Shqipëri.

Më datë [.....], shoqëritë Rimac Automobili d.o.o dhe Volkswagen Aktiengesellschaft, si dhe përfituesit Volkswagen Finance Luksemburg SA dhe Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft kanë nënshkruar “Marrëveshje e Opsionit të Vendorsjes”.

Bazuar në këtë marrëveshje palët synojnë të kombinojnë kompanitë Bugatti dhe Rimac në një ndërmarrje të përbashkët (Kombinimi i Biznesit). Palët do të krijojnë një biznes të qëndrueshëm dhe të vetëfinancuar për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e makinave me performancë të lartë (Biznesi i Kombinuar). Ndërmarrja e përbashkët NewCo do të përdorë teknologjinë ekzistuese, markat dhe njohuritë teknike të Bugatti dhe Rimac dhe në bashkëpunim do të menaxhojnë kostot dhe operacionet e shitjeve.

[.....]

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së hiper makinave, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota NewCo nga shoqëria Volkswagen Finance Luxemburg SA dhe shoqëria Rimac Automobili d.o.o.

Volkswagen Finance Luxemburg SA është një shoqëri Holding e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

[.....]

[.....]

Ndërmarrja e përbashkët J-V NewCo nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture), nga shoqëritë Volkswagen Finance Luksemburg SA dhe Rimac Automobili d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 818, Datë 02.09.2021

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CHIPITA INDUSTRIAL AND COMMERCIAL COMPANY S.A NGA SHOQËRIA MONDELEZ NEDERLAND SERVICES B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chipita Industrial and Commercial Company S.A nga shoqëria Mondelez Nederland Services B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Chipita Industrial and Commercial Company S.A nga shoqëria Mondelez Nederland Services B.V.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Chipita Industrial and Commercial Company S.A nga shoqëria Mondelez Nederland Services B.V.

Referuar “Marrëveshjes së shit – blerjes së aksioneve” të nënshkruar më datë 26 maj 2021, palët janë:

Pala blerëse: *Mondelez Nederland Services B.V*, shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar. [...]

Mondelez nuk ka filiale të regjistruar në Shqipëri. Produktet e Mondelez në Shqipëri tregtohen nëpërmjet distributorit vendas[...].

Pala shitëse:

1. *Competrol Establishment Cyprus LTD*, është një shoqëri e themeluar në Qipro.

2. *Cryred Investments LTD*, është një shoqëri e themeluar në Qipro.

3. *Aksionarët shtesë*, pjesëmarrës në nënshkrimin e “Marrëveshjes së shit – blerjes së aksioneve”.

Target: *Chipita Industrial and Commercial Company S.A (Chipita SHA)*, është një shoqëri anonime me seli në Bashkinë Metamorfofi/Attiki, Greqi, me objekt aktiviteti prodhimin e brioshëve të paketuara dhe prodhues kryesisht i ushqimeve me bazë buke të pjekur, si produkteve ushqimore *snacks*.

Chipita Industrial and Commercial Company S.A nuk ka filiale të regjistruar në Shqipëri. Produktet e Chipita në Shqipëri tregtohen nëpërmjet distributori i pavarur vendas [...].

Më datë 26 maj 2021, shoqëria Competrol Establishment Cyprus LTD, Cryred Investments LTD, Spyridon Theodoropoulos, Aksionarët shtesë dhe Mondelez Nederland Services B.V kanë nënshkruar “Marrëveshje shit – blerje e aksioneve”.

Transaksioni i propozuar lidhet me marrjen e kontrollit të vetëm nga Mondelez Nederland Services B.V mbi Chipita Industrial and Commercial Company S.A e cila është ristrukturuar përpara përfundimit të implementimit të këtij transaksioni dhe që aktualisht zotërohet nga Competrol Establishment Cyprus LTD, Cryred Investments LTD dhe ortak të tjerë.

Pas implementimit të transaksionit të propozuar Mondelez Nederland Services B.V do të zotërojë 100% aksionet e Chipita Industrial and Commercial Company S.A e cila do të zotërohet plotësisht nga Mondelez Nederland Services B.V.

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit me produkte ushqimore snack. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Chipita Industrial and Commercial Company SA nga shoqëria Mondelez Nederland Services BV.

Mondelez nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri. Produktet e Mondelez, në Shqipëri tregtohen nëpërmjet distributorit vendas [...]. Chipita nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri. Produktet e Chipita, në Shqipëri tregtohen nëpërmjet distributorit të pavarur vendas [...].

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme

midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Chipita Industrial and Commercial Company SA nga shoqëria Mondelez Nederland Services BV.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 819, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHENIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES PHARMA ONE SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Pharma One SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK,

Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë

të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve.

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.

17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.
18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
23. Ndërmarrja PharmaOne SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 13 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 215 102 copë maska.
24. Ndërmarrja Pharmaone SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Për këtë produkt nuk konstatohet rritje çmimi gjatë periudhës së tretë.

25. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

26. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
27. Ndërmarrja Pharma One SHPK ka tregtuar 23 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 58 212 copë.
28. Ndërmarrja Pharma One SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes konstatohet se vetëm për një lloj alkooli çmimi është rritur nga periudha e parë në të dytën.
29. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

30. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
31. Ndërmarrja Pharma One SHPK ka tregtuar 16 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 6 lloje: *AUS Dezinfektant Duarsh 100ML*, *Dezinfektant Duarsh 125ML*, *Dezinfektant Duarsh Gel 100ML*, *Gel Dezinfektant Duarsh 100ML – EV*, *Gel Dezinfektant Duarsh 80ML* dhe *Gel Dezinfektant Hand 500ML Pompë*.
32. Ndërmarrja Pharma One SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator

2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes, konstatohet se ndërmarrja ka aplikuar çmime të njëjta përgjatë periudhës hetimore.

33. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

34. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
35. Ndërmarrja Pharma One SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 58 copë.
36. Ndërmarrja PharmaOne SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, ku konstatohet se çmimi i shitjes ka qenë në rënie përgjatë periudhave.
37. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

38. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
39. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime

- apo kushte të padrejta tregtimi.
- b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
- ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
- d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
40. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
41. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
42. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresi – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Fufarma SHA, O.E.S Distrimed SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK, Evita SHPK, Delta Med SHPK, Montal SHPK, Incomed SHPK, Pharma One SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Farma Net Albania SHPK, Florifarma SHPK, CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK.
43. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje nga ku ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresi – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK janë përjashtuar nga hetimi administrativ dhe pasojave që rrjedhin prej tij.
44. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e

Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen Pharmaone SHPK.

45. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Pharmaone SHPK ka tregtuar 22 lloje të produktit alkool, 9 lloje të produktit maska dhe 16 lloje të produktit dezinfektant për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në analizën për vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim 5 lloje alkoolesh për të cilin sasia e shitur është mbi 2000 copë, 2 lloje maskash për të cilat sasia e shitur është mbi 5000 copë si edhe 5 lloje dezinfektantësh për të cilët sasia e shitur është mbi 500 copë.
46. Si konkluzion, nga vlerësimi i zbatimit të masës së përkohshme për ndërmarrjen Pharmaone SHPK, për produktet e analizuara, maska, alkool dhe gel dezinfektant, rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Pharma One SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Pharma One SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Pharma One SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.

IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Pharma One SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 820, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHENIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES NEW MEDICAL PLUS SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve ndaj ndërmarrjes New Medical Plus SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.

18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii.tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhure.
23. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes New Medical Plus SHPK.
24. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes New Medical Plus SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
25. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 774, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK”
26. Përsëri ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.

27. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin maska, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.
28. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK ka tregtuar vetëm 33 lloje të produktit maskë për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 682 651 copë maska.
29. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe për dy lloje maskash konstatohet një rritje e çmimit të shitjes nga periudha e parë në periudhën e dytë dhe një rënie e tij në periudhën e tretë.
30. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

31. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
32. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes New Medical Plus SHPK.
33. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes New Medical Plus SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
34. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 774, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK”.
35. Përsëri ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.
36. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin alkool, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.

37. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 8 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 9 005 copë.
38. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe për një lloj alkooli konstatohet një rritje e çmimit të shitjes nga periudha e parë në periudhën e dytë dhe një rënie e tij në periudhën e tretë.
39. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

40. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së pakëtuar.
41. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes New Medical Plus SHPK.
42. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes New Medical Plus SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
43. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 774, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK”.
44. Përsëri ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.
45. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin gel dezinfektant, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.
46. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK ka tregtuar 9 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët ka

qenë më i shitur 1 lloj: Dezinfektant për duar 100 ml.

47. Ndërmarrja New Medical Plus SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe çmimi nga periudha e dytë në të tretën ka qenë me ulje.
48. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

49. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
50. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se ndërmarrja New Medical Plus SHPK nuk ka treguar produkin termometër.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

51. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
52. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkoool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet

- zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
- ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
- d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
53. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
54. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
55. Me qëllim realizimin e një analize të plotë të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, të shtohen ndërmarrjet: Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
56. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, për ndërmarrjet e shtuara sipas pikës 1 të VKK nr. 752, datë 03.12.2020, të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 – 30 nëntor 2020, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga ndërmarrjet New Medical Plus SHPK.
57. Për sa më sipër, bazuar në të dhënat administruara gjatë inspektimit në lidhje me zbatimin e masës së përkohshme, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 766, datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen New Medical Plus SHPK”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes New Medical Plus SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes New Medical Plus SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja New Medical Plus SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve New Medical Plus SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 821, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES MEGAPHARMA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Megapharma SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.

18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii.tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
23. Ndërmarrja Megapharma SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 5 lloje maske dhe ka shitur një sasi prej 26 471 copë maska.
24. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, dhe konstatohet një rritje e çmimit të shitjes nga periudha e dytë në periudhën e tretë.
25. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

26. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
27. Ndërmarrja Megapharma SHPK Ka tregtuar 8 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 12 615 copë.
28. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes për produktin alkool konstatohet rritje e tij nga periudha e parë në të dytën dhe rënie nga periudha e dytë në të tretën.
29. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

30. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
31. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar 4 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 2 lloje: *Gel Hand 500ML (Aquila)* dhe *Gel Hand 100ML (Aquila)*.
32. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Konstatohet se për gel dezinfektant ka patur rritje të çmimit të shitjes përgjatë periudhës së dytë hetimore.
33. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

34. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
35. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj

disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se vetëm 12 ndërmarrje tregtojnë produktin termometër infrared të cilat janë Alfarmakos SHPK, Deltamed SHPK, Megapharma SHPK, Trimed SHPK, Pharmaone SHPK, Florifarma SHPK, Farmanet SHPK, Euromed SHPK, Fedos SHPK, OES Distrimed SHPK, Rejsi Farma SHPK, R&S Farma SHPK dhe Aquarius Medical SHPK.

36. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 17 copë.
37. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 me një çmim të pandryshuar.
38. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

39. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
40. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1)

të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.

41. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
42. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
43. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrja Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresì – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Fufarma SHA, O.E.S Distrimed SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK, Evita SHPK, Delta Med SHPK, Montal SHPK, Incomed SHPK, Pharma One SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Farma Net Albania SHPK, Florifarma SHPK, CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK.
44. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje nga ku ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresì – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK janë përjashtuar nga hetimi administrativ dhe pasojave që rrjedhin prej tij.
45. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion”, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen Megapharma SHPK.
46. Ndërmarrja Megapharma SHPK ka tregtuar 4 lloje të produktit alkool, 3 lloje të produktit gel dezinfektant dhe 3 lloje të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Nga këto produkte janë analizuar në mënyrë narrative: 1 lloj alkooli i cili është shitur në një sasi mbi 2000 copë, 2 lloje maskash të cilat janë shitur në një sasi mbi 5000 copë dhe 1 lloj gel dezinfektant i cili është shitur në një sasi mbi 500 copë.
47. Ka realizuar shitje të produktit “Protective Mask Face Mask KN95 (me valvul)” në një sasi prej 10 595 copë. Në qershor dhe korrik 2020, ky produkt nuk është tregtuar. Në gusht 2020, është blerë me një çmim mesatar 125 lekë/copë dhe është shitur me një çmim mesatar

181.6 lekë/copë. Në shtator 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 177.9 lekë/copë. Në tetor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 231.8 lekë/copë. Në nëntor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 114.4 lekë/copë. Në dhjetor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 112.9 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje çmimi në muajin tetor 2020.

48. Ka realizuar shitje të produktit “Protective Mask face Mask KN95 (pa valvul)” në një sasi prej 14 896 copë. Në qershor dhe korrik 2020, ky produkt nuk është tregtuar. Në gusht 2020 është blerë me një çmim mesatar 125 lekë/copë dhe është shitur me një çmim mesatar 166.6 lekë/copë. Në shtator 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 159.6 lekë/copë. Në tetor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 236.2 lekë/copë. Në nëntor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 108.1 lekë/copë. Në dhjetor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 107.7 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje çmimi në muajin tetor 2020.
49. Si konkluzion, nga vlerësimi i zbatimit të masës së përkohshme, ndërmarrja Megapharma SHPK për produktet Protective Mask Face Mask KN95 (me valvul) dhe Protective Mask face Mask KN95 (pa valvul) rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, nuk ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Megapharma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Megapharma SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë

lidhje me objektin e këtyre kontratave.

- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Megapharma SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltetin përkatës.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Megapharma SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 822, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES CFO PHARMA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes CFO Pharma SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.

18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
23. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 1 lloj maske dhe ka shitur një sasi prej 598 400 copë maska.
24. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Konstatohet një rritje e çmimit të shitjes së produktit maskë gjatë periudhës së dytë ndërkohë që në periudhën e tretë çmimi ka pësuar rënie.
25. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

26. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
27. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se ndërmarrja CFO Pharma SHPK nuk ka tregtuar produktin alkool.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

28. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së pakëtuar.
29. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se ndërmarrja CFO Pharma SHPK nuk ka tregtuar produktin gel dezinfektues.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

30. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
31. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se ndërmarrja CFO Pharma SHPK nuk ka tregtuar produktin termometër.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

32. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

33. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
34. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
35. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
36. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresì – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Fufarma SHA, O.E.S Distrimed SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK, Evita SHPK, Delta Med SHPK, Montal SHPK, Incomed SHPK, Pharma One SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Farma Net Albania SHPK, Florifarma SHPK, CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK.
37. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje nga ku ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresì – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK janë përjashtuar nga hetimi administrativ dhe pasojave që rrjedhin prej tij.

38. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen CFO Pharma SHPK.
39. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020.
40. Si konkluzion, nga vlerësimi i zbatimit të masës së përkohshme për ndërmarrjen CFO Pharma SHPK, për produktet e analizuara maska, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes CFO Pharma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes CFO Pharma SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja CFO Pharma SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.

IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes CFO Pharma SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 823, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES FLORFARMA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Florfarma SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situatë dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.

18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
23. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se ndërmarrja Florfarma SHPK nuk ka treguar produkin maska.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

24. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
25. Ndërmarrja Florfarma SHPK ka prodhuar 2 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor

2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 134 270 njësi dhe shitur 83 298 njësi. Për shkak të sasive të mëdha të shitura, për analizën narrative të luhatjes së çmimit më poshtë janë pasqyruar vetëm produktet me shitje mbi 10 000 copë.

26. Ndërmarrja Florfarma SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes konstatohet rritje e tij përgjatë periudhës hetimore.
27. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

28. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
29. Ndërmarrja Florfarma SHPK ka prodhuar 2 lloje të produktit gel dezinfektues për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 92 856 njësi dhe shitur 64 124 njësi dhe 9 578 njësi të dhuruara.
30. Ndërmarrja Florfarma SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes së produktit gel dezinfektant konstatohet se për një lloj geli dezinfektant ka patur rritje të çmimit të shitjes nga periudha e parë në të dytën dhe rënie nga periudha e dytë në të tretë.
31. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

32. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
33. Referuar VKK nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e

importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” dhe VKK nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020, rezulton se ndërmarrja Florfarma SHPK nuk ka treguar produkin termometër.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

34. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
35. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
36. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
37. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
38. Me qëllim realizimin e një analize të plotë të tregut, Komisioni i Konkurrencës me

vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, të shtohen ndërmarrjet: Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.

39. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, për ndërmarrjet e shtuara sipas pikës 1 të VKK nr. 752, datë 03.12.2020, të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 – 30 nëntor 2020, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga ndërmarrja Florfarma SHPK.
40. Për sa më sipër, bazuar në të dhënat administruara gjatë inspektimit në lidhje me zbatimin e masës së përkohshme, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 765, datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Florfarma SHPK”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Florfarma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Florfarma SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Florfarma SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Florfarma SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 824, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHENIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES AQUARIUS MEDICAL SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situatë dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.

18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii.tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëmrisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
23. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.
24. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
25. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 776, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK”.
26. Përsëri ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e

kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.

27. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin maska, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.
28. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 40 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 895 272 copë maska.
29. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ka tregtuar produktin maskë në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020 periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe konstatohet rritje çmimi për tre lloje maskash nga periudha e parë në të dytën dhe një rënie çmimi nga periudha e dytë në të tretën.
30. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

31. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
32. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.
33. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
34. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 776, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK”.
35. Përsëri ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.

36. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin alkool, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.
37. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 25 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 12 008 copë.
38. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020 periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe konstatohet rritje çmimi për një lloj alkooli nga periudha e parë në të dytën dhe një rënie të tij në periudhën e tretë.
39. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

40. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së pakëtuar.
41. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.
42. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
43. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 776, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK”.
44. Përsëri ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.
45. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin gel dezinfektant, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.

46. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ka tregtuar 11 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 2 lloje: Dezinfektant për duart 500 ml dhe xhel dezinfektues për duart 500 ml.
47. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe çmimi nga periudha e dytë në të tretën ka qenë me ulje.
48. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

49. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
50. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, është realizuar inspektimi pranë ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK.
51. Gjatë inspektimit janë administruar të dhëna në formë fizike dhe elektronike të ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK lidhur me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje.
52. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk i është përgjigjur shkresës nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” dhe shkresës nr. 110/147 prot., datë 29.01.2021 “Rikujtesë” të Autoritetit të Konkurrencës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 33 dhe 73 të ligjit nr. 9121/2003 me Vendimin nr. 776, datë 04.03.2021 vendosi: “Kërkesë për sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK”.
53. Përsëri ndërmarrja Aquarius Medical SHPK nuk ka depozituar pranë AK të dhënat e kërkuara nga Komisioni i Konkurrencës sipas Vendimit nr. 774, datë 04.03.2021.
54. Për analizimin e sjelljes së kësaj ndërmarrje për produktin termometër, janë marrë në shqyrtim të dhënat e administruara gjatë inspektimit.
55. Ndërmarrja Aquarius Medical SHPK ka tregtuar 2 lloje të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 592 copë.

56. Aquarius Medical SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes vihet re një rritje nga periudha e parë në periudhën e dytë, dhe një rënie gjatë periudhës së tretë.
57. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

58. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
59. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
60. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
61. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin

nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

62. Me qëllim realizimin e një analize të plotë të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, të shtohen ndërmarrjet: Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
63. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, për ndërmarrjet e shtuara sipas pikës 1 të VKK nr. 752, datë 03.12.2020, të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 – 30 nëntor 2020, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga ndërmarrja Aquarius Medical SHPK.
64. Për sa më sipër, bazuar në të dhënat administruara gjatë inspektimit në lidhje me zbatimin e masës së përkohshme, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 764, datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen Aquarius Medical SHPK”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

- d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Aquarius Medical SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltitetin përkatës.

IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Aquarius Medical SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 825, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA
DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES FLORIFARMA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Florifarma SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimin me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020

“Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.

18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii.tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëmrisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhure.
23. Ndërmarrja Florifarma SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 12 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 2 588 832 copë maska.
24. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar produktin maska në gjithë periudhën hetimore. Për këtë produkt nuk konstatohet rritje çmimi.
25. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

26. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
27. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar 7 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 13 968 copë.
28. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes për produktin alkool konstatohet rritje e tij nga periudha e parë në të dytën dhe rënie nga periudha e dytë në të tretën.
29. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

30. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
31. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar 8 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 7 lloje: *Dezifektues Duarsh *90ML*, *Dezifektues Duarsh *1LIT*, *Dezifektues Duarsh Gel *500ML*, *Diva Dezifektues *750ML*, *Gel Hand Sanitizer *100ML*, *Dezifektues Duarsh *1LIT Me Pompë dhe Gel Hand Sanitizer 500ML Me Pompë*.
32. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Konstatohet se për produktin gel dezinfektant ka patur rritje të çmimit të shitjes përgjatë periudhës së dytë hetimore, ndërsa vihet re një rënie e çmimit të shitjes në periudhën e tretë.
33. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

34. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e

situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.

35. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar 9 lloje të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 373 copë.
36. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e konkurrencës vihet re një rritje e çmimit nga periudha e dytë në periudhën e tretë.
37. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

38. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
39. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
40. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që

operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

41. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
42. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresi – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Fufarma SHA, O.E.S Distrimed SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK, Evita SHPK, Delta Med SHPK, Montal SHPK, Incomed SHPK, Pharma One SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Farma Net Albania SHPK, Florifarma SHPK, CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK.
43. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje nga ku ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresi – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK janë përjashtuar nga hetimi administrativ dhe pasojave që rrjedhin prej tij.
44. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen Florifarma SHPK.
45. Ndërmarrja Florifarma SHPK ka tregtuar 6 lloje të produktit alkool, 11 lloje të produktit maska dhe 8 lloje të produktit gel desifektant. Nga këto produkte janë analizuar në mënyrë narrative: 1 lloj alkooli i cili është shitur në një sasi mbi 2000 copë, 5 lloje maskash të cilat janë shitur në një sasi mbi 5 000 copë dhe 3 lloje gel dezifektanti që janë shitur në një sasi mbi 200 copë.
46. Si konkluzion, nga vlerësimi i zbatimit të masës së përkohshme për ndërmarrjen Florifarma SHPK, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Florifarma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Florifarma SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi ndërmarrja Florifarma SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Florifarma SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 826, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR
NDAJ NDËRMARRJEVE (1) ALDOSCH – FARMA SHPK; (2)
AQUILA GROUP SHPK; (3) CAPITAL GROUP SHPK; (4) DELTA
PHARMA – AL SHPK; (4) DELTA MED SHPK; (6) EVITA SHPK; (7)
FEDOS SHPK; (8) FUFARMA SHA; (9) INCOMED SHPK; (10)
MONTAL SHPK; (11) O.E.S DISTRIMED SHPK; (12) R&S FARMA
SHPK; (13) REJSI FARMA SHPK; (14) SIROL 2008 SHPK DHE (15)
WINPHARMA SHPK NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT,
PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE
DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurave të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve (1) Aldosch – Farma SHPK; (2) Aquila Group SHPK; (3) Capital Group SHPK; (4) Delta Pharma – AL SHPK; (5) Delta Med SHPK; (6) Evita SHPK; (7) Fedos SHPK; (8) Fufarma SHA; (9) Incomed SHPK; (10) Montal SHPK; (11) O.E.S Distrimed SHPK; (12) R&S Farma SHPK; (13) Rejsi Farma SHPK; (14) Sirol 2008 SHPK dhe (15) Winpharma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika (5) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe

- geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK,

Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-bletjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Komisioni i Konkurrencës Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florifarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
9. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;

- ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
10. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
11. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
12. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

13. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
14. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
- Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
15. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
16. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

konsiderohen si të këmbyeshem nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.

17. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.
18. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
19. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
20. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
21. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

22. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
23. Ndërmarrja Deltapharma – AL SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 19 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 190 750 copë maska. Këto maska janë tregtuar vetëm gjatë periudhës 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020.
24. Ndërmarrja Deltapharma - AL SHPK ka tregtuar produktin maska vetëm në periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe nuk konstatohet rritje çmimi.
25. Ndërmarrja Deltamed SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 21 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 63 929 copë maska.

26. Ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar produktin maska vetëm në periudhat 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Për këtë produkt nuk konstatohet rritje çmimi.
27. Ndërmarrja Evita SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 2 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 119 327 copë maska.
28. Për sa më sipër, vihet re se ndërmarrja Evita SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Për këtë produkt nuk konstatohet rritje çmimi.
29. Ndërmarrja Fedos SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 5 lloje maskash dhe ka shitur një sasi prej 742 984 copë.
30. Ndërmarrja Fedos SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe konstatohet se çmimi i shitjes ka qenë në ulje përgjatë periudhës së tretë.
31. Ndërmarrja Montal SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 1 lloj maske dhe ka shitur një sasi prej 68 200 copë maska.
32. Ndërmarrja Montal SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, çmimi i shitjes ka qenë me ulje përgjatë periudhës së tretë.
33. Ndërmarrja O.E.S Distrimed SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 2 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 40 974 copë maska
34. ndërmarrja O.E.S Distrimed SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Për këtë produkt vihet re që çmimi i shitjes në periudhën e tretë ka qenë në rënie.
35. Ndërmarrja Winpharma SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 5 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 1 157 070 copë maska.
36. Ndërmarrja Winpharma SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Konstatohet shitje e produktit maskë me një çmim konstant përgjatë dy periudhave të fundit, çmim i cili ka reflektuar çmimin e blerjes së produktit maskë.
37. Në përfundim të vlerësimit së sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

38. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
39. Ndërmarrja Aquila Group ka prodhuar 24 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 947 467 njësi dhe shitur 942 168 njësi. Për shkak të sasive të mëdha të shitura, për analizën narrative të luhatjes së çmimit më poshtë janë pasqyruar vetëm produktet me shitje mbi 10 000 copë.
40. Ndërmarrja Aquila Group SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes së të gjitha llojeve të alkoolit si edhe kostove të prodhimit konstatohet që çmimi i shitjes për të gjithë periudhën hetimore ka reflektuar kostot e prodhimit.
41. Ndërmarrja Capital Group SHPK ka prodhuar 4 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 13 058 njësi dhe shitur 12 970 njësi.
42. Ndërmarrja Capital Group SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe konstatohet se çmimi i shitjes ka qenë në rënie.
43. Ndërmarrja Sirol 2008 SHPK ka prodhuar 4 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 8 750 njësi dhe shitur 6 129 njësi.
44. Ndërmarrja Sirol 2008 SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes së të gjitha llojeve të alkoolit si edhe kostove të prodhimit konstatohet që çmimi i shitjes për të gjithë periudhën hetimore ka reflektuar kostot e prodhimit.
45. Ndërmarrja Aldosch SHPK ka tregtuar vetëm një lloj të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 4 957 copë.
46. Ndërmarrja Aldosch SHPK ka tregtuar produktin alkool vetëm në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020, me një çmim shitje konstant.
47. Ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar 15 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 18 200 copë.
48. Ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, përgjithësisht me një çmim në rënie në periudhën e tretë.
49. Ndërmarrja Fedos SHPK ka tregtuar 13 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total blerjesh prej 2 700 copë dhe një total shitjesh prej 1 487 copë.

50. Ndërmarrja Fedos SHPK nuk ka tregtuar sasi të mëdha alkoolesh në krahasim me ndërmarrjet e tjera.
51. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

52. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
53. Ndërmarrja Aquila Group SHPK ka prodhuar 19 lloje të produktit gel dezinfektues për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 786 771 njësi dhe shitur 783 519 njësi. Në analizën narrative janë marrë në shqyrtim 9 lloje gel dezinfektues për të cilët sasia e shitur është mbi 10 000 njësi.
54. Ndërmarrja Aquila Group SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes së të gjitha llojeve të gel dezinfektant si edhe kostove të prodhimit konstatohet që çmimi i shitjes për të gjithë periudhën hetimore ka reflektuar kostot e prodhimit
55. Ndërmarrja Capital Group SHPK ka prodhuar 5 lloje të produktit gel dezinfektues për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 154 482 njësi dhe shitur 154 122 njësi.
56. Ndërmarrja Capital Group SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e mësipërme vihet re se për produktet e tregtuara çmimi i shitjes ka pësuar rënie në periudhën e tretë.
57. Ndërmarrja Sirol 2008 SHPK ka prodhuar 7 lloje të produktit gel dezinfektant për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 42 284 njësi dhe shitur 45 283 njësi. Për shkak të sasive të vogla të shitura, për analizën narrative, nga tabela më poshtë nuk do të merren në analizë produktet në vijim: *Sanus Gel Hand Sanitizer 5l* dhe *Sanus Gel Hand Sanitizer 4l E70*.
58. Ndërmarrja Sirol 2008 SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e mësipërme vihet re se për produktet e tregtuara çmimi i shitjes ka pësuar rënie në periudhën

e tretë.

59. Ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar 11 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 6 lloje: *Gel Duarsh 100ML (Aquila)*, *Gel Duarsh 120 ML (Aquila)*, *Gel Duarsh 500 ML (Aquila)*, *Gel Duarsh 80ML (Aquila)*, *Manigen Sanavita Gel 80ML*, dhe *Xhel Dezinfektues Duarsh 125ML*.
60. Ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar produktin gel dezifektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes, konstatohet se ndërmarrja ka aplikuar çmime të njëjta përgjatë periudhës hetimore.
61. Ndërmarrja Delta Pharma - AL SHPK ka tregtuar vetëm 1 lloj dezinfektanti (Sanavita Manigien Gel Igienizzante 80 ML), të cilin e ka importuar nga Italia.
62. ndërmarrja Delta Pharma – AL SHPK ka tregtuar produktin gel dezifektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, me një çmim të pandryshuar.
63. Ndërmarrja “Fedos” SHPK ka tregtuar 5 lloje dezinfektantësh: *Dezinfektant 1 L*, *Gel 200 ml me pompë*, *Gel 1 L me pompë*, *Gel Hand Sanitizer 500 ml me pompë* dhe *Gel Dezinfektant 10 L*. Sasia totale e shitur për këto produkte ka qenë shumë e vogël (381 njësi gel-dezinfektant në total).
64. Ndërmarrja Fedos SHPK ka tregtuar produktin gel dezifektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 me një çmim të pandryshuar.
65. Ndërmarrja Fufarma SHPK ka tregtuar vetëm 1 lloj dezinfektanti (AlcOlina Gel Mani 100 ML Two Bee), të cilin e ka importuar nga Italia.
66. Ndërmarrja Fufarma SHA ka tregtuar produktin gel dezifektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, me një çmim të pandryshuar.
67. Ndërmarrja Winpharma SHPK ka tregtuar vetëm 1 lloj dezinfektanti (Derhand Plus Disifektant Gel 1LIT), të cilin e ka importuar nga Turqia.
68. Ndërmarrja Winpharma SHPK ka tregtuar produktin gel dezifektant në periudhën periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 me një çmim të pandryshuar.
69. Në përfundim të vlerësimit së sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezifektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezifektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

70. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
71. Ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 20 copë.
72. Deltamed SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 me një çmim të pandryshuar.
73. Ndërmarrja Fedos SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 609 copë.
74. Ndërmarrja Fedos SHPK ka tregtuar produktin termometër infrared në periudhën 1 mars 2020- 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe nga analiza e çmimit të shitjes vihet re se ky çmim ka qenë në rënie përgjatë periudhave.
75. Ndërmarrja OES Distrimed SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 138 copë.
76. Ndërmarrja O.E.S Distrimed SHPK ka tregtuar produktin termometër vetëm në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 me një çmim të pandryshuar.
77. Ndërmarrja R&S Farma SHPK ka tregtuar vetëm një lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 11 copë.
78. Ndërmarrja R&S Farma SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 me një çmim të pandryshuar.
79. Ndërmarrja Rejsi Farma SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 38 copë.
80. Ndërmarrja Rejsi Farma SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 me një çmim të pandryshuar.
81. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

82. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit

paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

83. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:

- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
- ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.

84. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.

85. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

86. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresi – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, Fufarma SHA, O.E.S Distrimed SHPK, Lekli SHPK, Intermed SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK, Evita SHPK, Delta Med SHPK, Montal SHPK, Incomed SHPK, Pharma One SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Farma Net Albania SHPK, Florifarma SHPK, CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK.

87. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendime individuale për secilën ndërmarrje nga ku ndërmarrjet Imi – Farma SHPK, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, MSE SHPK, Tresì – Farm SHPK, Dial – Alb SHPK, “Lekli” SHPK, Intermed SHPK janë përjashtuar nga hetimi administrativ dhe pasojave që rrjedhin prej tij.
88. Me qëllim realizimin e një analize të plotë të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolëve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, vendosi në pikën “1”, të shtohen ndërmarrjet: Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
89. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, për ndërmarrjet e shtuara sipas pikës 1 të VKK nr. 752, datë 03.12.2020, të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 – 30 nëntor 2020, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga ndërmarrjet *Capital Group SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK*.
90. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjet *Delta Pharma - AL SHPK, Delta Med SHPK, Evita SHPK, Fufarma SHA, Montal SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Incomed SHPK, Aquila Group SHPK dhe Sirol 2008 SHPK*.
91. Ndërmarrja Deltapharma - AL SHPK ka tregtuar 19 lloje të produktit maska dhe 1 lloj të produktit dezinfektant për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Kjo ndërmarrje nuk ka realizuar shitje të produktit alkool. Në analizën për vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim 5 lloje maskash për të cilat sasia e shitur është mbi 5 000 copë, si edhe 1 lloj dezinfektanti për të cilin sasia e shitur është mbi 500 copë.
92. Ndërmarrja Deltapharma - AL SHPK, për produktet e analizuara, maska dhe gel dezinfektant, rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
93. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Deltamed SHPK ka tregtuar 6 lloje të produktit alkool, 9 lloje të produktit dezinfektant dhe 19 lloje të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Nga këto produkte janë analizuar në mënyrë narrative: 2 lloje alkoolësh të cilat kanë një sasi të shitur mbi 2000 copë, 4 lloje maskash të cilat kanë një sasi të shitur mbi 5 000 copë dhe 2 lloje gel dezinfektant që kanë një sasi të

shitur mbi 500 copë.

94. Ndërmarrja Deltamed SHPK, për produktet e analizuar, maska, alkool dhe gel dezinfektant, rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
95. Ndërmarrja Evita SHPK ka tregtuar 2 lloj të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020, por nga këto vetëm një lloj ka shitur.
96. Ndërmarrja Evita SHPK, për produktin e analizuar maska, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
97. Ndërmarrja Fufarma SHA ka tregtuar 1 lloj produkti dezinfektant për periudhën 1 qershor 2020 – 1 dhjetor 2020.
98. Ndërmarrja Fufarma SHA, për produktin e analizuar gel dezinfektant, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
99. Ndërmarrja Montal SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në analizën për vlerësimin e masës së përkohshme është marrë në shqyrtim kjo lloj produkti sepse sasia e shitur e të cilit është mbi 5000 copë.
100. Ndërmarrja Montal SHPK, për produktin e analizuar maska, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
101. Ndërmarrja O.E.S. Distrimed SHPK ka tregtuar 2 lloje të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në analizën për vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim të dyja llojet e maskave për të cilat sasia e shitur është mbi 5000 copë.
102. Ndërmarrja O.E.S Distrimed SHPK, për produktin e analizuar maska, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
103. Ndërmarrja Incomed SHPK nuk ka tregtuar produktet maska, alkool dhe gel dezinfektues gjatë periudhës hetimore nëntor 2019 – dhjetor 2020.
104. Ndërmarrja Aquila Group SHPK ka prodhuar 24 lloje të produktit alkool për periudhën

qershor 2020 – dhjetor 2020, me një sasi totale të prodhuar prej 947 467 njësi dhe shitur 942 168 njësi. Në vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim 11 lloje alkoolesh për të cilat sasia e shitur është mbi 10 000 njësi. Sasia e pa u shqyrtuar më poshtë është 20 151 njësi ose rreth 2.1% e shitjeve totale.

105. Ndërmarrja Aquila Group SHPK, për produktin e analizuar alkool rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
106. Ndërmarrja Sirol 2008 SHPK ka prodhuar 4 lloje të produktit alkool për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 2 301 njësi. Për shkak të sasive shumë të vogla (nën 1 000) të shitura, në vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim të gjithë llojet e alkoolit të shitur.
107. Ndërmarrja Sirol 2008 SHPK, për produktin e analizuar alkool rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
108. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 dhe nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjet R&S Farma SHPK, Rejsi Farma SHPK, Aldosch SHPK dhe Euromed SHPK.
109. Ndërmarrja R&S Farma SHPK, gjatë periudhës 1 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, ka tregtuar vetëm produktin termometër, të cilët nuk janë objekt vlerësimi i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
110. Ndërmarrja Rejsi Farma SHPK, gjatë periudhës 1 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, ka tregtuar vetëm produktin termometër, të cilët nuk janë objekt vlerësimi i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
111. Ndërmarrja Aldosch SHPK, gjatë periudhës 1 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020, ka tregtuar vetëm produktin Alkool Etilik 70% i denatruar 100.
112. Ndërmarrja Aldosch SHPK, për produktin e alkool të analizuar rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë

të materialeve paramjekësore”.

113. Si konkluzion, nga vlerësimi i zbatimit të masës së përkohshme për ndërmarrjet Aldosch – Farma SHPK, Aquila Group SHPK, Capital Group SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Delta Med SHPK, Evita SHPK, Fedos SHPK, Fufarma SHA, Incomed SHPK, Montal SHPK, O.E.S Distrimed SHPK R&S Farma SHPK, Rejsi Farma SHPK, Sirol 2008 SHPK dhe Winpharma SHPK rezulton se kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika (5) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve 1) Aldosch – Farma SHPK; (2) Aquila Group SHPK; (3) Capital Group SHPK; (4) Delta Pharma – AL SHPK; (5) Delta Med SHPK; (6) Evita SHPK; (7) Fedos SHPK; (8) Fufarma SHA; (9) Incomed SHPK; (10) Montal SHPK; (11) O.E.S Distrimed SHPK; (12) R&S Farma SHPK; (13) Rejsi Farma SHPK; (14) Sirol 2008 SHPK dhe (15) Winpharma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 827, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E
ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE
DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN ALFAMARKOS SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe miratimi i angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Alfamarkos SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Shkresën e ndërmarrjes Alfamarkos SHPK protokolluar pranë AK me nr. 293/1 prot., datë 17.06.2021 “Kërkesë për sqarime të angazhimeve të shoqërisë Alfamarkos Shpk

në lidhje me procedurën hetimore të hapur nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e produkteve paramjekësore”.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK

në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjes Alfamarkos SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 742, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “ALFAMARKOS” SHPK”.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
9. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
10. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situatë dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.
11. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

12. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
13. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
14. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
15. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
16. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shitesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.
17. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkoool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
18. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
 - i. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - iii. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
19. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.

20. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

21. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
22. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 21 lloje maskash dhe ka shitur një sasi prej 676 321 copë.
23. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza konstatohet rritje e çmimit të shitjes nga periudha e parë në periudhën e dytë dhe një rënie çmimi nga periudha e dytë në të tretën.
24. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

25. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
26. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar 13 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 60 339 copë.
27. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes për produktin alkool konstatohet rritje e tij nga periudha e parë në të dytën dhe rënie nga periudha e dytë në të tretën.

28. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

29. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
30. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar 12 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 7 lloje: Gel Dezinfektant 500ML Pompë, Gel Dezinfektant 1L, Gel Dezinfektant 125ML Beba, Dezinfektant 100ML, Gel Dezinfektant 200ML dhe Dezinfektant 100ML Beba.
31. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe konstatohet që çmimi i shitjes ka qenë në rënie.
32. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

33. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
34. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 128 copë.
35. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe nga analiza e çmimit të shitjes vihet re se ky çmim ka qenë në rënie përgjatë periudhave.
36. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

37. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
38. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
39. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
40. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.
41. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrja Alfarmakos SHPK.
42. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së

përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen Alfarmakos SHPK.

43. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka tregtuar 13 lloje të produktit alkool, 18 lloje të produktit gel dezinfektant dhe 20 lloje të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Nga këto produkte janë analizuar në mënyrë narrative: 4 lloje alkooli të cilat janë shitur në sasi mbi 2000 copë, 6 lloje maskash të cilat janë shitur në sasi mbi 5000 copë dhe 6 lloje gel dezinfektant të cilat janë shitur në sasi mbi 500 copë.
44. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK, për produktet e analizuar, maska, alkool dhe gel dezinfektant, rezulton se ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
45. Bazuar në Rregulloren “Për procedurat e angazhimeve”, e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka paraqitur vullnetarisht angazhimet e saj me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave si dhe mbajtjen dhe respektimin e tyre për të gjithë periudhën e konsideruar të nevojshme nga ana e Autoritetit.
46. Konkretisht ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:
 - a. *Nuk do të abuzojmë më ndonjë pozitë dominuese e për pasojë nuk do të caktojmë çmime të padrejta apo kushte të cilat janë të padrejta për konkurrencën në këtë treg objekt hetimi.*
 - b. *Çmimet tona në këtë treg objekt hetimi do të jenë të orientuara drejt kostos dhe nuk do të aplikojmë rritje të jashtëligjshme.*
 - c. *Angazhohemi që të publikojmë çmimet e tregut objekt hetimi.*
 - d. *Do të ruajmë transparencën në çmimin e shitjes së mallrave të tregut objekt hetimi.*
 - e. *E në përgjithësi angazhohemi të mos bëjmë marrëveshje të ndaluara sipas ligjit dhe vendimeve të Autoritetit.*
47. Autoriteti Konkurrencës, pavarësisht se ka përfunduar procedurat hetimore në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues dhe tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerëson se angazhimet janë të qarta, të vetekzekutueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrja Alfarmakos SHPK si dhe angazhimet kanë natyrë sjellje, d.m.th. çmimet do të jenë të orientuara drejt kostos, do të jenë transparente, si dhe sjellja e ndërmarrjes Alfarmakos SHPK do të jetë në përputhje me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në veçanti me nenin 4 dhe nenin 9.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja Alfarmakos SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.
- III. Ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka detyrimin ligjor të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Alfarmakos SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penaltetin përkatës.
- V. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 vjeçare për të gjitha angazhimet e marra nga ndërmarrja Alfarmakos SHPK.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 828, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E
ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE
DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN FARMA NET ALBANIA
SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe miratimi i angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Farma Net Albania SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;

- Shkresën mbi angazhimet e ndërmarrjes Farma Net Albania SHPK protokolluar në AK me shkresën nr. 293/2 prot., datë 21.06.2021.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal

SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjes Farma Net Albania SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 745, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “FARMA NET ALBANIA” SHPK”.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
9. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
10. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përbalimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përbalimin e kësaj situate dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-

dezinfektues për duar dhe termometër infrared.

11. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

12. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
13. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
- Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
14. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
15. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
16. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.
17. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
18. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

- i.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
- ii.tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
- iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

19. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
20. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

21. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
22. Ndërmarrja Farmanet SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 28 lloje të ndryshme maskash dhe ka shitur një sasi prej 1,688,661 copë maska.
23. Ndërmarrja Farmanet SHPK ka tregtuar produktin maska vetëm në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza konstatohet për produktin Maska KN95 pa Valvul ka patur rritje të çmimit të shitjes gjatë periudhës së tretë.
24. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

25. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
26. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar 10 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 35 065 copë.

27. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza konstatohet se çmimi i shitjes për produktin alkool në periudhën e tretë ka qenë në ulje.
28. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

29. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së pakëtuar.
30. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar 32 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 9 lloje: Dezinfektant alkoolik spray 100ML, Gel Antibacterial 1L Hand Sanitizer, Gel Hand Sanitizer 1L Me Pompë, Gel Hand Sanitizer 100ML, Gel Hand Sanitizer 100ML/80ML, Gel Hand Sanitizer 200ML, Gel Hand Sanitizer 500ML (Eagle), SoClean Antibacterial 80 ML dhe Xhel Antibakterial 110ML FNA.
31. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e mësipërme vihet re se çmimi i shitjes ka qenë në ulje nga periudha e dytë në periudhën e tretë.
32. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

33. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
34. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar 5 lloje të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 1126 copë.
35. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes

vihet re një rritje çmimi përgjatë periudhës së dytë.

36. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

37. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
38. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
39. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
40. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me

shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

41. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrjet Farma Net Albania SHPK.
42. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen Farma Net Albania SHPK.
43. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka tregtuar 10 lloje të produktit alkool, 15 lloje të produktit maska dhe 26 lloje të produktit dezinfektant për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në analizën për vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim 2 lloje alkoolesh për të cilët sasia e shitur është mbi 2000 copë, 7 lloje maskash për të cilat sasia e shitur është mbi 5000 copë si edhe 6 lloje dezinfektantësh për të cilët sasia e shitur është mbi 500 copë.
44. Ka realizuar shitje të produktit *Alkool Etilik I Cnatyruar 70 _1l* me një total prej 17 138 copë për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në qershor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 236.2 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 643.7 lekë/copë. Në korrik 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 266.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 460.3 lekë/copë. Në gusht 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 266.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 479.1 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 262.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 393.8 lekë/copë. Në tetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 266.6 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 391.8 lekë/copë. Në nëntor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 273.6 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 409.6 lekë/copë. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 283.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 377.6 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje çmimi në muajt qershor 2020, gusht 2020 dhe nëntor 2020.
45. Ka realizuar shitje të produktit *Alkool Etilik I Cnatyruar 90 _1l* me një total prej 3 095 copë për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në qershor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 370.6 lekë/copë. Në korrik 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 632.7 lekë/copë. Në gusht 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 384.1 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 253.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 378.2 lekë/copë. Në tetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 360.2 lekë/copë. Në nëntor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 381.5 lekë/copë. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 252.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 375.8 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje e çmimit në muajin korrik 2020 dhe nëntor 2020.

46. Ka realizuar shitje të produktit *Maska Kn95 (Maxsharer)* me një total prej 119 610 copë për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në qershor 2020 dhe korrik 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në gusht 2020 për këtë produkt janë realizuar vetëm blerje me çmim mesatar prej 19.9 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 19.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 252.2 lekë/copë. Në tetor 2020 për këtë produkt janë realizuar vetëm blerje me një çmim mesatar prej 19.8 lekë/copë. Në nëntor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 80 lekë/copë. Në dhjetor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 298.9 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje në muajt shtator 2020 dhe dhjetor 2020.
47. Ka realizuar shitje të produktit *Maska Kn95 Me Valvul (Kine)* me një total prej 111 651 copë për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në qershor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 265.6 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 458.2 lekë/copë. Në korrik 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 583.6 lekë/copë. Në gusht 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 292.1 lekë/copë. Në shtator 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 331.1 lekë/copë. Në tetor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 424.6 lekë/copë. Në nëntor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 251.8 lekë/copë. Në dhjetor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 250 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje e çmimit në muajin qershor 2020, korrik 2020 dhe tetor 2020.
48. Ka realizuar shitje të produktit *Maske Pa Valvul FFP2 (NOBLE&CO)* me një total prej 141 790 copë për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në qershor 2020 dhe korrik 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në gusht 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 115.2 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 260 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 62 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 260 lekë/copë. Në tetor 2020 dhe nëntor 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 39.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 219.1 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet një diferencë e konsiderueshme midis çmimit mesatar të blerjes dhe atij të shitjes gjatë muajve në të cilët është tregtuar.
49. Ka realizuar shitje të produktit *Gel Hand Sanitizer 500 Ml (Eagle)* me një total prej 27 543 copë për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Në qershor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 382.8 lekë/copë. Në korrik 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 368.4 lekë/copë. Në gusht 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 434.3 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 233.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 373.1 lekë/copë. Në tetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 250 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 413.7 lekë/copë. Në nëntor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 219.6 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 454.5 lekë/copë. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 216.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 358.3 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje çmimi në muajt gusht 2020, shtator 2020 dhe tetor 2020.

50. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK, për produktet Alkool Etilik I Cnatyruar 70 _1l, Alkool Etilik I Cnatyruar 90 _1l , Maska Kn95 (Maxsharer), Maska Kn95 Me Valvul (Kine), Maske Pa Valvul FFP2 (NOBLE&CO), Gel Hand Sanitizer 500 Ml (Eagle) rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, nuk ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
51. Ndërmarrja Farmanet SHPK, për produktet Alkool Etilik I Cnatyruar 70 _1l, Alkool Etilik I Cnatyruar 90 _1l , Maska Kn95 (Maxsharer), Maska Kn95 Me Valvul (Kine), Maske Pa Valvul FFP2 (NOBLE&CO), Gel Hand Sanitizer 500 Ml (Eagle) rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, nuk ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
52. Bazuar në Rregulloren “Për procedurat e angazhimeve”, e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka paraqitur vullnetarisht angazhimet e saj me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave si dhe mbajtjen dhe respektimin e tyre për të gjithë periudhën e konsideruar të nevojshme nga ana e Autoritetit.
53. Konkretisht ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:
- i. *Ndërmarrja FARMA NET ALBANIA SHPK nuk do të bëjë asnjë marrëveshje të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:*
 - a) *caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;*
 - b) *kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;*
 - c) *ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;*
 - d) *në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - e) *kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.*
 - ii. *Ndërmarrja FARMA NET ALBANIA SHPK, nuk do të realizojë:*
 - a) *vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
 - c) *zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - d) *vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë*

detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

54. Në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, angazhimet e mësipërme janë marrë nga ndërmarrja nën hetim për gjithë periudhën kohore në të ardhmen.
55. Autoriteti Konkurrencës, pavarësisht se ka përfunduar procedurat hetimore në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues dhe tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerëson se angazhimet janë të qarta, të vetekzekutueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrja Farma Net Albania SHPK si dhe angazhimet kanë natyrë sjellje, d.m.th. çmimet do të jenë të orientuara drejt kostos, do të jenë transparente, si dhe sjellja e ndërmarrjes Farma Net Albania SHPK do të jetë në përputhje me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në veçanti me nenin 4.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja Farma Net Albania SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.
- III. Ndërmarrja Farma Net Albania SHPK ka detyrimin ligjor të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Farma Net Albania SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penaltetin përkatës.

- V. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 vjeçare për të gjitha angazhimet e marra nga ndërmarrja Farma Net Albania SHPK.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 829, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E
ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE
DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN EUROMED SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe miratimi i angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Euromed SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Shkresën mbi angazhimet e ndërmarrjes Euromed SHPK protokolluar në AK me

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK, Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK

në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
6. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 752, datë 03.12.2020 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon: Capital Group SHPK, Florfarma SHPK, Euromed SHPK, Aquarius Medical SHPK, New Medical Plus SHPK, Fedos SHPK dhe Winpharma SHPK.
7. Në zbatimin të VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” dhe të Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44, datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50, datë 19.10.2020, në datën 22.10.2020 u krye inspektim pranë ndërmarrjes Euromed SHPK.
8. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
9. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
10. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe

shërbimeve për përballimin e kësaj situatë dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.

11. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

12. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
13. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
- Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
14. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
15. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshme nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
16. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shitesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.
17. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
18. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

- i.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
- ii.tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
- iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

19. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
20. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

21. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.
22. Ndërmarrja Euromed SHPK përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 7 lloje maske dhe ka shitur një sasi prej 2 198 837 copë maska.
23. Ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza konstatohet se për produktin “Maska 3ply kirurgjikale” ka patur rritje të çmimit të shitjes gjatë periudhës së parë dhe të dytë ndërkohë që në periudhën e tretë çmimi ka pësuar rënie. Për produktin “Maska me llastik” ka patur rritje të çmimit të shitjes përgjatë tre periudhave.
24. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

25. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.

26. Ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar 4 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 19 793 copë.
27. Ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe konstatohet se për një lloj alkooli çmimi ka qenë në rënie nga periudha e dytë në të tretën.
28. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

29. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së pakeluar.
30. Ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar vetëm 1 lloj dezinfektanti (Xhel dezinfektant shumëpërdorimësh 1 LIT).
31. Ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza për këtë produkt vihet re një rritje e lehtë e çmimit nga periudha e dytë në të tretën.
32. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

33. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
34. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar 3 lloje të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 223 copë.
35. Ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020- 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, dhe nga analiza e çmimit të shitjes konstatohet rritje e tij, vetëm për një lloj termometër nga periudha e dytë në periudhën e

tretë.

36. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrebbërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

37. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
38. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
39. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike të cilat u administruan gjatë inspektimeve për ndërmarrjen Euromed SHPK, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga kjo ndërmarrje, u vu re që data e shitjeve dhe blerjeve të artikujve maska, dezinfektant si edhe alkool, nuk ishte e specifikuar. Për këto arsye gjatë hetimit të thelluar, është analizuar dhe zbatimi i masës së përkohshme nga kjo ndërmarrje për periudhën 1 nëntor 2019 – 31 dhjetor 2020.
40. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Euromed SHPK ka tregtuar 5

lloje të produktit maska, 3 lloje të produktit alkool dhe 1 lloj të produktit dezinfektant për periudhën nëntor 2020 – dhjetor 2020. Në analizën për vlerësimin e masës së përkohshme janë marrë në shqyrtim 1 lloj alkooli për të cilin sasia e shitur është mbi 2000 copë, 5 lloje maskash për të cilat sasia e shitur është mbi 5000 copë si edhe 1 lloj dezinfektanti për të cilin sasia e shitur është mbi 500 copë.

41. Ka realizuar shitje të produktit *Maska Kn (95)* me një total prej 98 260 copë për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020. Në nëntor 2019, dhjetor 2019, janar 2020 dhe shkurt 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në mars 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 300.2 lekë/copë por në këtë muaj nuk janë realizuar shitje. Në prill 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 305.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 549.9 lekë/copë. Në maj 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 391.1 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 450 lekë/copë. Në qershor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 309.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 495.2 lekë/copë. Në korrik 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 305.54 lekë/copë. Në gusht 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 300.2 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 520.4 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 281.7 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 229.3 lekë/copë. Në tetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 304.4 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 258.4 lekë/copë. Në nëntor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 309.4 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 254.9 lekë/copë. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 21.2 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 285.4 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje e çmimit në muajin qershor 2020, gusht 2020 dhe në muajin dhjetor 2020.
42. Ka realizuar shitje të produktit *Maska Personale* me një total prej 97 150 copë për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020. Në nëntor 2019, dhjetor 2019 dhe janar 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në shkurt 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 4.5 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 2.4 lekë copë. Në mars 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 4.3 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 4.9 lekë/copë. Në prill 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 22.5 lekë/copë por për në këtë muaj nuk janë realizuar shitje. Në maj 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 35.6 lekë/copë. Në qershor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 40 lekë/copë. Në korrik 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 7 lekë/copë. Në gusht 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 8.1 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 25 lekë/copë. Në shtator 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 16.6 lekë/copë. Në tetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 20 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 65.8 lekë/copë. Në nëntor 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 3.4 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 72 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje e çmimit në muajt maj 2020, qershor 2020, tetor 2020 dhe dhjetor 2020.
43. Ka realizuar shitje të produktit *MI/Maska FFP3* me një total prej 6 100 copë për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020. Në nëntor 2019, dhjetor 2019, janar 2020 dhe shkurt 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në mars 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 700 lekë/copë. Në prill 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar

blerje por është shitur mesatarisht me 897.5 lekë/copë. Në maj 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 964 lekë/copë. Në qershor 2020 dhe korrik 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në gusht 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 707.7 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt nuk është tregtuar. Në tetor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 322.2 lekë/copë. Në nëntor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 425.1 lekë/copë. Në dhjetor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 709.1 lekë/copë. Për këtë produkt pavarësisht se nuk janë realizuar blerje konstatohet rritje e çmimit në muajt prill 2020, maj 2020, nëntor 2020 dhe dhjetor 2020.

44. Ka realizuar shitje të produktit *xhel/xhel shumë përdorimësh* me një total prej 30 249 copë për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020. Në nëntor 2019 dhe dhjetor 2019 ky produkt nuk është tregtuar. Në janar 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 254.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 554.7 lekë/copë. Në shkurt 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 582.6 lekë/copë. Në mars 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 266.6 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 587.7 lekë/copë. Në prill 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 421.5 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 546.4 lekë/copë. Në maj 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 606.8 lekë/copë. Në qershor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 254.8 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 604.1 lekë/copë. Në korrik 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 384.6 lekë/copë. Në gusht 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 292.4 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 452.9 lekë/copë. Në shtator 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 253.2 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 261.7 lekë/copë. Në tetor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 349.4 lekë/copë. Në nëntor 2020 për këtë produkt nuk janë realizuar blerje por është shitur mesatarisht me 605.4 lekë/copë. Në dhjetor 2020 ky produkt është blerë mesatarisht me 242 lekë/copë dhe është shitur mesatarisht me 611.1 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje e çmimit në muajt maj 2020, qershor 2020, gusht 2020, nëntor 2020 dhe dhjetor 2020.
45. Ndërmarrja Euromed SHPK, për produktet Maska Kn (95), Maska Personale, MI/Maska FFP3 dhe Xhel/xhel shumë përdorimesh, rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, nuk ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
46. Bazuar në Rregulloren “Për procedurat e angazhimeve”, e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Euromed SHPK ka paraqitur vullnetarisht angazhimet e saj me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave si dhe mbajtjen dhe respektimin e tyre për të gjithë periudhën e konsideruar të nevojshme nga ana e Autoritetit.

47. Konkretisht ndërmarrja Alfarmakos SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:
Ndërmarrja EUROMED SHPK nuk do të bëjë asnjë marrëveshje të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:

- a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;*
- b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;*
- c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;*
- d) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
- e) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.*

48. Autoriteti Konkurrencës, pavarësisht se ka përfunduar procedurat hetimore në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues dhe tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerëson se angazhimet janë të qarta, të vetekzekutueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrja Euromed SHPK si dhe angazhimet kanë natyrë sjellje, d.m.th. çmimet do të jenë të orientuara drejt kostos, do të jenë transparente, si dhe sjellja e ndërmarrjes Euromed SHPK do të jetë në përputhje me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në veçanti me nenin 4 dhe nenin 9.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja Euromed SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.
- III. Ndërmarrja Euromed SHPK ka detyrimin ligjor të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të

detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Euromed SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penaltetin përkatës.
- V. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 vjeçare për të gjitha angazhimet e marra nga ndërmarrja Euromed SHPK.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 830, Datë 02.09.2021

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË
MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE
GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT
ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE MIRATIMIN E
ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE
DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN TRIMED SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe miratimi i angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Trimed SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24 germa (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave;
- Shkresën e ndërmarrjes Trimed SHPK protokolluar pranë AK me shkresën 293 prot.,

datë 15.06.2021 “Angazhime vullnetare në bazë të Rregullores “Për procedurat e angazhimeve”.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
3. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 717, datë 15.10.2020 vendosi “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjeve CFO Pharma SHPK, Delta Pharma – AL SHPK, Pharma One SHPK, Intermed SHPK, Alfarmakos SHPK, Trimed SHPK, Megapharma SHPK, Evita SHPK, IMI – Farma SHPK, Fufarma SHA, Medicamenta SHPK, Mini Invest Albania SHPK, Delta Med SHPK, O.E.S Distrimed SHPK, Montal SHPK, MSE SHPK, Farma Net Albania SHPK, Tresì – Farm SHPK, Incomed SHPK,

Florifarma SHPK, Lekli SHPK, Dial – ALB SHPK, Sirol 2008 SHPK, Aquila Group SHPK në tregun e shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore, për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

5. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, bazuar në Autorizimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 110/44 datë 24.8.2020 dhe nr. 110/50 datë 19.10.2020, u krye inspektim pranë ndërmarrjes Trimed SHPK.
6. Të dhënat e siguruar në formë fizike dhe elektronike, u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shit-blerjet e realizuara nga këto ndërmarrje. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë inspektimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 743, datë 19.11.2020 “Mbi zbatimin e pikës IV të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 717, datë 15.10.2020 për ndërmarrjen “TRIMED” SHPK”.
7. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 725, datë 09.11.2020 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””, vendosi. “Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.
8. Për efekt të analizës së konkurrencës dhe sjelljes së ndërmarrjeve periudha hetimore është ndarë në tre fasha kohore të cilat janë: 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020, 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020.
 - Në lidhje me këtë ndarje sqarojmë si më poshtë vijon:
 - i. 1 nëntor 2019 - 29 shkurt 2020 – është periudha përpara fillimit të pandemisë COVID-19;
 - ii. 1 mars 2020 - 31 gusht 2020 - është periudha e hapjes së procedurës së hetimit paraprak dhe marrjes së masës së përkohshme;
 - iii. 1 shtator 2020 - 31 dhjetor 2020 - është periudha e vlerësimit të sjelljes së shoqërive në hetim të cilat tregtojnë produkte në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues si dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
9. Për sa më sipër, përcaktimi i këtyre fashiave ndihmon në vlerësimin dhe krahasimin e sjelljes së ndërmarrjeve në hetim në kohën para, gjatë dhe pas dhënies së masës së përkohshme.
10. Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe APP nr. 296, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19”, është përcaktuar lista e mallrave dhe shërbimeve për përballimin e kësaj situatë dhe në këtë listë përfshihen, maskat, alkooli, gel-dezinfektues për duar dhe termometër infrared.

11. Metodologjia e përdorur është Materiali i OECD “Çmimet shfrytëzuese në kohën e COVID-19”¹.

II. Analiza e konkurrencës

II. 1 Tregu përkatës

12. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
13. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, tregu përkatës i produktit përfshin:
- Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - Tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;
 - Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
14. Përkufizimi i tregut për një produkt/shërbim merr parasysh efektin e zëvendësueshmërisë së produktit/shërbimit (në anën e kërkesës dhe ofertës).
15. Zëvendësueshmëria në anën e kërkesës nënkupton masën në të cilën produktet mund të konsiderohen si të këmbyeshmë nga këndvështrimi i prodhuesve ose i konsumatorëve. Politika e vendosjes së çmimeve të një firme për një produkt të caktuar disiplinohet nëse konsumatorët e kanë mundësinë të blejnë një produkt tjetër i cili, sipas vlerësimit të tyre është i barasvlefshëm për nga natyra, përdorimi dhe/ose çmimi.
16. Zëvendësueshmëria në anën e ofertës ndodh në rastin kur kufizimi konkurrues shtesë mbi një firmë mund të vijë nga prodhuesit e produkteve të tjera që e kanë mundësinë të ndërrojnë destinacionin e prodhimit të tyre pa vonesa për të prodhuar produktet në fjalë me një kosto të papërfillshme dhe janë të gatshëm të hyjnë në konkurrencë në segmentin e tregut përkatës.
17. Oferta në treg për produktet maska dhe termometër, sigurohet nga importi i realizuar nga ndërmarrjet në hetim, ndërsa produktet alkool dhe gel dezinfektues prodhohen në vend dhe/ose importohen.
18. Nisur nga sa më sipër, tregje përkatëse të produktit do të konsiderojmë:
- i. tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
 - ii. tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues;

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/Exploitative-pricing-in-the-time-of-COVID-19.pdf>

iii.tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.

19. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
20. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, furnitorët dhe klientët e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e konkurrencës, treg gjeografik do të konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

III.1 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave

21. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhure.
22. Ndërmarrja Trimed SHPK, përgjatë periudhës në hetim ka tregtuar 11 lloj maskash dhe ka shitur një sasi prej 200 821 copë maska.
23. Ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar produktin maska në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020, me çmime të pandryshuara.
24. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit maskë, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues

III.2.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

25. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
26. Ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar 16 lloje të produktit alkool për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një sasi totale të shitur prej 17 089 copë.
27. Ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar produktin alkool në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31

dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes për produktin alkool konstatohet rritje e tij nga periudha e parë në të dytën dhe rënie nga periudha e dytë në të tretën.

28. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit alkool, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.2.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues

29. Produkti gel dezinfektant është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektant ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
30. Ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar 22 lloje dezinfektantësh, ndër të cilët kanë qenë më të shitur 7 lloje: *Gel Hand Higjen *100ML, Gel Hand Higjen *120 ML, Gel Hand Higjen *150ML, Gel Hand Higjen *175ML, Gel Hand Higjen *1L, Gel Hand Higjen *500ML dhe Gel Hand Higjen *80ML.*
31. Ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar produktin gel dezinfektant në periudhën 1 nëntor 2019 – 29 shkurt 2020, periudhën 1 mars 2020 – 31 gusht 2020 dhe periudhën 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes për produktin gel dezinfektant konstatohet rritje e tij nga periudha e parë në periudhën e dytë dhe mbajtja e këtyre çmimeve edhe përgjatë periudhës së tretë.
32. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektant nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit gel dezinfektant, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III.3 Analiza e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

33. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
34. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar 1 lloj të produktit termometër për periudhën nëntor 2019 – dhjetor 2020, me një total shitjesh prej 21 copë.
35. Ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar produktin termometër në periudhën 1 mars 2020- 31 gusht 2020 dhe 1 shtator 2020 – 31 dhjetor 2020. Nga analiza e çmimit të shitjes konstatohet se ky çmim ka qenë në rënie përgjatë periudhave.

36. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e sjelljeve të bashkërenduar midis ndërmarrjeve për tregtimin e produktit termometër infrared, e cila ka si objekt dhe si pasojë kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 3, pika 4, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

IV. Zbatimi i masës së përkohshme

37. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 684, datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
38. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, vendosi:
- i. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:
 - a. Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
 - b. Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
 - c. Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - d. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.
39. Në kuadër të vlerësimit të masës së përkohshme, gjatë procedurës së hetimit paraprak, referuar informacionit të administruar pranë AK, është analizuar sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të materialeve paramjekësore për produktet maska, alkool dhe gel-dezinfektant.
40. Komisioni i Konkurrencës në vijim të procedurave të mësipërme u shpreh me Vendimin nr. 717, datë 15.10.2020 “Për vendosje gjobe dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj disa ndërmarrjeve për mos zbatimin e masës së përkohshme të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore””.

41. Në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 717, datë 15.10.2020, të dhënat e siguruara në formë fizike dhe elektronike për periudhën 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020 janë përpunuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, duke krahasuar deklaratat e subjektit me shitblerjet e realizuara nga ndërmarrjet Trimed SHPK.
42. Në zbatim të pikës 3 të Vendimit nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”, të dhënat e administruara pranë AK referuar shkresës sonë nr. 110/84 prot., datë 09.12.2020 “Kërkesë për informacion” u përpunuan nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën 1 qershor 2020 – 31 dhjetor 2020 për ndërmarrjen Trimed SHPK.
43. Bazuar në të dhënat e administruara, rezulton se ndërmarrja Trimed SHPK ka tregtuar 13 lloje të produktit alkool, 18 lloje të produktit gel dezinfektant dhe 8 lloje të produktit maska për periudhën qershor 2020 – dhjetor 2020. Nga këto produkte janë analizuar në mënyrë narrative: 1 lloj alkooli i cili është shitur në një sasi mbi 2000 copë, 3 lloje maskash të cilat janë shitur në një sasi mbi 5000 copë dhe 2 lloje gel dezinfektant të cilat janë shitur në një sasi mbi 500 copë.
44. Ka realizuar shitje të produktit “*Gel Hand Higjen* 1 L*” në një sasi prej 938 copë. Në qershor 2020, ky produkt nuk është tregtuar. Në korrik 2020, ky produkt është blerë me një çmim 333.3 lekë/copë dhe nuk ka patur shitje. Në gusht 2020, ky produkt është blerë me një çmim mesatar 333.33 lekë/copë dhe është shitur me një çmim mesatar 352 lekë/copë. Në shtator 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 352 lekë/copë. Në tetor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 352 lekë/copë. Në nëntor 2020, nuk ka patur blerje por është shitur me një çmim mesatar 352 lekë/copë. Në dhjetor 2020, ky produkt është blerë me një çmim mesatar 333.33 lekë/copë dhe është shitur me një çmim mesatar 450.5 lekë/copë. Për këtë produkt konstatohet rritje e çmimit në muajin dhjetor 2020.
45. Ndërmarrja Trimed SHPK, për produktin Gel Hand Higjen* 1 L rezulton se për periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2020, nuk ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.
46. Bazuar në Rregulloren “Për procedurat e angazhimeve”, e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Trimed SHPK ka paraqitur vullnetarisht angazhimet e saj me qëllim zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura të konkurrencës në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave si dhe mbajtjen dhe respektimin e tyre për të gjithë periudhën e konsideruar të nevojshme nga ana e Autoritetit.

47. Konkretisht ndërmarrja Trimed SHPK ka depozituar angazhimet si më poshtë vijon:
- Trimed do të aplikojë një çmim të shitjes me shumicë të produkteve në tregun përkatës të orientuar drejt kostos, duke mos aplikuar rritje të pajustificuara ekonomikisht dhe ligjërisht të këtij çmimi. Trimed do të vazhdojë publikimin e çmimeve të këtyre produkteve në faqen e saj zyrtare të internetit.*
 - Trimed do të jetë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së produkteve në tregun përkatës,*
 - Trimed nuk do të vendosë çmime apo kushte të tjera të padrejta tregtimi në tregun përkatës në rast se Trimed fiton ndonjë pozitë dominuese në këtë treg.*
 - Trimed nuk do të bëjë asnjë marrëveshje apo praktikë të bashkërenduar me objekt apo pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës, të konsideruar të ndaluar nga ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*
48. Në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, angazhimet e mësipërme janë marrë nga ndërmarrja nën hetim për gjithë periudhën kohore në të ardhmen.
49. Autoriteti Konkurrencës, pavarësisht se ka përfunduar procedurat hetimore në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues dhe tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerëson se angazhimet janë të qarta, të vetekzekutueshme si dhe janë depozituar vullnetarisht nga ndërmarrja Trimed SHPK si dhe angazhimet kanë natyrë sjellje, d.m.th. çmimet do të jenë të orientuara drejt kostos, do të jenë transparente, si dhe sjellja e ndërmarrjes Trimed SHPK do të jetë në përputhje me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në veçanti me nenin 4.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”,

VENDOSI:

- Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja Trimed SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.
- Ndërmarrja Trimed SHPK ka detyrimin ligjor të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

- d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Trimed SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penalitetin përkatës.

V. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 vjeçare për të gjitha angazhimet e marra nga ndërmarrja Trimed SHPK.

VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 831, Datë 23.09.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT (JOINT VENTURE), NGA SHOQËRITË ENEL X S.R.L. DHE VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG SA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët (JV), nga shoqëritë Enel X S.r.l. dhe Volkswagen Finance Luksemburg SA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, nga shoqëritë Enel X S.r.l. dhe Volkswagen Finance Luksemburg SA.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët nga shoqëritë Enel X S.r.l. dhe Volkswagen Finance Luksemburg SA.

Palët kanë nënshkruar më datë 24 qershor 2021 Marrëveshjen e Sipërmarrjes së Përbashkët ku:

Pala 1: Enel X S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, që ekziston sipas legjislacionit të Republikës së Italisë. Enel X S.r.l është linja globale e Enel S.p.A., që fokusohet në produktet dhe shërbimet e lidhura me energjinë, duke përfshirë sistemet e shpërndarjes dhe bateritë, ndriçimin e zgjuar, lëvizshmërinë elektrike, shërbime të karikimit të shpejtë dhe software për sistemet e vetë-gjenerimit.

Enel S.p.A. është një shoqëri aksionare e listuar në bursë, e cila është shoqëria mbajtëse (holding company) e Enel Group. Grupi Enel nuk është i pranishëm në Shqipëri dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar gjatë tre viteve të fundit.

Pala 2: Volkswagen Finance Luksemburg SA është një shoqëri aksionare, e organizuar sipas ligjeve të Luksemburgut dhe është pjesë e menaxhimit dhe industrisë së ndërmarrjeve. Volkswagen Finance Luksemburg SA është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.

Pala 3: Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare gjermane, e themeluar sipas legjislacionit gjerman.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Albania SHPK.

Ndërmarrje e përbashkët (JV) do të krijohet me qëllimin për të investuar, zotëruar, shfrytëzuar dhe operuar një infrastrukturë karikimi të shpejtë për makinat elektrike në Itali.

JV nuk do të ushtrojë aktivitetet në Shqipëri.

Më datë 24 qershor 2021, shoqëritë Enel X S.r.l., Volkswagen Finance Luxemburg SA dhe Volkswagen Aktiengesellschaft, kanë nënshkruar “Marrëveshjen e Sipërmarrjes së Përbashkët”, përmes së cilës do të themelojnë një ndërmarrja të përbashkët, me kontribute të barabarta në kapital ku shoqëritë Volkswagen Finance Luxemburg SA dhe Enel X S.r.l. do të zotërojnë 50% të kapitalit aksionar.

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të karikimit me fuqi të lartë elektrike për automjetet elektrike, të cilat do të jenë të aksesueshme publikisht, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota JV nga shoqëria Enel X S.r.l. dhe shoqëria Volkswagen Finance Luxemburg SA.

Volkswagen Finance Luxemburg SA është një shoqëri Holding e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK. Enel X S.r.L është pjese e Grupit Enel, grup i cili nuk operon dhe nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri në 3 vitet e fundit.

Ndërmarrja e përbashkët JV nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, (Joint Venture), nga shoqëritë Enel X S.r.l. dhe Volkswagen Finance Luksemburg SA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 832, Datë 23.09.2021

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SK WIND GMBH & CO.KG NGA SHOQËRITË STATKRAFT GERMANY GMBH DHE STATKRAFT HOLDING WIND & SOLAR DEUTSCHLAND GMBH.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH dhe Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH dhe Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH,

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëria Statkraft Germany GmbH dhe shoqëria Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH.

Referuar “Marrëveshjes së Shitblerjes” të lidhur më datë 20 gusht 2021, palët janë:

Blerësi 1. Statkraft Germany GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie: veprimtaria holding, blerja, administrimi dhe shitja e aksioneve në shoqëri të tjera dhe kryerja e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura.

Blerësi 2. Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie: blerja, administrimi dhe menaxhimi i shoqërive Holding.

Shoqëritë Statkraft Germany GmbH dhe Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH janë pjesë e Statkraft Group. Statkraft AS, është shoqëria mëmë e Statkraft Group.

Në Shqipëri, Statkraft AS është i pranishëm nëpërmjet filialeve të zotëruar prej tij, Statkraft Renewables Albania Sh.p.k dhe shoqërisë koncesionare Devolli Hydropower Sh.A.

Shitësi 1: Breeze Three Energy GmbH & Co. KG, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: pjesë e industrisë së gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Shitësi 2: Breeze Three GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionin gjerman.

Shoqëria Target: SK Wind GmbH & Co.KG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionin gjerman, me objekt veprimtarie: zotërimin e një portofoli me ferma të gjenerimit të energjisë nga era (Gjermani dhe Francë).

Shoqëria SK Wind GmbH & Co.KG nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nëpërmjet marrëveshjes së synuar, shoqëritë Statkraft Germany GmbH dhe Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH do të fitojnë kontrollin dhe pronësinë e plotë mbi shoqërinë SK Wind GmbH & Co.KG sipas kushteve dhe afateve në Marrëveshjen e shitblerjes.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH dhe Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH, i parashikuar në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i gjenerimit dhe tregtimit të energjisë së rinovueshme, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëria Statkraft Germany GmbH dhe shoqëria Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH, të cilat janë pjesë e Statkraft Group.

Statkraft Group është prezente dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë koncesionare Devolli Hydropower Sh.A.

SK Wind GmbH & Co.KG nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëria Statkraft Germany GmbH dhe shoqëria Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 833, Datë 23.09.2021

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BISER BIDCO S.A.R.L. DHE FILIALIT TË SAJ NOVA KREDITNA BANKA MARIBOR D.D. NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfthimin e kontrollit të shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Palët kanë nënshkruar “Marrëveshje e Shitblerjes së Aksioneve” ku,

Blerësi: OTP Bank Nyrt. është një shoqëri publike aksionare, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Hungarisë dhe ofron shërbimet e saj financiare universale nëpërmjet disa filiale në Evropën Qendrore dhe Lindore. Aktivitetet e OTP Bank Nyrt janë ndërmjetësim

monetar si dhe qira financiare, aktivitete të tjera të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensione, brokerimi i kontratave të letrave me vlerë, aktivitete të tjera ndihmëse të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensionit, aktiviteti i agjentëve dhe brokerave të sigurimit etj.

Në Shqipëri, OTP Bank Nyrt është prezente nëpërmjet filialit të saj OTP Bank Albania SHA, e cila është një shoqëri aksionare me objekt aktiviteti: pranimin e depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, dhënie huash, ndërmjetësim i transaksioneve monetare etj.

Shitësi: Biser Topco S.a.r.l. është një shoqëri private, me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Dukatit të Madhe të Luksemburgut dhe operon si një shoqëri holding dhe nëpërmjet filialeve, ofron shërbime financiare.

Shoqëria Target: Biser Bidco S.a.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Luksemburgut, me objekt aktiviteti pjesëmarrje në të gjitha shoqëritë ose ndërmarrjet në çfarë lloj forme dhe administrimi i këtyre pjesëmarrjeve, blerja me nënshkrim ose shkëmbim i të gjithë titujve, aksioneve dhe vlerave të tjera të pjesëmarrjes nga çdo subjekt publik ose privat etj. Biser Bidco S.a.r.l. zotërohet 100% nga [...]. është një shoqëri zotëruese (holding company), qëllimi i vetëm i së cilës është zotërimi 100% i aksioneve në Nova Kreditna Banka Maribor d.d.

Nova Kreditna Banka Maribor d.d. është një bankë sllovene, me seli në qytetin Maribor. Aktiviteti kryesor konsiston në shërbimet bankare, shërbimet financiare dhe shërbimet financiare shtesë për të cilat ka marrë miratim nga Banka e Sllovenisë.

Biser Bidco S.a.r.l. dhe Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nuk kanë filiale dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Më datë 31 maj 2021, shoqëritë Biser Topco S.a.r.l. dhe OTP Bank Nyrt. kanë nënshkruar “Marrëveshje e Shitblerjes së Aksioneve”, në lidhje me shit-blerjen e të gjithë kapitalit aksionar të Biser Bidco S.a.r.l. Sipas kësaj marrëveshjeje shitësi Biser Topco S.a.r.l. do të shesë aksionet tek blerësi OTP Bank Nyrt., i cili do të blejë aksionet dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që u bashkëngjiten atyre.

Pas transaksionit, Biser Bidco S.a.r.l. dhe Nova Kreditna Banka Maribor d.d. do të kontrollohen plotësisht nga OTP Bank Nyrt.

OTP Bank është e pranishme në Slloveni që prej vitit 2019, përmes blerjes së SKB Banka d.d., Ljubljana. Pas transaksioni të njoftuar shoqëria OTP Bank Nyrt do të përftojë kontrollin e shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. duke zgjeruar rrjetin e bankave të kontrolluara prej saj në Slloveni.

Sipas dokumentacionit të depozituar, transaksion i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Mbështetur mbi treguesit e publikuara nga Shoqata Shqiptare e Bankave për vitin 2020, struktura e tregut bankar në Shqipëri ka karakteristikat e një tregu mesatarisht i përqendruar pa praninë e bankave me pozitë dominuese. Para përqendrimit, pjesët e tregut të OTP Bank Albania SHA sipas aseteve, depozitave dhe kredive luhaten nga XXX %. Duke qenë se Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nuk është aktive në Shqipëri, dhe transaksioni i blerjes ndodh jashtë vendit, nuk do të ketë mbivendosje të aktivitetit të biznesit midis palëve të këtij përqendrimi në Shqipëri si rrjedhojë nuk do të kemi ndryshim të strukturës së tregut. Pjesa e tregut të OTP Bank Albania SHA do të mbetet në nivelet 6-10% duke mos sjellë ndryshime të strukturës së tregut edhe pas përqendrimit.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nga shoqëria OTP Bank Nyr.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 834, Datë 23.09.2021

**“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË GRUPPO SERVIZI ASSOCIATI S.P.A NGA
SHOQËRIA EURIZON CAPITAL SGR S.P.A”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përfhtimin e kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

Referuar “Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve” të nënshkruar në datë 26 maj 2021 dhe “Marrëveshjes së Aksionarëve” nënshkruar në datë 08 korrik 2021, palët janë:

Blerësi: Pramerica SGR S.p.A, një shoqëri aksionare, e cila ofron konsulencë në aktivitetin e drejtimit dhe të bashkërendimit të Grupo Bancario Intesa Sanpaolo. Nga data 1 korrik 2021, Pramerica SGR S.p.A është përthithur nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

Eurizon Capital SGR S.p.A është një shoqëri aksionare me një ortak të vetëm, e cila merret me investime, me tjetërsime dhe me negocime të të drejtave që kanë të bëjnë me titujt, merret me lëshimin dhe asgjësimin e certifikatave të pjesëmarrjes etj. Eurizon Capital SGR S.p.A është një shoqëri e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Intesa SanPaolo Group dhe një filial i kontrolluar drejtpërdrejt nga Intesa Sanpaolo S.p.A.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, shoqëri aksionare me objekt aktiviteti ofrimin e veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit.

Shitësi: Aurora Quattro S.p.A., shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Italisë, me aktivitet kryesor: shoqëri me pjesëmarrje aktivitete importi dhe eksporti, kontratë me rrjetin etj. Aurora Quattro S.p.A. zotërohet nga [...], [...] dhe nga z.[...].

Palë pjesëmarrëse: Al.Pe.Ivest S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Italisë, me objekt aktiviteti kryesor: aktivitete të shoqërive të kontrolluara të angazhuara në aktivitetet e menaxhimit, aktivitete importi dhe eksporti, kontratë me rrjetin etj.

Target: Gruppo Servizi Associati S.p.A (GSA) është një shoqëri aksionare, aktive në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të infrastrukturave dhe shërbimeve të sigurisë dhe parandalimit të zjarrit për fusha të ndryshme në sektorin privat dhe publik.

GSA S.p.A. nuk është aktiv në Shqipëri.

Më datë 30 qershor 2021, shoqëritë Pramerica SGR S.p.A, Aurora Quattro S.p.A dhe Al.Pe.Ivest S.p.A kanë nënshkruar “Kontratë Shitblerje Aksionesh”, në lidhje me shit-blerjen e të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë GSA S.p.A. Në bazë të kushteve të kësaj kontrate, shitësi Aurora Quattro S.p.A do të shesë aksionet tek blerësi Pramerica SGR S.p.A, (tashmë e përthithur nga Eurizon Capital SGR S.p.A), përmes shoqërisë që do të krijohet posaçërisht për këtë qëllim [...] S.p.A., e cila do të blejë ekskluzivisht të gjitha aksionet, që përfaqësojnë të gjithë kapitalin aksionar të targetit GSA S.p.A. Aksionet e shoqërisë Eurizon Capital SGR S.p.A do të kontrollohen në [...] nëpërmjet një shoqërie të re italiane të quajtur [...],.

Më datë 08 korrik 2021, palët [...], Al.Pe.Ivest S.p.A, [...] dhe [...] kanë nënshkruar Marrëveshjen e Aksionarëve. Kjo marrëveshje rregullon të drejtat dhe detyrimet e palëve në cilësinë e tyre si ortakë zotërues të aksioneve të shumicës ose të pakicave në [...] dhe GSA S.p.A.

Pas përfundimit të transaksionit, [...] do të zotërojë 100% të aksioneve të GSA S.p.A. Eurizon Capital SGR S.p.A zotëron shumicën e aksioneve në [...], ndërsa aksionarët e tjerë [...] SGR S.p.A dhe Z. [...] në këmbim të pjesëmarrjes së tyre të pakicës në [...], do të ri-investojnë në [...] një pjesë të të ardhurave të targetit.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A. nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A., i parashikuar në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg

përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i shitjes së produkteve për parandalimin e zjarreve, tregu i menaxhimit të objekteve duke përfshirë mbikëqyrjen dhe reagimin ndaj emergjencave nga zjarret dhe tregu për trajnim profesional dhe edukim me fokus specifik në parandalimin e zjarreve. Duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A. nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A. përmes një shoqërie me qëllim të veçantë që do të themelohet për këtë qëllim [...] S.p.A., e cila do të blejë të gjithë kapitalin aksionar të Targetit.

Eurizon Capital SGR S.p.A kontrollohet nga Grupi Intesa Sanpaolo, i cili është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, ndërmarrje që vepron në tregun e shërbimeve bankare.

Shoqëria Target Gruppo Servizi Associati S.p.A. nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A. nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 835, Datë 23.09.2021

**“ PËR MBYLLJEN E HETIMIT TË PËRGJITHSHËM NË TREGUN E SHËRBIMEVE
SPITALORE DHE DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbylljen e Hetimit të Përgjithshëm në tregun e shërbimeve spitalore dhe dhënien e disa rekomandimeve.

Baza Ligjore: Nenet 2, 3, 4, 8, 9, 24, germa d), neni 41 pika 1, neni 69 dhe 70 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003),

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Grupit të Punës mbi Hetimin e Përgjithshëm në shërbimin spitalor,

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, realizoi procedurën e hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimeve spitalore.
2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, është administruar informacion nga: Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Spitalet Bashkiake, Spitalet jopublike si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.
3. Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 17 Tetor 2019, mori në trajtesë gjetjet e raportit të Sekretariatit dhe konkludoi se vlerësimi i këtij tregu kërkonte analiza shtesë. Për

këto arsye, me vendimin nr. 669, datë 24.12.2019, Komisioni vendosi vijimin e Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor hapur me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar dhe hetimi do të përfshinte periudhën janar 2016 deri në dhjetor 2019.

4. Ndikuar nga kufizimet e vendosura prej pandemisë së virusit SARS COV-2 si dhe situatës në tregun e shërbimeve spitalore, Grupi i Punës, në zbatim edhe të vendimit të Komisionit nr. 688 datë 06.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës”, shtyu afatin e vlerësimit dhe dorëzimit të raportit hetimor.

II. VLERËSIM LIGJOR

5. Sistemi i kujdesit shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik i cili është i organizuar në nivelet e shërbimit primar, sekondar dhe të shërbimeve terciare. Shteti siguron pjesën më të madhe të shërbimeve që i ofrohen popullatës në fushën e promocionit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit.
6. Në sektorin publik, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është hartuese dhe përgjegjëse për politikën dhe strategjitë e sistemit shëndetësor, rregullimin e tij si dhe koordinimin e të gjithë aktoreve brenda e jashtë sistemit.
7. Përballë këtij shërbimi qëndron shërbimi shëndetësor jopublik, i cili duhet të konkurrojë me shërbimin publik në terma të cilësisë dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve, ndërkohë që individin duhet të përballët me dilemën e kostos dhe cilësisë.
8. Sektori i shëndetësisë funksionon në zbatim të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim të rregullojë organizimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë në fushën e shërbimit spitalor. Nëpërmjet këtij akti ofruesit e shërbimit spitalor ndahen në spitale publik dhe jopublik, i përgjithshëm dhe i specializuar. Ndarja në spitale publike dhe jopublike bëhet në bazë të përkatësisë së pronës dhe të financimit, si dhe në bazë të qëllimit të ushtrimit të veprimtarisë.
9. Ministri i Shëndetësisë njeh, hap, klasifikon dhe licencon spitale publike dhe jopublike, në varësi të përmbushjes së kushteve, arritjes së standardeve, në bazë të teknologjisë spitalore dhe shkallës së plotësisë të kërkesave.
10. Personat juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shërbimit spitalor jopublik, përveç kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe në VKM nr. 910, datë 18.6.2008 “Për miratimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë” duhet të aplikojnë pranë Qendra Kombëtare të Biznesit, në bazë të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
11. Aktualisht në Shqipëri ushtrojnë këtë aktivitet 13 institucione spitalore jopublik, të cilat janë të vendosura kryesisht në Tiranë.

II.1 Barrierat e hyrjes dhe zgjerimit

12. Barrierat e hyrjes në tregun e shërbimeve spitalore përfshijnë të gjitha pengesat që kufizojnë hyrjen e lirë në treg të një konkurrenti potencial, të cilat janë:

- barriera ligjore, rregulla, licenca dhe kritere specifike
 - barrierat ekonomike të natyrës strukturore
 - barrierat strategjike, të cilat lidhen me politikat qeverisëse
13. Nga vlerësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi të cilën funksion tregu i shërbimeve spitalore rezulton se aktet ligjore dhe nënligjore nuk pengojnë licencimin, zgjerimin apo nuk sjell kufizime sasiore për hyrje në treg.
 14. Në lidhje me barrierat ekonomike, kostot financiare të investimeve fillestare apo edhe të investimeve të zgjerimit në shërbimin spitalor janë shumë të lartë, si për shkak të sigurimit të ambienteve ku do të ofrohet shërbimi, ashtu edhe për shkak të investimit në pajisje mjekësore dhe elektromjekësore. Barrierat e larta ekonomike në hyrje, krijojnë barriera edhe në daljen nga tregu (falimentin) ku kostot e humbjes janë shumë të larta. Spitalet kryesore jopublike në vend janë investime të shoqërive të huaja.
 15. Në lidhje me barrierat strategjike, qeveria me qëllim përballimin e shpenzimeve në rritje të kujdesit shëndetësor dhe kërkesën për shërbime cilësore, përballë kufizimeve buxhetore, ka aplikuar kontratatë të tipit Partneritet Publik Privat (PPP) për disa shërbime, të cilat përbejnë një të drejtë të veçantë dhe barrierë për hyrje dhe zgjerim në tregun e shërbimeve të prekura nga këto kontrata.
 16. Dhënia e të drejtave të veçanta dhe ekskluzive për ndërmarrje private të përcaktuara, në zona të caktuara, të dhëna nga organe publike, përbëjnë kufizime të konkurrencës në treg dhe në zbatim të nenit 69 të ligjit nr.9121/2003 titulluar: “Detyrimi për organet e administratës qendrore dhe vendore”, në rastet e dhënies së të drejtave të veçanta dhe ekskluzive, duhet të kërkohej vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës me qëllim vlerësimin e shkallës së kufizimit të konkurrencës.
 17. Ndërmarrjet private që gëzojnë këto të drejta të veçanta dhe ekskluzive kanë detyrimin për të respektuar parimet dhe rregullat e konkurrencës, duke u sjellë në treg në mënyrë që të respektohet konkurrenca e lirë dhe efektive sipas parashikimit të nenit 9 të Ligjit.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III.1. Tregu përkatës

18. Mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës, vlerësimi i konkurrencës në një treg të caktuar realizohet mbi metodën Struktura-Sjellje -Performancë.
19. Përcaktimi i strukturës së tregut realizohet mbi evidentimin e tregjeve përkatëse dhe në bazë të nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkojnë nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.
20. Strukturat e tregut ndikojnë sjelljen e konkurrentëve në treg si dhe qëndrimin e përfituesve të shërbimit sipas tregjeve përkatëse. Sjellja e konkurrentëve në treg vlerësohet në përputhje me

nenit 4 dhe 9 të ligjit, duke u vlerësuar në këndvështrimin e një marrëveshjeje të ndaluar apo e një abuzimi më pozitën dominuese. Ndërkohë, performanca në termat e eficensës përcakton nivelin e cilësisë së shërbimit, eficensen e përdorimit të burimeve dhe efikasitetin e shërbimeve. Në një treg ku shërbimi i ofruar është një e mirë publike, ruajtja e cilësisë së shërbimit është dhe duhet të jetë prioritet i ofruesit të shërbimit.

21. Referuar Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa i përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a. Tregun e produkteve.
 - b. Tregun gjeografik.
22. Treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës të produktit janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës.
23. Referuar raportit të OECD “Competition in hospital services”¹, përkufizimi i tregut të produktit për shërbimet spitalore është i vështirë si nga perspektiva e kërkesës ashtu dhe nga ajo e ofertës, veçanërisht për shkak të kompleksitetit dhe diversitetit të llojeve të trajtimeve dhe kontrolleve. Shërbimin jopublik është zëvendësues eficient i shërbimit shëndetësor publik në drejtim të cilësisë dhe efikasitetit, por me kosto të lartë si për pacientët ashtu edhe për pjesën e shërbimeve të mbuluar nëpërmjet skemave të rimbursimit.
24. Duke qenë se shëndeti është primar për çdo person, shërbimet spitalore dhe ato shëndetësore në përgjithësi kanë një ndikim shumë më të madh në cilësinë e jetës së individëve se sa çdo nevojë tjetër, prandaj kërkesa konsumatore ndiqet nga nevojat shëndetësore dhe në përgjithësi konsumatori nuk priret drejt çmimit por drejt shërbimit që i plotëson më mirë nevojat. Për këto arsye, konstatojmë se sektori publik dhe jopublik, në shërbimi spitalor, janë zëvendësues nga ana e kërkesës për sa i përket shërbimit të ofruar.
25. Nga të dhënat e administruara nga spitalet publike dhe jopublike, rezulton se spitalet kanë të njëjtin profil shërbimesh (ofrojnë specialitete të njëjta), të cilat konsiderohen të zëvendësueshëm nga ana e ofruesve të shërbimit publike apo jopublike, pasi nuk kanë kosto shtesë nga pikëpamja e kapacitetit mjekësor, të specializuar në trajtimin e sëmundjeve të caktuara, dhe aparaturave të përdorura.
26. Për këto arsye, treg përkatës në këndvështrimin e konkurrencës do të konsiderojmë tregun e shërbimet spitalore, duke përfshirë të gjitha shërbimet mjekësore të ofruara nga spitalet publike dhe jopublike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

¹ <https://www.oecd.org/daf/competition/50527122.pdf>, Policy Roundtable - Competition in Hospital Services/2012

27. Nga analizës së strukturave të tregut sipas treguesve krahasimorë, konstatohet se konkurrentët kryesor në tregun e shërbimeve spitalore janë spitalet terciare (universitare) në Tiranë, Spitali Amerikan dhe Spitali Internacional (Hygeia), të cilat nuk zotërojnë pjesë të konsiderueshme në treg.
28. Për vet specifikat që ka kërkesa konsumatorë për këto shërbime, ku pacienti për zgjedhjen e ofruesit të shërbimeve prirët drejt cilësisë së shërbimit, si dhe referuar indikatorëve të mësipërm, spitalet jopublike janë konkurrentë të afërt të shërbimit publik

III.2 Analiza e sjelljes

29. Referuar nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese apo një grup ndërmarrjesh të cilat merren vesh për vendosje çmimesh, ndarje tregjesh, kufizim apo kontroll mbi tregjet, burimin e furnizimit apo prodhimin, sillen në mënyre antikonkurruese. Mbi këto principe u analizuar sjellja e ofruesve të shërbimit spitalor në sektorin publik dhe jopublik.
30. Vlerësimi i sjelljes së ofruesve të shërbimeve në treg u realizua mbi analizën e çmimeve (tarifave) të aplikuara nga spitalet publike dhe jopublike.
31. Në spitalet publike, çmimi i shërbimeve është i miratuar me Urdhrin nr. 28 datë 26.01.2016 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Urdhri përcakton mënyrën e funksionimit të sistemit të referimit, i cili konsiston në diagnostikimin e pacientit fillimisht nga mjeku i familjes, nga mjeku specialist për vizitë më të thelluar dhe nga shërbimi spitalor kur është e nevojshme.
32. Në spitalet jopublike shërbimi shëndetësor ofrohet kundrejt tarifave të përcaktuara nga organet e tyre drejtuese. Nga krahasimi i tarifave (çmimeve) të aplikuara nga spitalet jopublike për disa nga shërbimet më të shpeshta, nuk ngrihet dyshimi se mes spitaleve jopublike të këtë ndonjë marrëveshje për fiksion çmimi në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.
33. Në zbatim të ligjit nr.10383 datë 24.2.2018 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 308 datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar², Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FONDI) financon shpenzimet për disa paketa, të ofruara në shërbimin spitalor, të cilat janë:
- Paketa e shërbimit të dializës,
 - Paketa e shërbimeve të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë,
 - Paketa e shërbimeve të transplantit të veshkave (me dhurues të gjallë),
 - Paketa e shërbimit të implantit koklear,
 - Paketa e trajtimit të kataraktës,

² Me VKM nr. 815, datë 29.12.2017 “Për disa shtesa në VKM 308 datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, miratohet mbulimi i shpenzimeve edhe për dy paketa të reja: Paketën e trajtimit të kataraktës, dhe Paketa e shërbimit të radioterapisë (me akselerator linear) dhe me VKM nr. 373, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, shtohet Paketa e trajtimit paliativ; Paketa e trajtimit adjuvant/neoadjuvant; Paketa e trajtimit radikal; Paketa e trajtimit me IMRT.

- Paketa e shërbimit të radioterapisë.

34. Financimi i paketave dhe mbulimi i shërbimit shëndetësor nga të gjitha institucionet shëndetësore (publik dhe jopublik) i bën të konkurrueshëm ofruesit e shërbimit. Në zbatim të pikës 2 të VKM të sipërcituar, Këshilli Administrativ i Fondit (KAF) ka miratuar Vendimin nr. 88 datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrisë Kombëtare të Paketave të Financuara nga Fondi”, i ndryshuar, ku në pikën 11 të tij citohet: *“Në rast se në ditën e përcaktuar si më sipër nuk ka vende të lira në institucionet e shëndetit publik, atëherë nëpunësi i autorizuar i Fondit bën regjistrimin e pacientit në mënyrë të barabartë në institucionet shëndetësore jopublik të kontraktuar nga Fondi”*, dhe në pikën 12 citohet: *“Për rastet jashtë kapaciteteve mjekësore dhe teknike dhe për rastet e reja, regjistrimi në institucionet shëndetësore jopublike bëhet në mënyrë të barabartë, sipas një rendi alfabetik, duke marrë në konsideratë veçoritë e shërbimit”*³.
35. Në referencë të pikës 11 të VKA së sipërcituar, institucionet publike kanë përparësinë e ofrimit të shërbimit.
36. Mbështetur mbi informacion e depozituar nga FONDI, për numrin e rasteve të trajtuara nga spitalet publike dhe jopublike dhe të financuara prej tij sipas VKM së mësipërme, u konstatua se:
- shërbimi i dializës, ofrohet nga spitalet publike dhe jopublike nëpërmjet paketave të rimbursuar nga Fondi dhe nga shoqëria Dia Vita SHPK si mbajtëse e kontratës së koncesionit, e cila duhet të mbulojë me shërbimin dializës të sëmuret në disa rrethe.
 - Ofruesi me i madh i këtyre shërbimeve është spitali Amerikan dhe Internacional të cilët mbulojnë rreth XX% të nevojave për shërbimin e dializës dhe DIA VITA me XX% të tregut, si zbatuese e kontratës së koncesionit të dializës.
 - Tregu i shërbimit të dializës ka një përqendrim të lartë duke i dhënë karakteristikat e një tregu oligopolistik. Treguesit e përqendrimit HHI paraqitet me ulje gjatë vitit 2017; 2018 dhe 2019, por pjesa e tregut e tre konkurrentëve më të mëdhenj në treg është duke u rritur. Nga struktura e tregut, konstatohet se shërbimi i dializës po zhvendoset drejt spitaleve jopublike dhe shoqërisë koncesionare ndërkohë që në spitalet publike ofrohet vetëm pranë QSUT-së e cila mbulon XX% të kërkesës për shërbim.
37. Në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003 është vlerësuar pozita dominuese në tregun e shërbimit të dializës nga ku konstatohet se:
- Spitalet privatë zotërojnë pjesën më të madhe të tregut (XX%) në shërbimin e dializës;
 - Për dhënien e shërbimit të dializës, ka pengesa në hyrje për shkak të nevojave për investime fillestare, sigurim të stafit mjekësor dhe ndihmësmjek dhe ambienteve akomunuese për dhënien e shërbimit. Pjesa e madhe e tregut që zotërojnë spitali Internacional dhe Amerikan shërben si tregues për ekzistencën e barrierave për hyrje dhe zgjerim në këtë treg.
 - Mungesa e hyrësve të rinj në këtë shërbim, tregon që konkurrenca potenciale është e ulët, e ndikuar kjo nga investimet e rëndësishme të kryera për këtë shërbim, me të cilat hyrësit e

³ VKAF nr. 43 datë 21.03.2017 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 88 datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrisë Kombëtare të Paketave të Financuara nga Fondi”, ndryshon pika 12.

- rinj dhe konkurrentët duhet të përshtaten. Pacientët kanë marrëdhënie afatgjatë me ofruesin e shërbimeve, me efekte përjashtuese me konkurrentët e tjerë.
- Fuqia kundërvepruese e marrësve të shërbimit është e ulët, për shkak të karakteristikave të kërkesës për shërbim. Kërkesa nga pacienti për marrjen e këtij shërbimit përcaktohet nga mjeku.
38. Për sa më sipër, konstatohet se Spitali Amerikan dhe Spitali Internacional zotërojnë pozitë dominuese në tregun e shërbimit të dializës.
39. Sipas legjislacionit në fuqi, për shërbimin e dializës aktualisht aplikohet çmimi 11.203 lekë/pa TVSh për çdo seancë të ofruar nga koncesionari dhe çmimi 12,106 lekë/pa TVSh për çdo seancë të ofruar nga spitalet publike dhe jopublike. Nëpërmjet akteve nënligjore, aplikohen dy tarifa (koncesionari dhe shërbimi spitalor) për të njëjtin shërbim (shërbimit të dializës).
40. Mbështetur në testin e “Konkurrentit Eficent”, si dhe referuar pasqyrave financiare të shoqërisë koncesionare DIA VITA SHPK për vitet 2018-2019, rezulton se shoqëria paraqitet me rezultat financiar pozitiv, ku norma e fitimit është rreth XX%. Duke qenë se kjo shoqëria ofron vetëm shërbimin e dializës, të ardhurat e realizuar sipas tarifave të miratuara, mbulojnë kostot e shërbimit dhe çmimi 11,204 është një “çmim i drejtë”, i cili siguron efikasitet të shërbimit.
41. Për paketat e tjera të shërbimi konstatohet se:
- Shërbimet në paketat e zemrës mbulohen kryesisht nga QSUT dhe Senatoriumi dhe nga analiza e numrit të rasteve të trajtuara konstatohet rritje të numrit të rasteve si në shërbimin e kardiologjisë ashtu edhe në atë të kardiokirurgjisë, gjatë periudhës hetimore.
 - Paketa e transplantit të veshkave kryer pranë Spitalit Amerikan. Në spitalet publike nuk është realizuar asnjë procedurë e paketës së transplantit të veshkës.
 - Gjate vitit 2016-2019 nuk është realizuar asnjë ndërhyrje në shërbimin e implantit koklear.
 - Nga të dhënat e administruara nga Fondi, janë kryer ekzaminime në Paketën e trajtimit të kataraktës vetëm nga QSUT gjatë vitit 2019
 - Paketa e shërbimit të radioterapisë (me akselerator linear) është realizuar vetëm në QSUT.
42. Me VKM nr. 373 datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr. 308, datë 21.5.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor” është miratuar rritje e çmimit të paketave të mësipërme.
43. Në përfundim të vlerësimit të strukturave të tregut për paketat që mbulohen nga Fondi konstatohet se:
- Nuk ka ndarje të barabartë të shërbimeve mes spitaleve jopublike sipas parashikimit të VKA nr. 88 datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrat Kombëtar të Paketave të Financuara nga Fondi”, i ndryshuar.
 - Spitali Amerikan dhe Internacional ka përfituar fondet më të mëdha të financuara nga shteti për paketat e parashikuara në VKM nr. 308/2014 me rreth XX% për periudhën hetimore (2016-2019).

- i. Për shërbimet e dializës, i cili zë XX% të fondeve të financuara nga FONDI dhe transplantit të veshkave i cili zë XX% të fondeve të financuara nga FONDI, ofruesi me i madh është spitali Amerikan.
 - ii. Për shërbimin e dializës, aplikohen dy tarifa, përkatësisht me 11.203 lekë/pa TVSh për çdo seancë të ofruar nga koncesionari dhe 12,106 lekë/pa TVSh për çdo seancë të ofruar nga spitalet publike dhe jopublike.
- Në paketën e kardiologjisë, kardiokirurgjisë dhe paketa e shërbimit të radioterapisë, ofruesi kryesor është QSUT.
44. Nga vlerësimi i nivelit të shpenzimeve dhe investimeve, konstatohet rritje e cilësisë së shërbimit në spitalet publike, ndikuar nga investimet e kryera në infrastrukturën akomoduese dhe pajisje mjekësorë, si dhe përmirësim të treguesve të shfrytëzimit të shtratis (XX%-2016 ; XX%-2019) në spital dhe kohës së qëndrimit të pacientit në spital (XX ditë – 2015 ; në XX ditë -2019).
45. Mbështetur në pasqyrat financiare të spitaleve jopublike për periudhën objekt hetimi, është konstatuar mungesë e efikasitetit të shfrytëzimit të investimit, faktor i cili ka ndikuar në performancën financiare të ofruesve jopublik. Me përjashtim të spitalit të Zemrës, të gjithë spitalet e tjerë rezultojnë me humbje për gjithë periudhën hetimore. Mungesa e fitimit nga aktiviteti ekonomik, shoqërohet me ulje të kapitalit të shoqërisë, me pasiguri për vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik, mungesë të aftësisë investuese dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me pamundësinë për të ulur çmimin e shërbimeve që ofrohet nga këto spitale.
46. Nga analizat e mësipërme konstatohet se në tregun e shërbimeve spitalore, shërbimi i dializës ofrohet nëpërmjet një kontrate koncesionare, një e drejtë e veçanta /ekskluzive. Në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003 titulluar :“Detyrimi për organet e administratës qendrore dhe vendore”, çdo projekt akt normativ duhet të vlerësohet paraprakisht nga Autoriteti. Dhënia e të drejtave të veçanta kërkon vlerësimi ex-ante të Autoritetit të Konkurrencës.
47. Ndërmarrjet private që gëzojnë këto të drejta të veçanta dhe ekskluzive kanë detyrimin për të respektuar parimet dhe rregullat e konkurrencës, duke u sjellë në treg në mënyrë që të respektohen parashikimet e nenit 9 të Ligjit në lidhje me:
- vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
48. Shërbimi spitalor jopublik konkurron shërbimin spitalor publik në terma të cilësisë së shërbimit, por për shkak të kostove të larta (tarifave të shërbimit), shërbimi spitalor jopublik është joeficient dhe pak i aksesueshëm nga popullata, individit janë të prirur drejt shërbimit publik, për shkak të shpenzimeve që mbulohen nga shteti.
49. Aplikimi i paketave të shërbimeve, të cilat mbulohen nga FDSKSH, siguron mundësinë e marrjes së shërbimit nga pacientët, por zgjedhja e ofruesit të shërbimit (publik apo jopublik) nuk i lihet pacientit, por përcaktohet sipas parashikimeve të VKM nr. 308 datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor”, i ndryshuar.

50. Zgjerimi i numrit të paketave të shërbimeve që mbulohen nga Fondi do të rriste shkallën e zëvendësueshmërisë së shërbimeve nga spitalet publike dhe jopublik duke i bërë më konkurruese në shërbimin spitalor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d), nenit 69, nenit 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimeve spitalore.
2. T’i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që në mënyre të veçantë ka të bëjë me:
 - a. Kufizime sasiore për hyrje në treg dhe tregtim;
 - b. Vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejta të veçanta, në zona të caktuara për ndërmarrje ose produkte të caktuara;
 - c. Imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.
3. T’i rekomandojë Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, që të sigurojë shpërndarja në mënyrë të drejtë të paketave të shërbimeve, të parashikuara në VKM nr. 308 datë 21.05.2014, duke i vendosur të gjithë ofruesit (spitalet jopublik) në treg në kushte të favorshme konkurruese.
4. Monitorim e tregut të shërbimeve spitalore, kryesisht për paketat e shërbimeve të financuara nga Fondi, për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 836, Datë 23.09.2021

“Për dhënien e disa rekomandimeve Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ndërmarrjes Koncesionare “Mbi zbatimin e kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënia e rekomandimeve për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ndërmarrjen Koncesionare “Mbi zbatimin e kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”.

Bazë ligjore: Neni 24, gërma d) e f), neni 26, neni 69 dhe neni 70, pika 2, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi vlerësimin e kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (këtu e në vijim MIE) me nr. 6382 prot., datë 27.08.2021, me lëndë “Mbi bashkëpunimin në lidhje me zbatimin e kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës (këtu e në vijim AK) me nr. 386 prot., datë 30.08.2021. Referuar kontratës së depozituar pranë AK-së nëpërmjet kësaj shkrese, si dhe informacionit të publikuar në web-in zyrtar të MIE, rezulton si më posht vijon:
2. Bazuar në Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016–2020, miratuar me VKM nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e strategjisë sektoriale të

transportit dhe planit të veprimit 2016-2020”, një nga sfidat kryesore në sektorin ajror për periudhën e planifikimit 2016-2020 është: *“Krijimi i kushteve të përshtatshme për një treg më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara që do të sjellin mundësinë e një reduktimi në shpenzimet e udhëtimit për pasagjerët”*. Gjithashtu, një nga objektivat strategjike për transportin ajror është që: *“Shqipëria duhet të bëhet konkurruese në tregun e transportit ajror për të siguruar lidhje të drejtpërdrejtë me aeroportet kryesore evropiane në mënyrë që të rrisë fluksin e pasagjerëve për në dhe nga Shqipëria”*.

3. Për sa më sipër, në vijim të zbatimit të objektivave strategjik, me vënien në punë të Aeroportit të Vlorës, pritet që ky aeroport të ketë një ndikim të konsiderueshëm ekonomik, social dhe kulturor, në zhvillimin e kësaj zone, duke bërë të mundur hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin e turizmit, ofrimin e shërbimeve ajrore për transportuesit me kosto të ulët, çka do të sjelli dhe uljen e tarifave të biletave për udhëtime ndërkombëtare për qytetarët, duke e bërë tregun më konkurrues.
4. Në bazë të kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, Koncesionarit i jepet e drejta ekskluzive dhe detyrimi për projektimin, financimin, ndërtimin, kolaudimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e VIA-s, dhe të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë; e drejta e përcaktimit dhe arkëtimit të tarifave dhe të ardhurave të tjera të lejuara nga Kontrata; e drejta ekskluzive mbi projektin, si dhe e drejta reale mbi vendndodhjen dhe pasuritë e paluajtshme të Aeroportit.
5. Bazuar në nenin 2, pika 1 germa c, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), ky ligj zbatohet *“për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta”*. Duke qenë se një koncesion është mbartës i një të drejte speciale dhe/ose ekskluzive për ushtrimin e veprimtarisë, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 ato janë objekt vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.
6. Në vijim të procedurave të ndjekura nga MIE, vlerësojmë se MIE ka zhvilluar një procedurë konkurruese (*tender i hapur ndërkombëtar*), në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse. Në përfundim të këtyre procedurave, oferta fituese e këtij projekti është shpallur bashkimi i operatorëve ekonomikë/ofertuesit: Mabco Constructions SA, Yda Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi dhe 2A Group SHPK., me të cilët MIE ka nënshkruar kontratën e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”, me një kohëzgjatje 35 vjeçare, miratuar me VKM nr. 325, datë 02.06.2021. Një nga kushteve paraprake të kësaj kontrate është themelimi i shoqërisë koncesionare nga ana e Ofertuesve.
7. Lidhur me tregun ku do të operojë ky koncesion, tregu i ofrimit të shërbimeve aeroportuale, do të ketë më shumë se një operator duke e bërë këtë treg më

konkurrues, duke ofruar më shumë mundësi zgjedhjeje për pasagjerët dhe përdoruesit e tjerë të shërbimeve aeroportuale.

8. Koncesionari në bazë të kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës *gëzon të drejtën ekskluzive për projektimin, financimin, ndërtimin, kolaudimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e VIA-s, si dhe të drejtën e përcaktimit dhe arkëtimit të tarifave dhe të ardhurave të tjera të lejuara nga Kontrata*. Në këto kushte ky koncesionar do të ketë një ekskluzivitet në ofrimin e shërbimeve aeroportuale në VIA kundrejt përdoruesve të këtij aeroporti. Për këtë arsye janë analizuar kushtet më të rëndësishme të kontratës të vendosura ndërmjet shtetit dhe koncesionarit, si të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, tarifat, ofrimi i shërbimeve etj.
9. Sjellja e koncesionarit do të ndikohet nga të drejtat dhe detyrimet që ai merr përsipër në bazë të kësaj kontrate, ku një rol vendimtar ka detyrimi i Koncesionarit *për të ofruar qasje në shërbimet aeroportuale dhe tregtare në kushte të njëjta për të gjithë pasagjerët, avionët dhe përdoruesit e aeroportit nga të gjithë shtetet*, përveç nëse kërkohet ndryshe nga kjo Kontratë. Ky detyrim është në respektim të ligjit nr. 9121/2003, duke patur si qëllim të parandalojë një sjellje të mundshme antikonkuruese të Koncesionarit në rast ofrimi të shërbimeve ndaj përdoruesve të aeroportit.
10. Në bazë të së drejtës ekskluzive që ka Koncesionari merr përsipër të garantojë të paktën 1 (një) agent *ground handling* (Shërbime në tokë), i cili do të jetë i kualifikuar për të ofruar këto shërbime për të gjitha fluturimet që nisen ose mbërrijnë në VIA dhe do të mundet ta ofrojë shërbimin e ground handling të VIA-s. Megjithatë Koncesionari do të lejojë kompanitë ajrore që operojnë me avionët e tyre në VIA, të vetë-menaxhojnë avionët e tyre, me kusht që ky shërbim të kryhet nga stafi dhe me pajisjet e kompanisë ajrore. Njohja e kësaj të drejtë vetë kompanive ajrore, duke mos qenë të detyruar që të paguajnë VIA-n për kryerjen e shërbimeve në tokë, do të ulë kostot e operimit të këtyre kompanive duke ndikuar njëkohësisht në uljen e kostove të biletave.
11. Koncesionari do të mundësojë një ose më shumë pika për furnizimin e karburantit dhe shërbimet e karburantit në VIA, si dhe do të sigurojë ofrimin e shërbimeve të duhura të ruajtjes dhe shpërndarjes së karburantit në çdo kohë gjatë afatit të kësaj kontrate. *Koncesionari mund të sigurojë këto shërbime drejtpërdrejt ose përmes ofruesve të shërbimeve nga palë të treta*.
12. Ofrimi i shërbimit të furnizimit me karburant për avionë në aeroporte është një shërbim shumë i ndjeshëm për kompanitë ajrore, pasi një nga faktorët kryesorë që ndikon në çmimin e biletave është çmimi i karburantit. Për këtë qëllim Koncesionari duhet të nën-kontraktojë këto shërbime, bazuar në kritere dhe kushte të barabarta dhe jo diskriminuese, me qëllim mirëfunksionimin e tregut dhe bërjen e tij sa më konkurrues.

13. Në kuadër të ofrimit të shërbimeve aeroportuale dhe/ose tregtare, Koncesionari mund të hyjë në marrëdhënie kontraktore me Shoqëri të Lidhura me Ofertuesit ose me persona të tjerë, *me kusht që këto palë të përmbushin plotësisht kriteret përkatëse të kualifikimit, financiare dhe të eksperiencës që plotësojnë Ofertuesit përkatës për ofrimin e shërbimeve aeroportuale, fitues të koncesionit*. Pavarësisht nënkontraktimit të këtyre shërbimeve, detyrimet dhe përgjegjësia e Koncesionarit për ofrimin e shërbimeve aeroportuale dhe tregtare nuk do të kufizohet, shuhet ose lehtësohet si rrjedhojë e nënshkrimit të këtyre kontratave. *Këto kontrata do të nënshkruhen në bazë të parimeve të vlerës së tregut të konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit të kontraktuesve në situata të njëjta ose të ngjashme, transparencës dhe respektimit të legjislacionit të zbatueshëm*.
14. Sa më sipër Koncesionari duhet të sigurojë dhënien e mundësisë të ofrimit të shërbimeve aeroportuale dhe tregtare, kompanive të ndryshme, duke shmangur në çdo rast sjelljet e mundshme abuzive me pasoja të rënda për tregun.
15. Koncesionari duhet të depozitojë pranë MIE kontratat/marrëveshjet që do të lidh me palë të treta për ofrimin e shërbimeve aeroportuale dhe tregtare. Nëse MIE vlerëson se këto kontrata/marrëveshje përmbajnë kufizime në shkelje të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, MIE duhet ti njoftojë ato pranë Autoritetit të Konkurrencës.
16. Në bazë të Kontratës, Koncesionari do të përcaktojë Tarifatat për Shërbimet Aeroportuale dhe Tarifatat për Shërbimet Tregtare në mënyrë jodiskriminuese dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe praktikën e mirë të industrisë. Tarifatat për Shërbimet Aeroportuale do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, veçanërisht nenin 29 të Kodit Ajror dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe me detyrimet ndërkombëtare. Përpara vendosjes së këtyre tarifave Koncesionari duhet të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues (MIE). Tarifatat për Shërbimet Tregtare do të jenë të bazuara në vlerat e tregut dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe praktikën e mirë të industrisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d) e f), nenin 26, nenin 69, pika 1, dhe nenin 70, pika 2, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që nëse vlerëson se kontratat/marrëveshjet e lidhura nga Koncesionari përmbajnë kufizime në shkelje të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, t’i njoftojë ato pranë Autoritetit të Konkurrencës.

2. Detyrimin e ndërmarrjes Koncesionare që do të operojë Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës, që në respektim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, në veçanti të sillet:
 - a) *duke mos vendosur, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmime të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushte të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *duke mos zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke mos i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - c) *duke mos vendosur kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 837, Datë 29.09.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel CO SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel CO SHPK”.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26, neni 43, pika 5, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK, Albdesign PSP SHPK, Kristalina.KH SHPK, Euroform SHPK, Interlogistic SHPK, Marketing & Distribution SHPK, Inpress SHPK dhe Adel CO SHPK; dhe,

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar;

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 708, datë 23.09.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”, vendosi: hapjen e procedurës së hetimit Paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Referuar konkluzioneve të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr.762, datë 22.01.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.), vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, për periudhën kohore nga 1 Janari 2017 deri në 31 Dhjetor 2019.
3. Në zbatim të Vendimit nr. 762, datë 22.01.2021 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr 235/13 prot., datë 26.01.2021, "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.). Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga Autoritetet Kontraktore: AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD; Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
6. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, *tregu përkatës produkti është tregu i prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve, si printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj., të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.*
7. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi *tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet Tregu i prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD në zonën urbane më të populluar të RSH, Tiranë dhe Durrës, me shtrirje të produktit të shërbyer në tërë territorin e RSH.*

II.2 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

8. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga autoritetet kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, është analizuar dhe vlerësuar dokumentacioni dhe të dhënat e administruara nga Autoritetet Kontraktore: AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE, UKD, si dhe APP dhe KPP, meqenëse gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet nën hetim, nuk u gjet asnjë evidencë direkte që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik midis tyre.
9. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike (OECD - GUIDELINES FOR FIGHTING BID RIGGING IN PUBLIC PROCUREMENT), e cila është përshtatur në shqip nëpërmjet Udhëzuesit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, të Autoritetit të Konkurrencës. Bazuar në këtë metodologji është vlerësuar sjellja e ndërmarrjeve (Operatorëve Ekonomik) nëse janë përfshirë në ndonjërin prej skemave të marrëveshjeve në oferta.
10. Nga përpunimi dhe vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë hetimit të thelluar rezultoi se:
11. Hyrja në këtë treg kushtëzohet nga kërkesat dhe specifikimet teknike të vendosura sipas rastit nga autoritetet kontraktore në zbatim të legjislacionit të prokurimeve.

Autoritetet dhe entet kontraktore kanë detyrimin për të mos shmangur fushën e zbatimit të ligjit për prokurimin publik dhe për të mos ngushtuar/kufizuar në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar (neni 3, pika 2, e LPP nr. 162/2020).

12. Referuar nenit 77, pika 1, të LPP-së, autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; gjendjen ekonomike dhe financiare; aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
13. Për sa më sipër, nën këndvështrimin e ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, tregu i prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve është i hapur për operatorët që plotësojnë kërkesat për kualifikim, të cilat duhet të jenë të tilla që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
14. Në përfundim të inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte të cilat mund të provojnë ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim në procedurat e prokurimit publik sipas përcaktimit të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
15. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, më datë 27.06.2017, me objekt: “Për prodhimin e emisioneve të pullës postare, viti 2017”, me fond limit 15.974.500 lekë pa TVSH, ku kanë marrë pjesë: Adel Co SHPK me një vlerë oferte prej 69% të fondit limit; Albdesign PSP SHPK, me 72% të fondit limit; Ilar SHPK me 86% të fondit limit dhe Kristalina KH SHPK me 87% të fondit limit, vihet re se: nuk u konstatuan shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave; nga analiza e ofertave ekonomike të ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës; nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje, gjatë procedurës së hetimit të thelluar, nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis tyre sipas përcaktimit të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
16. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, më datë 24.07.2017, me objekt: “Blerje Shtypshkrime për vitin 2017”, me fond limit 50.593.702 Lekë pa TVSH, ku kanë marrë pjesë: Adel Co SHPK me 98% të fondit limit; Albdesign PSP SHPK me 96% të fondit limit dhe Kristalina KH SHPK me 88% të fondit limit, referuar sjelljes së këtyre operatorëve gjatë procedurës së prokurimit, rezulton se: nuk u konstatuan shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave; nga analiza e ofertave ekonomike të ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e

zërave të ofertës; nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje, gjatë procedurës së hetimit të thelluar, nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis tyre; Euroform SHPK ka shprehur interes për procedurën e prokurimit pasi është ankuar pranë Postës Shqiptare mbi kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë, duke lejuar ofertuesin Kristalina KH SHPK të ofertojë me makineri/pajisje shtypshkrimi të marra me qira nga vetë Euroform SHPK, duke hedhur dyshime për një përmbajtje të ofertës nga ana e këtyre ndërmarrjeve. Por kjo sjellje para ofertimit është e pamjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshjeje në oferta midis tyre, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, përderisa nuk rezultojnë evidenca të tjera bashkëpunimi midis tyre.

17. Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, më datë 04.09.2018, me objekt: “Blerje Shtypshkrimesh”, me fond limit 44.607.547 lekë pa TVSH, rezulton se: ndërmarrja Inpress SHPK ka shprehur interes në procedurën e prokurimit pasi është ankuar pranë Autoritetit Kontraktor mbi kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë duke lejuar ofertuesin M&D SHPK të ofertojë me makineri/pajisje shtypshkrimi të marra me qira nga vetë Inpress SHPK, sjellje e cila hedh dyshime për një përmbajtje të ofertës nga ana e këtyre ndërmarrjeve. Gjithashtu vihet re se ofertat e paraqitura nga ndërmarrjet: M&D SHPK (me 93% të FL), Albdesign PSP SHPK (me 92% të FL) dhe Kristalina KH SHPK (me 95% të FL) ndryshojnë shumë pak nga njëra-tjetra, duke hedhur dyshime se këto ndërmarrje mbështesin njëra-tjetrën duke përdorur skemën e ofertës së mbuluar me qëllim krijimin e përshtypjes së një oferte të pastër dhe një konkurrence të singertë. Për të provuar ekzistencën ose jo të këtyre skemave të marrëveshjeje të dyshuara në oferta, është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta. Për këtë arsye është shqyrtuar dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrjet: M&D SHPK; Adel CO SHPK; Albdesign PSP SHPK dhe Kristalina KH SHPK pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nga ku nuk u konstatuan shenja të njëjta në përgatitjen e ofertave. Nga analiza e ofertave ekonomike të këtyre ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës. Gjithashtu, gjatë procedurës së hetimit të thelluar janë kryer inspektimeve në këto ndërmarrje, nga ku nuk u gjetën evidenca direkte të bashkëpunimit midis tyre. Bazuar në këto konkluzione, sjellja e operatorëve ekonomik ofertues në procedurën e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, në mungesë të evidencave të tjera direkte dhe indirekte lidhur me sjelljen e tyre gjatë pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit, si dhe pas realizimit të tyre, i bënë të pamjaftueshme këto gjetje për të vërtetuar ekzistencën e skemave të marrëveshjeje në oferta midis tyre, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
18. Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, më datë 14.05.2018, me objekt: “Prodhim i emisioneve të pullës postare, viti 2018”, me fond limit 10.000.000 lekë pa TVSH, ku kanë marrë pjesë: Adel Co SHPK me 95% të fondit limit; Kristalina KH SHPK me 79% të fondit limit dhe Albdesign PSP SHPK me 75% të fondit limit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga këto ndërmarrje nuk u konstatuan shenja

të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave si dhe nga analiza e ofertave ekonomike të ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës. Gjithashtu, gjatë procedurës së hetimit të thelluar janë kryer inspektimeve në këto ndërmarrje, nga ku nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis tyre sipas përcaktimit të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

19. Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, më datë 31.07.2019, me objekt: "Prodhimi i Emisioneve të Pullës për vitin 2019", me fond limit: 8,319,625 lekë pa TVSH, pjesëmarrës janë Kristalina KH SHPK , Albdesign PSP SHPK dhe Adel CO SHPK, fituese është shpallur oferta më e ulët e paraqitur nga Kristalina KH SHPK me vlerë oferte 83% të fondit limit, shoqëruar nga dy oferta me vlera të njëjta prej 96% të FL. Kjo sjellje tregon se midis tyre nuk ka një marrëveshje sepse ofertat e njëjta nuk mundësojnë paracaktimin e fituesit, pasi fituesi në këto raste përzgjidhet me short. Gjithashtu duke vlerësuar në tërësi gjithë ecurinë e procedurës, ku fillimisht është kualifikuar vetëm Adel CO SHPK me 96% të FL, në qoftë se do të kishte një marrëveshje midis të tre ofertuesve nuk do të kishte pasur ankesa, të cilat sollën si rezultat fitimin e tenderit me një ofertë shumë më të ulët prej 83% të FL. Gjithashtu për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në plotësimin e ofertave është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk u konstatuan shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, si dhe nga analiza e ofertave ekonomike të ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës.
20. Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare SHA, më datë 10.12.2019, me objekt: “Blerje Shtypshkrimesh”, me fond limit 76.008.765,68 lekë pa TVSH, lindin dyshime për një bashkëpunim në oferta midis ndërmarrjeve Interlogistic SHPK, Inpress SHPK dhe M&D SHPK që në fazën e përlllogaritjes së fondit limit duke paraqitur oferta me çmime zërash të njëjta me qëllim rritjen e FL, dhe duke vazhduar në fazën e zhvillimit të procedurës së prokurimit nëpërmjet paraqitjes së një oferte të përbashkët si bashkim operatorësh ekonomik nga ofertuesit Interlogistic SHPK dhe Inpress SHPK, ndërkohë që OE Marketing&Distribution SHPK nuk ka paraqitur ofertë, duke hedhur dyshime për një ofertë të përmbajtur nga ana e këtij operatori me qëllim fitimin e tenderit nga BOE Interlogistic SHPK&Inpress SHPK, oferta e të cilëve është oferta fituese e kësaj procedure. Për të provuar ekzistencën ose jo të këtyre skemave të marrëveshjeje të dyshuara në oferta, është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë tender nuk u konstatuan shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave dhe nga analiza e ofertave ekonomike të ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës. Gjithashtu nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje, gjatë procedurës së hetimit të thelluar, nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar

midis tyre sipas përcaktimit të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Për pasojë, dyshimet e lindura për një bashkëpunim të mundshëm në oferta midis ndërmarrjeve Interlogistic SHPK, Inpress SHPK dhe M&D SHPK janë të pamjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshjeje në oferta midis tyre, përderisa nuk rezultojnë evidenca të tjera bashkëpunimi midis tyre.

21. Në tenderin e zhvilluar nga UKD, më datë 29.05.2017, me objekt: “Printim zarfim i faturave të përmuajshme të UKD SHA”, me fond limit: 5.150.000 lekë pa TVSH, nuk rezultojnë shenja të ngjashme në përgatitjen e ofertës si dhe modele të njëjta çmimi, duke mos pasur elementë të skemave të marrëveshjeve në oferta midis ndërmarrjeve ofertuese ne tender: Adel CO SHPK, Inform Albania SHPK (ADPSS) dhe Ilar SHPK.
22. Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA më datë 02.08.2018, me objekt: Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”, me fond limit: 5,500,000 lekë pa TVSH nuk vihen re skema të marrëveshjeve në oferta midis ndërmarrjeve ofertuese ne tender: Adel CO SHPK me 97% të FL dhe ADPSS SHPK (Inform Albania) me 69% të FL. Kjo pasi një marrëveshje në oferta synon fitim e tenderit duke paracaktuar si fitues ofertën më të ulët dhe njëkohësisht sa me afër FL të jetë e mundur, në veçanti në rastet kur ofertojnë vetëm ndërmarrjet e grupit (Ofertat në këto raste janë mbi 99% të FL). Në rastin konkret janë paraqitur vetëm dy oferta, ku oferta më e ulët e paraqitur nga ADPSS SHPK (Inform Albania) ka rezultuar anomalisht e ulët, gjë e cila tregon se nuk jemi para një rasti marrëveshjeje të ndaluar në oferta midis këtyre ndërmarrjeve.
23. Në tenderi e zhvilluar nga UKD, më datë 24.02.2020, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”, me fond limit: 6,330,816 rezulton se: M&D SHPK ka shprehur interes në procedurën e prokurimit pasi është ankuar pranë Autoritetit Kontraktor mbi kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë, ndërkohë që hyn si ofertues Inpress SHPK duke paraqitur për qëllime kualifikimi fatura tatimore shitje të Inpress SHPK me blerës ndërmarrjen Marketing&Distribution SHPK dhe Interlogistic SHPK për materiale shtypshkrimesh, gjë e cila tregon një marrëdhënie të vazhdueshme midis tyre. Kjo sjellje tregon për një marrëdhënie tregtare të vazhdueshme midis këtyre ndërmarrjeve, gjë e cila në vetvete nuk përbën një sjellje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, por ajo mund të shërbejë si një evidencë, e cila së bashku me evidencat e tjera, mund të vërtetojnë ose jo ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në oferta. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në plotësimin e ofertave është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk rezultojnë shenja të ngjashme në përgatitjen e ofertës si dhe modele të njëjta çmimi. Bazuar në këto gjetje vlerësojmë se sjellja e mësipërme e ndërmarrjeve Marketing&Distribution SHPK, Interlogistic SHPK dhe Inpress SHPK është e pamjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshjeje në oferta midis tyre, përderisa nuk rezultojnë evidenca të tjera bashkëpunimi midis tyre, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

24. Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga OSHEE, më datë 17.02.2017, me objekt: “Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer për nevoja të OSHEE SHA”, me fond limit 57.704.400 Lekë pa TVSH, midis ndërmarrjeve ofertuese në tender: Adel CO SHPK me 91% të FL, OE ADPSS SHPK me 81% të FL dhe Ilar SHPK me 84% të FL, nuk u konstatuan shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, si dhe nuk vihen re skema të marrëveshjeve në oferta midis tyre.
25. Në tenderin e zhvilluar nga OSHEE SHA, më datën 31.08.2018 me objekt: “Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE SHA”, me fond limit 57.704.400 lekë pa TVSH, vihet re se ndërmarrjet e dyshuara për marrëveshje Kristalina KH SHPK dhe ADPSS SHPK (Inform Albania) kanë ulur vlerën e ofertës së paracaktuar si fituese 77% të FL. Fitues është shpallur ADPSS SHPK (Inform Albania) me 77% të FL, mbështetur nga Kristalina KH SHPK 81% të FL. Ofertuesi i tretë është Adel CO SHPK me 92% të FL. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në plotësimin e ofertave është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk rezultojnë shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, si dhe nuk vihen re skema të marrëveshjeve në oferta midis tyre. Gjithashtu nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje, gjatë procedurës së hetimit të thelluar, nuk u gjetën evidenca për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis tyre sipas përcaktimit të nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003.
- Dyshimet e lindura për një bashkëpunim të mundshëm në oferta midis ndërmarrjeve Kristalina KH SHPK dhe ADPSS SHPK përmbajnë elemente të pamjaftueshëm për të vërtetuar ekzistencën skemave të marrëveshjeve në oferta midis tyre, përderisa nuk rezultojnë evidenca të tjera bashkëpunimi midis tyre, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
26. Në tenderin e zhvilluar nga OSHEE SHA, me objekt: “Printim i faturës të energjisë elektrike dhe zarfimi në versionin Selfmailer”, me fond limit 44.460.000 Lekë pa TVSH, viti 2019, vihet re se ndërmarrja Inpress SHPK, ka shprehur interes për procedurën e prokurimit dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë ekonomike duke i dhënë me nën qira Interlogistic SHPK makineri/pajisje shtypshkrimi, për qëllime kualifikimi në tender, sjellje e cila hedh dyshime për një ofertë të përmbajtur nga ana e këtij operatori me qëllim fitimin e tenderit nga Interlogistic SHPK. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në plotësimin e ofertave është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk rezultojnë shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, si dhe nuk vihen re skema të marrëveshjeve në oferta midis tyre. Gjithashtu nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje, gjatë procedurës së hetimit të thelluar, nuk u gjetën evidenca për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis tyre sipas përcaktimit të nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003. Dyshimet e lindura për një bashkëpunim të mundshëm në oferta midis ndërmarrjeve Interlogistic SHPK dhe

Inpress SHPK përmbajnë elemente të pamjaftueshëm për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshjeje në oferta midis tyre, përderisa nuk rezultojnë evidenca të tjera bashkëpunimi midis tyre.

27. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tenderin e zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), më datë 02.05.2017, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 12,022,823 lekë (pa TVSH), ku kanë marrë pjesë: ADEL CO SHPK me 76.04% të FL, ALBDESIGN PSP SHPK me 86.24% të FL, ILAR SHPK me 61% të FL dhe KRISTALINA KH SHPK me 79% të FL, vihet re se: nuk u konstatuan shenja të njëjta të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave; nga analiza e ofertave ekonomike të ofertuesve rezulton se midis tyre ka diferenca të ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës; nga inspektimet e kryera në këto ndërmarrje, gjatë procedurës së hetimit të thelluar, nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar midis tyre sipas përcaktimit të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
28. Në tenderin e zhvilluar nga AKBPM, më datë 23.05.2018 me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 16.915.000 lekë pa TVSH, rezulton se: Euroform SHPK ka shprehur interes në procedurën e prokurimit pasi është ankuar pranë Autoritetit Kontraktor mbi kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST dhe më pas nuk ka paraqitur ofertë duke lejuar ofertuesin Kristalina KH SHPK të ofertojë me makineri/pajisje shtypshkrimi të marra me qira nga vetë Euroform SHPK. Kjo sjellje hedh dyshime për një përmbajtje të ofertës nga ana e ndërmarrjes Euroform SHPK, duke mos ofertuar, në mënyrë që oferta e Kristalina KH SHPK e paracaktuar fituese në marrëveshjen midis tyre të pranohet si e tillë. Gjithashtu vihet re se ofertat e paraqitura nga ndërmarrjet: Albdesign PSP SHPK dhe Kristalina KH SHPK nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra dhe paraqiten me vlera të ulëta 70-74% të FL, ndërkohë që kur ofertojnë të vetme vlerat e ofruara prej tyre janë mbi 90% të FL, duke mbështetur njëra-tjetrën nëpërmjet skemës së ofertës së mbuluar. Por mungesa e shenjave të njëjta në përgatitjen e ofertave midis këtyre ndërmarrjeve; diferencat e ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës; mos gjetja e evidencave direkte gjatë inspektimit, i bëjnë të pamjaftueshme këto gjetje për të vërtetuar ekzistencën e skemave të marrëveshjeve në oferta midis këtyre ndërmarrjeve, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
29. Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore më datë 31.10.2019, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 17,605,000 lekë pa TVSH, nuk u konstatuan shenja të ngjashme/gabime të njëjta të bashkëpunimit në përgatitjen e ofertave midis ndërmarrjeve ofertuese në tender, si dhe nuk vihen re skema të marrëveshjeve në oferta midis tyre.

30. Në tenderin e zhvilluar nga Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (UKT), më datë 29.05.2017, me objekt: “Kryerja e shërbimit të printimit dhe zarfimit të faturës mujore të ujit”, me fond limit 21,000,000 lekë (pa TVSH), midis ndërmarrjeve ofertuese ne tender: Ilar SHPK me 58% të FL, Adel CO SHPK me 79.18% të FL, ADPSS) me 97.55% të FL, nuk u konstatuan shenja të njëjta në përgatitjen e ofertave si dhe modele çmimesh të njëjta, duke mos pasur elementë të skema të marrëveshjeve në oferta midis tyre.
31. Në tenderin e zhvilluar nga Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA më datë 17.12.2018, me objekt: “Shërbim Printim fatura Uji”, me fond limit 4,362,938 lekë pa TVSH, ku marrin pjesë OE Kristalina KH SHPK dhe ADPSP SHPK (Inform Albania) dhe fiton ADPSP SHPK (Inform Albania) me 99% të fondit limit mbështetur nga Kristalina KH SHPK me 100% të fondit limit, vihet re se kur ofertues janë vetëm këta operatorë ekonomikë, oferta e paraqitura prej tyre janë në vlera shumë të larta mbi 99% të FL, gjë e cila nuk ka ndodhur kur pjesëmarrja ka qenë më e gjerë se vetëm këta dy ofertues. Kjo sjellje hedh dyshime për një bashkëpunim të mundshëm midis këtyre dy ofertuesve në prokurime, duke rënë dakord paraprakisht për caktimin e fituesit me qëllim fitimin e tenderit me ofertë sa më afër FL (Skema e mbuluar). Por mungesa e shenjave të njëjta në përgatitjen e ofertave midis këtyre ndërmarrjeve; diferencat e ndjeshme në çmimin e zërave të ofertës; mos gjetja e evidencave direkte gjatë inspektimit, i bëjnë të pamjaftueshme këto gjetje për të vërtetuar ekzistencën e skemave të marrëveshjeve në oferta midis këtyre ndërmarrjeve, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
32. Në tenderin e zhvilluar nga Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA, më datë 12.11.2018, me objekt: “Shërbim printimi fatura uji”, me fond limit 19,190,164.5 lekë (pa TVSH), nuk vihen re skema të marrëveshjeve në oferta midis ndërmarrjeve ofertuese ne tender: Adel CO SHPK me 92.77% të FL dhe ADPSS SHPK (Inform Albania) me 96.43% të FL. Kjo pasi një marrëveshje në oferta synon fitim e tenderit duke paracaktuar si fitues ofertën më të ulët dhe njëkohësisht sa me afër FL të jetë e mundur, në veçanti në rastet kur ofertojnë vetëm ndërmarrjet e grupit (Ofertat në këto raste janë mbi 99% të FL). Në rastin konkret janë paraqitur vetëm dy oferta, ku oferta më e ulët e paraqitur nga Adel CO SHPK me 92.77% të FL është skualifikuar me vendim të KPP-së si rezultat i ankimit nga konkurrenti i tij i vetëm në tender ADPSS SHPK, duke sjellë si rezultat fitimin e tenderit nga ky i fundit. Kjo sjellje tregon se nuk jemi para një rasti marrëveshjeje të ndaluar në oferta midis këtyre ndërmarrjeve.
33. Sa më sipër, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si: dokumentacioni i dorëzuar nga ndërmarrjet ofertuese në procedurën e prokurimit objekt hetimi dhe dokumentacionit të administruar gjatë inspektimeve të realizuara në selitë e ndërmarrjeve nën hetim, rezulton: mungesa e shenjave të njëjta në përgatitjen e ofertave midis ndërmarrjeve, si dhe modeleve të njëjta të çmimit; mungesa e evidencave direkte gjatë inspektimit, të cilat nuk vërtetojnë ekzistencën e skemave të marrëveshjeve në oferta midis ndërmarrjeve nën hetim në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore

AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD, ndaj ndërmarrjeve: Inform Albania SHPK; Albdesign PSP SHPK; Kristalina.KH SHPK; Euroform SHPK; Interlogistic SHPK; Marketing & Distribution SHPK; Inpress SHPK dhe Adel CO SHPK.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 838, Datë 29.09.2021

**“Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë
Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB).

Baza Ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 për hapjen procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka vendosi:
 - I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve Fondi Besa SHA, Iute Credit Albania, Tirana Factoring& Lease SHA, Mogo Albania SHA, Unioni Financiar i Tiranës SHA
 - i. në tregun e kredisë;
 - ii. në tregun e mikrokredisë;
 - iii. në tregun e faktoringut’
 - iv. në tregun e qirasë financiare;
 - v. në tregun e parasë elektronike, shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave (kombëtare dhe ndërkombëtare).

II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2018 deri në 31 dhjetor 2020.

2. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 33 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, gjatë procedurave të hetimit të thelluar ka kërkuar informacion nga subjektet financiare jo banka lidhur me volumet e portolit sipas tregjeve përkatëse, normat mesatare të interesit, komisionet e aplikuara nga ana e SFJB-ve, etj.

Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit të thelluar nga disa SFJB që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e qirasë financiare vihet re se të dhënat lidhur me volumin e portofolit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 për SFJB-të Porsche Leasing, Mogo Albania dhe Albania Leasing rezultojnë të jenë të ndryshme nga të dhënat e administruara gjatë hetimit paraprak për këto ndërmarrje për periudhën respektive, gjë e cila bën që të ndryshojë struktura e tregut për ndërmarrjet në tregun e qirasë financiare.

Për sa më sipër me anë të shkresave nr. 161/46 prot., datë 17.05.2021 drejtuar Albania Leasing, nr. 161/52 prot., datë 17.05.2021 drejtuar Mogo Albania dhe nr. 161/54 prot., datë 17.05.2021 drejtuar Porsche Leasing është kërkuar nga ndërmarrjet informacion shtesë dhe sqarimi i informacionit lidhur me volumin e portofolit.

Në shkresën e saj nr. 161/75 prot., datë 24.05.2021 ndërmarrja Porsche Leasing shprehet se të dhënat për vitin 2020 i referohen vitit të plotë dhe jo vetëm periudhës janar – gusht 2020 dhe nuk shprehet për vitet 2018 dhe 2019. Gjithashtu konfirmon të dhënat e dërguara gjatë periudhës së hetimit të thelluar edhe në pyetësonin bashkëlidhur shkresës.

Në shkresën e saj nr. 161/89 prot., datë 26.05.2021 ndërmarrja Albania Leasing shprehet se të dhënat për vitin 2020 i referohen vitit të plotë dhe jo vetëm periudhës janar – gusht 2020 dhe nuk shprehet për vitet 2018 dhe 2019.

Në shkresën e saj nr. 161/82 prot., datë 26.05.2021 ndërmarrja Mogo Albania ka sjellë të dhënat lidhur me volumet e portofolit.

Nga të dhënat e administruara nga ndërmarrjet Porsche Leasing, Mogo Albania dhe Albania Leasing gjatë periudhës së hetimit paraprak, si dhe ato të administruara gjatë periudhës së hetimit të thelluar rezulton se:

- 2.1 Për ndërmarrjen Mogo Albania volumi i portofolit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 i sjellë gjatë periudhës së hetimit të thelluar rezulton më i ulët se volumi i portofolit gjatë hetimit paraprak, duke bërë që pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje gjatë hetimit të thelluar të dalë më e ulët se në hetimin paraprak.
- 2.2 Për ndërmarrjen Porsche Leasing volumi i portofolit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 i sjellë gjatë periudhës së hetimit të thelluar rezulton më i lartë se volumi i portofolit gjatë hetimit paraprak, duke bërë që pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje gjatë hetimit të thelluar të rezultojë më e lartë.
- 2.3 Për ndërmarrjen Albania Leasing volumi i portofolit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 i sjellë gjatë periudhës së hetimit të thelluar rezulton më i lartë se volumi i portofolit gjatë hetimit paraprak, duke bërë që pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje gjatë hetimit të thelluar të rezultojë më e lartë.

Të dhënat e administruara gjatë procedurës së hetimit të thelluar për këto ndërmarrje bëjnë që të ndryshojë struktura e tregut për vitet 2019 dhe 2020 për ndërmarrjet që operojnë në tregun e qirasë financiare.

Sa më sipër pas analizës së të dhënave rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu në tregun e qirasë financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020 është ndërmarrja Raiffeisen Leasing, e ndjekur nga ndërmarrjet Porsche Leasing, Landeslease dhe Albania Leasing.

3. Për sa më sipër, me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e qirasë financiare, vlerësojmë hapjen e hetimit të thelluar edhe për shoqërinë Raiffeisen Leasing për të vlerësuar nëse ka shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka, në pikën “1”, shtohet edhe ndërmarrja Raiffeisen Leasing.
- II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2018 deri në 31 dhjetor 2020.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 839, Datë 29.09.2021

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrime dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”

Baza Ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 74, pika 1, germa (c), neni 75, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrime dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU””, (këtu e në vijim VKK nr. 700/2020);
- Pretendimeve të paraqitura nga ndërmarrjet:
- Agro Blend SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 194/29 Prot., datë 20.09.2021 “Qëndrim mbi monitorimin e zbatimit të VKK Nr. 700, datë 24.04.2020”;
- Miell Tirana SHA me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 194/30 Prot., datë 20.09.2021, “Kthim përgjigje Tuajës me nr. 194/16 Prot., dt 08/09/2021”;

- Atlas Mills SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me nr. 194/31 Prot., datë 20.09.2021, “Informacion në përgjigje tuajës nr 194/23 prot datë 10.09.2021 si dhe në lidhje me raportin paraprak dërguar me nr 194/16 datë 08.09.2021”;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi pretendimet e paraqitura nga ndërmarrjet: Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK.
- Proces-Verbali i datës 20.09.2021, i cili pasqyron shpjegimet dhe sqarimet e subjekteve të mësipërme në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni i Konkurrencës.
- Prapësimet e depozituara nga AgroBlend SHPK nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. prot 194/29, datë 20.9.2021 “Qëndrim mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr. 700/2020”;
- Prapësimet e depozituara nga Miell Tirana SHA nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. prot. 194/30, datë 20.9.2021 “Kthim përgjigje Tuajës me nr. 194/16 Prot., dt 08/09/2021”;
- Prapësimet e depozituara nga Mills SHPK nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. prot. 194/31, datë 20.9.2021 “Informacion në përgjigje tuajës nr 194/23 prot., datë 10.09.2021”

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 700, datë 24.07.2020, ka vendosur:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.
- II. Konstatimin e sjelljes së bashkërenduar midis ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritetit vertikal, sjellje e cila bie në kushtet e zbatimit të nenit 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 germa a dhe b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK si vijon:
 1. Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 2. Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

3. Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
4. Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK-së të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.

IV. T'i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që në bashkëpunim me njëra-tjetrën, të sigurojnë nxjerrjen e një akti nënligjor të përbashkët për të realizuar ndarjen e produktit miell i importuar sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit tij dhe përqindjes proteinike në "Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave" siç përcaktohet në udhëzimin nr. 207, datë 31.3. 2015 të MBZHR:

- miell gruri për prodhim buke me përqindje proteinike 12%;
- bazë picash, kruasan, petë me përqindje proteinike 12.5%;
- miell për ëmbëlsira, kek, biskota, petulla me përqindje proteinike 9%;
- makarona me përqindje proteinike 11%.

V. T'i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si autoriteti mbikëqyrës i cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore:

a) Pas përditësimit të "Nomenklatures së Kombinuar të Mallrave", në zbatim të pikës IV, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të mundësojë kontrollin e nivelit të proteinës (% proteinike) për produktin miell importi me qëllim përdorimin e këtij produkti në destinacionin përfundimtar tij.

VI. Moszbatimi i përmbushjes së pikës III të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.

VII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për një periudhë 1 (një) vjeçare.

2. Për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të vendosura në VKK nr. 700/2020, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të pikës VII të këtij Vendimi, ka monitoruar sjelljen e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, për një periudhë 1 (një) vjeçare.
3. Me qëllim realizimin e procedurave të monitorimit në zbatim të VKK nr.700/2020, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, gjatë periudhës së monitorimit është kërkuar informacion nga ndërmarrjet: Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, si dhe më datë 05.01.2021 ndërmarrjet janë ftuar nga Sekretariati në një seancë dëgjimore për të dhënë sqarime dhe/apo depozituar informacione shtesë lidhur me zbatimin e detyrimeve të dhëna me VKK nr. 700/2020.

4. Bazuar në rezultatet e monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.9121/2003, me shkresat: nr. 194/19 prot, datë 10.09.2021, drejtuar AgroBlend SHPK; nr.194/20 prot, datë 10.09.2021, drejtuar Miell Tirana SHA; nr.194/21 prot, datë 10.09.2021, drejtuar Bloja SHA; nr. 194/22 prot, datë 10.09.2021, drejtuar Atlas Mills SHPK, iu komunikoi ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK rezultatet e monitorimit, si dhe në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003 i ftoi ato në seancën dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës, për të parashtruar pretendimet e tyre lidhur me këto rezultate.
5. Gjatë seancës dëgjimore të datës 20.09.2021 me ndërmarrjet AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, këto ndërmarrje paraqitën gojariisht pretendimet e shpjegimet e tyre para Komisionit të Konkurrencës.
6. Gjithashtu ndërmarrjet AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA dhe Atlas Mills SHPK, paraqitën edhe me shkrim pretendimet e shpjegimet e tyre mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr. 700/2020 në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, përkatësisht:
 - AgroBlend SHPK nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. prot 194/29, datë 20.9.2021 “Qëndrim mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr. 700/2020”;
 - Miell Tirana SHA nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. prot. 194/30, datë 20.9.2021 “Kthim përgjigje Tuajës me nr. 194/16 Prot., dt 08/09/2021”; dhe
 - Atlas Mills SHPK nëpërmjet shkresës protokolluar pranë AK me nr. prot. 194/31, datë 20.9.2021 “Informacion në përgjigje tuajës nr 194/23 prot., datë 10.09.2021.....”.

II. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve nën monitorim

7. Gjatë monitorimit është ndjekur e njëjta metodologji e përdorur në raportin e hetimit të thelluar për analizën e të dhënave të shitjeve mujore të depozituar nga ndërmarrjet për miellin nga gruri i zakonshëm, i cili u mbyll me VKK nr. 700/2020, pasi nuk u gjatën prova që vërtetonin komunikimin apo ndonjë marrëveshje të shkruar ndërmjet ndërmarrjeve, për kushtet e tregtimit, fiksime çmimesh, burimet e furnizimit, apo çdo element tjetër që mund të kufizojë, të shtrembërojë, apo pengojë konkurrencën. Gjatë kësaj procedure u kërkuan evidenca të karteleve apo marrëveshjeve të fshehta duke u bazuar në materialin e OECD¹ për “Zbulimin e Marrëveshjeve të fshehta”, sipas të cilit “Provat e përdorura për të vërtetuar një marrëveshje karteli mund të klasifikohen në dy lloje: të drejtpërdrejta dhe rrethanore. Provat rrethanore, përbëhen nga prova “komunikimi” dhe prova “ekonomike”, të cilat përfshijnë sjellje konstante, strukturën e tregut dhe prova të praktikave lehtësuese. Provat ekonomike identifikojnë kryesisht sjelljen e qëndrueshme, e cila sugjeron se është arritur një marrëveshje,

¹ Prosecuting Cartels without Evidence 2006

<https://oecd.org/daf/competition/prosecutionandlaenenforcement/37391162.pdf>

por edhe sjelljen e industrisë në tërësi, elemente të strukturës së tregut që sugjerojnë se mund të ketë fiksime të çmimeve në mënyrë të fshehtë, si dhe praktika të caktuara që mund të përdoren për të mbështetur një marrëveshje karteli. Provat e sjelljes janë lloji i vetëm dhe më i rëndësishëm i provave ekonomike. Analiza e kujdesshme e sjelljes së palëve është e rëndësishme për të identifikuar sjellje që mund të karakterizohet si në kundërshtim me interesin e secilës palë të marrë individualisht dhe që për këtë arsye mbështet ekzistencën e një marrëveshjeje.”²

8. Nga analiza e të dhënave ekonomike në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit nga ndërmarrjet AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, si dhe nga të dhënat e mbledhura pas prapësimeve të ndërmarrjeve, pas seancave dëgjimore u vu re se koha një vjeçare e monitorimit nuk lejon për konkluzione të tjera definitive e profesionale të cilat do t'i qëndronin testit të gjykatës, duke qenë se pjesa e tregut të ndërmarrjeve për analizën e qëndrueshmërisë bëhet në periudha më të gjata kohore (për më shumë shiko materialin e sipërcituar të OECD). Në këto rrethana faktike, mbeten në fuqi argumentet dhe konkluzionet e Vendimit 700/2020 edhe në përfundim të kësaj periudhe monitorimi.

9. Në VKK nr. 700/2020, paragrafët 20 dhe 22 Komisioni ka konkluduar se: “20. Nga analiza e strukturës dhe pjesëve të tregut të importit të miellit, për ndërmarrjet nën hetim, vërehet se ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe Atlas SHA / Atlas Mills SHPK zotërojnë **pjesë shumë të vogla të tregut të importit të miellit**. Ndërsa ndërmarrjet Miell Tirana SHA dhe Bloja SHA nuk rezultojnë si ndërmarrje importuese të miellit. **Rrjedhimisht nuk rezulton asnjë ndërmarrje të zotërojë pozitë dominuese, si dhe nuk vihet re qëndrueshmëri e pjesëve të tregut për ndërmarrjet objekt hetimi për pasojë nuk kemi shkelje të nenit 9 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar**”, dhe “22. Përsa i përket pjesëve të tregut, si në tregun e importit të grurit të zakonshëm, si në tregun e importit të miellit vlerësohet se **ndërmarrjet nën hetim nuk kanë qëndrueshmëri të pjesëve të tregut.**”.

Ndryshimi i pjesëve të tregut për importin e grurit është i dukshëm (diferenca e pjesës më të lartë të tregut me atë më të ulët për periudhën e hetuar) dhe varion nga XX% për Miell Tirana, XX% për Agro Blend, XX% për Bloja, dhe XX% për Atlas Mills. Paqëndrueshmëria e pjesëve të tregut dhe mospasja e asnjë ndërmarrje që zotëron më shumë se 40%, bën që asnjë prej tyre të mos ketë pozitë dominuese.

Në tabelën më poshtë tregohen pjesët e tregut të ndërmarrjeve nën hetim dhe monitorim.

Ndërmarrja	2017	2018	J-Q 2019	2020	J-SH 2021
Agro Blend SHPK	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%


² Po aty, faqe 21.

Miell Tirana SHA
Bloja SHA
Atlas Mills SHPK
Të tjera
Totali

XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
100%	100%	100%	100%	100%

10. Bazuar në indekset e përqendrimit CR3, CR4 dhe Indeksi i Përqendrimit Herfindahl-Hirschman (HHI) të tregut të importit të grurit, në lidhje me treguesin CR4 vërehet se këto ndërmarrje së bashku zënë nga 66-85% të tregut nga viti 2017 deri në shtator të vitit 2021, dhe ky indeks ka ardhur në rritje. Gjithashtu indeksi i përqendrimit HHI ka ardhur në rritje nga 1,433 në vitin 2017 në 1,967 për periudhën janar-shtator 2021, gjë që tregon se përqendrimi i tregut është rritur. Në bazë të literaturës kur vlerat e HHI janë në nivelin nga 1,500 deri në 2,500, kjo tregon që Autoritetet e Konkurrencës duhet t'i kenë në vëmendje të vazhdueshme këto tregje. Tregjet me indeks HHI mbi 2,500 duhen mbajtur nën monitorim në mënyrë të vazhdueshme;
11. Megjithëse integrimi vertikal i ndërmarrjeve nuk është i ndaluar nga ligji nr. 9121/2003 dhe as ka qenë objekt i hetimit, pasi nuk është analizuar përfshirja e ndërmarrjeve nën hetim në të gjithë segmentet e krijimit të produkteve deri tek konsumatori final, duhet të theksojmë se, angazhimi në dy ose tre segmente të rrjedhës së sipërme të këtij integrimi mund të krijojë problematika në lidhje me hyrjen e operatorëve të rinj në treg. Në këtë treg nuk ka asnjë barrierë ligjore për hyrje, por përqendrimi, përsa i përket importit dhe bluarjes së grurit, mund të bëjë që të shfaqen problematika jo vetën në rrjedhën e sipërme, por edhe në rrjedhën e poshtme të zinxhirit të furnizimit me miell;
12. Përcaktimi i tregut vetëm për miellin 500, duke mos pasur të dhëna për vëllimin që zë ky produkt në gjithë totalin e produkteve të ndërmarrjeve nën hetim e monitorim, qoftë edhe në pjesën që ato zënë në shitje, kufizon disi vlerësimin për produktet homogjene që tregtojnë ndërmarrjet në monitorim. Komisioni i Konkurrencës vlerëson se në këtë rast nuk gjendemi në kushtet e vërtetimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të sjelljes së bashkërenduar për produktet homogjene që tregtojnë ndërmarrjet. Një vlerësim gjithëpërfshirës që do të mund të na çonte në krijimin e një opinioni më të konsoliduar në lidhje me sjelljen e tyre (në pamundësi të gjetjes së provave të tjera) do të kërkonte një periudhë monitorimi shumë më të gjatë sesa një vit.
13. Çmimi i grurit në tregjet ndërkombëtare nga të cilat blejnë ndërmarrjet ka pësuar rritje (shih grafikun më poshtë). Ka fluktuacione të çmimeve nga muaji në muaj, por trendi është në rritje. Ndryshimet në vlera absolute të çmimeve për një kg të grurit të blerë në Janar 2020 dhe Shtator 2021 janë respektivisht: për Ndërmarrjen AgroBlend SHPK çmimi/kg është rritur me X Lekë; për Ndërmarrjen Miell Tirana SHA çmimi/kg është rritur me X Lekë; për Ndërmarrjen Bloja

SHA çmimi/kg është rritur me X Lekë; ndërsa për Ndërmarrjen Atlas Mills SHPK çmimi/kg është rritur me X Lekë. Ndryshimet në vlerë absolute janë të pamjaftueshme për analizë, nëse nuk shihen në gjithë dinamikën e tyre gjatë periudhës së hetimit dhe monitorimit. Ndryshimi i çmimit të blerjes së grurit, ka bërë që edhe çmimi i miellit të rritet për pasojë. Për rritjen e çmimit të miellit nuk ka prova të mjaftueshme që ka qenë abuziv përtej rritjes së niveleve të çmimit në burimin e furnizimit, duke qenë e provuar edhe nga normat e ulëta të fitimit edhe pas rritjes së çmimeve në bursë.




3

14. Në materialin e OECD⁴ për mënyrën e vlerësimit të kartelevë të heshtura (faqe 19) theksohet “Në përputhje me teoritë ekonomike, një histori e gjatë e legjislacionit të konkurrencës ka provuar që një sjellje nga konkurrentët që shoqërohet me rritje të menjëhershme të çmimeve nuk mjafton për të përcaktuar nëse jemi apo jo përpara një marrëveshje të fshehtë. Duhet të mblidhen prova të tjera për vërtetimin e kësaj lloji marrëveshje të paligjshme”.
15. Nga të dhënat e siguruar nga ndërmarrjet në monitorim, rezulton se norma e fitimit për ndërmarrjet AgroBlend, Atlas Mills, Miell Tirana dhe Bloja për vitet 2007-2020 paraqitet në nivele të ulëta dhe të ndryshueshme në vite, për secilën ndërmarrje. Pra, ndërmarrjet nuk kanë mundur të sigurojnë të njëjtin nivel fitimi ndër vite, ndërkohë që normat vazhdojnë t’i kenë të ulëta. Madje, nga informacionet dhe deklaratimet e depozituara në Autoritetin e Konkurrencës nga ndërmarrjet nën hetim e monitorim, rezulton se njëra nga ndërmarrjet ka periudha kohore të operimit në humbje.

³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

⁴ Prosecuting Cartels without Evidence 2006

<https://oecd.org/daf/competition/prosecutionandlawenforcement/37391162.pdf>



16. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, nuk konkludohet që ndërmarrjet kanë realizuar një sjellje të bashkërenduar gjatë periudhës në monitorim, pasi nuk janë evidentuar prova apo një numër i konsiderueshëm indiciesh për të dalë në një konkluzion të bazuar se sjelljet e ndërmarrjeve Bloja SHA, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Agro Blend SHPK kanë cenuar konkurrencën e lirë ⁵.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, neni 26 shkronja (d), nenin 74, pika 1/c) dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

I. Detyrimin e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK:

- Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
- Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
- Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

⁵ Prosecuting Cartels without Evidence 2006

<https://oecd.org/daf/competition/prosecutionandlawenforcement/37391162.pdf>

OECD “Për zbulimin e marrëveshjeve apo kartelevë të fshehta” dhe që lidhen me pjesën e qëndrueshme të tregut, norma të larta fitimi jashtë atyre të arsyeshme, sjellje në favor të grupit dhe jo individëve, sjellja anti-konkurrese, etj.

- Të aplikojnë kushte të barabarta tregtimi për veprime tregtare të njëjta ndaj subjekteve me të cilat hyjnë në marrëdhënie kontraktore të rrjedhës së poshtme të furnizimit me miell.
- II. Detyrimin e Ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK të depozitojnë pranë AK-së për periudhën e monitorimit:
- Raportim tre-mujor në lidhje me kostot e importit të grurit, kostot e miellit dhe çmimin e shitjes së miellit.
 - Raportim tre-mujor në lidhje me të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna.
- III. Ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK të mbahen nën monitorim edhe për një vit tjetër kalendarik. Monitorimi përfundon një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ekzekutimin e këtij Vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

MENDIMI I PAKICËS

Ne anëtarët e Komisionit të Konkurrencës: **Juliana Latifi** dhe **Eduard Ypi**, jemi dakort me propozimin e paraqitur nga Sekretariati, në lidhje me Draft-Vendimin “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 700, datë 24.07.2020”

Me VKK nr. 700, datë 24.07.2020, “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU” (këtu e në vijim VKK nr. 700/2020), Komisioni i Konkurrencës ka vendosur:

- I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.*
- II. *Konstatimin e sjelljes së bashkërenduar midis ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritetit vertikal, sjellje e cila bie në kushtet e zbatimit të nenit 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a dhe b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*
- III. *Detyrimin e ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK si vijon:*
 1. *Të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;*
 2. *Të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;*
 3. *Të mos ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;*
 4. *Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK-së të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në përmbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.*
- IV. *T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që në bashkëpunim me njëra-tjetrën, të sigurojnë nxjerrjen e një akti nënligjor të përbashkët për të realizuar ndarjen e produktit miell i importuar sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit tij dhe përqindjes proteinike në “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave” siç përcaktohet në udhëzimin nr. 207, datë 31.3. 2015 të MBZHR:*
 - *miell gruri për prodhim buke me përqindje proteinike 12%;*
 - *bazë picash, kruasan, petë me përqindje proteinike 12.5%;*

- miell për ëmbëlsira, kek, biskota, petulla me përqindje proteinike 9%;
- makarona me përqindje proteinike 11%.

V. *T'i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si autoriteti mbikëqyrës i cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore:*

a) *Pas përditësimit të “Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave”, në zbatim të pikës IV, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të mundësojë kontrollin e nivelit të proteinës (% proteinike) për produktin miell importi me qëllim përdorimin e këtij produkti në destinacionin përfundimtar tij.”*

VI. *Moszbatimi i përmbushjes së pikës III të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.*

VII. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për një periudhë 1 (një) vjeçare.*

Referuar Raportit të hetimit të thelluar “Në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas SHA / Atlas Mills SHPK”, miratuar nga Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 02.07.2020, dhe dërguar ndërmarrjeve në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar nëpërmjet shkresës nr. 56/3 prot, datë 07/07/2020 “Dërgim Raporti”, ka ftuar ndërmarrjet: Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK që të paraqesin me shkrim pretendimet e tyre mbi konkluzionet e Raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj këtyre ndërmarrjeve.

Nëpërmjet shkresës nr. 56/4 datë 07/07/2020 “Ftesë për dhënie mendimi”, KK i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në lidhje me problematikën e konstatuar gjatë procedurave hetimore dhe propozimit që në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, produkti miell i importuar të ndahet sipas karakteristikave, cilësisë së produktit, destinacionit përfundimtar të përdorimit të tij dhe përqindjes proteinike.

Sekretariati ka arritur midis të tjerave në këto konkluzione:

- Nga analiza e strukturës dhe pjesëve të tregut të importit të grurit të zakonshëm mund të themi se struktura e integruar e 4 ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas SHA / Atlas Mills SHPK ka krijuar një qëndrueshmëri e cila vjen si rezultat i politikave të tyre për shfrytëzim të linjave të prodhimit të miellit. Gjatë vitit 2018 vihet re një ulje e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve vetëm importuese të grurit. Kjo situatë bën që ndërmarrjet e blojës të jenë faktor i rëndësishëm në përcaktimin e ofertës së grurit në tregun e brendshëm. Respektivisht, Miell Tirana SHA XX%, Agro Blend SHPK XX%, Bloja SHA XX%, dhe Atlas Mills SHPK XX% (pa marrë

në konsideratë faktin se një nga ndërmarrjet kryesore të importit të grurit të zakonshëm, Besniku SHPK zotëron 100% të pronësisë së ndërmarrjes tjetër kryesore Atlas Mills SHPK dhe se të dy ndërmarrjet kanë shpesh marrëdhënie klient – furnitor) .

- Nga analiza e strukturës së tregut rezulton se ndërmarrjet importuese të grurit janë edhe prodhueset më të mëdha të miellit në vend, tre nga ndërmarrjet nën hetim, Miell Tirana SHA, Agro Blend SHPK, dhe Bloja SHA, janë dhe ndërmarrjet importuese më të mëdha të grurit të zakonshëm, *triticum aestivum*. Të vepruarit në këto tregje, zotërimi i sasive të mëdha të lëndës së parë dhe i linjës prodhuese krijon kushtet e integritimit vertikal në tregun e grurit dhe të miellit. Ky integrim e modifikon strukturën e tregut sepse shton një dimension në lidhjen midis konkurrentëve. Efektet e integritimit të ndërmarrjeve çojnë në rritjen e efikasiteteve të cilat nuk do të mund të arriheshin pa integrimin vertikal dhe gjithashtu krijon mundësinë për përjashtimin e firmave jo të integruara dhe pengesave financiare të mëdha në hyrje.
- Duke qenë se ndërmarrje operojnë në të gjithë nivelet e tregut, konkretisht në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, bëjnë që ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, të zotërojnë pjesën më të madhe në treg si rezultat i integritimit vertikal, të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin në tregun e prodhimit të miellit.
- Në treg nuk ekzistojnë pengesa ligjore për hyrje të reja. Pozita e konsoliduar e ndërmarrjeve në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut ndër vite, eksperiencia apo reputacioni, teknologjia dhe kapacitetet e larta përpunuese krijojnë vështirësi për një hyrës të mundshëm të ri. Për këtë arsye, një hyrje e re në këtë treg kërkon një investim shumë të madh dhe mundësisht integrim vertikal (të sigurojë lëndën e parë nga importi) për të përballuar tregun.
- Fuqia kundërvepruese e klientëve është e vogël si në tregun e shitjes së grurit ashtu dhe në tregun e prodhimit të miellit. Blerësit e grurit (blojet e vogla) janë ndërmarrje të detyruara të sigurojnë lëndën e parë për të mbajtur në punë linjat e prodhimit, të punësuarit e tyre dhe klientët e tyre të miellit. Fuqia e klientëve të miellit për të kundërvepruar është edhe më e dobët se e klientëve të grurit, pasi klientët (furrtarët) janë biznese të vogla që janë të detyruara të pranojnë çmime të caktuara prej furnitorëve të mëdhenj.
- Bazuar në analizën e fuqisë ekonomike dhe analizën e pasqyrave financiare të administruara, ndërmarrjet në hetim operojnë me norma të fitimit përgjithësisht pozitive, përveç Bloja SHA në vitin 2018 (me XX% humbje). Norma e fitimit kryesisht është afërsisht XX% (Besniku SHPK, Bloja SHA dhe Miell Tirana SHA) për gjysmën e rasteve kur kjo normë është pozitive (XX%, XX% dhe XX%) dhe në tre raste kjo normë është mbi XX% (Agro Blend SHPK 2017, 2018, Besniku SHPK 2017) dhe një rast shumë e ulët, XX% që korrespondon me ndërmarrjen Atlas Mills SHPK gjatë periudhës që sapo kishte nisur aktivitetin në fund të vitit 2018.

- Tregu objekt hetimi paraqitet problematik duke qenë se produkti miell për ëmbëlsira futet në tregun vendas si miell gruri pa përcaktuar destinacionin e tij përfundimtar dhe rrjedhimisht edhe cilësinë. Për këtë arsye mund të themi se çmimi i ulët i importit favorizon ndërmarrjet në treg, duke i vendosur ndërmarrjet prodhuese në kushte të pafavorshme të konkurrencës.
- AKU, në rolin e mbikëqyrësit të cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore, nuk përcakton nivelin e proteinës (% proteinike) në “Raportet e Provës” marrë në PIK (Pikat e Inspektimit Kufitar) për produktin miell, duke sjellë për pasojë mos identifikimin e llojit të produktit apo të cilësisë së tij. Ky fakt u jep mundësinë importuesve të miellit të operojnë në treg me çmime më të ulta, për produkte cilësisht të ndryshme duke deformuar tregun.
- Një tjetër arsye që lehtëson hyrjen e këtyre mallrave në treg është dhe mos kodifikimi doganor sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit, pra duke mos përcaktuar destinacionin përfundimtar të produktit (konkretisht miellit) siç dhe rekomandohet në udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Konkretisht DPD nuk e ka të parashikuar në “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave 2020” ndarjen e produktit miell gruri sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit dhe destinacionit përfundimtar të produktit (konkretisht miellit) siç dhe rekomandohet në udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 207, datë 31.03.2015. Ky element regjistrimi i produktit pengon identifikimin e llojit të produktit (miell) sipas cilësisë dhe destinacionit përfundimtar të përdorimit. Bazuar në nenin 17 “Kontrolli në doganë i ushqimeve të importuara”, të ligjit nr. 9863/2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, Autoritetet Doganore kryejnë procedurat doganore për ngarkesat ushqimore, pasi inspektorët e ushqimit, në pikat e inspektimit kufitar, kanë dhënë miratimin.
- Ky treg paraqitet problematik duke qenë se ky produkt futet në tregun vendas si miell gruri pa përcaktuar destinacionin e tij përfundimtar të përdorimit, përqindjen e proteinës dhe rrjedhimisht cilësinë e produktit. Për këtë arsye mund të themi se çmimi i ulët i importit të miellit me përqindje proteinike të ulët, nëse është përdorur jashtë qëllimit të tij të përcaktuar, favorizon ndërmarrjet importuese, si rrjedhojë deformon tregun, duke i vendosur ndërmarrjet prodhuese në kushte të pafavorshme të konkurrencës. Situatë e favorizuar edhe nga mos kodifikimi doganor sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit, pra duke mos përcaktuar destinacionin përfundimtar të produktit siç dhe rekomandohet në udhëzimin nr. 207/2015 të MBZHR.
- Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me çmimin e importit të grurit rezultojnë se ndërmarrjet nën hetim blejnë me çmime të përafërta, sasitë e importuara të ndërmarrjeve nën hetim nuk ndjekin trendin e çmimit CIF për të krijuar rezerva kur çmimi bie dhe për t’i përdorur këto rezerva kur çmimi është më i lartë, dhe nuk rezultojnë të ketë blerje në furnitorë të përbashkët.
- Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim Bloja SHA, Atlas Mills SHPK, Miell Tirana SHA dhe Agro Blend SHPK, që zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të importit të grurit, prodhimit

dhe tregtimit të miellit si rezultat i integritit vertikal, në lidhje me çmimin në tregun e shitjes së miellit vërehet se aplikojnë çmime të përafërta, sjellje të bashkërenduar e cila bie nën kushtet e nenit 3, pika 4 dhe nenit 4 pika 1 gërma a) e ligjit nr. 9121/2003.

- Ndërmarrjet nën hetim, caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes pothuajse të njëjta, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a) dhe b), e ligjit nr.9121/2003 pasi caktohen çmimet e shitjes dhe kufizojnë konkurrencën duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritit vertikal.
- Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me çmimin e shitjes së miellit për bukë vërehet se çmimet mesatare mujore gjatë periudhës hetimore (1 janar 2017 deri në 30 qershor 2019) janë të qëndrueshme për të njëjtën ndërmarrje dhe të përafërta midis ndërmarrjeve. Gjithashtu, edhe çmimet mesatare të tremujorëve rezultojnë se janë të përafërta. Ndërmarrja Atlas Mills SHPK, gjatë vitit 2018 pas përqendrimit, kohë kur pronësia e saj është transferuar ndërmarrjes Besniku SHPK me VKK nr. 622, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK”, ka shitur miell në tregun e tregtimit të miellit për bukë me çmime më të ulta se konkurrentët e tjerë; Por gjatë vitit 2019, ndërmarrja Atlas Mills SHPK ndjek çmimet e konkurrentëve të tjerë në tregun e tregtimit të miellit për bukë.
- Përsa më sipër, ndërmarrjet nën hetim, caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes pothuajse të njëjta, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a) dhe b), e ligjit nr. 9121/2003 pasi caktohen çmimet e shitjes dhe kufizojnë konkurrencën duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritit vertikal.
- Referuar konkluzioneve të mësipërme, rezulton se nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, janë konstatuar shkelje të ligjit të konkurrencës, **në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 gërma a) dhe b), e ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritit vertikal, si rrjedhojë kufizojnë konkurrencën.**

Në zbatim të pikës (VI) të VKK nr.700/2020, është realizuar monitorimi 1 vjeçar i ndërmarrjeve nën hetim.

Bazuar në metodologjinë e përdorur edhe gjatë hetimit të thelluar, si edhe në materialin e OECD “Zbulimi i marrëveshjeve të ndaluara pa evidenca direkte”¹, evidencat ekonomike indirekte, të

¹ Prosecuting Cartels Without Direct Evidence 2006

<https://www.oecd.org/daf/competition/prosecutionandlaenenforcement/37391162.pdf>

cilat tregojnë një sjellje të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve janë evidenca të strukturës së tregut, si dhe evidenca të sjelljes së ndërmarrjeve.

Për sa i përket evidencave ekonomike indirekte që lidhen me strukturën e tregut, të cilat mund të lehtësojnë marrëveshjet kartel janë: qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite, përqendrimi i lartë i tregut, barriera të larta në hyrje, nivel i lartë i integritimit vertikal dhe produktet homogjene.

Evidencat ekonomike indirekte të sjelljes së ndërmarrjeve janë: aplikimi i çmimeve të njëjta të shitjes dhe sjellje të përsëritura në lidhje me shkelje të konkurrencës.

Për sa më sipër në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003 evidencat ekonomike indirekte të strukturës të analizuara gjatë trajtimit të këtij rasti paraqiten si më poshtë :

– *Qëndrueshmëri të pjesëve të tregut ndër vite:*

Referuar gjetjeve të raportit të Hetimit të Thelluar dhe informacionit të monitorimit të zbatimit të VKK nr. 700/2020, që nga viti 2017-deri J –SH 2021 vihet re se ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK kanë vlera të qëndrueshme të pjesëve të tregut të importit të grurit: përkatësisht 2017, 2018, J-Q 2019, 2020, J-SH 2021:

Ndërmarrja	2017	2018	J-Q2019	2020	J-SH2021
AGRO BLEND SHPK	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
MIELL TIRANA SHA	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
BLOJA SHA	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
ATLAS MILLS SHPK	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
TË TJERA	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%
Totali	XX%	XX%	XX%	XX%	XX%

– *Përqendrim të lartë të tregut:*

Referuar gjetjeve të raportit të Hetimit të Thelluar dhe informacionit të monitorimit të zbatimit të VKK nr. 700/2020, bazuar në indeksat e përqendrimit CR3, CR4 dhe HHI të tregut të importit të grurit, në lidhje me treguesin CR4 vërehet se këto ndërmarrje së bashku zënë nga 66-85% të tregut nga viti 2017 deri në shtator të vitit 2021, dhe ky indeks ka ardhur në rritje. Gjithashtu indeksi HHI ka ardhur në rritje, gjë që tregon se përqendrimi i tregut është rritur.

Indeksi	2017	2018	J – Q 2019	2020	J – SH 2021
CR3	59%	58%	62%	64%	70%
CR4	69%	66%	69%	80%	85%
HHI	1,433	1,616	1,629	1,733	1,967

- *Barrierat në hyrje:*

Referuar gjetjeve të raportit të Hetimit të Thelluar, integrimi vertikal i ndërmarrjeve është një barrierë e fuqishme për hyrje të reja në treg, dhe sidomos në tregun e prodhimit të miellit, ku ndërmarrjet më të mëdha të importit të grurit janë dhe prodhuesit më të mëdhenj të miellit në vend. Në këtë treg është konstatuar se kuadri ligjor nuk krijon pengesa ligjore për hyrjet e reja në treg. Por, nga pikëpamja ekonomike, një hyrje e re në këtë treg kërkon një investim shumë të madh financiar si dhe kjo hyrje e re duhet të operojë në të gjithë zinxhirin vertikal të tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit.

– *Integrim vertikal:*

Referuar gjetjeve të raportit të Hetimit të Thelluar dhe informacionit të monitorimit të zbatimit të VKK nr. 700/2020, në tregun e prodhimit (përpunimit) të miellit në fabrikat vendase, ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas SHA / Atlas Mills SHPK kanë peshën më të madhe në treg në prodhimin e miellit. Ky integrim vertikal u jep mundësinë këtyre ndërmarrjeve që jo vetëm të prodhojnë 3-4 herë sasinë e miellit total të importuar, por të arrijnë të përballojnë sasi të konsiderueshme të nevojave vjetore për miell. Pra ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK kanë integrim vertikal në tregun e importit të grurit, prodhimit dhe tregtimit të miellit. Të vepruarit në këto dy tregje, zotërimi i sasive të mëdha të lëndës së parë dhe i linjës prodhuese krijon kushtet e integritimit vertikal në tregun e grurit dhe të miellit.

Ky integrim e modifikon strukturën e tregut sepse shton një dimension në lidhjen midis konkurrentëve. Efektet e integritimit të ndërmarrjeve çojnë në rritjen e efikasiteteve, të cilat nuk do të mund të arriheshin pa integrimin vertikal dhe gjithashtu krijon mundësinë për përjashtimin e firmave jo të integruara dhe barrierave të mëdha në hyrje.

- *Produkte homogjene:*

Produktet (grurë dhe miell) që ofrohen nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit janë homogjene midis ndërmarrjeve, pasi produktet që ofrohen është i njëjtë.

Në kuptim të nenit 4, të ligjit 9121/2003 evidencat ekonomike indirekte të sjelljes të analizuara gjatë trajtimit të këtij rasti paraqiten si më poshtë:

– *Çmime të njëjta shitje:*

Referuar gjetjeve të raportit të Hetimit të Thelluar dhe informacionit të monitorimit të zbatimit të VKK nr. 700/2020, nga të dhënat e administruara, për çdo muaj janë nxjerrë çmimet që ndërmarrjet nën hetim kanë të përbashkëta. Për secilin çmim është krahasuar volumi total i shitjes në atë muaj nga ajo ndërmarrje me volumin total të shitjes së miellit. Më pas, rezultatet janë krahasuar me ndërmarrjet e tjera duke nxjerre kështu çmimet ku ndërmarrjet kanë bërë më shumë volum shitje miell për secilin muaj.

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK, në lidhje me çmimin e shitjes së miellit vërehet se ndërmarrjet aplikojnë çmime të njëjta, sjellje e bashkërenduar, e cila bie në kundërshtim me nenin 4, germa a) e ligjit nr. 9121/2003.

– *Sjellje e përsëritur:*

Tregu i importit të grurit, prodhimit dhe tregtimit të miellit është hetuar ndër vite nga AK për shkelje të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, si në rastin e VKK nr. 126/2009 “Për mbylljen e Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit të grurit, prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës dhe rekomandimet përkatëse”.

Për sa mësipër nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, **gjatë periudhës 1 vjecare të monitorimit në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, janë konstatuar shkelje të ligjit të konkurrencës, në kundërshtim me nenin 3 pika 4, dhe nenin 4 pika 1 germa a) dhe b), e ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi këto ndërmarrje bashkërendojnë sjelljen duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritetit vertikal, si rrjedhojë kufizojnë konkurrencën. Këto ndërmarrje, nuk kane respektuar VKK nr.700/2000.**

Në respektim të procedurave ligjore të ligjit nr.9121/2003 Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 09.09.2021 ka miratuar Relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 700, datë 24.07.2020 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrime dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU”, dhe në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, me shkresat: nr. 194/19 prot, datë 10.09.2021, drejtuar AgroBlend SHPK; nr. 194/20 prot, datë 10.09.2021, drejtuar Miell Tirana SHA; nr. 194/21 prot, datë 10.09.2021, drejtuar Bloja SHA; nr. 194/22 prot, datë 10.09.2021, drejtuar Atlas Mills SHPK, u komunikoi ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK rezultatet e monitorimit, si dhe i ftoi ato në seancën dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës për të parashtruar pretendimet e tyre lidhur me këto rezultate.

VKK nr.700, datë 24.07.2020, është një vendim i cili nuk është ankimuar nga palët, si në rrugë administrative apo rrugë gjyqësore. Ai është një vendim, i cili në mënyrë *explicite* në pikën (VI) të tij, parashikon shprehimisht se: *Moszbatimi i përmbushjes së pikës III të këtij vendimi, në zbatim të nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me penalitetet përkatëse.*

Bazuar në Rregulloren “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”,² është përcaktuar metodologjia e përlllogaritjes së gjobës, dhe si vit bazë për përcaktimin e xhiros në zbatim të nenit 74 të ligjit nr.9121/2003 mbi të cilin është bërë përlllogaritja e gjobës, është viti 2020.

Në këto rrethana, vleftha e gjobës për secilën kompani bazuar në Rregulloren “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”, paraqitur nga ana e Sekretariatit është:

- I. Për ndërmarrjen Agro Blend SHPK për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 700/2020, gjoba është në masën 7.11% të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës (2020) sipas pasqyrave financiare në QKB, në vlerën XX Lekë.
- II. Për ndërmarrjen Miell Tirana SHA për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 700/2020, gjoba është në masën 10% të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës (2020), sipas pasqyrave financiare në QKB, në vlerën XX Lekë.
- III. Për ndërmarrjen Bloja SHA për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 700/2020, gjoba është në masën 5.26% të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës (2020), sipas pasqyrave financiare në QKB, në vlerën XX Lekë.
- IV. Për ndërmarrjen Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 700/2020, gjoba është në masën 3.28% të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës (2020), sipas pasqyrave financiare në QKB, në vlerën XX Lekë.

Në referencë të jurisprndencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë,³ ndërmarrjet AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK ndodhen në kushtet e një sjellje të bashkërenduar e cila çon konkurrencën në kushte që nuk korrespondon me kushtet normale të tregut, duke pasur parasysh natyrën e produkteve, rëndësinë dhe numrin e ndërmarrjeve në treg, si dhe madhësinë dhe natyrën e tregut në fjalë.

Një sjellje/praktikë e bashkërenduar nënkupton, përveç bashkërendimit të ndërmarrjeve, sjellje në treg në përputhje me ato praktika të fshehta dhe një marrëdhënie shkak-pasojë midis të dyjave, dhe si rrjedhojë kufizim të konkurrencës në treg.

² VKK nr. 120, datë 10.09.2009, përafruar me:

Commission Notice on Immunity from fines and reduction of fines in cartel cases/ 2006/C 298/11 (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A52006XC1208%2804%29>)

Guidelines on the method of setting fines imposed pursuant to Article 23(2)(a) of Regulation No 1/2003 (2006/C 210/02) (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A52006XC0901%2801%29>)

³ Capacity Building for Albania’s Competition Authority. Booklet ECJ jurisprudence trainings. Concerted practices and the standard of proof in EU Competition, 2021.

[...] një sjellje e bashkërenduar, në kuptimin e nenit 85 (1) të Traktatit, i referohet një forme koordinimi midis ndërmarrjeve e cila, pa arritur në fazën ku një marrëveshje apo e ashtuquajtur marrëveshje është lidhur, zëvendëson vetëdijshmi rrisqet e konkurrencës të një praktike bashkëpunimi mes tyre [...]. C-49/92 Anic [1999] §115.⁴

Nga vetë natyra, një sjellje/praktikë e bashkërenduar nuk i ka të gjitha elementet e një kontrate, por *inter alia* mund të lindë nga koordinimi i cili bëhet i dukshëm nga sjellja e pjesëmarrësve. C-48/69 ICI [1972] §64-65.⁵

Koncepti i një “sjellje/praktike të bashkërenduar” i referohet një forme koordinimi midis ndërmarrjeve, e cila, pa arritur në fazën kur është arritur një marrëveshje e ashtuquajtur është lidhur, zëvendëson vetëdijshmi rrisqet e konkurrencës të një praktike bashkëpunimi mes tyre, të cilat çojnë konkurrencën në kushte që nuk korrespondojnë me kushtet normale të tregut, duke pasur parasysh natyrën e produkteve, rëndësinë dhe numrin e ndërmarrjeve, si dhe madhësinë dhe natyrën e tregut në fjalë. Joined cases C- 40 to 48, 50, 54 to 56, 111, 113 and 114-73, Suiker Unie [1975] § 26.⁶

[...] një sjellje/praktikë e bashkërenduar nënkupton, përveç bashkërendimit të ndërmarrjeve, sjellje në treg në përputhje me ato praktika të fshehta dhe një marrëdhënie shkak -pasojë midis të dyjave. C-49/92 Anic Partecipazioni SpA [1999] §118.⁷

[...] për shkeljen e Nenit 101 (1) të TFBE (ish-neni 81 (1) TKE) është e mjaftueshme që një sjellje e bashkërenduar të ketë potencial - në bazë të përvojës ekzistuese - të prodhojë një ndikim negativ në konkurrencë. Me fjalë të tjera, sjellja e bashkërenduar duhet thjesht të jetë e aftë në një rast individual, që është, të ketë pasur parasysh kontekstin ligjor dhe ekonomik specifik që rezulton në parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të përbashkët.

⁴ [...] a concerted practice, within the meaning of Article 85(1) of the Treaty, refers to a form of coordination between undertakings which, without having been taken to a stage where an agreement properly so called has been concluded, knowingly substitutes for the risks of competition practical cooperation between them
C-49/92 Anic [1999] §115

⁵ By its very nature, then, a concerted practice does not have all the elements of a contract but may *inter alia* arise out of coordination which becomes apparent from the behavior of the participants
C- 48/69 ICI [1972] §64-65

⁶ The concept of a 'concerted practice' refers to a form of coordination between undertakings, which, without having been taken to the stage where an agreement properly so-called has been concluded, knowingly substitutes for the risks of competition, practical cooperation between them which leads to conditions of competition which do not correspond to the normal conditions of the market, having regard to the nature of the products, the importance and number of the undertakings as well as the size and nature of the said market. Joined cases C- 40 to 48, 50, 54 to 56, 111, 113 and 114-73, Suiker Unie [1975] § 26

⁷ [...] a concerted practice implies, besides undertakings' concerting together, conduct on the market pursuant to those collusive practices and a relationship of cause and effect between the two.
C-49/92 Anic Partecipazioni SpA [1999] §118

Kurdoqoftë dhe çfarëdolloj përmase, në fakt, efektet e tilla anti konkurruese mund të jenë më së shumti të rëndësishme për përcaktimin e shumës së çdo gjobë dhe në lidhje me kërkesat për dëmet.⁸

Një sjellje/praktikë e bashkërenduar i referohet një forme koordinimi midis ndërmarrjeve të cilat, pa arritur në fazën ku një marrëveshje apo e ashtuquajtur marrëveshje është lidhur, zëvendëson vetëdijshmi rrisqet e konkurrencës të një praktike bashkëpunimi mes tyre [...] kërkesa e pavarësisë nuk i heq të drejtën operatorëve ekonomikë për t'u përshtatur në mënyrë inteligjente me sjelljen ekzistuese dhe të parashikuar të konkurrentëve të tyre, megjithatë përjashton rreptësisht çdo kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë midis këtyre operatorëve, objektit ose efektit prej të cilave ose do të ndikojë në sjelljen në treg të një konkurrenti aktual ose potencial ose t'i tregojnë një konkurrenti të tillë, mënyrën e sjelljes të cilën ata vetë kanë vendosur të miratojnë ose që mendojnë të adoptojnë në treg.⁹

Juliana Latifi

Eduard Ypi

⁸ Capacity Building for Albania's Competition Authority. Booklet ECJ jurisprudence trainings, 2021. Coöperatieve Vereniging "Suiker Unie" UA and others v Commission of the European Communities. Joined cases 40 to 48, 50, 54 to 56, 111, 113 and 114-73

⁹ *Ibid.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 840, Datë 27.10.2021

**“ MBI AUTORIZIMIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË COMPAGNIE
DE BANQUE PRIVEE QUILVEST S.A NGA SHOQËRIA FIDEURAM – INTESA
SANPAOLO PRIVATE BANKING S.P.A.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të shoqërisë Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të shoqërisë Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A

Referuar “Marrëveshjes për blerjen dhe transferimin e aksioneve në lidhje me Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A.”, palët janë:

Blerësi: Fideuram - Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A. është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas ligjeve të Italisë, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve këshilluese financiare për të përbushur nevojat financiare të klientëve të saj.

Fideuram zotërohet plotësisht nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A, e cila është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A.

Shitësi: Quilvest Wealth Management S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me objekt aktiviteti ofrimin e zgjidhjeve të personalizuar të menaxhimit të pasurive dhe zyrave familjare.

Shoqëria zotërohet nga shoqëritë Quilvest S.A. dhe Vauban Participations S.A.. Dy shoqëritë, të cilët janë përcaktuar në marrëveshje si “aksionarët”, janë palë në marrëveshje vetëm për disa nga nenet që trajtojnë çështjet e angazhimit të palëve dhe procedurat pas mbylljes së marrëveshjes.

Target: Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, aktivitetet e së cilës kanë të bëjnë me investimet dhe shërbimet bankare, shërbimet e menaxhimit të pasurisë dhe shërbimet e zyrave për familjen etj.

Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A. nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Më datë 10 gusht 2021, shoqëritë Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A., Quilvest Wealth Management S.A., Quilvest S.A. dhe Vauban Participations S.A. kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerjen dhe transferimin e aksioneve në lidhje me Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A.”, në lidhje me blerjen dhe transferimin e të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A.

Në bazë të kushteve të kësaj kontrate, shitësi Quilvest Wealth Management S.A. do të shesë dhe transferojë aksionet tek blerësi Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A. në varësi dhe në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje. Pas përfundimit të transaksionit, shoqëria Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A. do të kontrollohet plotësisht nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë CBP Quilvest S.A. nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A., transaksioni i cili plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10, pika 1 germa b të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” tregu përkatës mund të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë CBP Quilvest S.A. nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A është pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo, i cili është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania, SHA.

CBP Quilvest S.A., është një shoqëri anonime me aktivitet ofrimi i shërbimeve bankare private dhe shërbimet e menaxhimit të pasurisë në Luksemburg dhe Beelgjikë, e cila nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Në tregun shqiptar, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Compagnie de Banque Privée Quilvest S.A nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 841, Datë 27.10.2021

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENERGY PLUS SHPK NGA SHOQËRIA DUFERCO
POBREG SHPK.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK.

Referuar dokumentit “Marrëveshje paraprake shitblerje”, të lidhur më datë 14 korrik 2021, palët janë:

Pala blerëse: *Duferco Pobreg SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: studimin, konsulencën, projektimin, prodhimin, realizimin, tregtimin e projekteve të investimit të centraleve, të linjave të transportit të energjisë elektrike, të impianteve në përgjithësi në sektorin e energjisë nga burime të rinovueshme në Itali dhe jashtë saj, menaxhimin e impianteve si në pikën më sipër, prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj, edhe nëpërmjet veprimtarisë së tregtimit, etj.

Shoqërinë *Duferco Pobreg SHPK*, zotërohet 100% nga shoqëria *Duferco Energia S.P.A.*, e cila është pjesë e grupit ndërkombëtar *Duferco*, aktive në sektorin e energjisë, në sektorët e çelikut dhe transportit detar.

Aktualisht shoqërinë *Duferco Pobreg SHPK* nuk ushtron asnjë aktivitet.

Pala shitëse:

1. *Agi Kons SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari në fushën e ndërtimit të përgjithshëm, veprimtari në fushën e projektimit, tregtim materialeve ndërtimi, import-eksport, etj.

2. *Energy Development Group SHA*, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: studimi, projektimi, konsulenca sipërmarrja zbatuese dhe/ose investimi për realizimin me fonde publike dhe/ose jo publike të hidrocentraleve, financimi, vënia në punë, administrimi, prodhimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, ndërtimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike për tregtimin e saj, konsulencë teknike në fusha të ndryshme, supervizim, menaxhime dhe studime të të gjitha llojeve, etj.

Target: *Energy Plus SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: ndërtimin në lumin Luma në rrethin e Kukësit të hidrocentralit “Pobreg”, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë financimin, ndërtimin, vënien në punë, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike të përfutur. *Energy Plus SHPK* është shoqëria koncesionare e themeluar për realizimin e kontratës së Koncesionit, e formës BOT, për ndërtimin e hidrocentralit POBREG mbi lumin Luma, rrethi i Kukësit

Shoqëritë *Duferco Pobreg SHPK*, *Duferco Energia S.P.A.*, *Agi Kons SHPK*, *Energy Development Group* dhe *Energy Plus SHPK*, kanë nënshkruar “Marrëveshje paraprake shitblerje” nëpërmjet të cilës shitësit kanë shprehur vullnetin e tyre për t’i shitur blerësit 100% të kapitalit themeltar që zotërojnë në shoqëri dhe rrjedhimisht, gjithë projektin, Hidrocentralin e Pobregut.

Shoqëria *Energy Plus SHPK*, aktualisht ka përfunduar me ndërtimin e hidrocentralit dhe është në fazën e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

Pas realizimit të transaksionit të propozuar shoqëria *Duferco Pobreg SHPK*, do të zotërojë plotësisht shoqërinë *Energy Plus SHPK*, e cila bëhet pjesë e Grupit *Duferco*.

Në zbatim të nenit 3 “ Kushti paraprak” të “Marrëveshjes paraprake të shitblerjes”, pala shitëse ka marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ERE, për ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK.

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu për prodhimin e energjisë elektrike dhe tregu i shitjes me shumicë të energjisë elektrike. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Për vitin 2020 numri i centraleve prodhuese private, të cilat kanë prodhuar energji elektrike, është 216 dhe kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 1,058 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, kurse 622 MW i përket centraleve të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.

Shoqëria Energy Plus SHPK zotëron hidrocentralin Pobreg, i cili ka kapacitet të instaluar prodhimi 12.3MW dhe ka prodhuar 37,285MWh gjatë vitit 2020. Prodhimi i hidrocentralit Pobreg gjatë vitit 2020 zë 0.7 % të totalit të prodhimit vendas të energjisë elektrike.

Transaksioni i propozuar do të realizojë përfundimin e kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK.

Duferco Pobreg SHPK është një shoqërie e sapokrijuar, e cila do të operojë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike pas mbylljes së marrëveshjes dhe zotërimit të hidrocentralin Pobreg, duke përfutur edhe pjesën e tregut të zotëruar tashme nga shoqëria Energy Plus SHPK.

Për shkak të pjesës së vogël që zotëron Energy Plus SHPK në tregun e prodhimit të energjisë elektrike dhe faktit që Duferco Pobreg SHPK nuk ka operuar në këtë treg, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun përkatës dhe nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 842, Datë 27.10.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË LOOM TECHNOLOGIES GMBH NGA SHOQËRIA TB DIGITAL SERVICES GMBH.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfthimin e kontrollit të shoqërisë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje aksionesh” të lidhur më datë 8 korrik 2021, palët janë:

Pala blerëse: *TB Digital Services GmbH*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: sigurimi, kryesisht dixhital, i lëvizshmërisë, shërbimeve të logjistikës dhe transportit të të gjitha llojeve, prodhimi dhe shitja e produkteve të ndërlidhura, si dhe pjesëmarrja në kompani të tjera., etj.

TB Digital Services GmbH kontrollohet në mënyrë indirekte nga Traton SE, aktiviteti i të cilës është biznesi i kamionëve dhe autobusëve i Grupit Volkswagen. Grupi Volkswagen drejtohet nga ndërmarrja mëmë Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), e cila operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala shitëse:

1. ProAktiv GmbH & Co. KG, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, e cila ka një partner me përgjegjësi personale dhe përfaqësohet individualisht.

2. Aksionarë (5 individë), të cilët zotërojnë aksione në shoqërinë Loom Technologies GmbH.

Target: *Loom Technologies GmbH*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimi dhe konsulenca mbi softuerët.

Shoqëria Loom Technologies GmbH, nuk zotëron degë apo filial në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura.

Ndërmjet shoqërisë TB Digital Services GmbH , Z.Viktor Muller, shoqërisë ProAktiv GmbH & Co. KG dhe individëve Z. Jurgen Ademmer, Z. Eduard Baun, Znj. Sabrina Klante dhe Z. Dean Gehrke, është lidhur “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, më datë 8 korrik 2021.

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësit dhe blerësi dëshirojnë të shesin/blejnë dhe transferojnë aksionet dhe kërkesat e huasë së Aksionarëve sipas kushteve të kësaj Marrëveshje.

Transaksioni i synuar parashikon blerjen e 100% të aksioneve të shoqërisë Loom Technologies GmbH, nga shoqëria TB Digital Services GmbH. Pas realizimit të transaksionit shoqëria TB Digital Services GmbH, do të zotërojë plotësisht shoqërinë Loom Technologies GmbH.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar, transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i programit softuerik për menaxhimin e aktivitetit të biznesit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit të shoqërisë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH.

TB Digital Services GmbH vepron në tregun e sigurimit, kryesisht dixhital, të lëvizshmërisë, shërbimeve të logjistikës dhe transportit të të gjitha llojeve, prodhimin dhe shitjen e produkteve të ndërlidhura, si dhe pjesëmarrja në kompani të tjera etj. TB Digital Services GmbH është pjesë e Grupit Volkswagen, i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, në tregun e shitjes së automjeteve dhe dhënien e qerasë financiare e shërbimeve të sigurimeve të lidhura me shitjet e automjeteve.

Loom Technologies GmbH nuk është i pranishëm dhe nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë përfutimit të kontrollit të shoqërisë Loom Technologies GmbH nga shoqëria TB Digital Services GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 843, Datë 27.10.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË CREDIT AGRICOLE SRBIJA A.D NOVI SAD NGA SHOQËRIA RAIFFEISEN BANKA A.D.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad nga shoqëria Raiffeisen Banka A.D.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad nga shoqëria Raiffeisen Banka A.D.

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad nga shoqëria Raiffeisen Banka A.D.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e shitblerjes në lidhje me aksionet në kapitalin e Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad” të lidhur më datë 5 gusht 2021, palët janë:

Pala blerëse: *Raiffeisen Banka A.D*, shoqëri aksionare, me seli Beograd, me objekt aktiviteti: ndërmjetësim tjetër monetar. Raiffeisen Banka A.D është pjesë e Raiffeisen Bank International

Group, i cili ofron shërbime bankare dhe financiare universale përmes disa filialeve në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Raiffeisen Bank International Group është aktiv në Shqipëri, ku operon përmes filialeve të tij, Raiffeisen Bank Albania SHA dhe Raiffeisen Leasing SHA

Raiffeisen Bank Albania SHA, është një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e saj, sipas licencës bankare të lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Raiffeisen Bank Albania SHA është një nga bankat kryesore në tregun e shërbimeve bankare në Shqipëri.

Raiffeisen Leasing SHA është një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: veprimtari qeraje financiare, kredidhënie, etj. Raiffeisen Leasing SH.A është shoqëria më e madhe në tregun e shërbimeve të qerasë financiare (leasing) në vend.

Pala shitëse: *Credit Agricole S.A*, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Francez, me aktivitet të kryer: koordinimi dhe kontrolli i institucioneve të kreditit, të centralizimit reciprok të kredisë bujqësore dhe menaxhimin e tepricës së depozitave dhe kursimeve të bankave rajonale të financimit reciprok të Credit Agricole.

Target: *Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad*, është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit të Serbisë, me objekt aktiviteti: Operim në sektorin financiar dhe bankar dhe ofrimi shërbimeve bankare, sipas ligjeve të Serbisë. Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad zotëron tërësisht filialin CA Leasing Srbija d.o.o, Beograd.

CA Leasing Srbija d.o.o, Beograd, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit të Serbisë, me objekt aktiviteti: Operimin në sektorin e leasing sipas ligjeve të Serbisë.

Shoqëria Credit Agricole S.A dhe asnjë prej filialeve të saj nuk operon dhe nuk është aktive në Shqipëri.

Ndërmjet shoqërisë Credit Agricole S.A dhe shoqërisë Raiffeisen Banka A.D. është nënshkruar dokumenti “Marrëveshje e shitblerjes në lidhje me aksionet në kapitalin e Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad”, nëpërmjet të cilës, shoqëria Raiffeisen Banka A.D do të bëhet zotërues i 100% i aksioneve të zakonshme tek shoqëria Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad dhe indirekt tek filiali i saj, shoqërinë CA Leasing Srbija d.o.o, Beograd.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad dhe kontrollit indirekt të shoqërisë CA Leasing Srbija d.o.o, Beograd nga shoqëria Raiffeisen Banka A.D, transaksion i cili plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare, por duke qenë se

transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Credit Agricole Srbija a.d. Novi Sad nga shoqëria Raiffeisen Bank A.D, pjesë e Raiffeisen Bank International Group, i cili ofron shërbime bankare dhe financiare universale përmes filialeve në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Raiffeisen Bank International Group është aktive në Shqipëri në tregun e shërbimeve bankare nëpërmjet Raiffeisen Bank Albania SHA dhe tregun e qerasë financiare (leasing) nëpërmjet Raiffeisen Leasing SHA.

Credit Agricole Srbija a.d. Novi Sad nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Shqipërisë

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje të tregjeve ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Credit Agricole Srbija a.d Novi Sad nga shoqëria Raiffeisen Banka A.D.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 844, datë 27.10.2021

“Mbi mospranimin e ankesës së ITD SHPK për ndryshimin e VKK nr. 814/2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i ankesës së ndërmarrjes ITD SHPK kundrejt VKK nr. 814/2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 40, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes ITD SHPK kundrejt VKK nr. 814/2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 814, datë 2.09.2021, “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”, ka vendosur:

“I. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimeve Publike që:

1. *Të udhëzojë autoritetet kontraktore të mos vendosin kritere përjashtuese në DST si autorizimin e prodhuesit/distributorit, duke krijuar barriera dhe pengesa në hyrje në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojëra.*
2. *Të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në lidhje me barrierat rregulluese të konkurrencës të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrative në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojëra.”*
2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankesë shoqëria ITD SHPK (këtu e në vijim referuara si Ankuesi), nëpërmjet shkresës së sajë nr. 292 prot., datë 20.09.2021, me lëndë “Ankesë kundër Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 814, datë 02.09.2021” (protokolluar pranë AK me nr. 41/23 prot, datë 21.09.2021), duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi.
3. VKK nr. 814/2021, “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”, ka për objekt vlerësimin e ankesës së shoqërive M&D SHPK, Interlogistic SHPK, Mond Office SHPK, Adastra SHPK, Adenis Kastrati PF dhe Europrinty Group SHPK, lidhur me vendosjen në DST të kriterit të kualifikimit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, në procedurat e prokurimit publik me objekt “Blerje Tонера/ bojëra”, si një kriter kufizues për konkurrencën në këtë treg.
4. Kjo VKK ka dalë në bazë dhe në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, duke patur si synim dhënien e rekomandimeve APP-së me qëllim shmangien e barrierave dhe pengesave në hyrje në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojëra për mirëfunksionimin e këtij tregu.
5. Konkretisht dispozitivi i këtij Vendimi i drejtohet APP-së si insitucioni kompetent që verifikon respektimin e detyrimit për përcaktimin e kërkesave për kualifikim, të cilat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Objekt i këtij vendimi nuk është sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e prokurimit publik të tonerave/bojërave, emrat e të cilëve evidentohen në pjesën argumentuese të tij. Informacioni i grumbulluar gjatë monitorimit mbi mënyrën e funksionimit dhe operimit të këtij tregu, por jo vetëm, ka ndihmuar në vlerësimin e objektit të ankesës së paraqitur.
6. Vendimarrja e KK synon mirëfunksionimin e tregut, duke dhënë rekomandimet përkatëse për APP-në, rekomandime të cilat konsistojnë në shmangien e barrierave dhe pengesave të panevojshme në hyrje në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojëra, si kriteri i autorizimit të prodhuesit/distributorit, në mbrojtje të interesit të përgjithshëm, gjë e cila nuk prek interesat e ligjshme të asnjë subjekti të përfshirë në këto procedura. Ky konkluzion i AK-së mbështetet edhe nga vendimi interpretues i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 572/2021, datë 03.09.2021 , sipas të cilit KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të heq kërkesën për autorizimin e prodhuesit/distributorit dhe të mbështetet në elementë të tjerë siç është parashikuar

në ligjin e ri për prokurimin publik për garantimin e synimit të cilësisë së mallrave objekt prokurimi.

Shqyrtimi i pranueshmërisë së ankimit:

7. Referuara pikës 2, të nenit 136 “Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent” të KPrA-së, *organi publik kompetent fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar*. Në zbatim të këtij neni, hapi i parë që ndiqet nga organi kompetent në rastin e një ankimi është shqyrtimi/vlerësimi nëse ankimi është i pranueshëm apo jo dhe kur ankimi konsiderohet i pranueshëm atëherë organi kompetent duhet të vazhdojë procedurën e ankimit dhe të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ.
8. Për të vlerësuar nëse ankimi ndaj vendimit nr. 814/2021 të Komisionit të Konkurrencës është i pranueshëm apo jo, i referohemi së pari përcaktimeve të ligjit të posaçëm. Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
9. Duke qenë se VKK nr. 814/2021 ka dalë në bazë dhe në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, në këtë rast zbatohen rregullat e përgjithshme mbi procedurat administrative të sanksionuara në Kreun II të tij, konkretisht në pikën 1 të nenit 40 “Ankimi ndaj vendimeve” ku përcaktohet se: *“Kundër vendimeve të Autoritetit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit”*.
10. Sa më sipër ligji i posaçëm nr. 9121/2003 parashikon të drejtën për t’u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, ndaj vendimeve të Komisionit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit, duke bërë përjashtim nga rregulli i përcaktuar në KPrA për ankimin administrativ brenda të njëjtit afat 30 ditor¹. Në këto kushte ankimi i paraqitur nuk plotëson kushtin e pranimit të ankimit sipas gjermës a) të nenit 135 të KPrA-së, sipas të cilit ankimi është i pranueshëm *nëse nuk është i përjashtuar shprehimisht me ligj*. Po sipas këtij neni (gjërma b), ankimi pranohet nëse ankuesi legjitimohet në bazë të nenit 128 të KPrA-së.
11. Konkretisht sipas nenit 128, pika 1, të KPrA-së, një ankim është i pranueshëm *kur ankuesi legjitimohet si palë në një procedurë administrative*. Përkufizimi i Palës në një procedurë administrative, jepet në nenin 3, pika 7, si dhe nenin 33 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
12. Në interpretim të këtyre dispozitave, duke qenë se: - *procedura e ndjekur nga AK për vlerësimin e ankesës lidhur me kriterin e kualifikimit për paraqitjen e autorizimit të*

¹ Neni 132, pika 1, e KPrA-së për cakton se: “Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ”.

prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, në procedurat e prokurimit publik me objekt “Blerje Tонера/ bojëra”, nuk ka filluar me kërkesë të ndërmarrjes ITD SHPK; - procedura e ndjekur nuk ka për objekt vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes ankuese në fjalë ITD SHPK dhe për më tepër ndaj kësaj ndërmarrjeje nuk është ndërmarr asnjë veprim procedural; - vendimi nr. 814/2021 i Komisionit të Konkurrencës nuk i drejtohet ndërmarrjes ankuese si dhe nuk çënon interesat e ligjshme të saj, pasi ky vendim synon shmangien e barrierave dhe pegesave të panevojshme në treg me qëllim rritjen e konkurrencës; ndërmarrja ITD SHPK nuk ka legjitimitet si palë në procedurën e ndjekur në kuptim të pikës 1 të nenit 33 të KPrA-së. Kjo ndërmarrje do të përfshihej si palë në këtë procedurë, në kuptim të pikës 3, të këtij neni vetëm nëse ky pozicion do ti jepej/njihej asaj, me kërkesë apo kryesisht, nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë zhvillimit të procedurës, si dhe nëse do të vlerësohej mundësia e cënimit të të drejtave ose interesave të ligjshme të kësaj ndërmarrjeje, gjë e cila nuk ka ndodhur.

13. Sa më sipër, Ankuesi ITD SHPK nuk ka legjitimitet në përputhje me nenin 128 të KPrA-së, duke mos plotësuar kushtet e pranimit të ankimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) dhe f), nenin 26 dhe 40 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- I. Mospranimin e ankesës së ndërmarrjes ITD SHPK kundrejt VKK nr. 814/2021, “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes ankuese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 845, Datë 16.11.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRIA STELLANTIS N.V DHE SHOQËRIA WONDERFUL STARS PTE.LTD.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Stellantis N.V dhe shoqëria Wonderful Stars Pte.Ltd.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Stellantis N.V dhe shoqëria Wonderful Stars Pte.Ltd.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Stellantis N.V dhe shoqëria Wonderful Stars Pte.Ltd.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për sipërmarrjen e përbashkët” palët janë:

Pala 1: Stellantis N.V, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e listuar publikisht në bursë, e organizuar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: aktivitete financiar. Stellantis N.V

është enti që rezultoi nga bashkimi ndërmjet Peugeot S.A dhe Fiat Chrysler Automobiles N.V, autorizuar nga Autoriteti i Konkurrencës me VKK nr.690, datë 28.04.2020 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Peugeot SA. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V”.

Stellantis N.V është shoqëria mëmë e Grupit të shoqërive Stellantis dhe nuk ka filiale, degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet distributorëve të pavarura, palë të treta.

Pala 2: Wonderful Stars Pte.Ltd, është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Singaporit, me objekt aktiviteti: shitja me shumicë e aparateve telefonikë dhe pajisje të tjera telekomunikacioni (p.sh. orë smart, kompjuter të veshur dhe libra elektronikë).

Wonderful Stars Pte.Ltd dhe Fih Mobile Limited, janë pjesë e Hon Hai Precision Industry Co.,Ltd, i cili është një prodhues global, lider i pjesëve dhe pajisjeve elektronike.

Pala 3: Fih Mobile Limited, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e listuar publikisht në bursë, e themeluar sipas legjislacionit të Ishujve Kajman. Fih Mobile Limited, është një shoqëri mbajtëse (holding company) investimesh kryesisht aktive në nivel ndërkombëtar në projektimin, zhvillimin, prodhimin, montimin dhe shërbimet që ofrohen pas shitjes për shoqëritë kompjuterike, shoqëritë e komunikimeve dhe pajisjeve elektronike të konsumatorëve.

Shoqëria mëmë e Fih Mobile Limited është shoqëria Foxconn (Far East) Limited Cayman.

Ndërmarrja e përbashkët (JV), Mobile Drive Netherlands B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez me objekt aktiviteti: aktivitet financiar.

Shoqëria Stellantis N.V. dhe Wonderful Stars Pte.Ltd, kanë rënë dakord të themelojnë sipërmarrjen e përbashkët, Mobile Drive Netherlands B.V. Pas përfundimit të marrëveshjes, JV do të zhvillojë ekrane dixhitale për automjete dhe shërbime të personalizuara të lidhura dhe synon të përshpejtojë afatet kohore të tregut për teknologjitë e përparuara të automjeteve të lidhura; do të konkurrojë për kontrata të programit global të automjeteve me Stellantis dhe kompani të tjera të industrisë së automjeteve; do të fokusohet në zhvillimin e platformës së infotainment, telematikës dhe shërbimit cloud me risi softuerike që pritet të përfshijnë aplikacione të bazuara në inteligjencën artificiale, komunikim 5G, shërbime të përmirësuara over – the – air, mundësi të tregtisë elektronike dhe integritet smart për ekranet dixhitale të automjeteve.

Pas mbylljes së këtij transaksioni, shoqëria Mobile Drive Netherlands B.V dhe filialet e saj do zotërohen 50% të aksioneve nga Wonderful Stars Pte.Ltd dhe 50% të aksioneve nga Stellantis N.V.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një shoqërie të përbashkët (joint venture) me funksione të plota nga shoqëria Stellantis N.V dhe shoqëria Wonderful Stars Pte.Ltd, duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg

përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu për sistemet e informacionit të drejtuesve të automjeteve dhe tregu për shërbimet cloud computing (IaaS/PaaS), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Stellantis N.V. nuk ka filiale, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri. Xhiroja e realizuar në tregun shqiptar është gjeneruar nëpërmjet një distributori të pavarur, palë e tretë. Foxconn Group dhe ndërmarrjet pjesë e marrëveshjes, nuk kanë asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri. Ndërmarrja e përbashkët J-V Mobile Drive Nederland B.V nuk operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Stellantis N.V dhe shoqëria Wonderful Stars Pte.Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 846, Datë 16.11.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBCHROME HOLDING SHPK DHE FILIALEVE TË SAJ NGA SHOQËRIA YILDIRIM INTERNATIONAL MINING INVESTMENTS B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfhtimin e kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh”, palët janë:

Pala blerëse: **Yildirim International Mining Investments B.V.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Hollandës. Yildirim BV është themeluar si një Ndërmarrje me Qëllim të Veçantë dhe kryen aktivitet tregtar si një shoqëri holding. Yildirim BV zotërohet në mënyrë indirekte nga Yildirim International Investments Holding B.V., pjesë e Grupit Yildirim.

Grupi Yildirim operon në një numër të madh industrish si: metalurgji dhe miniera, qymyre dhe koks, energji, plehra kimike/fertilizues dhe kimikate, menaxhim porti, transport, logjistik etj.

Grupi Yildirim nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Pala shitëse: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të veprimtarisë: investimi në instrumente financiare; investime në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të tretë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe të mos alternojnë objektin parësor të veprimtarisë së shoqërisë.

Target: Albchrome Holding SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: menaxhimi, aktivitetet mbështetëse për industrinë e minierave, shërbimet për mineralet jo-metalike etj. Shoqëria zotërohet tërësisht nga Balkan Finance Investment Group SHPK.

Albchrome Holding SHPK është e angazhuar në biznesin e kontrollit të interesit në kapitalin e dy Filialeve, të cilat i zotëron plotësisht:

Albchrome SHPK, është prodhuesi më i madh i kromit dhe ferrokromit në Shqipëri, i cili operon nëpërmjet dy kontratave të koncesionit; atë të ndërtimit, operimit dhe transferimit të uzinës së ferrokromit në Elbasan dhe minierat e kromit të Përrenjasit e Pojskës, si dhe kontrata e koncesionit për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit dhe të uzinës së ferrokromit Burrel.

Vllahen Mining SHPK operon në fushën e xeheror-kromit në Has, Shqipëri.

Më datë 15 tetor 2021, shoqëritë Yildirim International Mining Investments B.V., dhe Balkan Finance Investment Group SHPK kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerje aksionesh”, ku shitësi shet aksionet e shoqërisë target e filialeve të zotëruara prej saj, dhe blerësi blen aksione me efekt që nga Data e Mbylljes së marrëveshjes.

Në përfundim të transaksionit, Yildirim International Mining Investments B.V. do të fitojë kontrollin direkt mbi shoqërinë Albchrome Holding SHPK dhe kontroll indirekt mbi Filialet e saj, shoqëritë Albchrome SHPK dhe Vllahen Holding SHPK, të cilat do të bëhen anëtare të Grupit Yildirim.

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Albchrome Holding SHPK është një shoqëri e angazhuar në biznesin e kontrollit të interesit në kapitalin e shoqërisë Albchrome SHPK, e cili operon në tregun e nxjerrjes e përpunimit të xeherorit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit në uzinën e ferrokromit në Elbasan, Bulqizë e Burrel dhe shoqërisë Vllahen Mining SHPK, e cila operon në nxjerrjen e xeherorit të kromit në Has, Shqipëri.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe tregu i prodhimit të ferrokromit. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria zotëron pasuri të xeherorit të kromit dhe është prodhues i ferrokromit me karbon të lartë. Referuar të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për vitin 2020, rezultoi se, janë pajisur me leje të shfrytëzimit të xeherorit të kromit 261 subjekte nga të cilat 77 nuk janë aktive dhe prodhimi nxjerrës i xeherorit të kromit për këtë vit ka qenë 626,627 ton nga të cilat shoqëria Albchrome SHPK ka realizuar një prodhim prej 100,817 ton metrik xeheror duke mbajtur 16.1 % të tregut të përgjithshëm të prodhimit të xeheror kromit.

Në tregun e prodhimit të ferrokromit, prodhimi i përgjithshëm për vitin 2020 ka qenë 53,544 ton nga të cilat 63.7% janë realizuar nga Albchrome SHPK, dhe pjesa tjetër nga i vetmi konkurrent në vend, GSA SHPK.

Në përgjithësi, Shqipëria është një lojtar i vogël në tregun global, me pjesë tregu 0.5-1% dhe duke qenë se tregu i brendshëm ka një nevojë të ulët për këtë produkt, minerali i kromit dhe prodhimi i ferrokromit eksportohen jashtë vendit.

Me përfundimin e Transaksionit, Grupi Yildirim do të bëhet indirekt pronar i 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë Target dhe Filialeve të tij. Grupi Yildirim nuk është prezent në Shqipëri dhe transaksioni i propozuar do të mbajë të pandryshuar mjedisin aktual konkurrues.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 847, Datë 16.11.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EUROPCAR MOBILITY GROUP S.A NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG S.A DHE TRINITY INVESTMENTS DESIGNATED ACTIVITY COMPANY.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A dhe Trinity Investments Designated Activity Company.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A dhe Trinity Investments Designated Activity Company.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfthimin e kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A dhe Trinity Investments Designated Activity Company

Referuar dokumentit “Kontratë Kuadër Transaksioni”, palët janë:

Pala 1: Volkswagen Finance Luksemburg S.A është një shoqëri aksionare, e themeluar, sipas ligjeve të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: pjesëmarrje në shoqëri vendase dhe të huaja, ose në shoqëri të çfarëdo lloji, si dhe të menaxhojë këto pjesëmarrje, të marrë pjesë në krijimin, zhvillimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e çdo shoqërie ose ndërmarrje, etj.

Volkswagen Finance Luksemburg S.A, zotërohet tërësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft dhe është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.

Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Shoqëria gjithashtu mund të krijojë degë brenda dhe jashtë vendit, të themelojë ose të blejë shoqëri të tjera ose të marrë pjesë/ investojë në shoqëri të tilla. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Volkswagen. Group.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, dhe me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Pala 2: Trinity Investments Designated Activity Company, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Irlandës, me aktivitet të përcaktuar në përputhje me ligjin irlandez “Për shoqëritë Tregtare”. Trinity Investments Designated Activity Company është një shoqëri mbajtëse (holding company), e themeluar me qëllim për të investuar veçanërisht në shoqëritë që janë në fazën e rritjes dhe rastet e ristrukturimit.

Pala 3: Pon Holdings B.V, është një shoqëri e themeluar, sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: Aktivitet financiar, ofrim i burimeve njerëzore(nuk ka projekte punësimi).

Pala 4: Green Mobility Holding S.A (Bid Co), është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: pjesëmarrëse në shoqëri vendase dhe të huaja, ose në shoqëri të çfarëdo lloji, si dhe të menaxhojë këto pjesëmarrje. Shoqëria mund të blejë aksione, kuota dhe tituj të tjerë, obligacione të pasiguruara, certifikata depozite dhe instrumente të tjera borxhi përmes nënshkrimit, blerjes, këmbimit, dhe në përgjithësi të gjithë titujt dhe instrumentet financiare që emetohen nga subjekte ligjore publike ose private, etj.

Volkswagen Aktiengesellschaft përmes filialit të tij Volkswagen Finance Luksemburg S.A krijoi shoqërinë Green Mobility Holding. Qëllimi i vetëm kësaj shoqërie do të jetë mbajtja e aksioneve të Europcar Mobility Group.

Pala 5: Attestor Value Master Fund LP, është një partner i kufizuar i themeluar sipas ligjeve të ishullit Kaiman, Island (garantor i shoqërisë Trinity Investments Designated Activity Company).

Target: Europcar Mobility Group S.A., është një shoqëri aksionare, sipas legjislacionit Francez, me objekt aktiviteti: çdo blerje aksionesh ose interesash në ndonjë person juridik francez ose të huaj, si dhe çdo aktivitet që ka të ngjarë të kryhet nga një shoqëri holding – ku shoqëria merr pjesë, me çdo mjet, në çdo operacion që mund të lidhet me qëllimin e saj ose nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja, etj, në kuptim të nenit L 511-7 i njohur si Kodi Monetar dhe Financiar.

Europcar Mobility Group S.A, nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri.

Referuar “Kontratë Kuadër Transaksioni”, të lidhur më datë 28 korrik 2021, palët dëshirojnë të blejnë të gjitha aksionet e Europcar Mobility Group dhe dëshirojnë të kryejnë transaksionin e propozuar përmes një oferte blerje vullnetare të dorëzuar përmes shoqërisë Green Mobility Holding, të përcaktuar në këtë kontratë.

Palët kanë rënë dakort që Trinity Investments Designated Activity Company dhe Pon Holdings B.V, të bëhen aksionar të shoqërisë Green Mobility Holding S.A (Bid Co), pasi të jenë marrë të gjitha miratimet antitrust që kërkohen për Transaksioni i propozuar. Pas mbylljes së marrëveshje Volkswagen Finance Luxemburg S.A do zotërojë 66% të aksioneve, Trinity Investments Designated Activity Company do të zotërojë 27% të aksioneve dhe Pon Holdings B.V do të zotërojë 7% të aksioneve në shoqërinë Green Mobility Holding S.A.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të Europcar Mobility Group S.A nga shoqëria Volkswagen Finance Luxemburg S.A dhe Trinity Investments Designated Activity Company, duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i dhënies me qira të automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Volkswagen Finance Luxemburg SA është një shoqëri Holding e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, të cilët janë aktive në tregun e shitjes së automjeteve dhe në veprimtarinë e qirasë financiare dhe agjentit në sigurime.

Trinity nuk ka asnjë investim në sektorin e marrjes me qira të makinave. Trinity nuk ka asnjë filial, dege apo zyrë përfaqësimi dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri

Europcar nuk ka një filial të regjistruar në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dh për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A dhe Trinity Investments Designated Activity Company.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 848, Datë 03.12.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA ENERGY CITY DEVELOPMENT COMPANY DHE COLOUR PATH HOLDINGS LIMITED.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited.

Referuar “Marrëveshjes së ortakëve ndërmjet Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited”, palët në kontratë janë:

Pala 1: Energy City Development Company është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e

regjistruar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Shoqëria Energy City Development Company është zhvillues i projektit King Salman Energy Park (SPARK), e cila është një zone e re e zhvilluar industriale që përfshin një zonë industriale, një port tokësor dhe zonën logjistike të lidhur me të, një zonë tregtare, qendra trajnimi dhe investime rezidenciale dhe aktivitete tregtare në Arabinë Saudite.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri, por gjeneron të ardhura përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

Pala 2: Colour Path Holdings Limited, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të British Virgin Islands dhe me adresë në Hong Kong. Shoqëria Colour Path Holdings Limited zotërohet indirekt nga shoqëria Hutchinson Port Investments Limited, pjesë e Hutchison Ports Group një shoqëri lider në zhvillimin dhe operimin e terminaleve të kontenierëve dhe ofrues i shërbimeve logjistike të lidhura me to. Hutchison Ports Group është një divizion operativ i CK Hutchison Holdings Limited, një konglomerat multinacional me seli në Hong Kong.

CK Hutchison Holdings Limited nuk ka një prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri, ajo realizon xhiro në Shqipëri përmes (i)dyqaneve Rossman.

Ndërmarrja e përbashkët (JV), Energy City Logistics Company, do të themelohet në Al Khoba, Mbretëria e Arabisë Saudite dhe do të jetë aktive në zhvillimin, marketimin, operimin dhe mirëmbajtjen e portit tokësor dhe zonën logjistike të lidhur me të në (SPARK) dhe shërbime të tjera logjistike në Arabinë Saudite.

Pas themelimit të shoqërisë Energy City Logistics Company (JV), shoqëria Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited do të kenë një kapital fillestar nga i cili, Energy City Development Company do të zotërojë 51% të aksioneve në (JV) dhe Colour Path Holdings Limited do të zotërojë 49% të aksioneve në (JV) dhe secila prej palëve do të ushtrojë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Energy City Logistics Company /JV.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një shoqërie të përbashkët (joint venture) me funksione të plota nga Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited, duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet konsiderohet tregu i zhvillimit, marketimit, operimit dhe mirëmbajtjes së portit tokësor dhe zonës logjistike të lidhur me të, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV), nga shoqëria Energy City Development Company dhe shoqëria Colour Path Holdings Limited.

Energy City Development Company është një shoqëri e zotëruar tërësisht nga shoqëria Saudi

Arabian Oil Company, e cila nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri, por ajo gjeneron xhiro në tregun e produkteve të naftës dhe derivateve të saj.

Colour Path Holdings Limited është pjesë e grupit CK Hutchison Holdings Limited, e cila nuk ka një prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri, por ajo realizon xhiro në Shqipëri nëpërmjet rrjetit të dyqaneve Rossman.

Shoqëria, J-V, Energy City Logistics Company do të ushtrojë aktivitetin tregtar për shërbimet në zonën King Salaman Energy Park (SPARK), vetëm në Arabinë Saudite.

Transaksioni i synuar është një përqendrim konglomerat, i cili nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Energy City Development Company dhe Colour Path Holdings Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 849, Datë 03.12.2021

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRIA SKY UK LIMITED DHE SHOQËRIA PARAMOUNT PICTURES INTERNATIONAL LIMITED”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Sky UK Limited dhe shoqëria Paramount Pictures International Limited

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Sky UK Limited dhe shoqëria Paramount Pictures International Limited.

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Sky UK Limited dhe Paramount Pictures International Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje investimi për sipërmarrje të përbashkët”, e lidhur më datë 16 gusht 2021, palët në marrëveshje janë:

Pala 1: Sky UK Limited është një shoqëri e themeluar në Angli dhe Uells, me objekt aktiviteti: kompani transmetuese dhe telekomunikacioni britanike që ofron shërbime televizive dhe internet me brez të gjerë, shërbime të linjës fikse dhe të telefonisë celulare për konsumatorët dhe bizneset në Mbretërinë e Bashkuar.

Sky UK Limited zotërohet tërësisht nga Comcast Corporation, e cila është një shoqëri publike amerikane, një media globale, kompani teknologjike dhe argëtuese. Comcast operon përmes tre bizneseve të saj: (i) Comcast Cable, (ii) NBCUniversal dhe (iii) Sky.

Sky UK Limited nuk është aktive në Shqipëri, por realizon të ardhura minimale nëpërmjet veprimtarisë së shitjes së produkteve dhe shpërndarjen e filmave nga NBCUniversal, një biznes i medias dhe argëtimi, aktivitetet e së cilës përfshijnë: prodhimin, shitjen dhe distribuimin e filmit dhe përmbajtjes audio-vizive nën brandet Universal Pictures, Illumination, DreamWorks Animation dhe Focus Features. Shitja e filmave të para-prodhuar realizohet kryesisht nëpërmjet platformave Netflix, Amazon, si dhe disa shitje të tjera më të vogla në Google dhe Top Chanel.

Pala 2: Paramount Pictures International Limited është një shoqëri e themeluar në Angli dhe Uells, me objekt aktiviteti: prodhim dhe shpërndarje argëtimi nëpërmjet filmave. Kompania gjithashtu ofron shpërndarje të DVD-ve dhe disqeve blu-ray për filma dhe shfaqje televizive. Paramount operon në mbarë botën.

Paramount Pictures International Limited, është pjesë e grupit të kryesuar nga shoqëria ViacomCBS Inc, e cila është një shoqëri globale amerikane e listuar në tregun e medias dhe argëtimit.

ViacomCBS ka aktivitet të kufizuar në Shqipëri nëpërmjet shitjes dhe shpërndarjes së përmbajtjes audio-vizive (AV) dhe filmit nën brandet e Paramount dhe Miramax; furnizimit me shumicë të kanaleve televizive, nën brandet Comedy Central, Nickelodeon dhe MTV.

Ndërmarrja e përbashkët JVCo është shoqëria përmes së cilës investitorët do të vendosin pronësinë e tyre të barabartë (aksionet JVCo do të jenë aksionet e Sky UK Limited dhe të Paramount Pictures International Limited), e cila do të inkorporohet nga investitorët në Angli dhe Uells sipas dispozitave të “Marrëveshjes së investimit për sipërmarrjen e përbashkët”.

Palët kanë rënë dakord të krijojnë një sipërmarrje të përbashkët ndërmjet tyre, për të nisur dhe operuar një shërbim SVOD dhe për të vënë në dispozicion kanale të caktuara lineare në territoret e sipërmarrje së përbashkët. Palët do të nënshtrohen kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, për të përfshirë shoqërinë e re, JVCo, të inkorporohet nga investitorët në Angli dhe Uells në përputhje me dispozitat e “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët”, datë 16 gusht 2021.

Në lidhje me transaksionet e parashikuara në Marrëveshje, palët dhe/ose anëtarë të grupeve të tyre përkatëse kanë hyrë ose do të hyjnë në procedurën e përpilimit të Marrëveshjeve të Sipërmarrjes së Përbashkët, Aktin e Themelimit, Letrat e Abonimit, Marrëveshjen e Transferimit të Aseteve, Marrëveshje Tregtare dhe çdo Marrëveshje Tjetër të lidhur në përputhje me “Marrëveshjen e investimit për sipërmarrje të përbashkët”, datë 16 gusht 2021.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksione të plota nga shoqëria Sky UK Limited dhe shoqëria Paramount Pictures International Limited, duke plotësuar kriteret e neneve 10 dhe 12 të ligjit 9121/2003 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, i ndryshuar.

Vlerësimi i Konkurrencës

Sipas praktikave të mëparshme në tregje të tilla, Komisioni Evropian ka identifikuar aktivitete të ndryshme në zinxhirin e shitjeve audio-vizive: 1) tregu (i sipërm) i prodhimit dhe furnizimit me përmbajtje AV (duke përfshirë furnizimin e përmbajtjeve televizive të para-prodhuara dhe përmbajtje të nën-kontraktuara; 2) tregu (i ndërmjetëm) për furnizimin me shumicë të kanaleve televizive; dhe 3) tregu i (poshtëm) për furnizimin me pakicë të shërbimeve televizive për konsumatorët fundor.¹

JV nuk do të jetë aktiv në tregun e sipërm, të prodhimit dhe furnizimit me përmbajtje AV, por do të operojë vetëm në nivelet me shumicë dhe pakicë të zinxhirit të shitjeve audio-vizive.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit, i prekur nga transaksioni, do të konsiderohet tregu i furnizimit me shumicë të kanaleve televizive dhe furnizimit me pakicë të shërbimeve televizive, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit mund të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Ndërmarrje të përbashkët, joint-venture, me funksione të plota e krijuar nga shoqëria Sky UK Limited dhe shoqëria Paramount Pictures International Limited, do të funksionojë kryesisht në nivelin e shitjes për konsumatorët, pra në nivelin e poshtëm të zinxhirit të shitjeve në sektorin audio-vizive të tregut, një treg në të cilin ka natyrshëm konkurrencë të fortë dhe në rritje nga ofrues të tjerë të OTT² si Netflix dhe Amazon, të cilët transmetohen direkt te konsumatorët ose përmes platformave Multichannel Video Programming Distributor (MVPD). ViacomCBS nuk është aktiv në nivelin e shitjes për konsumatorët në Shqipëri dhe Comcast/Sky ka vetëm aktivitete minimale në Shqipëri. Prandaj, transaksioni i propozuar nuk krijon ndonjë treg të prekur në nivelin e shitjes për konsumatorët.

Ndërmarrje të përbashkët (JV) do të jetë aktive gjithashtu edhe në nivelin e ndërmjetëm të zinxhirit të shitjeve për sektorin audio-viziv, përmes shpërndarjes me shumicë, përfshirë dhe Shqipërinë. Prandaj, kjo konsiderohet si një mbivendosje horizontale edhe pse kanalet televizive do të mbeten të kontrolluara nga Partnerët dhe JV do të veprojë vetëm si një ndërmjetësues për shitje në lidhje me to. Pjesa e tregut në fjalë është më pak se 15%, si rrjedhojë nuk do të ketë tregje të prekura horizontalisht në nivelin e shitjes me shumicë.

Lidhur me marrëdhëniet vertikale, secili nga Partnerët në JV është aktiv në tregun e sipërm për licensimin e përmbajtjes audio-vizive dhe në furnizimin me shumicë të kanaleve TV, ndërsa JV do të jetë aktiv në tregun e poshtëm, për blerjen dhe për furnizimin me pakicë të përmbajtjes audio-

¹Burimi: Vendimi i Komisionit Evropian të Konkurrencës, datë 7 prill 2017 për Rastin M.8354 Fox/Sky.

² OTT= Over the top (shpërndarja e përmbajtjeve bëhet nëpërmjet internetit)

vizive.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje të tregjeve ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Sky UK Limited dhe shoqëria Paramount Pictures International Limited
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 850, Datë 03.12.2021

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË NGA SHOQËRIA
EUROSIG SHA.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga shoqëria Eurosigs SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga shoqëria Eurosigs SHA.

VËREN SE :

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfhtimin e kontrollit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga shoqëria Eurosigs SHA.

Referuar “Kontratë për shitblerjen e aksioneve” të lidhur më datë 08 korrik 2021, palët janë:

Pala blerëse: Eurosigs SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: “sigurimet në dëme”, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe

risigurime”, i ndryshuar, si dhe autorizimin e lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë.

Pala shitëse: Banka Islamike për Zhvillim është një institucion financiar ndërkombëtar, i regjistruar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, me objekt aktiviteti: pranimi i depozitave dhe shtimi i fondeve; marrja pjesë në kapitalin e projekteve prodhuese dhe sipërmarrjeve në vendet anëtare; dhënie hua ndaj sektorëve privatë dhe publikë për financimin e projekteve të tyre; investime në projekte të infrastrukturës ekonomike dhe sociale në vendet anëtare nëpërmjet pjesëmarrjes ose me marrëveshje të tjera financiare etj.

Target: Banka e Bashkuar e Shqipërisë është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari financiare dhe bankare.

Ndërmjet shoqërisë Banka Islamike për Zhvillim (shitësi) dhe shoqërisë Eurosig SHA (blerësi), është lidhur “Kontratë për shitblerjen e aksione”, ku palët kanë vendosur të respektojnë kushtet dhe afatet e detyrimeve përkatëse për të shitur dhe blerë 30% të aksioneve të Bankës së Bashkuar së Shqipërisë.

Në përfundim të transaksionit, Banka Islamike për Zhvillim do të zotërojë 42.204%, shoqëria Eurosig SHA, do të zotërojë 51.017% dhe pjesa tjetër do të zotërohet nga individë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga shoqëria Eurosig SHA. Ky transaksion ka marrë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë¹.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Aktualisht në sektorin bankar në Shqipëri operojnë 12 banka të nivelit të dytë me kapital të huaj dhe shqiptar. Tregu bankar në Shqipëri ka karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqendruar, pa praninë e bankave me pozitë dominuese.

Para përqendrimit, pjesët e tregut të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sipas aseteve, depozitave dhe kredive janë në vlerat 0.6-1%. Duke qenë se Eurosig SHA nuk operon në tregun e shërbimeve bankare dhe nuk gjeneron të ardhura në këtë treg, transaksionit i synuar nuk do të sjellë ndryshim të strukturës së tregut. Pjesa e tregut të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë do të mbetet në nivelin 0.6-1%.

¹ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 28, datë 2.6.2021, “Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga shoqëria “Eurosig” sh.a. të 21.02 për qind të kapitalit aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”

Si rrjedhojë, transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në Shqipëri. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim strukturën e tregut të shërbimeve bankare.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga shoqëria Eurosig SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.
3. Monitorimin e sjelljes së shoqërisë Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, për një periudhë 1 vjeçare nga data e marrjes së këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 851, Datë 03.12.2021

“Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Relacion “Mbi vlerësimin e shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me mungesën e konkurrencës në procedurat e prokurimit për mirëmbajtjen e aparaturave, kryesisht të XXX”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me mungesën e konkurrencës në procedurat e prokurimit për mirëmbajtjen e aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore”,

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me nr. 116 prot, datë 14.09.2021, protokolluar me tonën nr. 420 prot., datë 15.09.2021, lidhur me mungesën e konkurrencës në procedurat e prokurimit për mirëmbajtjen e aparaturave, kryesisht të XXXX të XXXX.
2. Nga vlerësimi i këtij rasti, rezulton se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat

prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator, konstatim i cili ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti Kontraktor. Vendosja e këtyre kriterëve, në respektim të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.

3. Referuar në nenin 3, pika 2 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sanksionohet qartë detyrimi që kanë autoritetet dhe entet kontraktore për të mos shmangur fushën e zbatimit të këtij ligji dhe për të mos ngushtuar/kufizuar në mënyrë artificiale konkurrencën. *Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
4. Në zbatim të nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomikë *duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar* që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
5. Gjithashtu në nenin 93 “Sigurimi i konkurrencës” të VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sanksionohet se: *Autoriteti/enti kontraktor duhet të marrë masa të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe konkurrencë të drejtë në procedurat e prokurimit.*
6. Ligji dhe rregullat e prokurimit mbështeten në parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve ose kandidatëve, si dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, dhe kanë për qëllim të nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre. Agjencia e Prokurimit Publik administron dhe mbikëqyr sistemin e prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efikasitetit e transparencës në procesin e prokurimit publik.
7. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka vlerësuar në vazhdimësi barrierat rregulluese të konkurrencës në tregjet e prokurimeve publike si dhe ka dhënë rekomandime përkatëse ligjore për mirëfunksionimin e këtij tregu, duke shmangur barrierat e panevojshme me qëllim rritjen e konkurrencës.
8. Referuar sa më sipër, Autoriteti kontraktor, duhet të vlerësojë rast pas rasti përcaktimin e kriterëve kualifikuese në DST, mbështetur në analiza konkrete të nevojave për mallra, punë apo shërbime dhe mundësisë që ka tregu për plotësimin e tyre. Vendosja e kriterëve për kualifikim në asnjë rast nuk duhet të jetë përjashtuese

duke kufizuar numrin e operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe duke sjellë si pasojë kufizimin e konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d, e f), nenin 26, nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Agjencisë se Prokurimeve Publike që:
 - Të udhëzojë autoritetet kontraktore të mos vendosin barriera dhe pengesa në hyrje në tregun e prokurimeve publike, nëpërmjet kriterëve të vendosura në DST.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 852, Datë 24.12.2021

“Për dhënie rekomandimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe dhënie detyrimi Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për rritjen e konkurrencës në ofrimin e shërbimit të auditimit ligjor”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie rekomandimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe dhënie detyrimi Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për rritjen e konkurrencës në ofrimin e shërbimit të auditimit ligjor.

Bazë ligjore: Neni 24, gërma d) e f), neni 26, neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi vlerësimin e kërkesës së Bashkimit Tregtar të Shqipërisë (BTSH) dhe Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë (BPSH) për rishikimin e vendimit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në kuadër të përcaktimit të tarifës minimale për auditim ligjor”;
- Shpjegimet e dhëna nga BTSH, BPSH, IEKA dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) në seancat dëgjimore të zhvilluara pranë AK-së më datë 10.11.2021, si dhe dokumentacionit shtesë të depozituar nga MFE, në vijim të seancës dëgjimore me shkresën nr. 280/11 prot, datë 17.11.2021, “Mbi seancën dëgjimore të organizuar në kuadër të “Kërkesë për rishikimin e vendimit të IEKA në kuadër të përcaktimit të tarifës minimale për auditim ligjor””.

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, nga Bashkimi Tregtar i Shqipërisë dhe Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë është paraqitur shkresa me nr. 146/1 prot, datë 26.05.2021, me

lëndë “Kërkesë për rishikimin e vendimit të IEKA në kuadër të përcaktimit të tarifës minimale për auditim ligjor”, nëpërmjet së cilës kërkohet ndërhyrja e AK për heqjen e tarifës orare minimale të auditimit prej 3,000 (tre mijë) lekësh, miratuar me vendimin nr. 80, datë 29.06.2011 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të IEKA.

2. Në vijim të procedurës së vlerësimit të kësaj kërke, bazuar në nenin 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, është kërkuar informacion shtesë nga Bashkimi Tregtar i Shqipërisë dhe Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar, si dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
3. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, më datë 10.11.2021 zhvilloi seanca dëgjimore me përfaqësues të MFE, BTSH, BPSH dhe IEKA, lidhur me vendimin e IEKA në kuadër të përcaktimit të tarifës minimale për auditim ligjor.
4. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit të administruar lidhur me ankesën e paraqitur rezulton se profesionet e Audituesit Ligjor (Ish Eksperti Kontabël i Regjistruar) dhe Kontabilistit të Miratuar, rregullohen me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar (ligji nr. 10091/2009).
5. Në kuadër të ligjit nr. 10091/2009 është krijuar Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur, si një organ kolegjal që realizon mbikëqyrjen publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, si drejtpërdrejt, ashtu edhe përmes mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA).
6. Në ligjin nr. 10091/2009 përcaktohet krijimi i IEKA si një organizim profesional, që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë organizimin e veprimtarisë së profesionit të audituesit ligjor dhe që organizohet si person juridik, në përputhje me këtë ligj dhe statutin e tij.
7. Sipas nenit 12 “Kompetencat e organizatës profesionale”, të ligjit nr. 10091/2009, IEKA ka për objekt të veprimtarisë të sigurojë ushtrimin e profesionit, në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.
8. Audituesi Ligjor është individ i miratuar nga autoritetet kompetente të mësipërme për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili kryen auditimin e pavarur të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera, kur auditimi detyrohet nga ligji, ose kërkohet në mënyrë vullnetare në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore.

9. Ligji nr. 10091/2009 parashikon dispozita për sigurinë e cilësinë e auditimeve, si nga ana e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, ashtu dhe nga vetë organizata profesionale e audituesve ligjor (IEKA), me qëllim shmangien e abuzimeve nga audituesit/shoqëritë audituese.
10. Në lidhje me përcaktimin e tarifave, në nenin 36 të ligjit nr. 10091/2009, ku flitet për rregullat e auditimit, citohet se rregullat për programin dhe kohën e punës përcaktohen në mënyrë që të sigurohet respektimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit, *duke i lënë mundësinë IEKA-s që për shërbimin e auditimit ligjor, t'i paraqesë bordit vetëm disa tregues, në lidhje me afatet kohore të auditimit ligjor*. Gjithashtu referuar nenit 33, pika 7, citohet përsëri se: *“Tarifa e auditimit ligjor nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi”*.
11. Sa më sipër ligji nr. 10091/2009 nuk përcakton të drejtën apo detyrimin e IEKA për të caktuar një tarifë minimale të detyrueshme për auditimin ligjor, por përkundrazi sipas këtij ligji tarifat e auditimit ligjor janë të lira për t'u negociuar me klientët që kërkojnë shërbimet e auditimit ligjor, pa u kushtëzuar në asnjë formë.
12. Ndyshe nga sa parashikohet më sipër në ligj, IEKA-s nëpërmjet Statutit të saj të miratuar me vendimin nr. 133, datë 27.12.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, si dhe vendimin nr. 125, datë 29.06.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, referuar nenit 15.2.18 dhe 15.2.19 të këtij Statuti, i jepet e drejta që nëpërmjet Këshillit Drejtues të saj:
- Të përcaktojë tabelat që do t'i paraqiten Bordit të Mbikëqyrjes Publike me treguesit në lidhje me afatet kohorë të auditimit ligjor (në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 10091/2009);
 - T'i paraqesë për miratim Asamblesë rregulla specifike lidhur me tarifën orare normale për kryerjen e auditimit ligjor.
13. Bazuar në këtë Statut IEKA, nëpërmjet shkresës së saj nr. 17 prot., datë 16.01.2017, njofton të gjithë Audituesit Ligjor se, referuar vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 80, datë 29.06.2011, *tarifa orare minimale* për auditimet ligjore do të vazhdojë të jetë në masën 3,000 lekë/orë punë.
14. Referuara materialit të publikuar nga IEKA me titull “Kujtesë 2021”¹, fq. 9, pika III “Afatet kohore të auditimit dhe tarifa orare e pagesës”, paragrafi i parë dhe i dytë: *“Audituesit Ligjor i ndalohet të zbatojnë tarifa të ulëta për qëllime të sigurimit të klientelës. Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve ka miratuar shumën prej 3,000 lekë/ora si tarifë normale orare për kryerjen e auditimit ligjor (Vendimi 29.06.2011). Tarifa orare normale për auditimet ligjore duhet të orientojë anëtarët AL në përcaktimin e honorareve gjatë misionëve të auditimit të Pasqyrave Financiare vjetore të entiteteve dhe duhet të shërbejë si një kufi minimum që ofrohet nga të gjithë anëtarët për shërbimin e auditimeve ligjore.”*

¹ <http://ieka.al/ep-content/uploads/2021/02/Kujtese-2021.pdf>

15. Sa më sipër tarifa orare për kryerjen e auditimit ligjor e përcaktuar nga IEKA shërben si një nivel minimal detyrues për të gjitha shërbimet e ofruara nga Audituesit Ligjor. E drejta e IEKA për përcaktimin e kësaj tarife minimale nuk parashikohet në ligjin e posaçëm nr. 10091/2009 sipas të cilit tarifat e auditimit ligjor nuk duhen kushtëzuar në asnjë formë (neni 33, pika 7). Nëpërmjet Statutit të saj të miratuar me vendimin nr. 133, datë 27.12.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, IEKA i ka dhënë vetes një të drejtë që nuk ja jep ligji, duke tejkaluar kompetencat e saj.
16. Liria e veprimtarisë ekonomike është një ndër të drejtat themelore kushtetuese, e cila kufizohet vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Lidhur me këto kufizime, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 12, datë 28.04.2009, ka konfirmuar se pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social. Në vendimin nr. 10, datë 19.03.2008, Gjykata Kushtetuese arsyeton se, nisur nga roli aktiv i shtetit, hartuesi i Kushtetutës ka parashikuar kriteret mbi bazën e të cilave ai mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e kësaj të drejte. Konkretisht, neni 11/3 i Kushtetutës parashikon se kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.
17. Referuar Dokumentit të Komisionit Evropian për Konkurrencën në Profesione të Lirë, (pikat 31, 32) citohet se: “Fiksimi i çmimit ose përcaktimi i çmimit minimal janë instrumente rregullatore me efekte negative për konkurrencën, duke reduktuar seriozisht përfitimet që tregjet konkurruese ofrojnë për konsumatorët [...]. Sipas disa shoqatave profesionale, çmimet fikse ofrojnë një mekanizëm për të siguruar çmime të ulëta”. Sipas të njëjtit dokument: “Teoria ekonomike sugjeron që, brenda një tregu konkurrues, rregullimi i çmimeve nuk ka gjasa të sigurojë çmime më të ulëta se nivelet konkurruese”. Referuar Dokumentit të Komisionit Evropian “Përparim nga Shtetet Anëtare në rishikimin dhe eliminimin e kufizimeve të Konkurrencës në fushën e Shërbimeve Profesionale” (pika 73), citohet se: “[...] duhen ndërmarrë veprime për të rishikuar veçanërisht në mënyrë kritike të gjitha çmimet fikse dhe minimale me qëllim heqjen e tyre kudo që të jetë e mundur [...]. Fiksimi i çmimeve nuk garanton cilësi, dhe mund të shërbejë për të penguar konkurrencën e shëndoshë midis ofruesve, dekurajuar eficientësinë, ose zhvillimin dhe futjen e shërbimeve inovative”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d) e f), nenin 26 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që, në Statutin e IEKA (miratuar me vendimin nr. 133, datë 27.12.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe vendimin nr. 125, datë 29.06.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve) të hiqet pika 15.2.19.

2. Detyrimin e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar që të mos vendosë tarifa për ofrimin e shërbimit të auditimit ligjor, duke mos imponuar praktika të njëjta në çmime, por duke i lënë ato të lira për t'u negociuar midis ofruesit të shërbimit dhe klientëve, me qëllim sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe efektive në ofrimin e këtij shërbimi, në zbatim të ligjit nr. 10091/2009 dhe ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 853, Datë 24.12.2021

“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d, neni 26, neni 43, pika 5, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve; dhe,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar.

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 719, datë 28.10.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, të ndryshuar, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

2. Referuar konkluzioneve të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 804, datë 04.06.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve, për periudhën kohore nga 1 Janari 2017 deri në 30 Tetor 2020.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet koncesionare Romano Port SHA, Porti MBM dhe Petrolifera Italo Albanese (PIA), si dhe ndërmarrjet e tjera që operojnë në tregun objekt hetimi; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Qendra Kombëtare e Biznesit; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Porti Detar Vlorë SHA; Portit Detar Shëngjin SHA; Autoriteti Portual Durrës.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

4. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
5. Referuar VKK nr. 804, datë 04.06.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve”, *treg përkatës të produktit do të konsiderojmë:*
 - *Tregun e ngarkim/shkarkimit dhe depozitimit të karburanteve në portet Porti Vlora 1 dhe Porto Romano Durrës;*
 - *Tregun e importit të karburanteve dhe të shitjes me shumicë të karburanteve për dy nëntregjet: nëntregu i produktit benzinë; nëntregu i produktit naftë (diesel).*
6. Ndërmarrjet nën hetim e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
7. Shërbimet e ngarkim- shkarkimit dhe depozitimit nëpërmjet rrugës detare ofrohen nga Porti Vlora -1 në Vlorë dhe Porto Romano në Durrës. Lidhur me mënyrën e funksionit të secilit port si dhe bazuar në marrëveshjet koncesionare, secili nga portet vlerësohet si treg përkatës gjeografik i veçantë.
8. Përsa i përket importit dhe tregimit me shumicë të karburanteve ndërmarrjet nën hetim zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.

II.2 Vlerësimi i pozitës dominuese

6. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 për sjellje të mundshme antikonkurruese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 9121/2003, përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
7. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit 9121/2003.
8. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: *pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve të blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes etj.; karakteristika të tjera të tregut përkatës.*
9. Ndërmarrjes PIA SHA, i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj, në portin Vlora-1, si dhe ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale të nevojshme në shërbim të terminalit bregdetar. Në bazë të kontratës Koncesionare, Koncesionari PIA SHA është i vetmi entitet, në të gjithë zonën e Gjirit të Vlorës (përfshirë zonën detare dhe platformat detare, nëse ka, të Gjirit të Vlorës), që do të lejohet të ndërtojë dhe të shfrytëzojë një terminal bregdetar dhe infrastrukturën e tij portuale, përfshirë këtu edhe platformat në det, si dhe i vetmi entitet i pajisur me të drejtën për të depozituar e trajtuar (ngarkim-shkarkim) (nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti) naftë, produkte të naftës, produkte të gazit të lëngshëm dhe produkte të tjera të lëngshme.
10. ***Në bazë të këtij koncesioni ndërmarrja PIA SHA zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të karburanteve në portin Vlora-1.***
11. Ndërmarrjes Romano Port i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës. Në bazë të këtij koncesioni Ndërmarrja Romano Port SHA ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, me kapacitet të kufizuar të përpunimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure, deri në 20.000 ton. Referuar ligjit nr. 9578, datë 11.7.2006, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”,

ratifikuar me ligjin nr. 9298, datë 28.10.2004”, Romano Port SHA operon me kapacitet 20.000 ton për naftën dhe 15.000 tonë për gazin e lëngshëm të naftës (GLN).

12. ***Në bazë të këtij koncesioni Romano Port SHA zotëron pozitë dominuese për kapacitetin deri në 20.000 ton në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburante në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***
13. Ndërmarrjes Porti MBM i është dhënë me koncesion e drejta ekskluzive për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë karburante të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, në Porto Romano Durrës.
14. ***Në bazë të këtij koncesioni Porti MBM zotëron pozitë dominuese për kapacitetin mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburante në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.***

II.3 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

15. Importi, depozitimi dhe ngarkim-shkarkimi i karburanteve në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet nëpërmjet 3 Konçensioneve në dy porte: Vlora - 1 dhe Porto Romano, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve koncesionare me: PIA SHA, Romano Port SHA dhe Porti MBM (Multy Buoy Mooring).
9. **Ndërmarrjes PIA SHA**, i është dhënë me koncesion ndërtimi dhe shfrytëzimi i terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj, në portin Vlora-1, si dhe ndërtimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturës portuale të nevojshme në shërbim të terminalit bregdetar. Në bazë të kontratës Koncesionare, ndërmarrja PIA SHA zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të karburanteve në portin Vlora-1.
10. Tarifat e shërbimeve portuale të aplikuara nga PIA SHA në Portin Vlora 1, janë miratuar me vendimin e OSHA nr. 4, datë 01.04.2010. Tarifat për ofrimin e shërbimit të depozitimit dhe trajtimit (ngarkim-shkarkimit) të anijeve me karburant, si dhe për shërbime të tjera tregtare që PIA SHA kryen për klientët që kanë kontraktuar kapacitete në terminalin PIA, vendosen me marrëveshje midis palëve kontraktuale, pasi nuk janë të miratuara paraprakisht nga OSHA në vendimin nr. 4/2010.
11. Për ofrimin e shërbimit të trajtimit (ngarkim-shkarkimit) dhe depozitimit të naftës dhe të nënprodukteve të saj, në portin Vlora-1 ku operon koncesionari PIA SHA, ndodhen 13 depozita për karburantet me kapacitet total përdorimi 68,400 m³. PIA SHA ka hyr në marrëdhënie kontraktore me operatorët e kualifikuar të interesuar për të operuar në këtë terminal lidhur me këto depozita. Gjatë periudhës hetimore PIA ka depozituar 7 (shtatë) kontrakta të lidhura ndër vite: 3 (tre) me shoqëri shqiptare dhe 4 (katër) me shoqëri të huaja.

12. Xhiro e PIA SHA për vitet financiare 2019 dhe 2020 janë përkatësisht XXX Lekë dhe XXX, ku rezulton me një fitim prej XXX lekë për vitin 2019 dhe për XXX për vitin 2020. PIA SHA rezulton me një normë fitimi rreth 20% për periudhën nën hetim duke patur parasysh dhe pozitën e saj si ndërmarrja e vetme koncesionare në portin e Vlorës.
13. Marrëveshjet e lidhura me shoqëritë shqiptare: Bankers Petroleum Albania Ltd; Everest OIL SHA dhe AIR BP Albania SHA, janë kontrata afatgjata me objekt depozitimin/magazinimin dhe trajtimin (ngarkim-shkarkimin) e produkteve të ndryshme hidrokarbure, konkretisht të: a) të produkteve të naftës krudo të papërpunuar, për ndërmarrjen Bankers; b) të produkteve të lëngshme të paambalazuara, Diesel 10 ppm dhe Benzinë, për ndërmarrjen Everest OIL SHA; si dhe c) produkteve të lëngshme të papërpunuara, produkti JET A1 (karburant për avion), për ndërmarrjen AIR BP Albania SHA. Këto janë kontrata afatgjata me kapacitete të dedikuara për depozitimin dhe trajtimin e produkteve të ndryshme, me të njëjtat kushte të përgjithshme, por me kushte të veçanta që variojnë për shkak të produkteve të ndryshme objekt depozitimi dhe trajtimi (si çmimet dhe garancitë financiare të lidhura me të), kushte këto të cilat janë vendosur bazuar në VKM nr. 110/2011.
14. Marrëveshjet e lidhura nga PIA SHA me shoqëritë e huaja që operojnë në magazinë të lirë doganore: NETSA SA, GUNVOR SA, ENI SPA (ENI) dhe INA-CRNA GORA d.o.o, janë kontrata individuale, afatgjata, me kapacitete të dedikuara për depozitimin dhe trajtimin e produkteve Diesel 10ppm dhe Benzinë, me çmime të ndryshme depozitimi dhe trajtimi, kushte këto të cilat janë vendosur bazuar në VKM nr. 110/2011.
15. Lidhur me interpretimin e këtyre kontratave, referuar VKM-së nr. 110/2011, pikës 1/ii), midis Palëve (OSHA dhe PIA SHA) është rënë dakord se standardi tip për ofrimin e këtyre shërbimeve është kontrata me afat për kapacitete të dedikuara, *edhe me afat të gjatë, si dhe duke siguruar nga klienti edhe garanci financiare ose një kontribut për investimet që do të kryhen nga PIA SHA*. PIA dhe klientët e saj janë gjithashtu, të lirë të negociojnë forma të tjera kontrate. OSHA-ja është dakord se *kontratat me afat janë thelbësore për të siguruar efikasitetin e investimit dhe furnizimin e rregullt të tregut*. Operatorët do të kontaktojnë PIA SHA drejtpërdrejt dhe kohë më parë në mënyrë të mjaftueshme për shërbimet e saj.
16. OSHA konfirmojnë të drejtat e plota të PIA SHA kundrejt operatorëve të kualifikuar¹, të interesuar për të operuar në terminal, duke e lejuar atë që të lidh kontrata me afate të gjata, si dhe të kërkojë garanci financiare ose kontribut për investimet nga këta operatorë.

¹ Sipas pikës 1/iii) të VKM nr. 110/2011, Operatorë të kualifikuar, nënkupton operatorë që kanë një qëndrueshmëri dhe organizim të përshtatshëm për të funksionuar me standardet e aplikueshme jo vetëm në lidhje me sigurinë dhe masat e shpëtimit, por edhe me planifikimin në kohë të operacioneve dhe furnizimeve, si dhe me besueshmërinë tregtare.

17. Gjithashtu, referuar pikës 1/iii) të VKM nr. 110/2011, jepet si shembull që PIA-ja *nuk duhet t'u shërbejë operatorëve që nuk vendosin garanci financiare të kënaqshme për PIA-n, që i kryejnë pagesat me vonesë ose që nuk i kryejnë fare ato, ose që kanë refuzuar të përmbushin kontratat e tyre në të kaluarën.*
18. Nga analiza e kontratave të lidhura nga PIA SHA me shoqëritë vendase dhe të huaja, për depozitim/magazinimin dhe trajtimin (ngarkim-shkarkimin) e karburanteve, rezulton se ato nuk përmbajnë kushte të padrejta tregtimi në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003. Kushtet e këtyre kontratave janë vendosur bazuar në VKM nr. 110/2011 dhe si të tilla vlerësohen si kushte të drejta tregtimi me palët.
19. **Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes PIA SHA gjatë periudhës hetimore është bazuar në VKM nr. 110/2011 dhe për pasojë nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.**
20. **Ndërmarrja Romano Port SHA**, në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit, ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, me kapacitet të kufizuar të përpunimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure, deri në 20.000 ton për naftën dhe 15.000 ton për gazin e lëngshëm të naftës (GLN). Në bazë të këtij koncesioni Romano Port SHA zotëron pozitë dominuese për kapacitetin deri në 20.000 ton në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburante në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.
21. Tarifatat e aplikuara për shërbimet portuale, ku përfshihen edhe tarifatat për ndarkim-shkarkimin e karburanteve, nga ndërmarrja Romano Port SHA, në portin Porto Romano, Durrës, janë miratuar me vendimin e OSHA nr. 3, datë 04.03.2009, vendimin nr. 6, datë 10.09.2009 dhe vendimin nr. 1, datë 09.06.2014.
22. Romano Port SHA funksionon në bazë të “Rregullores së funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë Romano Port”, miratuar me vendimin nr. 4, datë 27.04.2009 nga Organi Shtetëror i Autorizuar. Në nenin 5 të kësaj rregulloreje përcaktohen stanadartet teknike për akostimin e anijeve në platformë sipas madhësisë së anijes, të cilat variojnë nga 1.000 ton me zhytje 3.5 m deri në 40.000 ton me zhytje 11.5 m.
23. Referuar Kontratës Konkensionare, rezulton se Regullorja e Funksionimit ka tejkalur të drejtën ekskluzive që i është dhënë Koncesionarit Romano Port SHA për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure të madhësive deri në 20.000 ton, në Porto Romano Durrës, duke i lejuar atij, që të kryejë përpunimin e anijeve të madhësive edhe më të mëdha se 20.000 ton.
24. Xhiro e Romano Port SHA për vitet financiare 2019 dhe 2020 janë përkatësisht XXX Lekë dhe XXX Lekë, ku rezulton me një humbje prej XXX lekë ose 3.38 % për vitin 2019 dhe XXX ose 1.54% për vitin 2020.

25. Për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të anijeve me karburante, ndërmarrja koncesionare Romano-Port SHA ka hyrë në marrëdhënie juridike detyrimi me Agjencitë Detare/Spedicionere ose pritësin e mallit, pronarin e mallit (Operatorët Ekonomikë), nëpërmjet kontratës Tip, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me të njëjtat kushte të përgjithshme për nga objekti, qëllimi, mënyra e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me realizimin e shërbimit të ngarkim/shkarkimit të anijeve, si dhe kushtet e tjera të kontratës me të cilën operon ndërmarrja Romano-Port në Porto Romano, Durrës.
26. Në kontratë përcaktohet se Koncesionari Romano Port SHA për ofrimin e shërbimeve të përpunimit (ngrakim-shkarkimit) të anijeve me karburante, aplikon tarifat e miratuara nga OSHA me vendimin nr. 3, datë 04.03.2009, vendimin nr. 6, datë 10.09.2009 dhe vendimin nr. 1, datë 09.06.2014. Tarifat e papërcaktuara nga OSHA, negocohen me mirëkuptim mes palëve.
27. Kontratat e lidhura nga ndërmarrja Romano-Port me Operatorët Ekonomikë dhe Agjencitë Detare/Spedicionere nuk përcaktojnë çmime apo pagesa të tjera të ndryshme nga ato të miratuara nga OSHA në ngarkim të palëve, dhe të gjitha palët janë vendosur përballë kushteve të barabarta të ofrimit të shërbimeve portuale nga ana e Koncesionarit Romano-Port SHA.
28. **Për sa më sipër bazuar në sjelljen e ndërmarrjes Romano Port SHA në lidhje me vlerësimin e kontratave, tarifave të aplikura dhe fuqisë ekonomike dhe financiare në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, vlerësojmë se Romano Port SHA nuk ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg.**
29. **Ndërmarrja Porti MBM** në bazë të kontratës koncesionare (ligji nr. 104/2015, datë 23.9.2015) ka fituar të drejtën ekskluzive për përdorimin e portit dhe zotërimin e lirë të zonës (neni 32, pika 1/a), për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, në Porto Romano Durrës, për një periudhë prej 35 vjetësh. Në bazë të këtij koncesioni Porti MBM zotëron pozitë dominuese për kapacitetin mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra në tregun e ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburante në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës.
30. Tarifat për shërbimet portuale të Portit MBM, ku përfshihen edhe tarifat për ndarkim-shkarkim të karburanteve, janë të miratuara me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave nr. 5749/5 datë 10.9.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”.
31. Porti MBM funksionon në bazë të “Rregullores së funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë koncesionare MBM”, miratuar me vendimin nr. 1,

datë 03.05.2019 të MIE si Organi Shtetëror i Autorizuar. Në nenin 8 të kësaj rregulloreje përcaktohen standartet teknike për akostimin e anijeve në platformë sipas madhësisë së anijes, të cilat variojnë nga 1.000 ton me zhytje 3.5 m deri në 40.000 ton me zhytje 11.5 m.

32. Referuar Kontratës Koncesionare, rezulton se Regullorja e Funksionimit ka tejkalur të drejtën ekskluzive që i është dhënë Koncesionarit Porti MBM për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve që transportojnë karburante të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8(tetë) metra, në Porto Romano Durrës, duke i lejuar atij që të kryejë përpunimin e anijeve të madhësive edhe më të vogla se 20.000 ton.
33. Në projekt rregulloren e re të funksionimit të Portit MBM, iniciuar nga MIE në përmbushje të rekomandimeve të dhëna me VKK nr. 383, datë 17.11.2015, “Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”, *nuk bëhet përcaktimi i standarteve teknike për akostimin e anijeve sipas madhësisë së anijes, por kushtëzimi i vetëm për akostimin e anijeve në terminalin e hidrokarbureve është zhytja e anijes, kushtëzim ky i përcaktuar sipas kapaciteteve teknike infrastrukturore të Portit MBM në bashkëpunim me Kapitenerinë e Portit të Durrësit.*
34. Xhiro e Portit MBM për vitet financiare 2019 dhe 2020 janë përkatësisht XXX Lekë dhe XXX, me një fitim prej XXX ose 21.3% lekë për vitin 2019 dhe XXX lekë ose 22.34% për vitin 2020. Në vitet 2017 dhe 2018 Porti MBM ka rezultuar me humbje që përkon me periudhën e kryerjes së investimeve, pasi ndërmarrja ka filluar operimin në vitin 2019.
35. Për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të anijeve me hidrokarbure, ndërmarrja koncesionare Porti MBM ka hyrë në marëdhënie kontraktore me Agjencitë Detare/Spedicionere ose pritësin e mallit, pronarin e mallit (Operatorët Ekonomikë). Konkretisht gjatë periudhës hetimore Porti MBM ka lidhur 11 kontrata tip, nga të cilat 5 kontrata me Operatorët e tregut dhe 6 kontrata me Agjencitë Detare/Spedicionere. Këto janë kontrata Tip, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me të njëjtat kushte të përgjithshme për nga objekti, qëllimi, mënyra e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me realizimin e shërbimit të ngarkim/shkarkimit të anijeve, si dhe kushtet e tjera të kontratës me të cilën operon ndërmarrja Porti MBM në Porto Romano, Durrës.
36. Sipas kontartave për ofrimin e shërbimeve nga Koncesionari aplikohen tarifat e miratuara me Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE nr. 5749/5, datë 10.09.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”, të cilat ofrohen në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e

terminalit të Portit MBM. Tarifat e papërcaktuara në këtë udhëzim, negocohen me mirëkuptim mes palëve.

37. ***Kontratat tip të lidhura nga Porti MBM me operatorët dhe Agjencitë Detare/Spedicionere nuk përcaktojnë çmime apo pagesa të tjera të ndryshme nga ato të miratuara me udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE në ngarkim të palëve, dhe të gjitha palët janë vendosur përballë kushteve të barabarta të ofrimit të shërbimeve portuale nga ana e Koncesionarit Porti MBM.***
38. Përveç kontratave të mësipërme, ndërmarrja koncesionare Porti MBM ka lidhur një Akt-marrëveshje me ndërmarrjet: Kastrati Group SHA, Euro Tank SHA, Europetrol Durrës Albania SHA dhe Tenet SHA, e cila ka për objekt dhe qëllim dhënien e Autorizimit për Administrimin e Zonës së Lirë shoqërisë Koncesionare Portit MBM. Kjo akt-marrëveshje nuk përmban dispozita që mund të pengojnë, kufizojnë apo shtrembërojnë konkurrencën në treg, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërmat a), b), c), ç), d), si dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.
39. **Për sa më sipër bazuar në sjelljen e ndërmarrjes Porti MBM në lidhje me vlerësimin e kontratave, tarifave të aplikura dhe fuqisë ekonomike dhe financiare në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 vlerësojmë se Porti MBM nuk ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg.**
40. Tarifat e miratuara nga OSHA për ngarkim - shkarkimin e karburanteve si për Romano Port SHA dhe Portin MBM, në Porto Romano Durrës janë të njëjta. Përsa i përket tarifave të tjera portuale tarifatat maksimale janë të njëjta, por Porti MBM realizon disa shërbime të ndryshme nga Romano Port SHA për shkak të pozicionit të tij gjeografik dhe për këtë arsye ka disa zëra shtesë.
41. **Në lidhje me tregun e importit dhe shitjes me shumicë,** vihet re se pjesa më e madhe e karburanteve që importohen në vendin tonë është mbi 80% naftë dhe më pak se 20% benzinë. Pjesa më e madhe e importit të benzines dhe naftës, për periudhën nën hetim, kryhet nëpërmjet Portit të Durrësit (rreth 90% e importit) dhe një pjesë e vogël e importit realizohet nëpërmjet portit të Vlorës. Në tregun e importit të karburanteve operojnë një numër i madh ndërmarrjesh dhe tregu është i përqendruar, ku treguesi i përqëndrimit HHI ka ardhur në rënie gjatë periudhës hetimore.
42. Referuar sa më sipër, nuk konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve nën hetim në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve, por ndërmarrjet koncesionare, PIA SHA, Romano Port SHA dhe Porti MBM, të cilat kanë pozitë dominuese, kanë detyrim të veçantë për të mos abuzuar me pozitën dominuese që zotërojnë dhe të mos kryejnë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003. Në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003, OSHA (MIE, MFE) kanë detyrimin të zbatojë dispozitat e ligjit nr. 9121/2003 dhe të sigurojë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Mbylljen pa gjetje të procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

AUTORITETI I KONKURRENCĒS

